



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 25 MARS 2011

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
25. MARTA 2011. GODINE

MARS – MART
2011

E premte, 25.03. 2011, ora 10:00

Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuari kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
Konstatoj se në sallë janë prezentë 94 deputetë, andaj fillojmë me punime të mbledhjes plenare.

Ju njoftoj se në pajtim me nenin 15, paragrafi 3 dhe neni 42 i Rregullores së Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentar ka përgatitur dhe Kuvendit ia paraqet rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare.

Edhe pse jemi marrë vesh mos të flasim, i kemi tri paraqitje. Halit Krasniqi e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: I nderuar kryetar,
I nderuari kryeministër,
I respektuar Kabinet qeveritar,
Të nderuar e të respektuar kolegë deputetë,
Sot kemi një pikë të rëndësishme të rendit të ditës. Afër 75 mijë qytetarë të punësuar në institucionet publike drejtpërdrejt janë të lidhur me këtë temë, ndërsa rreth gjysmë milioni qytetarë në familjet e tyre do të kenë të hyra mujore më shumë dhe perspektivë më të mirë nga ky vendim që do të merret. Rrjedhimisht, edhe të gjitha ndërmarrjet e vogla e të mëdha do të kenë qarkullim më shumë dhe profit më të mirë dhe me këtë pjesë të ekonomisë janë të lidhura më se dhjetëra mijë qytetarë të Kosovës, të cilët gjithashtu presin me shumë interesim këtë temë.

Por, unë sot e shoh të arsyeshme të flas për një temë tjetër, jashtë rendit të ditës, por që është kryetëmë e ditës, është kryekapitull i jetës sonë në të kaluarën, në të tashmen dhe në të ardhmen. Është kryefjalë e sistemit tonë të vlerave të nëpërkëmbura, të cilat janë të vlerësuara, të çmuara në çdo kohë, dhe meridian të globit.

Të nderuar deputetë,
Ndër 12 mijë të vrarët gjatë luftës çlirimtare dhe 2500 dëshmorët, Malisheva ka dhënë 70 dëshmorë, 350 të vrarë civilë, nga këta - 60 femra, 14 fëmijë. 80 kanë qenë të rrëmbyer, që ne i quajmë të zhdukur, 40 janë të vrarë më vonë dhe janë gjetur nëpër varre masive në Kosovë dhe në Serbi dhe 40 nuk dihen fare se ku ndodhen. I di vetëm Beogradi zyrtarë. 250 të plagosur vuajnë në mënyrën e tyre, 52 nga këta janë femra, derisa 85% të fshatrave janë shkatërruar, 6.100 shtëpi të djegur.

Gjatë luftës në Bjeshkët dhe në vargmalet e Malishevës, janë strehuar mbi 250 mijë qytetarë të Malishevës dhe të komunave të tjera të Kosovës. Vetëm në vargmalet e bjeshkëve të Berishës janë strehuar 85 mijë qytetarë, ndërsa pjesa tjetër në Pagarushë, në Gurbardh, në Panorc, në Turjakë, në Burim, në Malet në mes të Sverkës dhe Damanekut, në malet e Bubavecit dhe të tjera vendbanime.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ju lutem, regjia, e zgjat një minutë fjalën. Ju e dini që kohën e keni të kufizuar...

HALIT KRASNIQI: Ju lutem, nuk zgjatem më shumë se 3 minuta, por edhe nja 2 minuta t'i kem!

Gjatë luftës në Bjeshkë dhe në vargmalet e Malishevës janë strehuar mbi 250 mijë qytetarë të Malishevës dhe të komunave të tjera të Kosovës. Vetëm në vargmalet e Bjeshkëve të Berishës janë strehuar 85 mijë qytetarë, ndërsa pjesa tjetër në Gurban, Turjakë, Burim, në malet mes Sverkës, Domanekut, malet e Bubavecit e në lokacione të tjera.

Gjatë luftës janë kryer tri masakra mizore nga forcat militare paramilitare serbe mbi civilët e pambrojtur, për të cilët asnjëherë nuk është përgjigjur askush. Masakra e Burimit më 31 mars 1999, në të cilën u vranë, u therën, u masakruan për së gjalli dhe për së vdekuri 34 civilë.

Më 27 shtator 1998, në Gullbovc u vranë, u therën u prenë në mënyrë barbare dhe duke u masakruar 13 civilë të pambrojtur. Më 27 gusht 1998, u vranë mizorisht 16 civilë dhe u plagosën 10-tëra të tjerë. Therjet me thika, tytat e automatikut deri në fyt e tortura tjera mesjetare, që zor se mund të përshkruhen realisht, me plotë trishtim dhe të paharrueshme që nga Gullboci, Burimi e deri në Bellanicë, në tërë anën e Llapushës.

Dita e arrestimeve të djemëve të UÇK-së, të gjitha këto kujtime të rënda i ka ringjallur te banoret e Malishevës. Të gjithë këta djem iu kishin përkushtuar shërimit të plagëve të luftës dhe ndërtimit të jetës së re, pa rënë ndesh asnjëherë me ligjet e shtetit të ri që po krijonim këto dhjetë vjet. Edhe më tepër i ka irrituar lajmi i dhënë në mediat elektronike me gjeneralitete të ish administratës serbe, që të jepnin idenë dhe ta krijonin bindjen se skenari është bërë në Beograd dhe është zbatuar me besnikëri nga EULEX-i.

(Nderprerje nga regjia)

KRYETARI: Vazhdojani edhe një minutë, pasi ky s'po di të ndalet!

HALIT KRASNIQI: Këto masakrat që i përmenda do të ishin më të mëdha dhe më të panumërta sikur mos të ishin atëherë pikërisht këta djem të armatosur dhe në uniformë të UÇK-së, të cilët janë burgosur tani. Këta djem, së bashku me shokët e tyre të informuar, penguan pikërisht ato personazhe me uniforma të ushtrisë dhe milicisë të Serbisë, për të cilët janë burgosur, se do të vazhdonin të masakronin civilë të paarmatosur, jo Brigada 121. Por asnjë brigadë e UÇK-së nuk ka shkelur ligjet e luftës, asnjëherë nuk ka kaluar në Serbi për të masakruar gra e fëmijë, për të dhunuar, ashtu siç bëri ushtria dhe milicia e Serbisë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Vetëm për këtë ngjarje ky parlament është dashur të takohet në një seancë të jashtëzakonshme me rend të ditës, - çfarë sistemi të vlerave po ndërtojmë, cili është misioni i EULEX-it, a është ky mision për shtetin juridik të së drejtës, sa është në shërbim të Serbisë ky mision dhe në shërbim të mandatit që ka? Ne e dimë se përmes ... të shteteve të cilat nuk kanë njohur Republikën e Kosovës, Serbia do të bëjë ndikimin e saj brenda EULEX-it. Qëllimet e Serbisë tani i njohim mirë, gjithashtu edhe strategjinë e saj për të ndëshkuar të gjitha personazhet e Luftës së UÇK-së, për të armiqësuar skenën politike dhe armiqësimin e shqiptarëve me misionet e bashkësisë ndërkombëtare. Qëllimin e parë, nuk ka mundur ta realizojë në masën e kërkuar dhe të dëshiruar prej saj, qëllimin e dytë e ka realizuar mjaft mirë. Ndërsa të tretin, kohë pas kohe, nëpërmes disa zhvillimeve e skenareve të cilët i kemi përvetësuar me naivitetin e pafalshëm. Lëvizje e radhës e skenareve të Beogradit zyrtar dhe të implementuar nga EULEX-i është edhe kjo valë e arrestimeve, nëse flasim me gjuhën juridike, do të thoshim me motive të dyshimta.

Të nderuar dhe të respektuar deputetë,

Seanca e jashtëzakonshme është dashur të mbajmë edhe vetëm për rastin e arrestimit të Drejtorit të policisë për regionin e Prizrenit. Jo pse është arrestuar, por për mënyrën e arrestimit. Duke mos respektuar autoritetet e larta zyrtare të shtetit tonë dhe duke dashur të bëj spektakël gjatë arrestimeve, misioni i EULEX-it, atë ditë ka rrezikuar jetën e policëve duke krijuar motive për konfrontim me armë të drejtuara njëri kundër tjetrit, dy skuadra policie të të njëjtit shtet. Unë kam besim të plotë në deklaratat e Ministrit Rexhepi, por ai duhet të kërkoj përgjegjësi nga dy drejtorët e tij në Prishtinë, të papërgjeshëm plotësisht, të cilët kanë rrezikuar jetët e policëve të tyre dhe imazhin e shtetit, pa dijeninë e të cilëve në asnjë mënyrë nuk ka mundur të zhvillohet operacioni.

Të nderuar dhe të respektuar kolegë deputetë,

Seanca e jashtëzakonshme është dashur të mbahet patjetër edhe për një zhvillim tjetër në këtë ditë. Ka ndodhur një precedent tjetër edhe më i rëndë, ndaj të cilit nuk do të duhej të ishte kaq indiferent ky parlament. Në këtë ditë është shkelur akti themeltar i këtij shteti. Është shkelur Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Duke e ndalur në bisedë, deputetin Fatmir Limaj, në ndërtesën e EULEX-it për mëse dy orë, janë përdhosë vlerat më sublimë të këtij shteti të prodhuara nga ky institucion më i lartë shtetëror. Çfarë kuptimi ka përmbajtja e kushtetutes nëse ne lejojmë që ajo të shkelet para syve tanë. Çka ka të shenjtë tani këtu dhe çka ka të paprekshme? Secili prej nesh e, edhe deputeti Fatmir Limaj, nuk mund t'i ikë përgjegjësisë nga ligji, eventualisht po të gjendet ndonjë fakt se ka rënë ndesh me të. Por, Kushtetuta e përshkruan qartë, kur dhe si. Këtë e ka bërë logjika juridike dhe eksperiencia në shtetet ligjore të së drejtës, duke njohur shembuj abuziv dhe zyrtar abuzues, si prokurori i historisë së trilluar të 80 milionëve. Duke kujtuar këtë histori për Deputetin Fatmir Limaj, çdo ndjekje, jo për motive nga lufta e UÇK-së, por për çfarëdo motivesh tjera, e bën të pabesueshëm për publikun edhe kur verdikti të bëhet i plotfuqishëm nga instancat kompetente.

Edhe më të dyshimta dhe më trishtuese i bën këto arrestime koha kur këto veprime janë bërë. Lënda, thuhet se është e para 12 viteve. Në këtë kohë kur është hapur kapitulli i bisedimeve me Serbinë, pse u vendos pikërisht tani në këto zhvillime- të urdhërohen arrestimet. Edhe më të dyshimtë, edhe më të dhimbshëm e bën fakti se kriminelët e shumtë,

që i ka Serbia edhe në pozita të ndryshme lokale, nuk është ndërmarrë ndonjë fushatë ndaj tyre. Edhe më të dyshimtë e bën procesin, fakti i tolerimit të kriminelëve të njohur të cilët livadhisin brenda kufijve të Kosovës, përkatësisht në veri të saj, para syve të personelit të EULEX-it dhe para syve të publikut.

Këtu në këtë foltore, për EULEX-in paraqes një kërkesë: Lironi nga burgu djemt e lirisë dhe burgosni zyrtarë serbë dhe të tjerë që ushtruan dhunë e terror të asaj përmase trishtuese, saqë e lëvizi gjithë ndërgjegjen botërore dhe mobilizoi tërë atë potencial njerëzor, gjithë atë teknikë e teknologji luftarake nga toka, nga uji dhe nga ajri, të cilin nuk e kishte parë ky kontinent! Ju falënderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Ju e dini që temat të cilat mund të ngrihen janë deri në 3 minuta, për rend të ditës - 2 minuta. Nëse keni kërkesa, si grupe parlamentare, për të futur një temë si të jashtëzakonshme, e keni në Rregullore, respektoni rregulloren, respektoni të drejtën e juaj një çështje ta shtini në rend të ditës, dihen format dhe kisha kërkuar që realisht asnjë çështje të mos shtrohet jashtë rendit të ditës! Tema të tilla mund të kërkohen dhe të futen në rend të ditës, por ekziston procedura se si bëhen kërkesat.

Fjalën e ka deputeti dhe nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë, vërtet u paraqita të them që po shkelet Rregullorja e Punës së Parlamentit, të cilën ju u përpoqët tash në vazhdim faktikisht ta arsyetoni, por në rast se Kryesia, në bashkëpunim me grupet parlamentare ka diskutuar gjerë e gjatë dhe është marrë vesh që, meqë ekziston një pikë e rëndësisë së veçantë të rendit të ditës, mos të ketë deklarime të lira, të mos ketë pyetje parlamentare, është dashur t'u thuhet këtyre njerëzve këtu që jemi marrë vesh të mos ketë. Natyrisht, është e drejta e deputetëve që një çështje urgjente ta paraqesin. Unë u përpoqa ta dëgjoj diskutuesin, ai s'paraqiti çështje urgjente, po e bëri një diskutim të lirë. Ju lus, zoti kryetar, t'i drejtoheni Kuvendit - a do të punojmë me rendin e ditës që e kemi marrë, të bërë përmes Kryesisë dhe grupeve parlamentare, a jo? Përndryshe, ne po rrëshqasim në diçka që s'është në rend dite. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Pasi veç hymë në këtë rend të ditës, unë s'po dua t'ia lë vetëm Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike ta thotë fjalën e vet. Për fjalë i kemi edhe 2 deputetë të lajmëruar: Gëzim Kelmendin dhe Liburn Aliun. Vetëm ju lutem, ta respektoni kohën, i keni 2 minuta. Pas 2 minutave duhet ta ndërprisni fjalën dhe të shkoni në vend!

GËZIM KELMENDI: I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuari kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra,

Kolegë deputetë të nderuar,

Shteti ynë i ri i Kosovës, pas shpalljes së pavarësisë dhe sot e kësaj dite vazhdon të kalojë nëpër sfida dhe vështirësi të ndryshme. Kjo periudhë e tranzicionit pa dyshim që është një periudhë mjaftë e vështirë dhe me natyrë mjaftë komplekse, prandaj kërkon angazhim dhe përkushtim maksimal të gjithë faktorit politik dhe të qytetarëve të Kosovës në përgjithësi

Jemi një shtet i cili si prioritet ka integrimin në Bashkim Evropian dhe në strukturat veriatlantike dhe pa dyshim që angazhohemi për marrëdhënie të mira dhe qeverisje me shtetet fqinje, si Shqipërinë, Maqedoninë, Malin e Zi dhe Serbinë. Megjithatë, pas shpalljes së pavarësisë shteti ynë i Kosovës po ballafaqohet edhe me një problem mjaftë serioz. Vonesat në caktimin e vijave të demarkacionit të kufijve të Kosovës kanë shkaktuar dhe po shkaktojnë vazhdimisht probleme. Në kohët e fundit pjesa perëndimore e Kosovës është duke u ballafaquar me një problem të tillë. Siç e dimë të gjithë, vitin e kaluar në aksin rrugor Pejë - Kullë – Rozhajë, në kufirin me Malin e Zi autoritetet malazeze kanë hyrë në territorin e Kosovës për 5 kilometra. Patëm pasur reagim të menjëhershme të popullatës të asaj ane dhe të kryetarit të komunës së Pejës, më pas ka qenë edhe reagimi nga ministri aktual, dr Bajram Rexhepi, i Punëve të Brendshme, dhe situata pak se është stabilizuar. Për këtë të gjithë jemi të njoftuar, por çka është kryesorja që sot desha ta paraqes këtu, se kjo nuk ka të ndalur nga shteti ynë fqinj. Në kohë të fundit është paraqitur problemi në kufirin tjetër, në aksin rrugor Pejë – Çakor – Andrijevicë, ku autoritetet malazeze kanë cenuar integritetin territorial të Kosovës. Qytetarët e asaj ane janë tejet të alarmuar dhe të shqetësuar. Kanë dërguar peticion dhe ankesë në komunën e Pejës, por megjithatë duke pasur parasysh se përgjigja e tyre ka qenë se kjo është kompetencë e Qeverisë, atëherë nuk ka mund të realizohet kërkesa e tyre.

Njëherësh, unë si përfaqësues i qytetarëve të Republikës së Kosovës, deputet nga Partia e Drejtësisë në Kuvendin e Kosovës shpreh shqetësimin tim të thellë për një çështje tejet të rëndësishme dhe vitale për çështjen e Kosovës. Kërkoj nga institucionet e Kosovës, konkretisht nga Ministria e Punëve ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit!
Liburn Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: Meqë 2 minuta ne kishim llogaritur fillimisht që do të mund të kemi rast për ta pasur fjalën, por po vazhdoj pra shpejt.

Desha të lidhem me çështjen e arrestimit të ish ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, si dhe me fletarrestim për deputetin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, zotin Fatmir Limaj.

Dua të them që kjo që po ndodhë, ky turp që po ndodhë, do të ndodhë edhe në vazhdim vazhdimisht pasi këto janë pasoja, pasoja që do të përsëriten dhe janë përsëritur vazhdimisht deri më sot. Këto pasoja, kjo rrugë kështu do të vazhdojë përderisa të mos eliminojmë shkaktarin, e në këtë rast shkaktari është vetë humbja e substancës së rrugës që Ushtria Çlirimtare e ka nisur më vonë nga politika. Pra, kur heq dorë nga e kaluara, të ardhmen ta përcaktojnë të tjerët dhe, rrjedhimisht, ne sot duhet t'i kundërvihemi Kushtetutës së Republikës së Kosovës, pakos së Ahtisarit, duhet ta ndryshojmë aty se pa e ndryshuar kushtetutën, gjëra të tilla, pra që ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

dhe të gjithë ata që kontribuuan për lirinë e Kosovës, do të arrijnë, kështu do të vazhdojnë të persekutohen dhe këto pasoja do të jenë të vazhdueshme përderisa të mos e eliminojmë, pra, shkaktarin. Kaq.

KRYETARI: Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

Përsëri ju kisha lutur që disa çështje mos i harxhoni për dy minuta. Në rend dite kemi:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare, të mbajtura më 7 dhe 10 mars 2011

Të nderuar deputetë,

Pyes, nëse keni vërejtje në këto procesverbale?

Fjalën e ka deputeti Arsim Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuari zoti kryetar!

Vërejtjet e mia kanë të bëjnë me procesverbalin e datës 10 dhe kanë të bëjnë me pikën e miratimit të vendimit për themelimin dhe përbërjen e komisioneve parlamentare, e cila pikë është proceduar bashkë me pikën për ndryshimin e rregullores.

Vërtet është përcjellë një vendim, i cili s'ka qenë i plotë, sepse kanë munguar emrat e anëtarëve të Partisë Demokratike dhe të Aleancës Kosova e Re. Më vonë ato janë dhënë me shkrim dhe pastaj kam kuptuar se emri im figuron si zëvnedëskryesues i parë i Komisionit Legjislativ. Për shkaqe parimore, për shkak se dy partitë kryesore - Partia Demokratike dhe Lidhja Demokratike nuk kanë respektuar kriterin profesional, por politik, deklaroj se heq dorë nga kjo pozitë dhe do të vazhdoj të punoj në këtë komision në cilësinë e anëtarit të thjeshtë.

KRYETARI: Faleminderit!

Do të thotë, grupi parlamentar e njofton Kuvendin për këtë çështje.

Vazhdojmë. Fjalën e ka deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, zoti kryetar!

E kam një vërejtje, e cila vije nga mënyra se si është shkruar Procesverbali i mbledhjes plenare të mbajtur më 7 mars, në mbledhjen ku është diskutuar nëse negociatat me Serbinë duhet të vazhdojnë apo jo. Ne e dimë që ajo mbledhje ka qenë një prej mbledhjeve më të gjata të kësaj legjislature dhe, rrjedhimisht, ka pasur më së shumti diskutime dhe mospajtime në mes deputetëve të ndryshëm. Ndërkohë, në procesverbal kjo mbledhje nuk është reflektuar. Pra, procesverbali i kësaj mbledhje është i përmbledhur në jo më shumë se tri faqe e gjysmë, ndërkohë që procesverbali i mbledhjes së 10 marsit, e cila ka qenë një mbledhje shumë më e shkurtër dhe shumë me më pak debate, është i përmbledhur në 8 faqe.

Në procesverbalin e mbledhjes së 7 marsit janë paraqitur shkurtimisht ato që kanë thënë kryetarët e grupeve parlamentare, ndërkohë që të gjitha debatet tjera janë reduktuar në një

paragraf, ku thuhet që opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë pikë të renditë të ditës kanë dhënë edhe deputetët dhe pastaj është lista e emrave të deputetëve.

Ne konsiderojmë që këto nuk kanë qenë opinione, vërejtje dhe sugjerime, mirëpo kanë qenë pjesë të një debati të nxehtë politik për një çështje shumë të rëndësishme dhe madhore për Kosovën dhe ka pasur mospajtime diametralisht të kundërta me pozicionin e Qeverisë. Ndërkohë që ky paragraf këtu nuk e reflekton në asnjë mënyrë atë që ka ndodhur në atë seancë.

Prandaj, konsiderojmë që ky procesverbal nuk është procesverbal që na tregon neve dhe do t'iu tregojë gjeneratave të ardhshme se çka ka ndodhur në atë seancë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Për sqarim, edhe të tuajin, edhe të opinionit, procesverbali, pse është njëri më i shkurtër dhe tjetri më i gjatë, mendoj që vetë natyra e procesverbalit të datës së 10 marsit është tjetër dhe e ka kushtëzuar numerikisht të jetë më i madh sepse janë emrat e komisioneve dhe të deputetëve të komisioneve. Megjithatë, se si është zhvilluar debati, janë stenogramet dhe ato janë publike. Në stenogramet prezantohet i gjithë debati që është thanë, procesverbalet janë përmbledhje. Diçka tjetër nuk kemi.

Atëherë konstatoj se Kuvendi miratoi procesverbalet e mbledhjeve të 7 dhe 10 marsit.

Pika e dytë e rendit të ditës:

2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011,

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim, në parim, të këtij projektligji.

Ftoj kryeministrin, zotin Hashim Thaçi, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektbuxhetin për vitin 2011.

Zoti kryeministër, e ke fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Parlamentit, zoti Krasniqi!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Zonja dhe zotërinj,

Kam kënaqësinë e veçantë që sot para jush të prezantoj Projektbuxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011.

Ju, me siguri se tashmë e keni lexuar Projektbuxhetin për vitin 2011, të cilin e keni në duart tuaja dhe me siguri i keni krijuar opinionet apo edhe qëndrimet tuaja të respektuara lidhur me projektbuxhetin.

Unë sot do të prezantoj para jush, të nderuar deputetë, dhe përpara qytetarëve të Republikës së Kosovës një përmbledhje të përpjekjeve dhe të punës serioze të të gjitha institucioneve qeverisëse të Republikës së Kosovës në përgatitjen e këtij projektbuxheti.

Ekspertë të shumtë vendorë dhe ndërkombëtarë kanë punuar palodhshëm nën udhëheqjen e Ministrisë së Financave dhe janë përkujdesur që kërkesat dhe nevojat e të gjithë pjesëmarrësve në procesin buxhetor të bashkërendohen dhe të harmonizohen mirë.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni t'ju falënderoj në emrin tim dhe të qeverisë për mundësinë që e keni krijuar të gjitha grupet parlamentare, pozitë dhe opozitë, që ministri i Financave, në secilin grup parlamentar veç e veç ta prezantojë, të diskutojë, të sqarojë, por edhe t'u përgjigjet pyetjeve tuaja legjitime.

Kjo punë e madhe është bërë me qëllim që të përgatitet një projekt-buxhet i balancuar, që adreson kërkesat e qytetarëve dhe që është në përputhshmëri me strukturën e deritashme të politikave të kujdesshme zhvillimore të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Hartimi i buxhetit paraqet një ndër punët më sfiduese për qeveritë e secilit vend dhe një gjë e tillë është e kuptueshme për faktin se nevojat e qytetarëve dhe dëshirat për të bërë më shumë për vendin janë më të mëdha sesa mundësitë dhe potenciali në dispozicion.

Nga ana jonë, ne kemi bërë çdo gjë që në kuadër të mundësive tona në këtë projekt-buxhet të adresojmë nevojat e të gjithë qytetarëve të vendit tonë. Po ashtu, ne jemi përkujdesur seriozisht që të kemi rezervë adekuate buxhetore për t'u ballafaquar me situata të papritura.

Qeveria e Republikës së Kosovës është shumë e vetëdijshme për modelet që kemi adaptuar.

Ne jemi të vetëdijshëm se duke përkrahur dhe fuqizuar modelin e ekonomisë së hapur të tregut të lirë, përgjegjësia për çdo veprim të ndërmarrë përmes politikës fiskale është shumë e madhe.

Çdo shpenzim më i lartë kërkon më shumë punë nga ana jonë për t'u kujdesur se një veprim i tillë është i matur dhe rezulton me përfitime ekonomike e përmirësim të mirëqenies së qytetarit.

Për më shumë, ne jemi kujdesur që çdo iniciativë e re fiskale të mos rezultojë me një barrë të rënduar taksash për qytetarët tanë.

Ne vazhdojmë të mbetemi të përkushtuar që për shumën e njëjtë financiare, me të cilën qytetari i Kosovës i kontribuon buxhetit të Qeverisë së tij duke paguar rregullisht tatimet

e parapara me ligj, ne si qeveri jemi duke punuar që t'i ofrojmë qytetarit çdo vit mirëqenie më të mirë dhe shërbime më cilësore.

Kosova nuk është shtet i izoluar dhe as ekonomia jonë nuk është e izoluar, dhe si e tillë ndikohet vazhdimisht nga ambienti i jashtëm ekonomik, andaj edhe politikat e reflektuara në Projekt buxhetin e vitit 2011 janë hartuar duke marrë në konsideratë përparësitë dhe rreziqet që sjell ky model ekonomik.

Por, mbi të gjitha, të nderuar deputetë, politikat ekonomike të Qeverisë së Republikës së Kosovës janë hartuar duke pasur gjithmonë parasysh nevojën për përshtatjen e ambientit ekonomik të vendit tonë me standardet e nevojshme për anëtarësimin në Bashkimin Evropian, në pajtueshmëri me vullnetin e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Të nderuar deputetë,
Zonja dhe zotërinj,

Rrethanat politike të krijuara në fund të vitit 2010, na pamundësuan që në harmoni me obligimet ligjore ta procedojmë këtë dokument në Qeveri dhe në Parlament para mbylljes së vitit 2010.

Unë, sot nuk dua të merrem me ngjarjet që krijuan një situatë të tillë, mirëpo sot dua t'ju ftoj të gjithë juve, të nderuar deputetë, që me përgjegjësinë më të lartë ta analizojmë dhe diskutojmë këtë projekt-buxhet vetëm mbi bazën e argumenteve të arsyeshme dhe propozimeve konkrete, të cilat mund ta përmirësojnë projektbuxhetin.

Ky projekt-buxhet është reflektim i Programit të Qeverisë së Republikës së Kosovës që ka për synim krijimin e kushteve për rritje të qëndrueshme ekonomike dhe për përmirësimin e mirëqenies së të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Gjithashtu, duhet theksuar se ky buxhet është diskutuar deri në detaje me Fondin Monetar Ndërkombëtar, si dhe me Komisionin Evropian, me të cilët janë harmonizuar pjesa më e madhe e gjërave dhe linjave buxhetore.

Këto diskutime po vazhdojnë ende me qëllimin e vetëm që Kosova të mbetet pjesë e Programit të FMN-së dhe, natyrisht, të përfitojë grandet financiare të premtuara.

Diskutimet me FMN-në janë shumë serioze dhe po zhvillohen mbi bazën e argumenteve reciproke dhe do të vazhdojnë edhe në të ardhmen.

Dua t'ju sqaroj juve, të nderuar deputetë, dhe të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës se Qeveria e Kosovës ka partneritet me institucionet financiare ndërkombëtare, duke përfshirë bashkëpunimin e ngushtë edhe me FMN-në.

Bisedat me FMN-në janë në proces e sipër dhe janë zgjatur për shkak se ne jemi të bindur se masat të cilat i kemi ndërmarrë në zbatim të vendimit për ngritje pagash janë të besueshme, janë reale dhe ne jemi në gjendje t'i realizojmë këto masa, ashtu siç i kemi

prezantuar gjatë negociatave me këto institucione dhe ashtu siç edhe planifikohet në këtë projekt-buxhet.

Unë jam i bindur se argumentet tona janë duke u analizuar në mënyrë shumë serioze nga FMN-ja dhe se i tërë ky proces do të përmbyllet me sukses, sepse Qeveria e Republikës së Kosovës është e përgjegjshme për obligimet që ka në kuadër të Programit të FMN-së dhe natyrisht që do të punohet dhe do të vazhdohet që të mbetemi pjesë e këtij programi.

Sido që të jetë, kjo çështje është një sfidë të cilën unë, si kryeministër, së bashku me Kabinetin tim, jemi të gatshëm ta pranojmë me aprovimin e këtij projektbuxheti, por edhe përmes kontributit tuaj të vazhdueshëm në implementimin e politikave ekonomike për vendin tonë.

Të nderuar deputetë,
Zonja dhe zotërinj,

Të dhënat aktuale dëshmojnë se ekonomia jonë, edhe përkundër tronditjeve në tregjet ndërkombëtare, ka arritur të gjenerojë një rritje reale ekonomike mbi 4.% gjatë vitit 2010, ndërsa për vitin 2011, departamentet e specializuara brenda institucioneve tona parashohin një rritje reale ekonomike prej 5.3%.

Në anën tjetër, Fondi Monetar Ndërkombëtar doli rishtazi me një parashikim edhe më optimist për një rritje reale të Bruto Prodhimit Vendor prej 5.5%.

Një rritje e tillë ekonomike në masë të madhe pritet të vije nga rritja e konsumit, rritja e investimeve dhe ajo e eksporteve.

Kontributi i rritjes së këtyre komponentëve plotësohet po ashtu edhe nga përkrahja e ekonomisë së Kosovës nga remitancat e bashkatdhetarëve, si dhe nga investimet nga jashtë.

Në planin afatmesëm 2011-2013, kontributi relativ i konsumit pritet të zvogëlohet, ndërsa ai i investimeve dhe eksporteve pritet të prijë në rritjen reale ekonomike.

Me vëmendje kemi ndjekur edhe lëvizjet e çmimeve të importit dhe për shkak të lëvizjes së tyre neve na është dashur të jemi edhe më të kujdesshëm në parashikimet tona për rritjen reale ekonomike.

Gjithsesi, unë e rikonfirmoj pozicionin tonë pro tregut të lirë, por zëshëm e ritheksoj gjithashtu se institucionet përgjegjëse e kanë përkrahjen time të plotë për parandalimin e veprimeve spekulative apo koordinimit monopolist në dëm të qytetarit të Kosovës.

Ekonomia jonë arriti që ta tejkalojë mirë krizën ekonomike globale, dhe tani mund të vjelë rezultate të mira nga mundësitë që vijnë nga rimëkëmbja e ambientit të jashtëm ekonomik.

Këtë e tregojnë edhe projeksionet afatmesme, që flasin se jo vetëm në vitin 2011, por edhe në vitet në vijim Kosova mund të zhvillohet me një normë reale prej mbi 5%.

Unë dhe Kabineti im do të jemi vazhdimisht aktivë që të mundësojmë shfrytëzimin e një potenciali të tillë dhe në asnjë mënyrë nuk do të lejojmë që qytetarëve tanë t'u mohohet kjo mundësi.

Buxheti i vitit 2011, është punuar mbi analizën e këtyre zhvillimeve, si dhe është formuluar në funksion të rritjes ekonomike të vendit.

Ky buxhet ka për synim ruajtjen e qëndrueshmërisë makro-fiskale të vendit, duke siguruar të hyra buxhetore në vlerë prej 1,264.000.000 milionë euro (një miliard e dyqind e gjashtëdhjetë e katër milion euro), të hyra këto 12% më të larta se të hyrat e vitit të kaluar.

Shpenzimet buxhetore janë planifikuar të arrijnë nivelin prej 1,434.000.000 milionë euro (një miliard e katërqind e tridhjetë e katër milion euro), apo rreth 19% më të larta në krahasim me vitin e kaluar.

Kjo rritje e shpenzimeve në masë të madhe i atribuohet investimeve kapitale madhore, siç është autostrada Vërmicë – Merdare, autostrada “Ibrahim Rugova”, pastaj investimeve tjera infrastrukturore, siç janë rrugët Prishtinë–Pejë, Prishtinë–Mitrovicë, ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve, urave, ndërtimi dhe rehabilitimi i objekteve shkollore, spitaleve, qendrave të mjekësisë familjare dhe shumë projekteve tjera me rëndësi vitale për shtetin dhe qytetarët tanë.

Kategoria e pagave dhe mëditjeve po ashtu paraqet një pjesë të rëndësishme të këtij buxheti, duke mundësuar kështu realizimin e plotë të vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ngritjen e pagave të mësuesve, personelit shëndetësor, shërbyesve civilë, të gjithë policëve, pjesëtarëve të FSK-së, doganierëve, inspektorëve tatimorë, zjarrfikësve dhe kategorive tjera të cekura në vendim të qeverisë.

Gjithashtu, kategoria e subvencioneve dhe transfereve ka pësuar një rritje të ndjeshme, duke reflektuar kështu ngritjen e mbështetjes për pagat për të gjithë invalidët e Luftës së UÇK-së dhe familjeve të dëshmorëve, sipas vendimit të qeverisë.

Po ashtu, në këtë buxhet janë planifikuar mjetet për ngritjen e pensioneve dhe përfitimeve për të gjitha shtresat sociale, në harmoni me ligjin, i cili pritet shumë shpejtë të procedohet në Kuvend, për miratim.

Lidhur me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për një rritje të pagave në sektorët kryesorë të shtetit tonë, ka pasur diskutime të ndryshme, të cilat shpeshherë përveç kritikës qëllim-mirë dhe korrektuese, kanë bartur me vete edhe tone kundërshtuese për qëllime politike.

Të nderuar deputetë,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Kosova është shtet i ri, i mundësive shumë të mëdha, por nga pasojat e së kaluarës, për fat të keq, vazhdon të mbetet vendi më i varfër në Evropë, me buxhetin më të vogël në Evropë, me përqindjen më të lartë të të papunëve, me standardin më të ulët dhe pagat më të ulëta në Evropë.

Të nderuar deputetë,
Të nderuar qytetarë,
Këtë prapambetje shekullore duhet tejkalojmë. Këtë trend duhet dhe mund ta ndalim bashkërisht.

Unë sot dua të sqaroj edhe një herë se vendimi për rritjen e pagave, i marrë në janar të vitit 2011, ndoshta ka qenë një ndër vendimet e mia më të vështira për t'u ndërmarrë, mirëpo njëkohësisht ai ka qenë një vendim i domosdoshëm, i arsyeshëm dhe shumë i përgjegjshëm, duke pasur parasysh gjendjen e rëndë socio-ekonomike në vend.

Ne si liderë apo njerëz të politikës definitivisht duhet ta instalojmë njëherë e përgjithmonë standardin e realizimit të premtimit para qytetarëve.

Ju, të nderuar përfaqësues të zgjedhur drejtpërsëdrejti nga qytetarët e Kosovës, e dini shumë mirë, ashtu siç e di edhe unë, se standardi i jetesës në Kosovë ka qenë dhe vazhdon të mbetet më i ultë në Evropë.

Pagat minimale ekzistuese në sektorët kyç të shtetit tonë nuk garantojnë shërbime cilësore dhe administratë funksionale shtetërore në shërbim të qytetarëve të Kosovës.

Unë kam dashur që ta ndryshoj këtë gjendje të rëndë të qytetarëve tanë, prandaj vendimi është në shërbim të ndryshimit të kësaj gjendjeje.

Unë dhe Qeveria e Kosovës nuk mund të lejojmë që dinjiteti njerëzor dhe intelektual e profesional i mjekëve, mësuesve, policëve, zjarrfikësve, doganierëve, inspektorëve tatimorë, shërbyesve civilë, i familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës, të nëpërkëmbet edhe më tutje.

E kam theksuar dhe e ritheksoj fuqishëm: - punëtoria kosovare nuk ka pasur paga, deri më tani është shërbyer, mund të themi, me ndihma sociale, prandaj ne të gjithë bashkërisht duhet ta ndryshojmë këtë gjendje, dhe ju ftoj.

Vendimi i Qeverisë pra synon t'i jap fund kësaj gjendje, ta përmbyll këtë gjendje dhe unë e di se me këtë rritje të ndjeshme të pagave, standardi jetësor do të ndryshoj për të mirë jo vetëm për ata punonjës të cilët përfitojnë drejtpërsëdrejti nga kjo rritje, por kjo do të rezultojë në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për të gjithë qytetarët tanë.

Unë jam krenar që e kam marrë një vendim të tillë dhe jam më se i sigurt në mbështetjen tuaj për rritjen e pagave.

Sot nuk do të dëshiroja as unë, e askush në Kosovë, që të shoh ndarje në baza partiake rreth rritjes së pagave.

Ju ftoj të gjithëve, pa dallime partiake, të ngriheni mbi motivet e ngushta partiake, në favor të mbështetjes së vendimit të qeverisë për rritjen e pagave.

Mësuesit, policët, shërbyesit civilë, punëtorët shëndetësorë, pjesëtarët e FSK-së, doganierët, zjarrfikësit, minatorët, pensionistët, invalidët e luftës dhe familjet e dëshmoreve nuk i përkasin kësaj apo asaj partie. Ata janë njerëzit e nderuar e të respektuar të Kosovës, për ta kemi përgjegjësi të gjithë.

Është e vërtetë, vendimi është imi dhe i Qeverisë, i kabinetit që e udhëheq, por të mirat do t'i gëzojnë të gjithë qytetarët e Kosovës. Vendimi nuk ka qenë i lehtë, ka qenë jashtëzakonisht i rëndë për t'u marrë. Prandaj, unë ju ftoj të gjithëve të mbështesni këtë vendim për t'u implementuar. Mbështetja juaj e ndihmon qeverinë për ta implementuar sa më shpejt këtë vendim të domosdoshëm, të arsyeshëm dhe shumë të përgjegjshëm shtetëror dhe qytetar.

Vendimi im për rritjen e pagave-buron nga nevojat dhe gjendja e punëtorëve të Kosovës, e jo nga asnjë motiv apo ego politike.

Prandaj, sot, kur sytë dhe mendja e qytetarëve të Kosovës janë të drejtuar kah ne, ju me votën tuaj pro këtij projektbuxheti mund t'iu dëshmoni atyre përkushtimin tuaj për ta përmirësuar mirëqenien e tyre sociale, si të zgjedhurit e tyre.

Të nderuar deputetë,
Zonja dhe zotërinj,

Në përgjithësi është ruajtur roli i buxhetit, si mjet për përmirësimin e ambientit ekonomik, në pajtueshmëri me nevojat zhvillimore.

Struktura e projektbuxhetit sërish dominohet nga shpenzimet kapitale, të cilat kanë një pjesëmarrje prej 40%, ndërsa të gjitha kategoritë tjera janë më të ulëta.

Rritja e Buxhetit është bërë në harmoni me rritjen e aktivitetit të përgjithshëm ekonomik, andaj edhe të hyrat e përgjithshme buxhetore do të kenë një pjesëmarrje prej 27% në tërë Bruto Prodhimin Vendor, çka edhe na bën një nga Qeveritë që rëndojnë më së paku ekonominë e tyre në rajon.

Të nderuar deputetë,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Zonja dhe zotërinj,

Rruga jonë drejt zhvillimit ekonomik dhe arritjes së standardeve të jetesës evropiane nuk është e lehtë. Nuk është vetëm rrugë e vullnetit të mirë, e as rrugë që mund ta bëjmë vetë, si një individ, si një parti, apo si një institucion.

Rruga drejt një zhvillimi ekonomik që do t'iu mundësojë qytetarëve të Kosovës të ardhura dhe jetë të njëjtë me atë të qytetarëve nga shtetet e zhvilluara, është rrugë e vendimeve të menduara mirë, e vendimeve të guximshme dhe e vendimeve të besueshme, që sjell besim, shpresë dhe optimizëm për jetë më të mirë për qytetarët tanë.

Me përkrahjen e Buxhetit për vitin 2011, ne bashkërisht do të marrim vendime të tilla, të menduara, të guximshme, dhe të besueshme, vendime këto që mundësojnë një të ardhme më të mirë ekonomike për Republikën e Kosovës.

Duke iu falënderuar për vëmendjen tuaj, unë edhe një herë ju ftoj për debat konstruktiv, në dobi të interesave të shtetit dhe të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Buxheti i Qeverisë së Kosovës nuk është vetëm buxhet i qeverisë, është buxheti i të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, është buxheti i të gjithëve. Ju faleminderit shumë për vëmendjen tuaj!

KRYETARI: Faleminderit për prezantimin!

Ftoj ministrin e Financave, zotin Bedri Hamza, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Projektbuxhetin për vitin 2011.

BEDRI HAMZA: I nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Krasniqi,
I nderuar zoti kryeministër,
Të nderuar zëvendëskryeministra,
Të nderuar ministra,
Deputetë të nderuar,
Të nderuar të pranishëm, qytetarë të dashur të Republikës së Kosovës,
Ndjehem i nderuar që sot kam rastin para juve ta paraqes Projektligjin për buxhetin për vitin 2011.

Fillimisht më lejoni që t'i bashkangjitem falënderimit kryeministrit për të gjitha grupet parlamentare, që në bazë të kërkesës tonë na kanë mundësua që në takime shumë konstruktive, shumë korrekte, me diskutime shumë profesionale ta diskutojmë Projektbuxhetin për vitin 2011.

Dokumenti të cilin sot po e prezantoj para jush, orienton politikën fiskale të vendit tonë jo vetëm për vitin 2011, por edhe për një periudhë më të gjatë.

Duke marrë parasysh peshën e këtij projektbuxheti, shpresoj që sot do të arrijë përmes fjalimit tim të pasqyrojë rëndësinë që i është dhënë punës analitike dhe kujdesit profesional gjatë hartimit të tij.

Kryeministri në fjalimin e tij dha një përshkrim të përgjithshëm mbi themelet e krijimit të projektbuxhetit, si dhe paraqiti kushtet ekonomike dhe politike nga të cilat buron ky projekt-buxhet.

Në vazhdim, mua më mbetet që të prezantoj nga perspektiva ekonomike dhe financiare katër aspekte të rëndësishme të projektbuxhetit duke u përqendruar:

Në një, në aspektet ligjore dhe procedurale të ndërlidhur me hartimin e projektbuxhetit dhe duke theksuar edhe rëndësinë që i kemi dhënë transparencës gjatë procesit përgatitor dhe mbikëqyrës.

Nën dy, në aspektin e ndërlidhshmërisë së këtij projektbuxheti me zhvillimet ekonomike gjatë vitit 2010 si në vend, ashtu jashtë vendit. Me theks të veçantë, po ashtu, do të flas për parashikimet ekonomike dhe kuadrin e përgjithshëm makro-ekonomik mbi të cilin bazohet ky projekt-buxhet.

Nën tre, do të përqendrohem më detajisht në diskutimin e strukturës së projektbuxhetit 2011, duke u përqendruar në planifikimin e të hyrave, të shpenzimeve dhe në financimit për projektbuxhetin e vitit 2011.

Dhe, nën katër, përfundimisht do të flas për rolin e këtij projektbuxheti në relacion me institucionet financiare ndërkombëtare.

I nderuar zoti kryetar i Kuvendit,

I nderuar zoti kryeministër,

Të nderuar ministra,

Deputetë të nderuar,

Procesi përgatitor për projektbuxhetin e vitit 2011 është zhvilluar brenda kuadrit të rregullt buxhetore, siç edhe parashihet me nenin 20 të Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe të përgjegjësisë.

Janë zhvilluar dëgjime të rregullta buxhetore dhe janë bashkërenduar kërkesat e të gjitha organizatave buxhetore në përputhje me prioritetet zhvillimore.

Për arsye politike, procesi i dorëzimit të projektbuxhetit u shty, ndërsa operacionet buxhetore vazhduan në përputhje me nenin 24 të Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe të përgjegjësisë.

Sot dokumenti i paraqitur para jush vjen si rezultat i një pune integrale të të gjitha institucioneve ekzekutive të vendit tonë dhe përmbajtja u përgjigjet saktësisht kërkesave të përcaktuara në nenin 21 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe të përgjegjësisë.

Duhet të theksoj se sado profesionale të jetë puna brenda institucioneve publike, duhet qenë të vetëdijshëm se ajo nuk është e plotë nëse nuk është transparente ndaj qytetarit.

Andaj, gjatë gjithë procesit buxhetor edhe në vazhdimësi ne mbetemi të përkushtuar, të orientuar në transparencë të gjerë për punën që bëjmë.

Qytetarët tanë tani kanë mundësinë që raportet e ekzekutimit të buxhetit t'i përcjellin në baza mujore, kuartale dhe vjetore nga Web faja e Ministrisë së Financave, së bashku me shumë informacione të tjera mbi mbarëvajtjen e politikës fiskale në vend. Në po këtë faqe, ne kemi publikuar edhe projektbuxhetin që ju sot e keni para vetes.

Kjo formë e punës po krijon mekanizma më të mirë të përgjegjësisë duke qar drejt një menaxhimi ekonomik të orientuar drejt rezultateve të dëshmuara, të cilat për qytetarë janë të prezantuara si informacione lehtë të arritshme.

Mbi këtë punë dhe mbi këtë parim presim që të gjitha planifikimet dhe projeksionet e Qeverisë së Kosovës të bazohen në të dhëna që janë të disponueshme për të gjithë ekspertët e fushës së ekonomisë dhe për të gjithë qytetarët.

Në bazë të të dhënave aktuale ekonomike, të ofruara edhe publikisht nga institucionet gjegjëse brenda Qeverisë së Kosovës, nga Banka Qendrore e Kosovës, por edhe nga institucionet tjera ndërkombëtare, Ministria e Financave vlerëson se Bruto Prodhimi Vendor gjatë vitit 2010 është rritur me një normë reale vjetore mbi 4%.

Duke i komentuar zhvillimet që kanë shtyrë këtë rritje, më lejoni t'ju japë pasqyrë dhe bazën e parashikimeve për periudhën 2011 – 2013, mbi të cilat bazohen supozimet për Projektbuxhetin e vitit 2011.

Gjatë vitit 2010, eksportet e mallrave u rritën me 77%, ndërsa importet e mallrave me 11% në krahasim me vitin 2009.

Mbulueshmëria e importeve nga eksportet është rritur për 14% në vitin 2010, me një diferencë prej 5% nga viti 2009.

Në muajt vijues të vitit 2011, eksportet dhe importet vazhduan trendin e njëjtë të rritjes.

Edhe të dhënat e sektorit bankar mbështesin vlerësimin për rritjen reale ekonomike, ku gjatë vitit 2010 kreditë e dhëna nga bankat komerciale janë rritur në një normë prej 13.2%, ndërsa depozitat 11%.

Duke dëshmuar se likuiditeti ishte i kënaqshëm, si dhe kërkesa për kredi dhe oferta e mjeteve të qytetarëve për depozita është rritur në përputhshmëri me vlerësimin tonë për rritjen ekonomike.

Në sektorin fiskal, zhvillimet kanë qenë të kënaqshme. Janë grumbulluar 701 milionë euro nga tatimet në kufij, ndërsa nga tatimet të cilat i mbledh dhe i administrojnë Administrata Tatimore e Kosovës - 221 milionë, duke tejkaluar në mesataren në nivelin e planifikuar të të hyrave buxhetore. Edhe të hyrat vetanake të nivelit qendror dhe atij

komunal u arkëtuan në vlera më të larta se sa që ishin projektuar me buxhetin e vitit 2010, çka flet për maturinë tonë në projektimin e të hyrave.

Në anën tjetër, shpenzimet e buxhetuara për vitin 2010 janë realizuar në normën prej 94% si stimul i mirë fiskal ndaj ekonomisë së vendit, duke rezultuar nga përmirësimi i kapaciteteve planifikuese dhe kapaciteteve për ekzekutim buxheti nga ana e institucioneve publike.

Janë shpenzuar 455.3 milionë euro apo 91% e shpenzimeve të buxhetuara kapitale, çka paraqet edhe normën më të lartë të realizimit të buxhetit në historikun e shkurtër fiskal të institucioneve tona.

Edhe shpenzimet në kategoritë tjera ekonomike janë realizuar me norma të ngjashme dhe në përgjithësi niveli i shpenzimeve totale arrin vlerën prej 1 miliard e 272 milionë.

Është përcjellë me vëmendje të veçantë edhe lëvizja e çmimeve gjatë vitit 2010, nga të cilat çmimet e konsumit janë rritur në mesatare vjetore prej 3.5% gjatë vitit 2010, të ndikuara kryesisht nga çmimet e importeve, të cilat u rritën mesatarisht me 5%. Kjo lëvizje u reflektua më shumë në çmimet vendore të bukës, të drithërave dhe të derivateve.

Nga këto të dhëna që unë i prezantova deri tani, ekspertët e Ministrisë së Financave kanë vlerësuar se rritja reale ekonomike prej 4% gjatë vitit 2010 i atribuohet kryesisht rritjes së konsumit, të eksporteve dhe të investimeve.

Natyrisht se rritja e këtyre komponentëve do të rezultonte në rritje shumë më të lartë të Bruto Produktit Vendor, sikur prirja për të importuar përbrenda ekonomisë sonë të ishte më e ulët.

Prandaj, ofrimi i kushteve për uljen e kësaj prirjeje do të mbetet qëllim vital i politikave tona makro - ekonomike në të ardhmen.

Për periudhën 2011 – 2013 vlerësohet se rritja reale ekonomike për vitin 2011 do të jetë 5.3%, ndërsa rritja reale mesatare për tërë periudhën e projektuar është 5.1%. Kjo rritje pritet të rezultojë nga rritja e eksportit, të investimeve dhe të konsumit. Ndikim të theksuar do të ketë rritja e konsumit publik, që vjen si rezultat i ngritjes së pagave në këtë sektor, si dhe ngritja e efektit multiplikativ të kësaj politike brenda ekonomisë sonë.

Rritja e konsumit privat prej 5.6% parashihet të jetë një nga kontribuuesit kryesor të rritjes gjatë vitit 2011, e prirë nga rritja modeste e remitencave, nga zgjerimi kreditor, nga shtimi i besimit të konsumatorëve.

Po ashtu, investimet private të rriten me një normë prej 13%, e cila rritje do të vijë pas tejkalimit të efekteve të pjesshme të krizës, që u reflektuan më së shumti me rënien e investimeve të huaja direkte.

Një nga stimujt kryesor të rritjes pritet të vijë nga shtimi i investimeve kapitale, të cilat janë buxhetuar në vlerën prej 572 milionë euro gjatë vitit 2011, apo 117 milionë euro më shumë se realizimi i këtyre shpenzimeve gjatë vitit 2010. Kjo është një rritje prej 2.5% të përqindjes së Bruto Produktit Vendor të vitit 2010.

Çmimet e konsumit për shkak të zhvillimeve ekonomike ndërkombëtare janë menduar dhe parashikuar të rriten me normë mesatare vjetore prej 5.3% gjatë vitit 2011, duke vijuar me stabilizim të lëvizjes së çmimeve në nivel mesatar prej 2.5% gjatë periudhës 2012 dhe 2013.

Ministria e Financave ka qenë shumë e kujdesshme në projeksionet e saja të ambientit makro-ekonomik, çka dëshmohet edhe nga krahasueshmëria e projeksioneve tona me ato të Fondit Monetarë Ndërkombëtar.

Të nderuar të pranishëm,

Të nderuar bashkëqytetarë,

Mbi këta parametra makro-ekonomikë që unë i prezantova deri më tani, Ministria e Financave me departamentet përkatëse ka bërë edhe parashikimin e të hyrave buxhetore dhe ka përcaktuar hapësirën e mundshme shpenzuese gjatë vitit 2011, por edhe gjatë periudhave vijuese.

Në vazhdim, më lejoni që t'ua jap në mënyrë pak më analitike parashikueshmërinë e të hyrave dhe të dalave buxhetore.

Të hyrat e parapara që të jenë për buxhetin e Kosovës për vitin 2011 si të hyra të rregullta, janë në lartësi prej 1 miliard e 264 milionë. Nëse e shikojmë strukturën e këtyre të hyrave, shohim se të hyrat të cilat janë të planifikuara që administrohen dhe të mbliidhen nga doganat janë në vlerë 831 milionë euro, që janë rreth 19% më shumë se periudha e njëjtë e vitit paraprak, domethënë më shumë se në vitin 2010.

Çka do të ndikojë në rritjen e të hyrave për 19% në vitin 2011, krahasuar ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, vazhdoje fjalën!

MINISTRI BEDRI HAMZA: ... janë 5.3%, ndërsa rritja nominale do të jetë 8%, rritja e akcizave të cilat kanë ndodhur në pjesën e dytë të vitit 2010, pritet që të japë efektin e plotë gjatë vitit 2011 dhe, normalisht, kjo vjen edhe si rezultat i një bashkëpunimi më të mirë të doganave të Kosovës me doganat e vendeve të regjionit, rritja e performancës dhe e produktiviteti në këtë institucion.

Të hyrat të cilat administrohen nga Administrata Tatimore e Kosovës janë planifikuar që të jenë në lartësi 261 milionë euro, apo 18% më shumë se sa në vitin 2010.

Masat të cilat kanë ndikuar në planifikimin prej 18%, janë: rritja ekonomike, rritja e pagave, që ndikon edhe në pagesën më të lartë të tatimeve që paguhen në emër të tatimeve në të ardhurat individuale dhe rritja e performancës së këtij institucioni, normalisht edhe zvogëlimi i informalitetit.

Rritja kanë shënuar edhe të hyrat vetanake të nivelit qendror dhe të nivelit komunal.

Na bën të jemi optimistë në përmbushjen e planit të hyrave edhe fakti se për këtë pjesën e parë të këtij viti për këta dy muajt e parë kemi pasur një trend shumë pozitiv të të hyrave dhe nëse e krahasojmë me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, kemi të hyra më të larta prej 34%.

Sa u përket të dalave buxhetore, më lejoni të them se në pozicionin e pagave është paraparë implementimi i vendimit të Qeverisë, të marrë në mbledhjen e Qeverisë në janar të këtij viti, ku nga ky vendim përfitojnë mbi 70 mijë punëtorë të cilët realizojnë paga përmes buxhetit të Kosovës, ku përmirësohet pozita e 70 mijë familjeve në Kosovë.

Pozicioni Mallra dhe Shërbime mbetet përafërsisht në nivelin e njëjtë të vitit paraprak, nuk është rrezikua funksionaliteti i organizatave buxhetore, kemi pasur qëllim që në këtë kategori të jemi të kujdesshëm, mirëpo pozicionet kryesore brenda kësaj kategorie, siç është pozicioni i barërave esenciale, nuk e kemi prekur dhe e kemi lënë në nivel prej 18.7 milionë euro.

Te kategoria e Subvencioneve dhe Transferove janë përfshirë vendimet për rritjen e pagave për familjet e dëshmorëve dhe invalidëve të luftës për 50%. Është paraparë kostoja e Ligjit për pensionet, është paraparë kostoja e Ligjit për kategoritë e dala nga lufta, është paraparë kostoja për Ligjin e punës, i cili fillimisht ka qenë i vlerësuar me 1.8 milionë euro, ndërsa tash është i postuar në 5.8 milionë euro.

Dhe, vijmë te ai pozicioni, ku kemi qenë më të kujdesshmit, pavarësisht rritjeve dhe përmirësimit të pozitës materiale dhe të mirëqenies sociale të të gjithë qytetarëve të Kosovës, ne kemi vazhduar me trendin pozitiv të investimeve kapitale, ku nga 456 milionë të shpenzuar në vitin 2010, investimet kapitale për vitin 2011 janë paraparë 572 milionë apo një rritje prej 26%.

Grandet qeveritare për komunat në projektbuxhetin për vitin 2011 janë rritur për rreth 24% krahasuar me buxhetin e vitit 2010, duke arritur shumën prej mbi 300 milionë euro, krahasuar me 242 milionë euro, sa ishin në vitin 2010. Kjo rritje u mundësua si rezultat i masave të marra për rritjen e të hyrave të përgjithshme buxhetore. Më duhet të theksoj se ndarja e grandeve për komuna i respekton në tërësi kriteret e përcaktuara për këtë qëllim.

Natyrisht se unë nuk fillova të prezantoj specifikisht edhe ndarjen që janë bërë për sektorë të ndryshëm për të mbuluar shpenzimet operationale. Është e kuptueshme se të gjithë këta sektorë do të përfitojnë nga ngritja e kategorive ekonomike operationale, duke mos dëmtuar alokimet për kategoritë tjera ekonomike.

Në aspektin makro-ekonomik, skema e paraqitur e rritjes së shpenzimeve është në pajtueshmëri me kornizën makro-fiskale dhe garanton qëndrueshmëri të sistemit ekonomik dhe të rritjes reale ekonomike.

Shpenzimet rrjedhëse nuk tejkalojnë 10% të Bruto Prodhimit Vendor gjatë periudhës 2011 – 2013.

Pagat dhe mëditjet parashihen të mbeten në nivelin mesatar prej 8% të Bruto Produktit Vendor gjatë periudhës afatmesme 2011 – 2013, me një rritje të ndjeshme në vitin 2011, po me një rënie të pjesëmarrjes në Bruto Produktin Vendor pas të 2011-ës.

Mallrat dhe shërbimet parashihen të mbesin në 4% të Bruto Produktit Vendor, ndërsa subvencionet dhe transferet do të mbesin 6% të Bruto Produktit Vendor.

Për të realizuar reforma strukturore dhe për të ofruar kushte më të mira për një rritje ekonomike të udhëhequr nga sektori privat, shpenzimet kapitale do të arrijnë nivelin prej 12% të Bruto Produktit Vendor.

Si përfundim, deficitin rezultues pritet të jetë me 4.8% të produktit vendor në vitin 2011, me një përmirësim të dukshëm në vitet vijuese, duke arritur normën prej 2.7% të Bruto Produktit Vendor në vitin 2013.

Deficiti primar i projektuar në vlerë prej 170 milionë euro dhe ai i përgjithshëm i projektuar në vlerë prej 226 milionë euro do të financohet nga dy burime, në masën më të madhe nga mbështetja direkte buxhetore, por edhe nga pjesë e të hyrave të njëhershme që janë projektuar të vijnë nga transfere të aksioneve në pronësi publike në aksione me pronësi private.

Unë do të doja t'i prezantoja të gjitha informatat që përbën projektbuxheti i vitit 2011, por koha nuk më lejon një komiditet të tillë. Prandaj, ju informoj edhe një herë se tabelat e prezantuara në këtë projekt-buxhet janë gjithëpërfshirëse dhe Ministria e Financave është përkujdesur që ju të mund të gjeni informatat e hollësishme në dokumentin që e dorëzuam në Parlament.

Nën katër, dhe për fund, të nderuar të pranishëm dhe bashkëqytetarë, Unë dua të theksoj se në qershor të vitit të kaluar ne nënshkruam programin e parë në mes të Republikës së Kosovës dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar. Me duhet të shpjegoj se ky program parashihet 6 rishikime. Kjo për arsye se marrëveshja dhe parametrat e performancës në këtë marrëveshje janë parashikime të cilat jo gjithmonë realizohen ashtu siç projektohen.

Po ashtu, rishikimet ekzistojnë për t'i dhënë qeverive fleksibilitet për të adresuar nevojat e kohës. Natyrisht se rrethanat e fundit të vitit 2010 nuk parashihnin kur u nënshkrua ajo marrëveshje. Edhe përkundër rrethanave të jashtëzakonshme politike për vitin 2011, janë respektuar në tërësi obligimet e Qeverisë brenda marrëveshjes.

Tani në vitin 2011, ne përballemi me një situatë të re. Të hyrat dhe shpenzimet gjatë vitit 2010 kanë mbi përformuar parashikimet e qershorit dhe ne si përfaqësues të qytetarëve të Republikës së Kosovës e kemi për obligim që qytetarëve t'ju ofrojmë mundësi më të mira nëse kemi besim se mundësitë e tilla me të vërtetë ekzistojnë.

Natyrisht, ne jemi të nisur nga parimi i respektimit të marrëveshjeve të mëparshme dhe në saje të këtyre marrëveshjeve kemi akomoduar synimet tona për përmirësimin e administratës publike dhe adresimin e çështjeve sociale brenda kuadrit të gjerë të programit të qershorit të vitit 2010.

Ju rikujtoj se me këtë program deficieti i projektuar për vitin 2011 ishte më i lartë se sa që është prezantuar sot në dokumentin e Projektbuxhetit të vitit 2011.

Mbi këto parime ne kemi pasur negociata shumë të frytshme edhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar, me të cilin jemi dakorduar për shumicën e linjave dhe të kategorive buxhetore.

Tani, ashtu siç e potencoi edhe kryeministri në fjalimin e tij, neve na mbetet që para dhe gjatë vazhdimit të negociatave me Fondin Monetar Ndërkombëtar të dëshmojmë se planet e prezantuara janë të menduara, të guximshme dhe të besueshme.

I nderuar zoti kryetar i Kuvendit,
Të nderuar zëvendëskryeministra,
Të nderuar ministra,
Deputetë të nderuar,

Nga kjo që thashë deri tani, ju siguroj se Projektbuxheti i vitit 2011 është një projekt profesional, por edhe vizionar, i cili vetëm me mbështetjen tuaj mund të bëhet edhe projekt i qytetarit dhe realisht të ndikojë në përmirësimin e jetës së tij.

Vota “pro” këtij buxheti, do të thotë votë për përmirësimin e pozitës së materiale për 70 mijë të punësuar në sektorin publik. Do të thotë, votë për përmirësimin e pozitës materiale të 70 mijë familjeve në Kosovë. Vota “pro” e këtij projektbuxheti, do të thotë votë për përmirësimin e familjeve më të vlerësuara në Kosovë – të familjeve të dëshmorëve. Vota “pro” këtij buxheti, do të thotë votë për përmirësimin e pozitës materiale të njerëzve më të merituar në këtë vend – të invalidëve të luftës. Vota “pro” këtij buxheti, do të thotë votë “pro” mundësisë së hartimit dhe aprovimit të Ligjit për pensionet. Vota “pro” e këtij buxheti, do të thotë votë “pro” mundësisë së hartimit dhe aprovimit të Ligjit për kategoritë e dala nga lufta. Vota “pro” këtij buxheti, do të thotë votë “pro” për më shumë investime kapitale, për vazhdimin e projektit më kapital të autostradës, për vazhdimin e shumë rrugëve regjionale, për blerjen e librave falas për të gjithë nxënësit e shkollave fillore, për më shumë subvencione në bujqësi, për rregullimin e shumë çështjeve në kulturë.

Duke ju falënderuar për vëmendjen, unë ju lus që ta aprovojmë këtë projektligj. Ne si Ministri e Financave do të jemi të kujdesshëm që t'i evidencojmë të gjitha vërejtjet, rekomandimet, këshillat, propozimet alternative, por edhe kritikën qëllim mirë, që gjatë

punës në komisionet funksionale në mes dy leximeve, të gjitha propozimet që janë brenda mundësive reale, të përfshihen dhe ky projektligj të begatohet dhe të pasurohet. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit, ministër, për arsyetimin e Projektbuxhetit të vitit 2011!

Të nderuar deputetë,

Pas prezantimit dhe arsyetimit të projektbuxhetit, hapi debatin për diskutim, në parim.

Ftoj kryetaren e Komisionit për Buxhet dhe Financa, deputeten Safete Hadergjonaj që ta marrë fjalën.

SAFETE HADERGJONAJ: I nderuar zoti kryetar,

I nderuar zoti zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa, me datën 18 mars, sipas rekomandimit të Kryesisë së Kuvendit ka shqyrtuar, në parim, Projektbuxhetin për vitin 2011 të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe i ka rekomanduar Kuvendit që këtë projekt-buxhet ta miratojë në parim.

Dua të theksoj faktin se në Komisionin për Buxhet dhe Financa, pjesa e opozitës është dakorduar që të shqyrtohet në Kuvend, por të mos miratohet në parim në komision, ndërsa shumica e komisionit ka votuar “pro” këtij projektbuxheti dhe i ka rekomanduar Kuvendit që ta miratojë, ashtu që të krijohet mundësia e komisionit të bëjë përmirësime të mundshme në faza të shqyrtimit të mëtutjeshëm të projektbuxhetit.

Në pjesën tekstuale është rregulluar mënyra e ndarjes dhe e menaxhimit të mjeteve. Megjithatë, komisioni ka vlerësuar se duhet bërë disa përmirësime në pjesën tekstuale, sidomos duhet bërë riformulimi i nenit 14 dhe disa përmirësime teknike dhe gjuhësore të cilat, sipas rregullores, do të bëhen pas miratimit të parë, në parim, gjatë amendamentimit të projektligjit.

Në pjesën tabelore vërehet se janë rritur të hyrat, kurse ka një shpërndarje shumë më të mirë të fondeve aty ku përfitojnë qytetarët. Është bërë rritja e të hyrave në 1 miliard e 264 milionë euro, që do të thotë se do të ketë rritje për 12.3% në krahasim me vitin 2010, ku pjesëmarrja e të hyrave të përgjithshme në Bruto Produktin Vendor do të jetë 27.3%.

Nëse analizojmë me kujdes shifrat në këtë projekt, vërejmë se fondet janë orientuar për politikën që janë shpallur si prioritete me programin e Qeverisë.

Shpenzimet janë rritur në 1 miliard e 434 milionë euro, që do të thotë se ka rritje për 19.3% në krahasim me vitin e kaluar, ku në saje të kësaj rritje është bërë një mbështetje e shtuar financiare për punonjësit e sektorit publik dhe për kategoritë sociale. Janë reduktuar shpenzimet jo produktive dhe mjetet janë përqendruar në projekte të rëndësishme kapitale në arsim, në infrastrukturë, në shëndetësi, në bujqësi e tjera.

40% e shpenzimeve të përgjithshme janë orientuar për investime kapitale, kurse janë reduktuar shpenzimet për mallra dhe shërbime në 13%.

Me këtë projekt-buxhet rriten pagat dhe mundësohet të realizohen projekte me interes kombëtar, siç është autostrada.

Janë zvogëluar subvencionet për ndërmarrjet publike, kurse ka rritje të subvencioneve për mirëqenien sociale për 9% që ka rezultuar me rritjen e pagave për kategoritë e luftës dhe është mbuluar me kosto financiare Ligji për pensionet, që pritet të miratohet së shpejti.

Prandaj, mendoj se komisioni ka pasur arsye për ta përkrahur këtë projektbuxhet.

Të nderuar deputetë,

Në komision ka pasur debat konstruktiv, deputetët kanë vlerësuar buxhetin, por edhe kanë shprehur vërejtjet e tyre, që besoj shumë se disa prej këtyre vërejtjeve do të inkorporohen në buxhet gjatë amendamentimit.

Po ashtu, disa deputetë kanë shprehur hezitimin e tyre se burimet financiare që mbushin buxhetin sipas parashikimeve të Qeverisë, nuk janë shumë të sigurta.

Është përkrahur rritja e pagave, por kërkohet nga Qeveria që të bëjë një kontroll të mirëfilltë të strukturës së të punësuarve, të kontrollohen koeficientet sipas të cilëve paguhen, ashtu që të mos paguhet i njëjti punëtor, me të njëjtë punë, me të njëjtin profesion me koeficientë të ndryshëm. Sidomos një gjë e tillë është shumë e theksuar nëpër komuna, prandaj një auditim i përgjithshëm për këtë çështje është më se i domosdoshëm. Ajo çka ne do të kërkojmë, është që krahas përmirësimit të pozitës materiale të të punësuarve, të rritet efikasiteti në punë dhe të luftohen dukuritë negative.

Problem në vete për Komisionin për Buxhet dhe Financa ende mbetet buxheti i agjencioneve të pavarura dhe të rregullatorëve ekonomikë të pavarur, në mungesë të një legjislacioni të duhur për këto agjencione. Sidomos kur është çështja e pagave të bordeve, ka laramani të madhe në disa agjencione. Pagat kanë qenë të rregulluara me ligjet që janë shfuqizuar, kurse me ligjet në fuqi pagat e bordeve rregullohet në bazë të Ligjit mbi pagat e zyrtarëve të lartë, ligj i cili nuk është miratuar ende.

Rekomandojmë qeverinë që ta sjell në Kuvend sa më shpejt këtë ligj dhe të mos përcillet ky problem nga viti në vit.

Po ashtu, komisioni ka rekomanduar që të bëhet unifikimi i pagave të shërbyesve civilë të agjencioneve të pavarura dhe të rregullatorëve konform ligjeve të cilat janë në fuqi.

Në Komisionin për Buxhet dhe Financa kanë ardhur shumë kërkesa nga ministrinë, por edhe nga agjencionet e pavarura. Kërkesat e ministrive Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk ka shprehur disponimin e madh për t'i shqyrtuar me qenë se në Qeveri të gjithë ministrat e kanë votuar këtë projektbuxhet me datën 11 mars, prandaj janë të paarsyeshme kërkesat të cilat ia adresojnë komisionit. Kurse Komisioni për Buxhet dhe

Financa do t'i shqyrtojë me kujdes të gjitha kërkesat të cilat kanë ardhur nga agjencionet e pavarura dhe të bëjë pranimin e këtyre kërkesave kur ato janë të arsyeshme dhe t'ju mundësohet këtyre agjencioneve dhe rregullatorëve ekonomikë të pavarur ta ruajnë pavarësinë e tyre.

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka miratuar Projektbuxhetin për vitin 2011 dhe u rekomandon deputetëve ta miratojnë në parim këtë projektligj dhe t'i krijojnë mundësinë komisionit për të bërë përmirësimet e mundshme gjatë amendamentimit, ashtu që buxheti të jetë i miratuar në lexim të dytë më së largu më 31 mars. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Tani është radha e kryetarëve të grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputeti Adem Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Zëvendëskryeministër, ministra,

Kolegë të nderuar deputetë,

Sot para nesh kemi dokumentin themelor të Qeverisë së Republikës së Kosovës për këtë vit, do të thotë për vitin 2011.

Projektbuxheti i vitit 2011 është bërë në përputhje të plotë me programin qeveritar dhe prioritetet e përcaktuara të Qeverisë së Republikës së Kosovës, i cili ka synim parësor mbështetjen e politikave zhvillimore të cilat adresojnë fuqishëm nevojat e qytetarëve.

Më saktësisht, struktura e buxhetit respekton prioritetet kryesore siç janë: rritja ekonomike, zhvillimi dhe fuqizimi i kapaciteteve institucionale, qeverisja e mirë, stabiliteti social, rritja e mirëqenies së qytetarëve.

Ky projektbuxhet adreson nevojat ekonomisë së vendit, duke ruajtur nivelin e lartë të investimeve kapitale, si dhe krijimin e ambientit stimulues për investime të sektorit privat dhe zhvillimin e infrastrukturës së nevojshme për fuqizimin e po këtij sektori.

Të hyrat e rregullta buxhetore për vitin 2011 janë parashikuar të jenë në vlerë prej 1 miliard e 264 milionë, apo rreth 12.3% më të larta se të hyrat e rregullta për vitin 2010.

Rritja e të hyrave buxhetore ka arritur si rezultat i performancës së mirë të të hyrave gjatë vitit të kaluar dhe gjatë 2 muajve të parë të këtij viti, gjë që ka krijuar një bazë solide mbi të cilën janë bërë parashikimet për vitin 2011.

Qeveria ka ndërmarrë masa në ngritjen e nivelit të inkasimit të të hyrave në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Është bërë pajisja e bizneseve me numra fiskal, që mundëson identifikimin e të gjitha bizneseve aktive në Kosovë, futja e arkave fiskale, vlerësimi i stoqeve të kompanive, kontrollet më të shpeshta, avancimi i sistemit informativ. Të gjitha

këto masa të ndërmarra kanë filluar të japin efektet pozitive në rritjen e të hyrave buxhetore.

Nëse e analizojmë me kujdes projektbuxhetin, vërejmë se Qeveria është e përqendruar në ofrimin e një rritje të qëndrueshme ekonomike. Buxheti si tërësi ofron shumë në përgjithshme të shpenzimeve publike prej 1 miliard e 434 milionë euro, e që shënon një rritje prej mbi 19.35%, krahasuar me buxhetin e vitit të kaluar.

Ky buxhet siguron stimulimin fiskal që Kosova të ketë një rritje të projektuar ekonomike, që është paraparë mbi 5.3 gjatë vitit 2011, me të cilin nivel të rritjes është pajtuar pas analizave dhe studimit të bërë nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, ku del në 5.5%. 40% të shpenzimeve primare të këtij buxheti apo 373 milionë euro, 25.6% më shumë se vitin e kaluar janë dedikuar për shpenzime kapitale, duke mbuluar nevojat kryesore dhe me prioritet të vendit.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike është i mendimit se kjo qasje i jep buxhetit komponentin zhvillimor, e cila si e tillë ofron shtytje të vazhdueshme për rritjen ekonomike në vend, krijimin e vendeve të reja të punës dhe krijimin e infrastrukturës së nevojshme për zhvillim të qëndrueshëm të sektorit privat.

Nga ngritja e këtij buxheti përfitojnë infrastruktura, arsimit, shëndetësia, bujqësia, si dhe sektori i sigurisë në vend.

Me këtë projektbuxhet është bërë mbështetje e sektorit bujqësor dhe rural, duke përfshirë këtu edhe rritjen e subvencioneve në 7 milionë e 400 mijë euro, kurse për investime kapitale janë paraparë afër 3 milionë euro.

Krahas buxhetit në nivel qeveritar, është rritur dukshëm edhe buxheti në nivel komunal. Buxheti i komunave është rritur për 57 milionë e 955 mijë euro, apo 19% më shumë se në vitin 2010. Ajo çka e karakterizon këtë buxhet, është shpërndarja proporcionale e projekteve investive në të gjitha komunat e vendit. Buxheti i komunave në vlerë prej 352 milionë e 833 mijë euro u siguron komunave nivelin e duhur për ta mbështetur zhvillimin ekonomik, lokal dhe përmirësimin e shërbimeve efikase ndaj qytetarëve të komunave të tyre. Ndonëse buxheti komunal do të financohet në masën deri në 85% nga grandet qeveritare, përkatësisht 300 milionë euro nga niveli qendror, komunat kanë treguar përkushtim të vazhdueshëm drejt rritjes së të hyrave vetanake, që planifikohen të jenë mbi 51 milionë euro.

Nga ky buxhet përfitojnë edhe kategoritë, disa kategori tjera që lirishtë mund të themi që deri më tash kanë qenë në mëshirën e fatit, siç janë: familjet e dëshmorëve, invalidët e luftës, të punësuarit, shërbyesit civilë, që rrokin një shifër rreth 70 mijë vetë. Ligji për vlerat e luftës, Ligji për pensionistët, kategori kjo që deri më tash ka jetuar në një gjendje të mjerë dhe pa asnjë përkujdesje, si dhe Ligji i punës. Nga kjo shihet qartë se Qeveria e Kosovës është e gatshme që të shtrijë dorë dhe të ndjejnë këto kategori mbështetjen institucionale.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e mbështet projektbuxhetin dhe kërkon mbështetjen nga të gjithë deputetët, në mënyrë që t'i krijojme mundësi Qeverisë të marrë hapat e rëndësishëm drejt zhvillimit ekonomik të Kosovës.

Investimet e bëra gjatë këtij viti dhe ato të planifikuara për vitin 2011 në infrastrukturë dhe në projektet e tjera kapitale, janë një përkushtim i rëndësishëm për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, si dhe në funksion të mirëqenies së gjithë qytetarëve të Kosovës.

Prandaj, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës i fton të gjithë deputetët që të mbështesin këtë projektbuxhet. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të grupit parlamentar të LDK-së, deputeti Naser Osmani e ka kërkuar fjalën.

NASER OSMANI: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë dhe Kabinet qeveritar,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës konsideron se ky buxhet që i është propozuar Kuvendit të Republikës së Kosovës, është një projekt i bazuar në interesat e ngushta politike, pa koncept zhvillimor, i cili rrezikon stabilitetin financiar dhe zhvillimor të ardhshëm të vendit.

Ky dokument nuk siguron qëndrueshmëri buxhetore për këtë vit dhe rrezikon qëndrueshmërinë për vitin 2012 dhe në vitet në vijim.

Të hyrat tatimore të buxhetit për 78% janë në varësi nga doganat, që është një tregues shumë i keq për perspektivën tonë të integritetit evropian. Buxheti nuk siguron qëndrueshmëri makro-ekonomike të vendit. Mbi 52% të buxhetit shpenzohen për transfere sociale, paga dhe mëditje, kurse rreth 50% të investimeve kapitale është e koncentruar vetëm në një projekt. Një strukturë të tillë të buxhetit të qartë të kësaj Qeverie, pa vizion për prioritet, i mungon tërësisht strategjia zhvillimore.

Buxheti rezulton të mos përputhet me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve. Ai u është përshtatur premtimeve të fushatës parazgjedhore dhe interesave dhe politikave të ngushta partiake të zotit Thaçi, duke injoruar interesat afatgjatë të vendit dhe mbështetjet me Fondin Monetar Ndërkombëtar, si dhe institucionet tjera financiare ndërkombëtare.

Norma e rritjes ekonomike, e planifikuara, nuk do të shprehet në zvogëlimin e varfërisë dhe në ngritjen e mirëqenies sociale, sepse nuk priten efekte multiplikative nga rritja e pagave në sektorin publik për arsye të importeve të larta. Ndërkaq, koncentrimi i investimeve bën që një numër i madh i firmave vendore të industrisë ndërtimore të mbesin krejtësisht pa punë.

Buxheti shkel rrënjësisht rregullat më të rëndësishme financiare të Bashkimit Evropian. Ka deficit buxhetor. Ky deficit buxhetor nuk guxon të kalojë 3.5% të GDP-së, ndërsa propozimi i këtij buxheti arrin në 5.2%. Projektbuxheti parashihet një deficit primar prej 170 milionë euro, kur i shtohen dhe kreditë për ndërmarrjet publike, atëherë deficitin i

përgjithshëm bëhet hiq më pakë se 226 milionë euro, në supozimin se do të arrihet të hyrat totale prej 1 miliard e 264 milionë euro. Duhet të përkujtojmë se vendet të cilat nuk i kanë respektuar kufijtë e deficitit, siç janë Greqia dhe Irlanda, përfunduan më pas në kolaps financiar.

Planifikimi i buxhetit është që deficitin prej 226 milionë euro të financohet pjesërisht nga ndihmat financiare, kreditë dhe kontributet tjera të jashtme. Të gjitha këto kontribute janë të kushtëzuara nga marrëveshja me Fondin Monetar Ndërkombëtar, prandaj në rast të mos aprovimit dhe mos pajtimit të Fondit Monetar Ndërkombëtar, me çfarë ndërlidhen vendimet edhe të Bankës Botërore dhe të Komisionit Evropian, hendeku buxhetor dhe rrjedhimisht deficitin i planifikuar mbetet i pafinancuar, duke rrezikuar kolaps të brendshëm financiar. Prandaj, shtrohet pyetja e thjeshtë - si mund të marrë Kuvendi vendim për paratë e institucioneve financiare ndërkombëtare ose vendim dhe aprovim për paratë e huaja që nuk na janë dhënë.

Projekti i buxhetit nuk parasheh rritje të pagave sipas premtimit të zotit Thaçi, 30, 40 dhe 50%. Pagat në këtë buxhet kanë shënuar rritje në një vlerë prej 72 milionë euro, në vend të 140, sa ishin premtuar, e që është 23% në krahasim me vitin 2010. Kjo flet se premtimi për rritjen e pagave, që zoti Thaçi e bëri gjatë fushatës parazgjedhore, me të cilin premtim i bleu votat, ka qenë i papërgjegjshëm dhe nuk po përmbushet ashtu siç është thënë.

Lidhja Demokratike e Kosovës mendon se arsimtarët, mjekët, policët, pjesëtarët e FSK-së, si dhe shërbyesit e tjerë civilë dhe profesionalë meritojnë t'u ngrihet paga, mirëpo ky premtim në formën në të cilën u bë, u përcoll me efekte negative sa i përket rritjes së çmimeve dhe të inflacionit, sepse inflacioni në muajin e parë të këtij viti arrin në 9%. Në anën tjetër, rritja e pagave në këtë vit nuk përcillet me rritje efektive në dy vitet e ardhshme.

Nga teksti dhe tabelat buxhetore mungojnë shpjegime se për çfarë do të përdoren 20 milionë euro, që janë të specifikuara si memorandum të mirëkuptimit të organizatave qendrore buxhetore.

Fondi për Mallra dhe Shërbime mbetet i njëjtë për 3 vitet e ardhshme, që nuk siguron rritje të cilësisë së shërbimeve dhe funksionalizimin e objekteve nga investimet kapitale, sidomos në arsim dhe në shëndetësi.

Qeveria nuk ka afruar një strategji se si do të investohen huat e kompanive publike, kur do të kthehen këto hua dhe si do të ngrihen kapacitetet e këtyre kompanive, që të jenë në gjendje t'i kthejnë ato hua. Nuk ka të dhëna se çfarë kanë ndodhur me kreditë që u janë akorduar deri më tani kompanive publike.

Lidhja Demokratike thekson se rritja e çmimeve, informaliteti ekonomik prezent në masë të madhe në Kosovë dhe shkalla e lartë e inflacionit, që po gufojnë si rezultat i sjelljeve dhe politikave të papërgjegjshme të kryeministrit Thaçi dhe të Qeverisë së tij, nuk prekin vetëm rreth 70 mijë të njerëzve, njerëz të cilëve ju premtua rritja e pagave, por mbi 2

milionë banorë të Kosovës, inflacioni dhe çmimet prekin edhe pensionistët, edhe të papunët, edhe sektorin privat, për këta ky buxhet nuk afron ama bash kurrjë.

Qeveria tenton që përmes këtij ligji, në nenin 4, të kamuflojë edhe privatizimin e PTK-së, që është në kundërshtim me ligjin dhe me kushtetutën, është fjala për Ligjin për ndërmarrjet publike. Shtrohet edhe pyetja se si mund një Qeveri e papërgjegjshme të përcaktojë vlerën e privatizimit të një kompanie publike në një dokument të buxhetit, që është dokument publik dhe transparent, që për çdo blerës të ardhshëm kjo mund të inkurajojë investitorët e mundshëm që të vejnë monopol në limitin e epërm të vlerësimit të aseteve të PTK-së. E gjithë kjo flet se kemi të bëjmë me një Qeveri jo serioze. Ndërkaq, sa i përket privatizimit, edhe nëse ndodhë një proces tjetër dhe i ligjshëm, nuk mund të priten se këto mjete do të arkëtohen në vitin 2011. Pagesat e paradhënies të paraqitura në nenin 12 të ligjit të propozuar për buxhetin, konsiderojmë se janë në kundërshtim me Ligjin mbi financat publike dhe si të tilla rrezikojnë paranë publike, nëse Qeverisë i lejohet që të japë paradhënie deri në 100% të vlerës së kontratave për mallra dhe shërbime.

Kemi vërejtje po ashtu lidhur me mosrespektimin e kufizimeve në punësim për 1204 persona.

Ndërsa neni 15 nuk duhet të vlejë për komunat, sepse ai shpreh tendencë të centralizimit fiskal kur përdoren të hyrat vetanake, sepse komunat aprovojnë ndryshimin në kuvend komunal dhe vetëm e informojnë ministrinë.

Grupi Parlamentar i LDK-së vlerëson dhe planifikimi joreal i burimeve për mbulimin e deficitit buxhetor do të rrezikojë rezervën në Bankën Qendrore dhe do të ndikojë në stabilitetin e sistemit bankar. Për këtë arsye konsiderojmë se Qeveria duhet të ofrojë mekanizma të tjera të mbulimit të deficitit, siç është emetimi i borxhit të brendshëm dhe ndryshimi i ligjit i cili do të mundësojë mobilizimin dhe shfrytëzimin e pjesës së mjeteve që mbahen jashtë Kosove për projekte zhvillimore reale, siç është bujqësia dhe sektori i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Kosovë.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës vlerëson se Ligji mbi buxhetin duhet t'i kthehet Qeverisë në rishqyrtim, në mënyrë që buxheti të garantojë qëndrueshmëri të të hyrave dhe të shpenzimeve për këtë vit dhe për 2 vitet e ardhshme, që buxheti të sigurojë qëndrueshmëri të rritjes reale të pagave...

Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti

KRYESUESI: Faleminderit! Edhe një minutë, regjia!

NASER OSMANI: ... që buxheti të sigurojë stabilitet makro-ekonomik, duke u orientuar në projekte reale zhvillimore dhe buxheti të përfshijë të burime reale të kompensimit të deficitit. Faleminderit, për vëmendje!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Siç jemi në dijeni të gjithë, Kosova ka mungesë të madhe të prodhimit. Vetëm gjatë vitit 2010, importi i gjithëmbarshtëm në Kosovë e ka tejkaluar vlerën prej 2 miliard e 131 milionë eurove, ndërkohë që me eksport këtë import tejet të madh e kemi mbuluar me vetëm 294 milionë euro, pra e kemi mbuluar me vetëm 13.74%. Më tepër se çfarëdo deklarimi i cilit do zyrtarë të lartë të shtetit për Kosovën shtet të pavarur dhe sovran, këta numra kokëfortë tregojnë se sa e varur është Kosova nga mallrat që na vinë nga jashtë, më së shumti nga rajoni, pra Serbia dhe Maqedonia, por edhe nga vendet tjera.

Me qenë se nuk kemi prodhim, nuk kemi as punësim. Zyrtarisht papunësinë e kemi alarmante në 45%, e jo zyrtarisht kjo shifër është edhe më alarmante dhe arrin herë në 50%, e herë në 55%, varësisht se nga kush e merr këtë të dhënë. Por pavarësisht se cila është e vërtetë, kjo e dhënë flet për mjerimin ekonomik e shoqëror të cilin po jetojmë ne sot. E pavarësisht sa zëshëm flet, ajo nuk mund të na portretizojë në asnjë mënyrë vështirësinë me të cilën ballafaqohen ata që institucionet e Kosovës i njohin vetëm si përqindje, pra të papunësuarit, në përditshmërinë e tyre të vrazhdë, pa mundësi që të organizojnë jetë të dinjitetshme dhe të jetojnë falë punës së tyre.

E kur nuk ka prodhim e nuk ka as punësim, atëherë kemi varfëri. Mbi 40% të popullit të Kosovës sot jetojnë me jo më shumë se 1.8 euro në ditë, e 18% nuk i kanë as 92 centë në ditë për t’i shpenzuar. Edhe këta për ekzekutivin e Kosovës figurojnë vetëm si shifra, madje shumë shpesh nuk figurojnë as si shifra. Për ta nuk flitet, sepse ata janë dëshmia reale që e hedhë teposhtë tërë investimin mediatik të Qeverisë së Kosovës, që është Qeveria e së kaluarës, po edhe Qeveria e tashme për suksesin kaq të madh ekonomik e shoqëror të Kosovës. Po pavarësisht nëse flitet për ta apo jo, ata janë këtu dhe janë në përpjekje të vazhdueshme për t’i mbijetuar ngritjes enorme të çmimeve të artikujve bazë për jetë. Pra, paramendoni deputetë të nderuar, se si e kalon ditën një person me 92 centë. Ai e blen një bukë, që kushton 40 centë dhe për të pasur mundësi që ta ketë një shujtë të dytë, e blen edhe një bukë që kushton po ashtu 40 centë, dhe kaq.

Ekziston një keqkuptim i zakonshëm këtu në Kosovë kur flitet për këto shifra. Mendohet se ata që e kanë një vend të punës, të paktën i kanë ikur lakut të varfërisë. Të paktën ata me rrogën e tyre arrijnë të mbijetojnë dhe të kenë ushqim e veshmbathje të mjaftueshme, shtëpi i ngrohta e higjienë modeste. Harrohet se rroga në Kosovë nuk ta siguron domosdoshmërisht asnjërin prej këtyre kushteve bazike të ekzistencës. Ta zëmë, një punëtor në Bechtel & Enka paguhet vetëm 70 centë në orë punë, gjë që e obligon atë të punojë të paktën 10 orë në ditë për ta përmbyllur ditën me 7 euro në ditë. E nëse punon gjatë tërë muajit pa pushim, atëherë ai do t’i marrë disi 210 euro pagë bruto.

Pas kontributeve pensionale dhe pas tatimit në të ardhura, nëse natyrisht Bechteli i paguan këto për punëtorët e vet, atëherë punëtorit tonë i mbesin 194 euro për ta ushqyer familjen, e ta zëmë se ky punëtor familjen e ka 5 anëtarësh, i bie t’i taktë nga 39 euro në muaj për secilin anëtarë apo 1.29 euro në ditë për secilin anëtarë. Pra, këta janë nën

pragun e varfërisë. E të tillë janë të gjithë ata që jetojnë në kushte të njëjta familjare, madje edhe nëse pagën bruto e kanë 270 euro, sa thuhet të jetë paga mesatare në Kosovë.

Në kushte të tilla ishte dashur ta shohim një buxhet që i adreson këto nevoja të njerëzve dhe këto interesa të punëtorëve dhe të shoqërisë në përgjithësi. Por, në vend të kësaj neve na është vënë përpara një buxhet, i cili i plotëson disa nevoja dhe interesa të cilat nuk janë tonat e nuk po i dimë se të kujt janë. Për shembull, aty shihet se të hyrat nga doganat planifikohen të shënojnë rritje prej mbi 18%, njëjtë sikurse edhe të hyrat nga tatimet e mbledhura brenda vendit. Gjatë vitit 2010, jo më shumë se 11% të të gjitha ndërmarrjeve që kanë qenë të regjistruara janë marrë me bujqësi apo industri nxjerrëse e përpunuese, pra që janë marrë me prodhim. Pjesa tjetër kanë qenë ndërmarrje tregtie ose financiare, ndërtimtarie e shërbime tjera të ndryshme. Ndërkohë që në prodhim janë të angazhuar vetëm 9.9% e fuqisë punëtore në Kosovë.

Nëse ky buxhet është planifikuar nga Qeveria, atëherë ky buxhet tregon se si Qeveria planifikon ta rrisë konsumin e mallrave të prodhuara dikush jashtë Kosovës. Pra, t'i finançojë ekonominë e vendeve tjera, duke e thelluar deficitin tregtarë tonin me to.

Ky nuk është buxhet zhvillimor, por buxhet që synon replikimin e saktë të asaj që po jetojmë sot dhe të asaj që e kemi jetuar deri dje. Në këtë buxhet nuk ka asnjë vijë që merret seriozisht me nevojat e bujqësisë së Kosovës, e as me domosdonë e industrializimit të vendit. Krejt çka shohim aty, janë shpenzimet enorme në rrugë dhe planifikimet e palogjikshme dhe të jashtë ligjshme për privatizimin e pronës publike, më saktësisht për privatizimin e Postës dhe Telekomit të Kosovës.

Pra, e keni parë që në buxhet, neni 4 thotë që Qeveria tashmë e ka të drejtën që të fillojë me privatizimin e Postës dhe Telekomit të Kosovës, kur dihet shumë mirë që Ligji për ndërmarrjet publike këtë të drejtë nuk ia jep Qeverisë pa e marrë ajo njëherë pranimin e Kuvendit. Pranimi i Kuvendit për privatizimin e PTK-së nuk është dhënë, rrjedhimisht Qeveria nuk e ka këtë të drejtë që të procedojë me shitjen e aksioneve të PTK-së.

Derisa ne po flasim ne këtu, punëtorët e PTK-së së bashku me qytetarët janë mbledhur në sheshin “Nëna Terezë” dhe e kanë organizuar protestën kundër privatizimit të PTK-së. Sheshi “Nëna Terezë” është i mbushur plotë me njerëz që po e kundërshtojnë privatizimin e PTK-së dhe, rrjedhimisht, po e kundërshtojnë edhe këtë buxhet, për të cilën po flasim ne sot këtu.

Se shteti zhvillimor është krejt ndryshe, është një shtet që ka ndarë mendjen të zhvillohet dhe nëse e ka ndarë mendjen të zhvillohet, i ndanë edhe paratë për t'u zhvilluar. Këtu te ne, kjo do të nënkuptonte rritje të theksuar të buxhetit për subvencionim të bujqësisë, rritje të investimeve në industri dhe miniera, krijim të fondit të rezervave shtetërore, krijim të kushteve të favorshme të tregut për prodhimin vendor, krijim të fondeve zhvillimore dhe qasje të lehtë të kapitalit për prodhuesit vendorë e kështu me radhë. Pra, rritje të prodhimit dhe të plasmanit të prodhimit, e me këtë edhe rritje të punësimit dhe rritje të të hyrave të brendshme tatimore për Kosovën, që do të na mundësonin buxhete tjera më të mëdha dhe më të balancuara, krijim të fondeve për shëndetësi e të mira sociale

që i përmbushin nevojat e secilit qytetarë, pavarësisht nëse janë studentë, punëtorë, pensionistë a të sëmurë, sepse këto janë nevojat e Kosovës.

Për të qenë më konkret, në vend se buxheti i shtetit tonë t'i ndajë 225 milionë euro vetëm këtë vit për ndërtimin e një rruge, sa janë planifikuar t'i paguhen Bechtelit, edhe pse ka shumë gjasa që gjatë këtij viti kësti të jetë shumë më i madh, pra deri në 400 milionë, në vend të 225 milionëve, ai do të duhej t'ia ndante një shumë shumë më të madhe dhe më domethënëse sektorit të bujqësisë. Zhvillimi i këtij sektori ka potencial për të punësuar dhjetëra mijëra qytetarë të Kosovës, si dhe do ta zhvillonte industrinë e përpunimit të ushqimit, e cila po ashtu do ta zbuste ndjeshëm papunësinë.

Në vend se t'i mbyllim krejt paratë tona në asfalt, duhet t'i investojmë ato në Trepçë dhe ta nxisim industrinë metalurgjike. Në vend se të planifikojmë ta shesim pasurinë dhe kompanitë tona publike, duhet të planifikojmë si t'i rrisim dhe forcojmë kapacitetet tona prodhuese dhe njëkohësisht t'i marrim fondet tona të gjeneruara nga privatizimi i deritashëm dhe t'i fusim ato në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit, duke krijuar kështu një fond zhvillimor për vendin.

Kështu do të rritej ekonomia, do të zvogëlohej papunësia dhe varfëria, si dhe do të rriteshin të hyrat buxhetore, e atëherë do të kishim të ardhura më të shumta edhe për infrastrukturë. Kështu, me buxhete të tilla vetëm sa po e vazhdojmë këtë mjerim, e ky mjerim është bërë kafshatë e pa kapërdijshme për popullin e Kosovës.

Prandaj, na tregoni, të nderuar anëtarë të Qeverisë së Kosovës, si e keni ndërmend ta bindni këtë popull për buxhetin të cilin na keni vendosur përpara. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Mendoj se hyrja e fjalës sime u ndërrua pak pas një margaritari që nga dha ministri Hamzaj.

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Po citoj nuk po parafrazoj. Zoti Hamzaj, ministri i Financave, tha kështu: "Një pjesë e buxhetit të Kosovës, do të thotë diku 300 milionë, do të mbushen përmes transferit të aksioneve të aseteve publike në asete private". Në vend se të thuhet shkurt, përmes privatizimit të postës. Mund të them që kjo fjalë, zoti Hamzaj, tregon se kultura e punës e kësaj Qeverie nuk ka ndërruar hiq prej kulturës së punës së Qeverisë së kaluar. Do të thotë, Qeveria është një makinë propagandistike që flet krejt diçka tjetër dhe bën krejt diçka tjetër. Mendoj se është e ndershme të na thuhet - shitja ose privatizimi, jo të na thotë transferi i aseteve, blla, blla, blla, më falni në shprehje!

Çështje tjetër është se, zoti kryeministër, Aleanca sinqerisht ka dëshirë ta shohë Qeverinë e Kosovës të suksesshme. Nuk është demagogji kjo çka po ju them, për shkak se Qeveria e suksesshme është jetë më e mirë për qytetarët e Kosovës. Ama kjo Qeveri e juaja, as e

kaluara, as e tashmja nuk po na jep as edhe një argument të vetëm që na të besojmë se ju po punoni për të mirën e vendit.

Tash po ju them edhe diçka çka tha kryeministri. Kryeministri tha - po i rrisim rezervat për situata të papritura. Ky buxhet i sivjetmi, po thotë, i rritë rezervat e shtetit për situata të papritura. Ndërsa ky buxhet parasheh 1 miliard e 264 milionë të hyra e 1 miliard e 434 milionë të dala, do të thotë më shumë shpenzon se që krijon, edhe duke e shitur postën, e në të njëjtën kohë edhe po e rritka rezervën! Me sinqeritetin më të madh, po ju them unë juve, ne këtu diçka në rregull nuk e kemi, do të thotë nuk është në rregull për shkak se kryeministri po flet qysh duhet të jetë, e po vepron krejt kontra. Ose për shembull, për Fondin Monetar Ndërkombëtar na foli një copë kohë. Edhe ne e dimë çka po thotë Fondi Monetar Ndërkombëtar. Ajo çka tha kryeministri është krejt e kundërta, çka në esencë po thotë Fondi Monetar Ndërkombëtar. Edhe në të njëjtën kohë kryeministri po na thotë që në Kosovë ka sukses, po rritet kjo, po rritet ajo, po rritet ajo, do të thotë fjali kryesore është - ka rritje të ndjeshme ose të dukshme. Po ma kujton një kohë kur përmendeshin edhe bimët foragjere që prodhoheshin, thoshin ka rritje të dukshme të prodhimit të bimëve foragjere. Po çfarë rritje të dukshme? Rritje të dukshme të shpenzimeve enorme - po, përmes shitjeve të aseteve nacionale, po jo përmes të hyrave.

Tash duhet të kaloj gjithqysh te fjala që e kam përgatitur, se s'po bën ndryshe.

Ky projektbuxhet po tregon se Kosova na hyrë në një rrugë të rrezikshme gati, gati pa kthim. Kosova ka pas ndërtuar një kulturë buxhetore. Do t'ju them se në vitin 2002 kemi pasur diku 360 milionë euro buxhet përafërsisht, shumë përafërsisht. Ndërsa në vitin 2004 kemi mbërrirë diku 470 milionë euro, do të thotë ka pasur rritje, me rritje të rezervave. Ndërsa prej dhjetorit të vitit 2004 deri në dhjetorin e vitit 2007, prej 470 milionë, buxheti i Kosovës ka mbërrirë në 1 miliardë e 50 milionë ose 47 milionë, me 400 milionë rezerva buxhetore. Krejt këto çka i fola, i ka trashëguar Qeveria paraprake e zotit Thaçi. 1 miliardë e 40 milionë euro buxhet, me 400 milionë euro rezerva buxhetore. A dini ku jemi sot? Me të hyra buxhetore diku 1 miliardë e 200 milionë, me shitje të postës, do të thotë, i hiqni 300 milionë, janë diku 900 e diçka milionë. I hiqni edhe donacionet që po i merr, që ndoshta i merr prej Bashkimit Evropian, Fondit Monetar e të tjerë, domethënë jemi diku 800 milionë të hyra e rezervat buxhetore në zero. Kjo është, do të thotë, çka kemi sot realisht, nëse dikush do ta shohë. Do të thotë, prej një mendësie të ndërtimit të buxhetit të kujdesshëm, të buxhetit jo deficitar, buxhetit i cili garanton stabilitet fiskal, kemi ardhur në një gjendje në të cilën i kemi disa të hyra të supozuara prej 1 miliardë e 434 milionë euro dhe po ju tregoj cilat janë ato të supozuara. Është krejt lehtë, i keni nëpër tabela. 70 milionë euro, thotë, donacione. Krejt në rregull, po e pranojmë. 50 milionë euro, thotë, Komisioni Evropian, ky komision i cili ka shkruar letër, i ka thënë - s'duam t'ia japim Qeverisë. 87 milionë FMN, që është kredi edhe grand, kredi e butë edhe grand. 7 milionë Banka Botërore njëjtë, 300 milionë, thotë, financimi i njëhershëm i transferimit të aseteve private, publike dhe ato private, domethënë 300 milionë posta është. Krejt këto grumbull bëjnë 514 milionë euro, të cilat Qeveria nuk i ka, po supozon që ka për t'i pasur realisht edhe për të pasur të paktën këtë 300 milionëshin, duhet të thuhet kushtetuta, duhet të thuhet kushtetuta, sot duhet të votohet bashkë edhe privatizimi i PTK-së, edhe votimi i buxhetit, që realisht nuk është diçka që Kuvendi duhet

ta bëjë. Kuvendi nuk guxon ta thyej kushtetutën, është jashtëligjshme, është edhe e pandershme.

Për t'u mbushur ky buxhet, në anën tjetër, kërkohen diku 130 milionë euro të hyra shtesë prej doganave. Ne si deputetë të Kosovës, që shumica prej nesh edhe nuk jemi ekonomistë, duhet të mendojmë. Qysh mund t'i rrisim të hyrat në dogana për 130 milionë euro, cila është metoda? Ose duhet t'i detyrojmë kompanitë për të blerë më shumë, edhe populli për të hëngër më shumë detyrimisht, edhe ata të papunët edhe krejt, se diqysh ai duhet të doganohet malli ose duhet të rriten tarifatat ose, fundi i fundit, duhet të zaptohen pikat 1 dhe 31. Nëse dikush prej jush mendon se cila do prej këtyre të triave bëhet, kisha pas dëshirë të dëgjoj, të më tregohet se qysh?

Po kaloj pak te shpenzimet, edhe një herë. Definitivisht që shpenzimi detyrimisht është po aq i papërgjegjshëm sa edhe grumbullimi, se s'ka qysh për të qenë ndryshe. Po jap një shembull. Prej vitit 2008, do të thotë me rishikim të vitit 2008 është paraparë ndërtimi i rrugës Komoran – Caralevë, janë dhënë mjetet. Për të njëjtën rrugë janë ndarë mjete edhe në vitin 2009.

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Për të njëjtën rrugë janë ndarë mjete edhe në vitin 2010 dhe po ju betohem çelni projektbuxhetet, për të njëjtën rrugë ndahen mjete edhe në vitin 2011. Kjo është mënyra qysh Qeveria e Kosovës në vitin e katërt të saj i shpenzon mjetet e buxhetit të Kosovës edhe qysh i rritë pagat, edhe qysh e shtinë Kosovën në borxh dhe i shet krejt asetet nacionale që të mund të financojë nga 4 herë të njëjtën rrugë. S'po kaloj diku tjetër.

Çështje tjetër është se duke pasur parasysh këtë mënyrë të shpenzimit, projekte të bartura nga viti i kaluar janë ... milionë euro, ndërsa projekte të reja kapitale i keni 43 milionë euro. Edhe kjo tregon se sa zhvillimor dhe sa "përparimtar" është ky buxhet i kësaj qeverie.

Tani, në tabela prapë gjen diçka tjetër. Gjeni që Qeveria më shumë po shpenzon mjete për vetura të veta, se sa për subvencionim të bujqësisë, i keni, merrni, mblidhni shifrat edhe e keni të qartë. Edhe a ju kujtohet ky i njëjti kryeministër, kur ka pas thënë para tri vjetësh, kemi për t'i hequr krejt veturat zyrtare, s'ka më të dilet jashtë me vetura zyrtare, s'kemi për të bërë kështu. Realisht, sot po t'i qorrojnë sytë vetura me shkronjën Z edhe prapë kanë për të blerë të tjera.

Në këtë buxhet ju mund të shihni që për ndërtim të objekteve qeveritare ndahen më shumë mjete se për krejt mjedisin edhe planifikimin hapësinor në Kosovë, që e kemi shumë problematik, shihni, edhe këtu i keni shifrat, e kjo e njëjta Qeveri para 3 vjet na ka pas thënë që brenda vitit s'ka për të pasur më institucione në objekte me qira. Në vitin e katërt hala i ka, edhe hala ndanë mjete për të ndërtuar më tepër objekte.

Diskutabile, e përmendi një deputet, është diskutabile sa po rriten pagat, por realisht kjo rritje e pagave na ka prurë deri në këtë ditë edhe nuk po dua të hyjë se a është 23% apo jo, 23% është totali i rritjes, me siguri se del pak më shumë për shkak se një kategori të

njerëzve nuk iu rritet paga, edhe pse punojnë në institucione. Kjo është diçka që duhet të shihet, po ajo që duhet definitivisht të përmendet, është se edhe premtimi ka qenë i papërgjegjshëm, nuk ka qenë i përgjegjshëm ai premtim dhe tash kemi ngelur në këtu në këtë situatë që duhet ta bëjmë një gjë të tillë dhe do ta bëjmë, me siguri!

Tani, rritja e pagave, disa fjali. Rritja e pagave për Kosovën prej buxhetit, prej mjeteve të cilat mbledhen nga secili qytetar i Kosovës, nuk është e barabartë, se dikujt i rriten, dikujt nuk i rriten. Atyre që nuk ju rriten janë punëtorët që punojnë në sektorin privat, janë pensionistët, këtu u përmendën por nuk ju rriten pensionet atyre, edhe janë të papunët, që janë diku 60% e popullit të Kosovës, atyre nuk ju rriten. Përderisa efekti i rritjes së çmimeve për shkak të rritjes së pagave është i barabartë, çmimet janë rritur për krejt qytetarët e Kosovës barabar, po dikujt i është rritur paga, dikujt jo. Edhe efekti total i rritjes së pagave, të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës, sipas të gjitha gjasave në fund të vitit do ta shohim se do të shkaktojë më shumë varfëri se sa përmirësim të jetës së qytetarëve të Kosovës.

Çështje tjetër tepër me rëndësi që duhet të përmendet, është që po na përsëritet edhe herën e katërt që kjo Qeveri bën buxhet, është ndarja jo e drejtë e mjeteve nëpër zona. Unë e di që këtu ka deputetë prej Suharekës dhe e kam marrë me qëllim Suharekën, si komunë, jo Gjakovën, se do të flet dikush tjetër, edhe po ju them diçka. Për tri vitet që vinë, nuk parashihet asnjë investim kapital në Suharekë. A ndërtohet kështu solidariteti mes njerëzve në shtetin e ri të Kosovës? Pse duhen qytetarët e Suharekës të jenë solidarë me qytetarët e një komune tjetër që udhëhiqet nga PDK-ja, nëse prej taksave të tyre mjetet shkojnë krejt diku tjetër dhe atyre nuk ju kthehet kurrgjë tjetër. Ky është shkatërrim i solidaritetit në mes njerëzve në shtet, njerëz nuk ndihen solidar...

KRYESUESI: Edhe një minutë!

ARDIAN GJINI: Së fundi, po kaloj te shitja e postës. Nuk ka nevojë të kamuflohet. Keni për ta shitur 300 milionë, po vitin e ardhshëm kur ta bëni buxhetin, nuk kenë për t'ua pasur as 300 milionë të postës, as 40 milionë dividendë që po ia merrni. Çka mund të shitni vitin tjetër? Pyetja është, zotëri qeverisë, çka doni të shitni vitin tjetër dhe po kaloj shpejt, në fund të fundit.

Para 20 viteve mësuesit, mjekët, administrata gjyqësore, të gjithë këta njerëz që sot po u rriten rrogat, bile edhe punëtorët e postës, që po protestojnë, i kanë lëshuar vendet e punës për mos t'iu nënshtruar Serbisë, kanë ndejë pa rroga për shkak të patriotizmit. Ata sot thonë - i duam rrogat edhe s'na ndien. A e dini pse thonë kështu? Për shkak se patriotët profesionistë që janë ulur mbrapa meje, i marrin më shumë se 2 mijë euro rrogë, i kanë krejt privilegjet dhe e kanë rrjepur vendin deri në skaj të skajit. Pse atyre t'ua ndiej pse bankroton shteti. Kurrkujt më, nuk ka nevojë t'ua ndiej askujt pse po bankroton shteti, kur nuk ua ndien njerëzve që paguhet për t'ua bërë patriotë. Faleminderit!

KRYESUESI: Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar kryeministër,
Të nderuar kolegë,
Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re e mbështet në parim Projektligjin për
buxhetin për vitin 2011. Janë me rëndësi tri komponentë në këtë projektligj.
E para, rritja e pagave,
Së dyti, vazhdimi i investimeve kapitale dhe
E treta, zvogëlimi i shpenzimeve për mallra dhe shërbime.

Natyrisht, kolegët nga grupi parlamentar do të japin edhe në fusha të veçanta veç e veç
rekomandimet dhe ne do të japim kontributin tonë në komisionet përkatëse. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, deputeti Rashiq e ka fjalën.

SAŠA RAŠIĆ: Hvala, gospodine prededavajući!

Poštovani premijeru,

Predstavnici vlade,

Kolege poslanici,

Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke svakako je razmotrila Nacrt budžeta
Vlade Kosova za 2011. i na čelu podržava ovaj predlog.

Svakako da želim ističi da smo sa ministrom za finansije imali određene konsultacije i da
ćemo te konsultacije nastaviti i određene preporuke koje budemo imali u vezi budžeta
dostaviti i ministru i kroz komisiju dati svoj doprinos da imamo dobar budžet. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit parlamentar “6+”, deputeti Enis Kervan.

ENIS KERVAN: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Sayın Baskan, degerli Başbakan ve kabinesi çok değerli milletvekilleri.

Bugün Kosova Cumhuriyeti 2011 yılı Bütçe tasarısı görüşülmektedir. 6+ Parlamenter
grubu prens’pte butceyi desteklemektedir

2001 Yılı bütçesinin kimi maddeleri ve içeriliğiyle ilgili bazı önerilerim de
bulunmaktadır. Dolayısıyla sözkonusu önerilerimin Genel Kuruldaki birinci okunuştan
sonra ana komisyonlarda dikkate alınması talebinde bulunmaktayım.

2011 Yasa taslağının 5. maddesi Bütçenin belediye dağılımını öngörmektedir. Fakat
Fakat 5. maddenin 3. paragrafındaki eğitim bümülümünde, özellikle Türk dilinde eğitim
görülen belediyelerde Türkçe eğitim için gerekli olan ayrıca bir yatırım öngörülmemiştir.
Okullardaki öğretmenlerimiz, eğitim müdürlüklerindeki koordinatörlerimiz, kendi
sahaları dışındaki teknik işlere de el atmak zorunda olup, olup konuyla ilgili Eğitim
Müdüriyetlerinde Türk uzmanlarına yönelik bütçe halen öngörülmemiştir.

Taslağın 5. maddesine dayanarak Türk toplumu için önemden olan Türkçenin resmi
kullanımda dil olduğu Priştine, Gilan, Mitroviça, Vuştri belediyelerinde Yerel Yönetimler

bakanlığı tarafından 2007/06 nolu İdari Yönerge'nin yürürlüğe girmesine rağmen yasal hakları doğrultusunda Türk dili üzere kadro elemanlarının teminatı için yine bir bütçe öngörülmemiştir. Planlama, belediyelerde değil, merkezi İdare Yönergesi'nin çıktığı merkezde öngörülmelidir.

Bütçe taslağının 10. maddesi Diğer bütçe dağılımını içermektedir.

10.maddenin 2. fıkrası RTK bütçesinin yüzde 5lik dağılımının topluluk medyalarına adandığını ve bu desteğin RTK yasasının 20. maddesiyle uyum içerisinde Kosova başbakanlık ofisi tarafından gerçekleştirileceği ifade edilmektedir. Benim bu konudada itirazım olacaktır. Sözkonusu Kosova'da Türk medyası olunca geçmişteki tecrübelerimiz bu bütçeden Türk medyalarının yararlanmadığını veya 2 sene önceki cüzi ödemelerinin bile kimi medyalarımıza gerçekleştirilmediğini bildirmekte yarar görüyorum. Bu yüzden bu maddede topluluklara yönelik ayrı ayrı planlamanın yerleştirilmesi gereğini uygun görüyorum.

Topluluklar ve Geri Dönüş Bakanlığı bütçesinin büyük bir çoğunluğunun, geri dönüşe yönelik planlandığını görmekteyiz. Oysa gereksinim duyulan diğer alanlara ve topluluk beklentilerine yeterince yer verilmediğini belirtmek istiyorum.

Kosova Cumhuriyeti Eğitim Bakanlığı tarafından Türkçe ders kitaplarının basılması ve basılan Türkçe ders kitapları müellif ve çalışanlarının ödeneklerinin bu yılki bütçede de ayrı bir kategoride öngörülmediğini ve bunun ileriye yönelik tekrar sorun yaratacağını belirtmek istiyorum.

Başbakanlıktaki topluluklar ofisinde de topluluklara yönelik ayrı ayrı bütçe dağıtımının olmayışı topluluklar arasında sıkıntı yaratacağı kanaatindeyim.

Son olarak Kosova Eğitiminde, sağlık, polis sektöründe ve diğer alanlardaki çalışanların maaş artışının bütçede öngörülmesini selamlar ve desteklerken, en yakın zamanda Kosovadaki emeklilerin de tamamen beklentilerini karşılamanın acil planlamaya alınması gereğini düşünüyorum.

Teşekkürler. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Radha është e deputetëve. Fjalën e ka deputeti Berat Buzhala.

BERAT BUZHALA: I nderuar zoti kryesues,

Zoti kryeministër, ministra,

Të nderuar deputetë,

Askush nuk ka pritur prej gjithë kolegëve, edhe të opozitës, që ta mbështet pakufishëm këtë projektbuxhet të propozuar nga Qeveria e Kosovës, mirëpo së paku do të ishte e ndershme që të përshëndet rritja e pagave. Unë e di që gjithë prej jush keni familjar, keni vëllezër, motra që punojnë në arsim, shëndetësi edhe sigurisht që ata ndihen mirë me këtë rritje të pagave. U përmend këtu varfëria, u përmend këtu mjerimi edhe skamja. E ka përmendur edhe kryeministri më herët. Këtu nuk ka pasur paga, ka pasur lëmoshë. Me 250 euro pagë, një familje prej 5 anëtarëve ka rrëshqitur në shportën e varfërisë ekstreme. Me rritjen e pagave edhe ato familje do të dalin nga ky mjerim, nga kjo skamje.

Në rritjen e pagave rritet edhe kualiteti, edhe efikasiteti, do të rritet kualiteti i jetës, do të rritet dhe do të zhvillohet ekonomia e vendit, sepse fuqia blerëse e gjithë atyre 70 mijë personave që do t'i ngrohë dora e Qeverisë, do të jenë..., (mirë de, kur të shkoni te shtëpia, ju tregoni edhe familjarëve të juaj se nuk jeni kundër rritjes së pagave). Efikasiteti, punëdhënësi, Qeveria në këtë rast, do të ketë mundësi më të mëdha që ndaj mjekëve, ndaj arsimtarëve, ndaj doganierëve të kërkojë efikasitet më të madh në punë, e deri tash ka qenë e pamundshme. Edhe ju e dini konkurrencën në arsim, pikërisht për shkak të nivelit të ulët të pagave ka qenë niveli i ulët i interesimit për të qenë arsimtarë, për të qenë profesorë. Arsimtarët kanë qenë të detyruar që t'i mbajnë nga dy puna, ndërsa tash paga do të jetë e dinjitetshme për ata njerëz. Çka është interesant të thuhet, është që edhe përkundër kësaj rritje, rreth 40% e buxhetit shkon në investime kapitale, pra nuk janë prekur në asnjë rast investimet kapitale. Ndërsa dikush e përmendi edhe autostradën, është e vërtetë, mirëpo përveç autostradës, edhe 50% të investimeve kapitale shkojnë në investime tjera kapitale, jo vetëm në autostradë. Është përmendur bashkimi kombëtar, e ka përmendur edhe zoti Pacolli, presidenti i vendit tash në Shqipëri. Unë nuk shoh rrugë tjetër përveç autostradës, përveç lidhjes me shtetin amë se si do të bëhet bashkimi kombëtar, si do të bëhet bashkimi ekonomik i Kosovës dhe i Shqipërisë. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Mbas këtyre margaritarëve të parafolësit... Buxheti sivjet për sigurimin e funksionimit të mirëfilltë të shoqërisë, pa dyshim që duhet bazohet në parametra ekonomike dhe në një vizion të qartë se ku dëshiron ta dërgojë një Qeveri një ekonomi të një vendi.

Projekti buxhetor i prezantuar nga Qeveri në këtë formë, është në kundërtënie me dy elemente themelore.

Nuk janë marrë për bazë parametrat ekonomikë për vendosjen e shpenzimeve dhe në mungesë të një vizioni të qartë, rritja e shpenzimeve ka bazë politike dhe nuk ka si pikë referimi realizimin e një strategjie të zhvillimit ekonomik.

Për më shumë, ky projekt propozim nuk merr për bazë dokumentin e vetëm ekzistent, atë të Kornizës afatmesme të shpenzimeve. Forma e vendosjes mbi zgjerimin e shpenzimeve, gjithashtu është në kundërshtim me praktikën e mira buxhetore, qasjes nga poshtë lartë, e cila qasje kërkon që secili entitet buxhetor apo shpenzues i parasë publike të vendos mbi ... apo propozimin mbi shpenzimet vjetore.

Rritja e shpenzimeve ka qenë jashtë praktikave normale dhe ligjore të parapara edhe me Ligjin mbi financat publike. Sigurisht, rritja e pagave ka dal si rezultat i premtimeve elektorale dhe jo si rezultat i rritjes së performancës së sektorit publik. Kjo shkakton një precedencë të rrezikshme, ku paraja publike shfrytëzohet për interesa të ngushta personale apo partiake.

Argumenti mbi gjendjen e rëndë sociale të punëtorëve të arsimit dhe shërbyesve të tjerë civilë sigurisht që qëndron, por gjithashtu gjendja e pjesës tjetër të popullatës e mjerë dhe e rëndë, po ashtu qëndron dhe me këtë buxhet asgjë nuk përmirësohet në këtë drejtim. Pa dyshim që s' duhet harruar asnjëherë edhe gjendjen e pensionistëve, këtu u tha, të cilëve për 3 vite vetëm 5 euro iu ka rritur pensioni, e kam fjalën për pensionistët kontributdhënës dhe po ashtu këtu parashihet një shtim i mjeteve për pensionistët, por nuk është rritje e pensionit të tyre në asnjë mënyrë, po parashihet kur të miratohet një ligj, i cili është në përgatitje, po është ligj për mendimin tonë, kur të vijë do ta themi mendimin, jashtëzakonisht i keq.

Po ashtu, Qeveria gjithashtu gjatë këtij viti ka kaluar, gjegjësisht ka planifikuar një reformim sektorit publik, në të cilin është paraparë edhe struktura e pagave e bazuar në performancë, e kjo nuk po ndodhë.

Deficit buxhetor mbi normat e pranueshme të Bashkimit Evropian dhe FMN-së rrezikon shterjen e saldosh së parasë së gatshme, e me këtë rrezikohet të futet vendi në krizë fiskale.

U thanë edhe më herët, por po e përsëris që mosmarrëveshjet me FMN-në rrezikojnë në mënyrë të sigurt 50 milionë eurot e Komisionit Evropian, 20 milionët eurot nga Banka Botërore, si dhe natyrisht 87 milionët në pikëpyetje vinë nga ato që parashihet t'i marrin nga FMN-ja.

Sigurisht, i gjithë koncentrimi edhe fjalimi edhe në fillim i zotit Thaçi ka qenë politik, siç ka qenë dhe mund të thuhet aspak s'ka qenë shpjegues të nevojës dhe të arsytimit për ato pozicione që i përmendi disa gjatë fjalës së tij. Po e përsëris, ka qenë, siç ka qenë çdo herë politik, edhe aty ku s' duhet të jetë politik. Nuk ka qenë dhe nuk është temë sot vetëm pagat, por është temë buxheti. Duke mos anashkaluar rëndësinë e pagave dhe duke mos anashkaluar rëndësinë dhe nevojën e përkrahjes së ngritjes së këtyre pagave, edhe këtu megjithatë po kamuflohet dhe nuk po u thuhet realisht qytetarëve dhe atyre që presin këtë rritje se pagat po u rriten ashtu siç është premtuar, që ne do ta mbështetnim gjithsesi, po kjo s'po ndodhë dhe këtu ka një marketing.

Pa këtë pjesë të mjeteve të buxhetit, ky buxhet është totalisht i paqëndrueshëm dhe jo zhvillimor.

Sigurisht që vendimi që ka qenë për ngritjen e pagave, ka qenë, e kemi thanë disa herë në atë kohë, një vendim tërësisht politik, vendim marketingu dhe se ky ka qenë politik dhe jo ligjor në atë kohë, vërteton fakti që edhe sot e kësaj dite katër muaj kalojnë, gjegjësisht tre muaj po kalojnë dhe kjo s'ka mund të realizohet sepse ka qenë i paligjshëm, sepse s'ka kaluar përmes Kuvendit të Kosovës.

Temë kundërshtuese, u thanë edhe disa fjali këtu, do të jenë me motive politike. Unë po pajtohem që nëse ka kundërshtime, mund të jenë më motive politike, po nuk janë nga ana jonë, po janë pikërisht nga ana e kryeministrit, që edhe këtu ka bërë politikë dhe po tenton të kamuflojë atë që s' mund të kamuflohet. Dhe, pa dyshim që për ne, u tha më

herët, por edhe për mua si deputet nuk mund të jetë i pranueshëm tentimi që neni 4, kur është thënë disa herë, te pjesa që ka të bëjë qartë me shitjen e Postës, tentohet të kamuflohet në këtë mënyrë dhe ky proces të kryhet kështu dhe të vihet para aktit të kryer. Ne kemi qenë, jemi për ekonomi të lirë të tregut, por jo në këtë mënyrë dhe absolutisht ne, gjatë fjalës u tha edhe më herët, në emër të grupit sigurisht që ne do t'i themi qëndrimet tona.

Thjeshtë, ky buxhet nuk siguron asnjë qëndrueshmëri ekonomike dhe fut vendin në një krizë sociale, për të cilën nuk do të dëshironim ta shohim në vepër, por kjo do të shihet shumë shpejt dhe mund të jetë qysh në fund të këtij viti ose në fillim të vitit të ardhshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar ministri i Brendshëm, Bajram Rexhepi.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: I nderuar zoti kryesues,
I nderuar zoti kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,
Të nderuar deputetë,

Nuk dua të flas shumë për arsye se shumë gjëra u thanë nga parafolësit dhe nga kryeministri, nga ministri i Ekonomisë dhe Financave. Duam shpjegime të duhura për këtë lexim të parë të Projektligjit për buxhetin dhe natyrisht që të gjithë jemi të vetëdijshëm se çfarë rëndësie ka aprovimi i buxhetit për funksionimin në përgjithësi edhe të institucioneve, edhe për paga, edhe të gjitha të tjera, pra është një ndër prioritetet më të larta jo vetëm të Qeverisë, por të institucioneve dhe jam i bindur se në atë frymë edhe do të diskutohet dhe me të drejtë presim që kjo të aprovohet dhe të vazhdojmë me sfidat tjera që na presin.

Dua të them disa gjëra që megjithatë kjo është një buxhet i balancuar relativisht mirë dhe, natyrisht, në këtë buxhet ka edhe investime kapitale që janë në rritje, ka më tepër transfere për komuna, ka rritje pagash dhe në asnjë mënyrë nuk e dëmton funksionalitetin qoftë të ministrive, qoftë të komunave dhe të tjerë.

Natyrisht që gjatë dëgjimeve që janë bërë të fundit, të gjithë duhet të jemi të vetëdijshëm që të kemi kursime aty ku mund të kursehet dhe kjo është plotësisht e drejtë dhe natyrisht që sidomos ky segment i rritjes së pagave duhet të konsiderohet si domosdoshmëri që është dashur të ndodhë për arsye se me vite të tëra, ta citoj kryeministrin, shumë rroga i kanë përngjarë më tepër ndihmës sociale dhe ka filluar rritja nga 2 – 3 vitet e mëparshme, mirëpo, megjithatë, nëse i kemi krahasuar këto rroga me rajonin, kanë qenë më të voglat dhe me të drejtë është dashur që për afërsisht të afrohemi sa u përket pagesave, rrogave me shtetet në rajon, ne nuk pretendojmë me shtetet më të zhvilluara, po kryesisht ngjashëm me rajon. Mos t'i përmend të gjitha ato kategori të cilat u përmendën dhe natyrisht që kjo do të reflektohet në përmirësimin e gjendjes sociale të gjithë shërbyesve civilë, po edhe të kategorive të tjera të cilat rreth 70 mijë familje do të kenë përfitime nga këto rritje dhe natyrisht që ka dilema se sa janë harmonizuar qëndrimet me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Natyrisht që bisedimet vazhdojnë edhe për çështje tjera. Mirëpo, Ministria e Financave i ka bërë shpjegimet e duhura nga vinë ato të hyra për këtë rritje të

pagave dhe kjo jo vetëm për vitin 2011, por edhe në bazë të kornizës afatmesme duhet të ketë qëndrueshmëri buxhetore edhe viteve të ardhshme dhe tehu i të gjitha këtyre të hyrave është rritja e performancës dhe të hyrave nga dy kategori, ku edhe bëhet mbledhja më e madhe e të hyrave, pra nëpërmjet doganave dhe administratës tatimore, lufta, zvogëlimi i informalitetit dhe kjo nuk do të thotë se kjo do të shkojë në dëm të biznesit, por një performancë shumë më e mirë edhe e doganave, edhe administratës tatimore, të cilët qysh në dy muajt e parë i ka dhënë rezultatet e para dhe janë shumë optimiste se do të tejkalohen të hyrat e planifikuara. Në anën tjetër, është edhe dividendën në atë drejtim dhe sigurisht që garancitë e plota janë dhënë të argumentuara për qëndrueshmërinë buxhetore jo vetëm për sivjet, por edhe për vitet e ardhshme. Dhe, të them nga një përvojë që kam pasur më parë, Fondit Monetar Ndërkombëtar i intereson sa ke qëndrueshmëri të të hyrave, sidomos të çështja e pagave. Sa i përket investimeve kapitale ose investimeve ad-hoc mund të lejojnë, mirëpo edhe në këtë drejtim edhe në bazë të kornizës afatmesme dhe shpjegimeve garantohet qëndrueshmëria buxhetore dhe makro-ekonomike.

Dëgjova nga parafolësit që shpeshherë ky buxhet nuk është i projektuar që ta zhvillojë ekonominë. Të bëjmë një dallim. Shtetet që kanë fuqi të madhe ekonomike, ato në raste të caktuara kur ekonomia e tyre ngec, lëshojnë mjetet, paratë nga buxheti i tyre dhe ndikojnë në zhvillimin ekonomik. Edhe Kosova, si shteti më i varfër në Evropë, po edhe shumë të tjera edhe të mesme, duhet ta dinë se buxheti është ndihmesë në zhvillimin ekonomik, por buxheti i shtetit nuk e zhvillon ekonominë. Shteti duhet të krijojë ambientin e mirë për investime, që i thonë ambient shëndetshëm, ose të themi i përshtatshëm me lehtësira të ndryshme dhe zhvillimi ekonomik e rritë buxhetin, pastaj që të kemi shërbime më të mira. Prandaj, kjo është një dallim. Natyrisht se s'do të thotë kjo se buxheti nuk ndikon. Ndikon, po investimet kapitale për momentin janë kryesisht në sektorin publik, janë në subvencione në bujqësi, ku fermerët mund të inkurajohen që prodhimet e këtyre vendore të përfitojnë, nga ato të përfitojë edhe Kosova dhe ta zbutë pak edhe raportin eksport – import, por natyrisht që edhe detyra e shtetit është që të krijojë infrastrukturë më të mirë, që të bëjë shërbime më të mira dhe investime, kryesisht investime private janë ato që e bëjnë zhvillimin ekonomik të mirëfilltë edhe mbledhja e taksave nga këta investitorë privatë e rrit edhe buxhetin e shtetit për shërbime më të mira. Faleminderit! unë s'desha shumë të përsëris, se shumë fjalë i thanë parafolësit, kështu që me kaq e përfundoj edhe apeloj që të jemi në nivel të detyrës dhe ta kuptojmë si prioritet jo vetëm të Qeverisë, por në përgjithësi të Kosovës për buxhetin. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Fjalën e ka kërkuar kryeministri, zoti Thaçi.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuari kryesues Haliti!
Të nderuar deputetë,
Unë do të ndërlihem vetëm në 2 – 3 çështje që u ngritën këtu, që kërkojnë sqarim para opinionit publik, po edhe para jush të gjithëve.

Ne i prezantuar qëndrimet tona si Qeveri e Republikës së Kosovës. I falënderoj të gjithë shefat e grupeve parlamentare mbështetës të Projektbuxhetit për vitin 2011, i vlerësojmë

me respekt edhe opinionet e ndryshme që u paraqitën gjithashtu sot në këtë debat. Por, dëshiroj të theksoj se këtu e tërë esenca e diskutimit po ndërlidhet në 3 – 4 çështje.

E para, tek premtimi im dhe mbajtja e premtimit, e zotimit dhe fillimit të realizimit sot për rritjen e pagave për mësuesit, personelin shëndetësorë, shërbyesit civilë, policët, pjesëtarët e FSK-së, doganierët, inspektorët tatimorë, zjarrfikësit, gjithashtu edhe marrëveshjet me minatorë, kategoritë e luftës, invalidët e luftës, familjet e dëshmorëve.

Është e vërtetë se ne kemi pasur debate edhe gjatë fushatës elektorale dhe dikush ka premtuar andej, dikush këndej, dikush s'ka guxuar as të premtojë. Fushatat elektorale, zgjedhjet e lira mbahen për të prezantuar ofertë, alternativë, vizion. Prandaj, Qeveria e Kosovës e ka vizionin shumë të qartë që del nga vullneti i qytetarëve të Kosovës, nga besimi i qytetarëve të Kosovës, e ai besim është shumë i qartë, i pranuar dhe i njohur nga të gjitha partitë politike dhe gjithë bota demokratike.

Kështu që e ritheksoj edhe njëherë, ai vendim është i Qeverisë së Kosovës, ndërsa rritja e mirëqenies sociale do të ndodhë për të gjitha kategoritë dhe këto të mira do t'i gëzojnë punëtorët e Kosovës. Është shqetësuese deklarimi hezitues apo kundërshtues për rritjen e pagave nga disa zëra të deputetëve që u dëgjuan këtu.

As mësuesit, as policët, as punëtorët shëndetësorë, as kategoritë tjera që i kemi përmendur nuk janë të një apo të kësaj apo asaj partie, as të pozitës, as të opozitës, por janë njerëzit e nderuar e të respektuar të Kosovës, para të cilëve kemi obligim të gjithë. Dhe, unë kam besuar se pikërisht ky vendim i Qeverisë në shërbim të gjithë qytetarëve të vendit, do të jetë ai i cili do t'i ofrojë edhe pikëpamjet, por edhe qëndrimin unik të Kuvendit të Kosovës në vendimmarrje për diskutimin, natyrisht, se unë sikur të isha në pozitën tuaj apo tuajën, do të kërkoja pse s'janë rritur rroga 100% jo 50%, po 100%, e jo të atakohet Qeveria që po e realizon një domosdoshmëri, një nevojë jetike për qytetarin e Kosovës.

Në anën tjetër, shprehen kritika pse po investohet në një projekt. Nuk përmendet projekti. Ai projekt të cilin po e kritikoni, po e refuzoni dhe kundërshtoni, disa prej deputetëve, e ka emër dhe mbiemër. Është autostrada Vërmicë – Merdare, rruga pra, autostrada "Ibrahim Rugova". Ai projekt ka filluar vitin e kaluar, sivjet për te janë ndarë mjetet që i keni lexuar. Ai projekt do të vazhdojë deri në Merdare dhe nuk do të ndalet së punuar asnjë ditë për 24 orë në ditë e natë, që është duke u punuar edhe tani.

Ju informojë se me 30 tetor është planifikuar, do të thotë, inaugurimi i pjesës së 34 kilometërshit të parë të autostradës moderne, do të vazhdohet në sektorin e katërt dhe ju informoj gjithashtu se planifikojmë që edhe sektorin e pestë ta fillojmë sivjet.

U tha, marketing politik. As edhe një herë dhe ju të gjithë e dini, e dinë edhe të gjithë qytetarët e Kosovës, ai projekt nuk është një projekt, ai është projekti i Kosovës, ai është projekti integritit kombëtar dhe euroatlantik, ai është projekti jetik për qytetarët e Kosovës. Prandaj, të hezitohet dhe të kundërshtohet ai projekt, është qasje plotësisht jo në përputhshmëri me vullnetin e qytetarëve të Kosovës, jo e drejtë politikisht, prandaj unë

kërkoj që ai projekt të mbështetet nga të gjithë. Për çdo rrethanë, unë nuk do ta ndalë, do të vazhdoj deri në Merdare dhe do ta përbyll. Ka qenë projekt i ëndrrave të qytetarëve të Kosovës, ne po e realizojmë sot së bashku dhe është para së gjithash meritë e qytetarëve të Kosovës.

U përmendën komunat, unë nuk dëshiroj sot të hyjë këtu në krahasime se sa janë investuar në këtë komunë apo në atë komunë. Po ju siguroj edhe garantoj se nuk ka favorizime apo diskriminime në baza politike, të përkatësive partiake që i udhëheqin komunat e caktuara. Nëse jeni të gatshëm për debat, mund të bëjmë krahasime për çdo vit. Edhe pushtetet janë ndërruar këtu dhe është mirë që janë ndërruar, uroj që të ndërrohen edhe në të ardhmen e duhur, kur të vlerësojnë qytetarët e Kosovës. Por, u përmend Theranda, Suhareka. Unë, vetëm për informimin e deputetit të mëparshëm që e përmendi, theksoj se edhe Prizreni, edhe Theranda apo Suhareka, siç ke qejf për të thënë, sivjet dhe vitin e ardhshëm do të jetë përfituesja historike e investimeve, sepse përgjatë tërë territorit trup e tërthor Therandës do të kalojë autostrada.

Prandaj, unë ju ftoj të shkoni edhe ta vizitoni, shkoni dhe vizitoni dhe i shihni investimet që po ndodhin. Natyrisht që do të kalojë edhe për Malishevë, do të vjen në Prishtinë, do të kalojë edhe në Besianë, deri në Merdarë dhe ka filluar nga kufiri me Shqipërinë. Kështu që unë ju ftoj që në këto tri çështje të jemi shumë korrektë, sepse janë në interesin e gjithë qytetarëve dhe të shtetit të Kosovës, nuk janë në interesin e ngushtë të asnjë individi, të asnjë Qeverie, të asnjë partie, por në interesin e të gjithëve. Ju faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit!

Zoti Mujota e ka kërkuar fjalën përpara. A replikë, okej, zoti Hamiti ka replikë, po s'ta ka përmendur emrin. Po, jo burrë, në çdo diskutim s'mundesh ti replikë të bësh.

FEHMI MUJOTA: Faleminderit!

I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Për të pasur parasysh të gjitha elementet e buxhetit që kanë të bëjnë me Ministrinë e Infrastrukturës dhe për të tërhequr vëmendjen e çdo deputeti që në rast të përdorjes së ndonjë krahasimi apo fakti, të ketë parasysh në mënyrë të saktë të gjitha tabelat. Do të përpiqem që të prezantoj në mënyrë të saktë planifikimin e buxhetit për Ministrinë e Infrastrukturës dhe mbi bazën e cilave objektive strategjike është hartuar.

Objektiva strategjike të Ministrisë së Infrastrukturës përfshinë integrimin e infrastrukturës transportuese të Kosovës në rrjetin kryesor rajonal, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e rrjetit aktual rrugor, shtimin e sigurisë në rrugë dhe zhvillimin e infrastrukturës hekurudhore dhe zhvillimin e transportit ajror.

Për vitin 2011, Ministria e Infrastrukturës ka përfituar një buxhet prej 276 milionë euro për funksionimin e saj. Ky buxhet është i ndarë në pesë kategori ekonomike, që do të

paraqes më poshtë në mënyrë të specifikuar për të eliminuar çdo interpretim të gabuar të këtij buxheti.

Në kategorinë Paga dhe Mëditje, Ministria ka përfituar një buxhet në vlerë prej 1 milion e 207 mijë euro. Ky buxhet përfshin edhe rritjen prej 30% të pagave për shërbyesit civilë.

Në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve, Ministria ka përfituar një buxhet në vlerë prej 10 milionë euro dhe kjo kategori ndahet në dy nënkategori për të mos pasur keqkuptim, janë dy nënkategori të mëdha që duhet caktuar nënkategoritë në mënyrë të saktë, sepse do të bëni gabime gjatë interpretimit.

Në Mallra dhe Shërbime kapet shuma prej 910 mijë euro, ndërsa mirëmbajtja e rrugëve nacionale dhe regionale ka vlerën prej 9 milionë euro. Siç shihet, shuma më e madhe është ndarë për mbulimin e shpenzimeve që dalin nga obligimet për mirëmbajtjen e rrugëve nacionale dhe regionale. E ky buxhet ende është i vogël për mbulimin dhe funksionimin normal të kësaj kategorie dhe, natyrisht, në të ardhmen do t'i kushtohet një vëmendje më e madhe.

Në kategorinë e Shpenzimeve Komunale, Ministria e infrastrukturës ka përfituar një buxhet në vlerë prej 108 mijë euro dhe ky buxhet do të shërbejë për mbulimin e shpenzimeve për 11 objekte të para në shtatë regjione të Republikës së Kosovës që janë pjesë e funksionimit të kësaj ministrie.

Kategoria e Subvencioneve dhe Transfereve ka përfituar një buxhet për vitin 2011 në vlerë prej 2 milionë e 103 mijë euro. Ky buxhet është ndarë në atë mënyrë që mbulon funksionimin e dy programeve që kanë të bëjnë me fushën e subvencioneve.

Programi i Transportit Humanitarë Rrugor në vlerë prej 1 milion e 11 mijë euro dhe Programi i Transportit Humanitar Hekurudhor në vlerë prej 1 milionë e 91 mijë euro.

I pari ka të bëjë me subvencionimin dhe ndihmën e lëvizjes së lirë për të gjitha komunitetet e Kosovës nëpërmjet autobusëve qarkullues dhe nëpër zonat që konsiderohen si të veçanta në kuptimin e sigurisë fizike, si ato Mitrovicë e Veriut, Kamenicë, Gjilan, Graçanicë dhe vende të tjera.

Por, vëmendja kryesore duhet tërhequr tek shpenzimet kapitale. Ministria e Infrastrukturës për këtë kategori ka përfituar një buxhet në vlerë prej 263 milionë e 533 mijë euro. Ky buxhet do të dedikohet kryesisht në mbulimin e investimeve në dy fusha që janë më kryesore dhe me prioritetin e parë.

Projekti i autostradës Morinë – Merdarë ka buxhetin në vlerë prej 225 milionë euro dhe projekte të tjera do të kenë buxhet në vlerë prej 38 milionë 533 mijë euro dhe këtu dua të tërheqë vëmendjen sërish në dy aspekte.

Buxheti prej 225 milionë euro është buxhet i planifikuar për mbulimin e shpenzimeve për projektin e autostradës, që nënkupton se po punohet në katër segmente, të cilat i përmendi

edhe kryeministri. Dhe, natyrisht, buxheti prej 38 milionë e 533 mijë euro është buxhet që do të investohet në mbulimin dhe vazhdimin e projekteve të vjetra të infrastrukturës rrugore që janë vazhdimësi prej vitit 2010, 2011 dhe do të kemi disa prej tyre edhe në vitin 2012.

Ndërsa, projekte të reja që do të zhvillohen në këtë vit, do të kemi rreth 13 projekte ose 13 projekte saktë, do të kemi rreth 12 milionë investime të reja.

Por, nëse dëshiron dikush të specifikohet secili projekt, në secilën komunë për vitin 2011, unë mund të paraqes edhe tabelat e sakta për projektet të cilat kanë qenë të parapara në vitin 2010, 2011, 2012, që nënkupton se është një zhvillim i jashtëzakonshëm në një projektim shumë të saktë të këtij buxheti, të cilën, këtë ministri e ka udhëhequr ministri Limaj dhe unë e falënderoj publikisht për një prezantim të tillë të këtij buxheti.

Dhe, në fund dua tërheq një vëmendje tek deputeti Gjini, i cili përmendi Suharekën. Secili prej juve mund të përmend secilën komunë dhe unë do të ofrojë pasqyra të sakta. Por, nuk e besoj që zoti Gjini nuk e ka kuptua se Samadrazha dhe Studenqani nuk janë fshatra në komunën e Suharekës. Prandaj, dua të ju them që në Samadrazhë do të investohen 158 mijë euro në këtë vit, ndërsa në Studenqan, nga 1 milion e 256 mijë euro, që është një projekt i paraparë, këtë vit janë të siguruara 700 mijë euro. Prandaj, të keni kujdes kur përmendni komunat, për jo saktësinë që i përmendni. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Për replikë është lajmëruar Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Me qenë se nuk është këtu, unë veç do të doja të pyes shkurt. A janë rritë rrogat prej 1 janarit, a po rriten 50, 40 dhe 30%, për këtë duhet të japë përgjigje kryeministri dhe që të dyja, po them, janë negative. Nuk është e vërtetë që ka hezitim dhe mos të tentojë me këtë lojë politike ta qesë topin diku, që dikush është kundër rritjes së pagave. Nuk është e vërtetë ajo që e thotë, po as s'po e realizojnë si e kanë premtuar, sepse s'ka pasur as bazë ligjore ngritja që e kemi thënë në atë kohë, sepse po vërtetohet që ky Kuvend po duhet të vendosë. Ky ka qenë kontestimi vazhdimisht i LDK-së dhe jo kontestim diçka tjetër, prandaj mos të tentojë t'u qesë pluhur syve qytetarëve. Ne e kemi kontestuar mënyrën e premtimit, sepse s'ka vendosur Kuvendi për buxhet. Kjo ka qenë arsyeja dhe s'po realizohet as 50, as 40, as 30%. Prandaj edhe nëse s'përmenden emra, qytetarët e dinë ku po aludon. Prandaj, po e them që përsëri është marketing politik i pastër.

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti. Fjalën, jo replikë.

SABRI HAMITI: Nuk do të përmend emra, sepse po thotë kolegu im, që e ka emrin, po është duke udhëhequr, prapë s'ia përmend emrin. Do të përpiqem, asnjë ministër që e respektoj shumë, që po lidhet këtu, mos t'ia përmend emrin sepse është problem, sipas kolegut tim që po e udhëheq seancën, sepse s'duhet të përmendet emri. Me të gjitha rregullat, ekziston emri kur përmendet, që më bëhet replikë apo replika bëhet edhe për

materien, e cila aludon ose mendimi që i orientohet një njeriu ose një grupi, në këtë rast ka të bëjë edhe me grup.

Pra, rrogat e nëpunësve civilë duhet të rriten, është keq që nuk rriten sa duhet, sepse s'ka para, të bëhemi të qartë me veten dhe me qytetarët. Është çështje tjetër kur ajo premtohet nga një zyre partiake dhe në kohën e propagandës zgjedhore. Diferenconi sendet, se jemi kaq moti një pjesë këtu në parlament edhe i dimë këto punë.

E dyta, nëse të ardhurat, rrogat, rroga janë ato, tentojnë të rriten, është mirë që të kenë mbulesë. Ato rriten për të gjithë, por duhet të ketë mbulesë me çka paguhen ato. Po e zëmë, unë po them që janë pak 30%, në kuptimin e voluntarizmit dua 60%, po ajo është fluskël, fjalë goje nëse unë e them këtë - s'ka mbulesë. Kjo farë ideje ka dalë si propagandë parazgjedhore, është bërë vendim Qeverie në kalim dhe tash ne po bisedojmë në Kuvendin e Republikës së Kosovës a ekzistojnë fondet që ajo të ndodhë. Unë edhe një herë po them tash, në emër tim, po, duhet të ndodhë, po, duhet të ketë rritje, po, duhet të ketë mbulesë dhe kjo u krye.

Tash është problemi i autostradës prej një kufiri në kufi të Kosovës. Absolutisht, është projekt që se kundërshton askush, veç se as të mos krekoset kush për te veçanërisht, sepse nëse është projekti i Kosovës, është projekt i Kosovës. Dhe, prapë është një ministër që unë s'mund t'ia përmendi tash emrin, duhet ai të krekoset sepse ka qenë ministër sektori, nëse kjo është projekt i madh i Kosovës dhe i Qeverisë. Edhe kujtesën, mos të harrojmë, ne kemi kujtesë këtu. Ne kemi pasur një Qeveri me Hashim Taçin në koalicion LDK-ja, 3 vjet. Nëse 3 vjet edhe Hashim Thaçi, që tash ia përmenda emrin me qëllim, edhe LDK-ja, që po ia përmendi me qëllim, 3 vjet a se paskan ditur këta që s'paskan marrë rrogë njerëzit, po paskan pasur ndihma sociale, a? Po këta kanë sunduar, edhe Hashimi, edhe LDK-ja dhe e paskan zbuluar tash sot, për kuptimin e të folurit propagandistik që gjithë njerëzit në Kosovë paskan ndihma sot. Atëherë, nëse këto nuk kanë qenë rroga, po kanë qenë ndihma sociale, kjo Qeveri dhe ne sot s'po bëjmë gjë, veç po e shtojmë për 20% ndihmën sociale. A, me të folurit që po përdor. Kaq! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Kryesues dhe deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Pyetja se a të rriten apo mos të rriten pagat për punëtorët e sektorëve publikë, është një pyetje e cila bile as që nuk duhet të shtrohet, sepse kësaj pyetje i dihet përgjigja. E kjo është se rrogat është dashur të rriten edhe më shumë, edhe më herët. Kurse gjysma e popullit të Kosovës, që janë aktualisht pa punë, së pari shpresojnë dhe presin të kenë një rrogë një ditë, sepse atë nuk e kanë hiq. Punëtorët e sektorëve publikë kanë të drejtë të jenë të pakënaqur dhe kanë të drejtë në rritje pagash, aq më tepër kur shokët e kryeministrit nëpër borde kompanish publike i kanë pagat deri 40 herë më të mëdha se sa mjekët apo policët e Republikës së Kosovës, apo kur njerëz të tillë bordesh së bashku madje marrin edhe miliona euro bonuse dhe në kohën kur të ardhurat e një pensionisti për dy vite rresht janë po aq sa kushton vetëm rrota e xhipit luksoz të një ministri. Kjo pabarazi është diçka që nuk përbihet, prandaj populli me të drejtë edhe po revoltohet.

Madje, edhe ne deputetët i kemi pagat shumë të larta, prandaj mendoj që duhet të punojmë për zbutjen e dallimit mes rrogave tona me ato të punëtorëve të sektorëve tjerë publikë. Dhe, pastaj shtrohet pyetja si mund ta përfaqësojë popullin e varfër, me një euro në ditë, një zyrtar politik me mbi 2000 euro të ardhura në muaj. Në këtë Kuvend ka deputetë dhe pushtetarë që krejt karrierën e tyre e kanë harxhuar duke punuar për t'ia shtuar vetes privilegjet dhe pagat.

Ne nuk kemi problem me rritjen e pagave të punëtorëve të sektorëve publikë. Madje rritjen e pagave e inkurajojmë. Ajo me çka kemi problem në projektbuxhetin e qeverisë, është mënyra që është gjetur për ngritjen e këtyre pagave.

Së pari, rritja e pagave është bërë praktikë e premtimeve elektorale. Kjo do të thotë që Qeveria ka bërë përpjekje për ta blerë pushtetin. Ne mendojmë që rritja e mirëqenies së qytetarit nuk do të jetë diçka që Qeveria ia kushtëzon qytetarit me votë. Ky është keqpërdorimi më i madh i parasë publike, e cila tek e fundit, është e qytetarëve si taksapagues. Mirëqenia e qytetarit duhet të jetë obligim shtetëror dhe jo fushatë zgjedhore për zgjatjen e pushtetit.

Problemi i dytë që kemi në këtë politikë ekonomike të Qeverisë, ka të bëjë me faktin se Qeveria në njërin anë po ua vendos punëtorëve të sektorëve publikë një shumë simbolike në xhep, po në anën tjetër po atë xhep ua ka shqyer, prandaj paratë po avullohen menjëherë.

Rritja e parë e çmimeve ka ndodhur tashmë ende pa u rritë pagat, realisht, kurse me siguri që edhe një tjetër rritje çmimesh do të ndodhë atëherë kur pagat me rritje do të merren, realisht. Vetë premtimi i Qeverisë për ngritje pagash në të vërtetë i ka ngritur çmimet, gjë që automatikisht e ka anuluar përparësinë e ndjeshme të ngritjes së pagave. Sipas Entit të Statistikave, çmimi i shportës së ekonomisë familjare është ngritur, prandaj ngritja e pagave fatkeqësisht nuk do të ketë efekt të ndjeshëm në mirëqenien e qytetarëve të Kosovës. Dhe, tash kur pritet që çmimet të rriten sërish pas marrjes së pagave të ngritura, siç është për shembull buka që pritet të shkojë deri në 50 centë, qytetari i Kosovës do të ishte fort i lumtur po që se muajin do të mund ta mbyllte pa borxhe.

Ngritja e pagave kështu qysh po bëhet nga Qeveria, pra në mënyrë krejtësisht artificiale, do të kishte ndonjë efekt në mirëqenien e qytetarëve po që se Qeveria do ta mbronte po ashtu popullin si konsumator nga manipulatorët dhe monopolizuesit e ngritjes së kontrolluar të çmimeve, kryesisht të produkteve bazike të jetesës, si dhe të derivateve, që në Kosovë janë më të shtrenjtat në Evropë. Por, qeveria nuk mund ta mbrojë popullin nga këta manipulues, meqë pikërisht këta manipulues dhe monopolizues janë financues të pushtetarëve dhe të fushatave të tyre zgjedhore. Prandaj, krejt çka bëjnë këta politikanë kur vinë në pushtet, janë shpërblimet dhe përmbushja e detyrimeve të marra.

Problem tjetër në këtë strategji qeveritare për ngritje të pagave është edhe mënyra se si është paraparë gjetja e parave për ta realizuar këtë qëllim. Po e shesin shumë lirë, për të mos thënë falë, Postë-Telekomin e Kosovës për t'i ngritur pagat. Dhe, këtë gjë po e bëjnë në mënyrë klandestine, duke e futur shitjen e PTK-së brenda planifikimit buxhetor. Kjo

nuk është vetëm dhënie me një dorë dhe marrje me tjetrën, siç po e bën Qeveria me ngritjen e pagave dhe njëkohësisht me ngritjen e çmimeve. Kjo tashmë me PTK-në është edhe futje e dorës së Qeverisë në xhepin e ardhmërisë. Këtu Qeveria i ka futur duart në xhepat e fëmijëve tanë dhe në xhepat e atyre që nuk kanë lindur ende. Qeverisë nuk po i mjafton vetëm shlyerja e historisë dhe keqpërdorimi i të tanishmes, po tash po na cenohet edhe ardhmëria. Pagat e rritura në këtë mënyrë nuk mund të jenë të qëndrueshme dhe kjo është sikur ta shesësh Kosovën, ta kthesh atdheun në para e pastaj të jetosh derisa t'i harxhosh ato para, pas të cilave nuk do të mbetet as atdheu, as paratë.

Një herë e shitën Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, tash PTK-në, pastaj kanë paralajmëruar për KEK-un, me siguri që do t'i vijë një ditë radha edhe Trepçës dhe shtrohet pyetja a do të na i privatizojë kjo Qeveri një ditë edhe ajrin.

Shuma e nevojshme për ngritjen e pagave sipas këtij buxheti, është planifikuar të jetë mbi 70 milionë euro, kurse të njëjtën kohë deficitit tregtar i Kosovës pritet të rritet mbi 180 milionë euro. Çka do të thotë ky raport? Ky raport do të thotë se Kosova do të vazhdojë të eksportojë edhe më shumë para, pa arritur të krijojë njëkohësisht bazë të qëndrueshme të rritjes graduale ekonomike përmes prodhimit, e cila do të gjeneronte ngritje graduale pagash, vetvetiu. Kjo politikë e vulos përfundimisht këtë nivel të ngritjes së pagave për një kohë të gjatë, kurse nevojat e qytetarëve do të vijnë duke u rritur nga dita në ditë.

Në fund, problematike për neve mbetet edhe data që e ka zgjedhur Qeveria për ngritjen e pagave, por e dimë që kjo gjë nuk ju ka bërë përshtypje, meqë për ta një prill është shumë shpesh, gati po thuaj se për çdo ditë.

I ftoj deputetët e këtij Kuvendi që ta dëgjojnë zërin e popullit dhe të punëtorëve të PTK-së, të cilët janë duke demonstruar jashtë këtij Kuvendi dhe jo zërin e interesit të politikanëve, që për pushtet po e shesin ekonominë e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka deputeti Blerim Shala.

BLERIM SHALA: I nderuar kryesues,

Kabinet i qeverisë,

Të nderuar deputetë,

Buxheti i Republikës për vitin 2011, për të cilin po flasim këtu sot, ka një histori të veten, që më së miri i shfaq përmasat e krizës institucionale, politike, ekonomike dhe sociale në të cilën gjendet Kosova. Jemi vonë me punën e buxhetit, por jemi vonë edhe me të gjitha çështjet tjera të cilat përkojnë me ekonominë dhe politikën e Kosovës.

Qeveria e Kosovës me këtë buxhet po përpiqet me mish e me shpirt të na tregojë që është në rrugë të drejtë, që me këtë buxhet do të instalojë paqen sociale në Kosovës, që madje ky buxhet flet për një perspektivë afatmesme ekonomike të vendit dhe që njëkohësisht Qeveria ka ruajtur raportet e mira me Fondin Monetar Ndërkombëtar, me të cilin Qeveria e Kosovës në korrikun e vitit 2010 ka nënshkruar se me arazhmanin, i cili është çelës për marrjen e ndihmës financiare ndërkombëtare për Kosovën. Fatkeqësisht, për qytetarët e

Kosovës, asnjëri prej këtyre qëllimeve nuk sendërtohet me Ligjin për buxhetin e Kosovës për vitin 2011, ndërsa gjendja sociale e kosovarëve është me e keqe se kurrë. Vetëm 3 prej 10 kosovarëve me moshë pune janë të punësuar. Varfëria ka mbërrirë në shkallën prej 49%, varfëria e skajshme godet 22% të qytetarëve të Kosovës. Aktualisht me skemat sociale në fuqi, me ... buxhetin e Qeverisë, diku 156.267 të varfër të Kosovës janë të ndihmuar nga Qeveria dhe ata marrin në ditë 0.51 centë, gjë që së shpejti nuk do të mjaftojë për një bukë të vetme. Qindra mijëra kosovarë të tjerë janë në mëshirë të fatit dhe në realitetin e fatkeqësisë. Po, t'i kthehemi vetë propozim - buxhetit për vitin 2011.

Së pari, sa i përket paqes sociale, nëse analizohet propozim – buxheti, shihet që rritja e tashme e rrogave në sektorin publik është e para dhe e fundit për tri vitet e ardhshme. Në ndërkohë, për shkak të inflacionit të parashikuar prej vetë Qeverisë, do të ndodhë zhvlerësimi i kësaj rritjeje. Nëse TVSH do të rritet prej 16 në 19%, siç është paralajmëruar, për shkak të pasojave që do të ketë kjo rritje në shportën familjare, vlera e rrogave në fund të këtij viti do të jetë realisht më e ulët se sa që ka qenë në fund të vitit 2010. Po del që kjo rritje e rrogave në fakt është një iluzion afatshkurtër.

Së dyti, me rritjen e paraparë ekonomike për 5 vitet e ardhshme, në këtë propozim - buxhet do të kemi shtim të papunësisë, rritje të varfërisë, thellim të pakënaqësisë sociale. Për ta zvogëluar papunësinë ..., duhet 10 vjet zhvillim ekonomik prej së paku 7% në vit. Kjo është një shifër e pa arritshme për Qeverinë e Kosovës. Qeveria e Kosovës llogaritet edhe kur bëhet fjalë për këtë rritje modeste ekonomike në investime private, të cilat vjet kanë rënë për 0.9%, sipas shënimeve të vetë qeverisë, e tash pritet të rriten me një normë mesatare prej 13.4%, gjë që është larg realitetit. Po del, pra, që Kosova nuk do të ketë zhvillim të mirëfilltë ekonomik, por një vizion afatmesëm qeveritar.

Së treti, sa i përket relacioneve të Qeverisë së Kosovës me Fondin Monetar Ndërkombëtar, Qeveria e kryeministrit Thaçi ka arritur që brenda një periudhe fare të shkurtër kohore, që nuk kap as 9 muaj, të shkel disa herë mbi Marrëveshjen Stand - by, të dakorduar me FMN-në në korrik të vitit 2010. Kosova e cila është anëtare e FMN-së që nga viti 2009, nuk guxon të sillet me kaq shpërfillje dhe papërgjegjësi, sepse tutje degradon edhe ashtu pozitën e keqe ndërkombëtare, rrezikon me këtë sjellje anëtarësim në BERZH, në Bankën Ekonomike për Rindërtim dhe Zhvillim dhe gjithsesi mëdysh mundësinë e marrjes së përkrahjes financiare ndërkombëtare, e cila në këtë propozim - buxhet është 140 milionë euro.

Së katërti, ky propozim buxhet flet për një mungesë të vizionit për zhvillimin ekonomik të Kosovës, sepse të hyrat thuaj se në tërësi lidhen me funksionimin e doganave të Kosovës e jo me kapacitetet prodhuese vendore. Për shembull, për bujqësinë në këtë buxhet janë të ndarë më pak se 1%, edhe pse bujqësia dhe agrobiznesi bëjnë një të tretën e Bruto Prodhimit Vendor, 25% të eksportit dhe njëkohësisht dy të tretat e të varfërve jetojnë në mjediset rurale. Pra, investimet eventuale në bujqësi do t'i ktheheshin shumëfish Kosovës dhe do të kontribuonin për stabilitetin social. Të konkludojmë, ky propozim - buxhet i Qeverisë së Kosovës paralajmëron vazhdimin dhe thellimin e krizës ekonomike dhe sociale në Kosovë. Kosovën e presin ditë të rënda në të gjitha fushat, do

të ketë deficit të parave, deficit të propozimeve të qëndrueshme për zhvillimin ekonomik dhe mirëqenie sociale, deficit të kredibilitetit politik.

Me këtë buxhet, Qeveria e Kosovës do të jetë keq me qytetarët e vet, keq me bashkësinë ndërkombëtare, keq me të gjithë. Në fund, do të jetë keq me vetveten. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka ministri Bedri Hamza. Këta kanë përparësi ministrat, sa herë që ta kërkojnë fjalën, është buxheti, kjo është si rregull.

BEDRI HAMZA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Fillimisht më lejoni t'ju falënderoj për të gjitha diskutimet e juaja, por e pash të arsyeshme që të jap disa shpjegime, disa sqarime të nevojshme për disa çështje që u ngritën.

Kur flasim me shifra, ju kisha lutur që të jemi korrektë dhe të jemi preciz, mos të manipulojmë me shifra dhe të krijojmë konfuzitet.

Pjesëmarrja e të hyrave të doganave në totalin e të hyrave të përgjithshme nuk është 78%, por është 65%, është në kontinuitet me periudhën e kaluar, nuk është mirë, duhet ndryshohet, po duhet të ndryshohet kujdesshëm në favor të hyrave në brendi. Shpenzimet kapitale nuk janë të koncentruara në një projekt. Nga 572 milionë euro që janë të ndara për shpenzimet kapitale, 225 milionë janë të ndara për projektin më kapital, që është autostrada "Ibrahim Rugova", ndërsa pjesa tjetër shkon për projekte tjera kapitale, që nëse i shkojmë me kujdes tabelat e buxhetit, janë qindra ndoshta edhe mijëra projekte kapitale.

Norma e rritjes ekonomike.

Buxheti nuk është ligj dhe nuk është dokument i nevojave, po është i mundësive reale. Rritja reale ekonomike e projektuar prej 5.3%, ne nuk po themi që ndoshta është e nevojshme, dëshirojmë që të jetë edhe 10%, nuk është fontanë dëshirash buxheti, po është prej rritjeve më të mëdha ekonomike në gjithë Evropën.

Memorandumet e mirëkuptimit.

Memorandumet e mirëkuptimit ekzistojnë në historikun 10 vjeçar të buxheteve të Kosovës, i kemi redukuar. Kanë të bëjnë me disa organizata buxhetore, që në këtë rast është Universiteti i Prishtinës, është Ministria e Shëndetësisë, është Ministria e Drejtësisë, që një pjesë të hyrave vetanake ju kthehen këtyre organizatave buxhetore dhe i shfrytëzojnë sipas prioriteteve të tyre.

Kreditë për ndërmarrjet publike janë të projektuara konform kontratave të cilat janë të lidhura mes Qeverisë së Kosovës dhe këtyre ndërmarrjeve dhe nëse e shikojmë me kujdes buxhetin, qysh në vitin 2013 fillon kthimi i këtyre kredive.

Punësimet e reja nuk kanë të bëjnë me rritjen e administratës, por kanë të bëjnë me organizatat e reja buxhetore, në këtë rast ka të bëjë FSK-ja dhe plotësimi i numrit në FSK

konform standardeve të parapara dhe kompletimi i stafit të disa agjencioneve të reja që posa janë themeluar.

U përmend këtu se nga një miliard e 264 milionë euro këtu hyn edhe pjesa e financimit njëhershëm. Unë kam bërë përpjekje që të formulohem edhe në aspektin gjuhësor edhe profesional drejt, besoj e kam arritur, i vlerësoj ata që ma bëjnë përkthimin dhe deshifrimin e fjalimit, mirëpo 1 miliard e 264 milionë nuk janë paraparë me 300 milionë nga financimi i njëhershëm, këto janë të hyra të rregullta për buxhetin e Kosovës.

U përmendën këtu edhe kontratat me kompanitë private. Shteti nuk ndërhyt në ndërmarrjet private.

Është e projektuar ekzakt shuma e cila është ndarë për kryerjen e punimeve në projektin më kapital – autostrada. Nuk mund të mbërrijë këtë vit deri në 400 milionë, nuk mundet sepse dorëzohet pasqyra e rrjedhës së parasë e do t'i përmbahet kryesi i punimeve.

Dallimi në mes të hyrave dhe të dalave.

U përmend deficieti buxhetor. Deficieti buxhetor brenda periudhës makro-fiskale vlerësohet se të jetë 2.7, që është brenda parametrave të Bashkimit Evropian. Edhe nën supozimin teorik se buxheti i Kosovës, që s'ka ndodhur edhe s'ndodh në asnjë vend të botës të shpenzohet buxheti 100%, edhe nën supozimin teorik që buxheti të shpenzohet 100%, edhe për vitin 2011 Kosova e ka deficitin më të ulët se 5.2%.

Si do të mblidhen të hyrat nga dogana dhe administrata tatimore? Nëse për 2 muajt e parë të këtij viti ka pasur një performancë të mirë të të hyrave nga këto dy institucione që i administrojnë këto të hyra dhe janë më të larta se viti 2010 për 34%, atëherë është logjike që do të thotë ka mundësi që të jenë më të mëdha për 18%, me masat që i kam përmendur. Objektet e Qeverisë duhet të ndërtohen, sepse po kritikohemi se po paguajmë qira, për të mos paguar qira, duhet të vendosen institucionet në objektet e veta.

Rrogat e Qeverisë, u përmend çështja e pagave. Buxheti është projektuar mbi prioritetet e Qeverisë. Një nga këto dy prioritet është rritja ekonomike dhe prioriteti tjetër është përmirësimi mirëqenies sociale. Nuk është hera e parë që Qeveria e Kosovës e kryesuar dhe e udhëhequr nga kryeministri Hashim Thaçi i rritë rrogat. Edhe në mandatin e kaluar nga rritja e rrogave kanë përfituar edhe arsimtarët, edhe punëtorët shëndetësorë, edhe policia dhe përfitojnë prapë. Po, prapë kjo rritje s'është e mjaftueshme, se për të pasur performancë, për të pasur produktivitet, duhet të paguhet eksperti për të ndërtuar në institucione.

U përmendën, prapë po lidhem te shifrat. Do të jemi korrektë. Nuk është korrekte të thuhet se rroga e një anëtari, unë nuk po hy në atë se rroga e anëtarit të bordeve të ndërmarrjeve publike është e lartë apo është e ulët, a e bëjnë ata punën konform pagës që e marrin apo s'e bëjnë, janë çështje tjera që duhet të diskutojmë. Po nëse themi që e merr 40 herë rrogën e një mjeku, del që i merr 20 mijë euro në muaj. Nuk e di a mund të arsyetohet.

Edhe po vij te çështja e parafundit, relacionet me Fondin Monetar Ndërkombëtar. E kemi një letër nga Fondi Monetar Ndërkombëtar. Dëshiroj që të jem shumë korrekt, kemi pasur takime, kemi pasur progres për buxhetin e vitit 2011, kemi te çështja e pagave ende, edhe pse ka pasur përafrime të qëndrimeve, kemi biseda të cilat besoj që suksesshëm do t'i përmbylim.

Sa iu përket të hyrave të tjera, të gjitha kategorive, edhe të dalave tjera buxhetore, ne i kemi të harmonizua në plotësi edhe është mirë që këtu është e përfaqësuesi i Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe po e ritheksoj, te çështja e pagave kemi përafrim të qëndrimeve dhe besoj që ditët në vijim do të arrijmë që të harmonizohemi plotësisht dhe ne të jemi brenda programit me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Sa i përket bujqësisë, edhe përfundova duke falënderuar, ne e dimë që s'është mjaftueshëm, po janë rritur subvencionet për bujqësi në raport me vitin paraprak dhe kjo rritje subvencione për bujqësi ka mundësuar që të përfitojë Ministria e Bujqësisë edhe rreth 20 milionë euro donacione për projekte që janë jashtë buxhetit. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit!

Do ta plotësojë diskutimin ministri Beqaj.

BESIM BEQAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Zëvendëskryeministër, Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Mua më vjen mirë që sot jemi këtu për të diskutuar rreth përcaktimit dhe parimeve për ndërtimin e një modeli për zhvillimin ekonomik dhe ai model është modeli i ekonomisë së tregut, i cili lejon ndërmarrësinë e lirë, model i ekonomisë së tregut i cili mundëson që sektori privat në të ardhmen duhet të jetë bartës edhe i zhvillimeve, edhe i punësimeve, edhe i investimeve, sektor privat i cili gjatë tërë këtyre viteve të fundit në Kosovë ka punësuar shumë më shumë njerëz se sa në sektorin publik. Prandaj, në këtë drejtim ne jemi sot këtu për ta prezantuar një buxhet i cili ka një të ardhme për vendin, një buxhet të perspektivës së qytetarëve, një buxhet ku do të depërtonin mbi 70 mijë familje përmes rritjes së pagave dhe mirëqenies së tyre.

Sigurisht që zëvendësimi i sektorit publik me atë privat është domosdoshmëri e kohës. Me këtë, edhe në projeksionet buxhetore të cilat janë bërë, kanë treguar edhe vlerësimet nga fondi Monetar Ndërkombëtar që përkundër që ne kemi paraparë për këtë vit rritje të buxhetit për 5.2%, edhe planifikimit për rritje reale ekonomike nga ana e Fondit Monetar Ndërkombëtarë janë parë në nivel 5.5%, që tregon që ka qëndrueshmëri makro-ekonomike, që tregon që ka planifikim ekonomik, që tregon që ka mundësi nga zhvillimi i ndërmarrësish private dhe hyrja në treg edhe më fuqishëm të sektorit privat të krijojë një mundësi të tillë. Prandaj, për ne është shumë e rëndësishme që të plotësojmë standarde ndërkombëtare, ta funksionalizojmë ekonominë e tregut, të jemi në harmoni me politikat ekonomike të institucioneve financiare ndërkombëtare, siç janë Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore dhe na mundësojnë gjithashtu për të plotësuar kërkesën zhvillimore ndaj Unionit Evropian, OBT-së dhe mekanizmave tjerë ndërkombëtarë.

U përmend këtu disa herë që pjesë e Ligjit të buxhetit është edhe privatizimi i Postës dhe se ka një tendencë për kamuflim.

Të nderuar deputetë, të respektuar qytetarë të Republikës së Kosovës, procesi për përgatitjen e privatizimit të Postës dhe Telekomit ka filluar në vitin 2007, me një strategji të miratuar nga institucionet e Republikës së Kosovës, nga Kuvendi paraparak në vitin 2008, me një proces mjaftë të hapur dhe transparent, me angazhim të mekanizmave të fuqishëm ndërkombëtarë, këshilltarë strategjikë dhe këshilltarë transaksion. Përkundër normave të cilat janë paraparë dhe janë shfrytëzuar në vende tjera të rajonit, Kosova ka shkuar edhe me këshilltarë të transaksionit, që i kemi prezentë dhe në ndërkohë për të dhanë një mendim të dytë në këtë koncept kemi angazhuar edhe këshilltarin për transaksion strategjik, këshilltar i cili merret me avokaturë të niveleve ndërkombëtare, prandaj jemi plotësisht të sigurt se çdo veprim i cili është bërë në parimin e futjes në Ligjin e buxhetit është në plotni në harmoni me Kushtetutën e vendit, në harmoni me ligjet. Prandaj, me këtë drejtim dua ta heq atë dilemë.

Pse Qeveria është përcaktuar që të vazhdojë me hyrje të sektorit privat në tërë ekonominë e Kosovës, është se ka nevojë për reformë strukturale të ekonomisë dhe duhet ta vëmë në jetë modelin e ekonomisë së tregut në vendin tonë. Ka nevojë qytetari ynë për ofrim të shërbimeve më të lira, më cilësore dhe më efektive, ka nevojë të zëvendësohet ky sektor publik, duke i lëshuar rrugë kapitalit privat dhe ekonomisë së tregut, ka nevojë për punësime të reja nga investimet e ardhshme private në kompani dhe në industri të tjera të lidhura, ka nevojë për përmirësim të transparencës dhe zvogëlim të mundësive për keqpërdorime, ka nevojë për investime në infrastrukturë, e cila do të mundësojë zhvillimin ekonomik, ka nevojë për investime shtesë në ndërmarrje, të cilat do të mundësojnë, thashë, nëse flasim për Postën dhe Telekomunikacionin, shërbimet tjerat të cilat qytetarit i kanë munguar me vite të tëra, sepse nuk ka pasur konkurrencë në treg dhe këtu e kemi edhe trigjinë edhe katërgjinë, nëse flasim për sistem të komunikimit.

Gjithashtu, është paraqitur nevoja që Qeveria do të mbajë një pjesë të rëndësishme të aksioneve sa i përket vendimeve, por paketa e ofruar e cila është përgatitur nga Qeveria paraprake, ka kalua në një vendim në parim në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe është proceduar si e tillë, është mundësuar që investitorit të mundshëm privat t'i jepet mundësia për marrje të vendimeve, menaxhim të mirëfilltë të ndërmarrjes, mos futje të sektorit publik në këtë ndërmarrje dhe realisht me këtë duke maksimizuar edhe çmimin e shitjes për një aset të tillë publik.

Gjithashtu, jemi bazuar në garancinë që jep Qeveria e Kosovës për mbrojtjen më të mirë të mundshme të punëtorëve të PTK-së edhe për 4 vite të tjera. Njëkohësisht, duke u bazuar edhe në modelet e privatizimeve të tilla në nivel rajoni, sepse realisht është Kosova vendi i vetëm i cili e mban edhe më tutje në sektorin publik një sektor kaq të rëndësishëm.

Prandaj, të nderuar deputetë, qëllimi ynë është të kemi një sektor publik, i cili kushton më pak, por që punon më shumë dhe më mirë. Të gjitha diskutimet e deritashme, gati po

thuj se në asnjë prej tyre nuk është refuzuar privatizimi. Unë dhe as shkolla ekonomike, që unë e përfaqësoj, nuk kemi dilemë për procesin e privatizimit, absolutisht dhe Kosova nuk mund të qëndrojë indiferente karshi zhvillimeve ekonomike të cilat po ndodhin në rajon dhe konkurrenca, e cila realisht është e pamëshirshme. Prandaj, edhe posta edhe privatizimet e mundshme të cilat do të vinë në të ardhmen edhe me kapital privat, do të vazhdojnë të punësojnë qytetarë të Kosovës, do të vazhdojnë të paguajnë furnizues të vet vendorë, të paguaj tatime dhe taksa dhe ajo çka është shumë e rëndësishme, do të vazhdojnë të investojnë dhe të ofrojnë shërbime më të mira, më të shpejta, më të shumta dhe më të lira për qytetarët e vendit.

Qeveria ka marrë në formë të dividendës kohën e fundit po thuj se në bazë vjetore 30 milionë euro, por në vend se t'i presim që këtë dividendë ta marrin për vite me radhë dhe me rrezik të madh në realizimin e asaj, ne i marrim ato dividenda tash dhe investojmë në projekte të rëndësishme për kapitalin e vendit dhe e zgjerojmë bazën e kapitalit tonë shoqëror, e rrisim atë atraktivitetin për investime duke siguruar infrastrukturë të mirë dhe konkurruese në rajon, që do të mundësojë rritje të rëndësishme ekonomike në nivel rajoni për shtetin tonë.

Pra, me gjithë privatizimin e mundshëm, sepse ajo është subjekt i vendimit të juaj, të nderuar deputetë, mbetet edhe më tutje ndërmarrje e Kosovës PTK-ja, sikurse shumë e shumë kompani tjera private në Kosovë, të cilat janë pasuri ekonomike e Kosovës dhe bazë për punësim dhe rritje ekonomike. Kosova ka shumë ndërmarrje të avancuara private, të cilat kanë qenë dhe janë bartës të zhvillimit ekonomik, të punësimit qoftë në sektorin e telekomunikacionit, qoftë në sektorin bankar, të shërbimeve, të prodhimit të teknologjisë informative, të tregtisë. Prandaj, një transformim i tillë do të mundësojë që këto ndërmarrje do t'u bashkëngjiten këtyre ndërmarrjeve të cilat punojnë me tërë kapitalin, potencialin njerëzor për avancim dhe rritje të biznesit të tyre, rritje të punësimit që është aq i nevojshëm dhe kështu për rritje ekonomike dhe mirëqenie të vendit.

Prandaj, ne jemi të bindur se diskutimi i frytshëm dhe aprovimi i Ligjit për buxhet, sigurimi i transparencës së plotë, plotësimi i standardeve më të larta të privatizimit, sigurimi i ligjshmërisë dhe garancitë që jep Qeveria dhe Kuvendi i Republikës do të mundësojnë arritjen e vlerës maksimale për shitjen e PTK-së dhe shfrytëzimin më të mirë të këtyre mjeteve për një jetë më të mirë dhe perspektivë për qytetarët tanë.

Edhe një herë dua të potencoj se ekonomia e tregut është ajo e cila në fokus ka ndërmarrësinë private, është ajo e cila maksimizon vlerën e parasë për qytetarin, ajo e cila siguron jetëgjatësi të suksesit në ndërmarrje dhe përgjegjësi në marrjen e vendimeve, prandaj ju ftoj të votoni për të ardhmen ekonomike, për ekonomi të tregut, për shërbime më të mira për qytetarët, duke pritur dhe secili qytetar sot po pret organin më të lartë ligjvënës për të dhënë fjalën dhe për të hapur një perspektivë më të mirë për ta në aspektin e konceptit të zhvillimit ekonomik.

Prandaj, janë ata qytetarë të cilët e meritojnë një gjë të tillë dhe unë ju bëj ftesë që ta votoni sot Ligjin për buxhet. Njëkohësisht, u përmend këtu edhe shitja e Aeroportit. Për hir të korrektesisë dhe të moslejimit të lojës me ndjenja të qytetarëve të Kosovës, ju

njoftoj që Aeroporti nuk është i shitur, por është dhënë me koncesion, me një kontratë jashtëzakonisht të favorshme, e cila, mund t'i merrni t'i analizoni të gjitha ato kontrata dhe do ta shihni që ka pasur një mundësi jashtëzakonisht të mirë dhe është realizuar në mënyrë shumë, shumë transparente dhe në mënyrë më të mirë të mundshëm për zhvillimin e ardhshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Të paraqitur ka shumë, a jeni për pauzë.

Atëherë, e marrim një pauzë për drekë deri në orën 14:00 dhe vazhdojmë.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Donika Kadaj - Bujupi.

DONIKA KADAJ – BUJUPI: Faleminderit!

Edhe pse Qeveria s'qenka këtu, po ndoshta kthehen më vonë a i marrin rekomandimet diqysh.

I nderuar kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Nuk është hera e parë që Qeveria Thaçi nuk e ka mbajtur fjalën për premtimet e dhëna. Prandaj, po konsideroj se është e panevojshme kjo dalja e ministrave në vazhdimësi, po më duken si pionier të devotshëm në një periudhë të kaluar kur dilnin edhe recitonin njëri mbas tjetrit, të na bindin që kanë të drejtë apo që ky është një projekt, qysh thanë, me prioritete për zhvillim ekonomik, sepse nuk bëhet fjalë për asnjë prioritet që lidhet me zhvillim ekonomik të këtij vendi. Dhe, unë po jap vetëm një argument pse. Është një buxhet komplet shpenzues dhe jo zhvillues. Përderisa për blerjen e veturave ndahen 1.5 milionë euro, në sektorin e bujqësisë kjo Qeveri që thotë që ka prioritet zhvillimin ekonomik, ndanë 1% të buxhetit të përgjithshëm. Në të gjitha vendet në rajon, për bujqësi ndahen prej 5 deri në 8%, prandaj unë pyes Qeverinë Thaçi se si do të konkurrojnë prodhimet tona në raport me ato të rajonit përderisa nuk e kemi asnjë përkrahje. Nuk e besoj që këta, veturat e zeza që kanë për të kushtuar rreth 2 milionë euro, mund ta përkrahin zhvillimin e bujqësisë, nuk po shoh si, nëse ka ndonjë lidhje, ndoshta ministri i Financave më vonë na tregojnë se si mundet të përkrahjet.

Kategoria e dytë, ku flet që kemi të bëjmë me një buxhet komplet shpenzues dhe aspak zhvillues, janë mallrat dhe shërbimet, të cilat nuk janë zvogëluar as këtë vit, por përkundrazi kemi një rritje të shpenzimeve. Të përkthehet më shqip, domethënë taksat e qytetarëve të Kosovës shfrytëzohen për kategoritë apo përshkrimet, siç janë laminat, perde, tepih, 100 mijë euro për freskimin e IT (teknologjisë informative). Ndërkaq, mungon një sado pak investim i vogël në rritjen e performancës, profesionalizimit dhe zhvillimit të kuadrove në mënyrë që të rritet funksionaliteti i kësaj Qeverie dhe në përgjithësi institucioneve. Do të thotë nuk ka asnjë paragraf që flet për këtë investim.

Nga ajo se çka kemi nxjerrë, edhe pse shifrat ashtu si çdo herë kanë qenë shumë të pasakta edhe mund ta komplimentojmë Qeverinë se po dëshmon edhe një herë që janë

mjeshtër të mashtrimeve, është se mesatarja e rritjes së pagave në Kosovë është rreth 23% në rrogën bazë. Po e ceku edhe një herë me rrogën bazë, sepse reduktimi i cili është bërë përmes një neni në Projektligjin për buxhet, parasheh heqjen e mëditjeve, pagesave, shujtave e të tjerë, që i bien se ai premtimi për 50% të rritjes së pagave jo që nuk po realizohet dhe nuk do të realizohet kurrë, dhe këtë nuk po e thotë opozita, por po e thonë kontot e qytetarëve, të punëtorëve të cilët nuk i kanë marrë pagat me rritje. Po kjo rritje nuk do të jetë as 23% as 30% dhe as 50%, po nuk dihet as vetë sa do të jetë, sepse në njërin anë kanë marrë dhe në njërin anë kanë shtuar shumë pak. Do të thotë, përkundër kësaj, sado e vogël qoftë kjo rritje, edhe nëse është një cent më shumë në buxhetin e varfër të qytetarëve të Kosovës, ne e përshëndesim dhe gëzohemi që ka ndodhur, sidomos kur kemi parasysh që kemi të bëjmë me një popullsi shumë të varfër. Mirëpo, na shqetëson shumë fakti se në Kosovë mbi 50% të qytetarëve të Kosovës nuk punojnë fare, do të thotë janë të papunë dhe nuk marrin rroga fare. Ndërkohë që projektimi i pagave ka rezultuar me rritjen e qimeve, në mesin e tyre rritjen e çmimit të bukës. Çka ndodhë me këta njerëz që fare nuk punojnë dhe fare nuk marrin paga, ndërkohë që duhet paguar çmime më të shtrenjta. Çka ndodhë me pensionistët, çka ndodhë me motrat medicinave, të cilave u është shkurtuar pagesa për ndërrimin e natës dhe gjatë festave. Do të thotë, përderisa thuhet që e bëjnë rritjen në rrogën bazë, u janë hequr të gjitha mëditjet dhe të gjitha ato përkrahjet të cilat i kanë marrë qoftë si mëditje, qoftë si pagesë për ndërrimin e natës, por që në fund të fundit kanë qenë më shumë para në buxhetin e tyre. Domethënë, kjo ka qenë një planifikim fushate i buxhetit, kanë qenë premtime dhe marrëveshje të cilat kanë ndodhur, kanë filluar në vitin 2007, kanë vazhduar edhe në vitin 2010 dhe nuk mund të realizohen, sepse nuk kanë bazë, fatkeqësisht nuk kanë bazë, po përmes të cilave fatkeqësisht kjo Qeveri ka mbërritur në vijë në pushtet prapë dhe me këtë ka bërë do të thotë shtimin e diferencave sociale në vend, sepse tani kemi një kategori që është e punësuar, një kategori shumë e vogël e cila merr një pagë pak më të madhe se që e ka marrë, ndërkohë që me atë pagë, për shkak të çmimeve shumë të larta nuk mund t'i blejë gjërat elementare të cilat i nevojiten për një jetë normale dhe kemi pjesën tjetër e cila është varfëruar edhe më shumë dhe ekzistenca e së cilës po rrezikohet.

Vazhdon të kemi invazion fiskal në veri të vendit dhe derisa ne presim të arrestohen kriminelët që kjo të ndalet, ne po shohim spektakle të arrestimeve të ish - ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Prandaj, kur flasim për prioritete, unë po pyes cilat janë prioritetet tona? Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e rekomandon Qeverinë Thaçi, që prej leximit të parë, në leximin e dytë të heqë dorë nga kategoritë që lidhën me luksin e tepruar për Qeverinë, siç janë: blerja e 1.5 milion euro vetura, pastaj mallra dhe shpenzime dhe të njëjtat mjete t'i investojë, për shembull, në: bujqësi, shëndetësi, punë të jashtme, të investojmë në kuadro profesionale, në mënyrë që të kemi një diplomaci e cila më vonë mund të përkthehet në diplomaci ekonomike për vendin apo të krijojmë një hapësirë më të mirë për investime dhe për investitorë, sepse kemi probleme dhe nuk po i shohim që janë të gatshëm që të vijë dhe të investojnë në Kosovë. Të veprojë konform interesave të vendit duke shfrytëzuar mekanizmat kushtetues dhe shtetëror për ta ndalur invazionin fiskal në veri të vendit, të bashkërendojë planin e Qeverisë me projektbuxhetin, sepse ajo çka është prezantuar si plan qeverisës, nuk reflekton në buxhet. Të gjitha projektet apo shumica e projekteve të komunave, janë projekte të vjetra të cilat vetëm barten, në mesin e tyre po dua edhe një herë ta ritheksoj, sepse e

bëtë një reagim ndaj Suharekës. Është shumë e vërtetë që nuk ka projekte kapitale dhe që janë, bëhet fjalë për projekte të vjetra të cilat janë bartur prej vitit në vit. Kështu ka ndodhur edhe në shumicën e komunave tjera.

Gjithashtu, rekomandojmë që të hiqni dorë nga qëllimi i shitjes së paligjshme të Postës, respektivisht të nenit 4. Ajo çka u tha që po e bëni në të mirë të punëtorëve, atëherë të na tregoni se punëtorët jashtë që po protestojnë, a janë duke protestuar, sepse ju po veproni mirë dhe ndoshta po bëjnë festë dhe ne e kemi keqkuptuar, apo me të vërtetë ka protesta dhe pakënaqësi, sepse ju po doni ta falni dhe jo ta shitni, jo ta privatizoni në të mirë të vendit, por ta falni për 300 milionë euro një resurs i cili brenda vitit ka të hyra shumë më shumë se kaq. Prandaj, cila është arsyeja e shitjes?

Do të thotë, po mundoheni ta menaxhojmë krizën me këtë dokument të cilin e keni paraqitur si buxhet dhe këtë e bëni në mungesë të një vizioni të zhvillimit ekonomik. Do të thotë, ashtu siç nuk ka pasur vizion për zhvillim ekonomik prej vitit 2007, Qeveria Thaçi po vazhdon me të njëjtën. Kryeministri tha që pa fajin e Kosovës ne vazhdojmë të jemi me papunësinë më të lartë në Evropë dhe vazhdojmë të jemi vendi më i varfër në Evropë. Është e vërtetë që është pa fajin e Kosovës, dhe ndoshta edhe pa fajin e udhëheqësisë së Kosovës, të institucioneve dhe të Qeverisë. Po harroj të them që me fajin e kësaj Qeverie, ne vazhdojmë të jemi vendi me korrupsionin më të lartë në Evropë dhe kjo duhet të ndalet, sepse nuk mund të kemi zhvillim ekonomik, e as nuk mundemi ta fajësojmë historinë se ne sot po ballafaqohemi me korrupsion kaq të lartë në vend.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, duke pasur parasysh që kemi një krizë të madhe buxhetore, në parim do e mbështesë këtë projektligj nëse, po e përsëris edhe njëherë, nëse hiqet neni 4, ku parashihet shitja e Postës dhe nëse prej vazhdimit të parë, do të thotë prej këtij leximit të parë, në leximin e dytë, mblidhen të gjithë kryetarët e komunave dhe diskutohet dhe vendoset për prioritetet të cilat do të jenë në interes të zhvillimit të komunave. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Unë u njoftoj që janë lajmëruar për debat 56 deputetë.

Ju kisha lutur që, unë nuk po shkoj që ne ta votojmë kohën, por vërtet diskutimet të mos jenë mbi 5 minuta ose përndryshe ne duhet ta vazhdojmë nesër. Ju e dini që buxheti duhet të miratohet brenda këtij muaji. Prandaj, unë veç po ju lus që vërtet të keni parasysh vëmendjen, mendoj që për 5 minuta deputetët që diskutojnë mund të thonë mjaftë. Por, përsëri prapë nuk po e kufizoj, në fakt, se ju do të jeni ata që do të duhej ta kufizoni e jo unë, por po ju lus, nëse mendoni që ta kryejmë sonte, t'i shkurtoni vetë diskutimet, nëse jo, vazhdomë nesër.

Fjalën e ka deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, kryetar!

Të nderuar atë pranishëm dhe ministra të Kabinetit qeveritar që janë këtu, Duke analizuar Projektbuxhetin e vitit 2011, i cili është i mbështetur në Ligjin për menaxhimin e financave publike, mund të them se nenet të cilat janë paraqitur në projektbuxhet, do të ishte sugjerim i imi për Qeverinë në të mirë të qytetarëve, që këto

të amendamentohen në komisionin parlamentar, kur dihet se Qeveria në dy vendimet e saja, vendimi nr. 2 dhe në vendimin nr. 3, e ka privatizimin e Postës dhe privatizimin e Distribucionit dhe Furnizimit, ku thuhet shumë qartë se këto ndërmarrje publike duhet të privatizohen, mirëpo a do të ndodhë privatizimi a nuk do të ndodhë, dihet mjaftë mirë si qëndrojmë me investitorët direkt të huaj në Kosovës. Dhe, fatbardhësisht, kjo nuk do të jetë çështje e cila nuk do të kuptohet nga Qeveria, besoj në të mirë të qytetarëve të Kosovës. Sugjerimi im i dytë është që të ruhet marrëveshja me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore, për arsye të veçantë dhe këtë e di mjaftë mirë Qeveria cilat janë arsyet e veçanta të cilat duhet t'i ruajmë marrëdhëniet shumë të mira me ta dhe kjo në favor dhe në të mirë të qytetarëve të Kosovës.

Sugjerimi im i tretë është që të hyrat e projektuara në këtë projektbuxhet të realizohen. Fatkeqësisht, që nuk e kemi edhe ministrin e Punëve të Brendshme, këtu, duke zbatuar ligjet dhe duke luftuar ekonominë jo formale dhe të gjitha bizneset e mëdha, duke marrë parasysh se shumë biznese të mëdha janë të atakuara direkt me njerëz të politikës që të paguajnë pranë Administratës Tatimore taksat e tyre dhe kështu t'i ndihmojmë këtij projektbuxheti që të mbërrijmë deri në fund të vitit, duke marrë parasysh se nuk mund të themi se është buxhet për të gjitha dëshirat e qytetarëve, por buxhet i cili mund të realizojë së paku interesat e qytetarëve apo të taksapaguesve të Kosovës.

Sugjerimi i katërt është, fatbardhësisht që e kemi ministrin këtu, është çështja e subvencionimit të ndërmarrjeve publike, rasti konkret është për KEK-un, ku diku 27.3 milionë euro jepen vetëm për import të energjisë, atëherë do ta kisha shtruar kërkesën te ministri, duke marrë parasysh se e ka Ligjin për ndërmarrje publike dhe njësi brenda monitorimit të ndërmarrjeve publike brenda kësaj ministrie, që të kërkojë llogari nga kjo ndërmarrje publike për taksat e qytetarëve të Kosovës të cilat i ndahen kësaj ndërmarrjeje publike.

Sugjerimi i pestë është që deficitin që është paraqitur në këtë projektbuxhet, nuk kam nevojë të them se të gjithë e kemi tekstin përpara, të kihet kujdes si do të mbulohet, për arsye se duhet me çdo kusht Kosova të arrijë në atë nivel çfarë duhet në bazë të politikave makro-ekonomike. Duke marrë parasysh se buxheti, thashë edhe në fillim, është buxhet i cili duhet t'i mbulojë së paku kërkesat e qytetarëve, në parim përkrah këtë projektbuxhet dhe sugjeroj te komisioni parlamentar, që këto vërejtje apo sugjerime në të mirë të këtij projektbuxheti të amendamentohen dhe ky projektbuxhet t'u kthehet në të mirë taksapaguesve të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!
Fjalën e ka deputeti Shaip Muja.

SHAIP MUJA: I nderuar, zoti kryeparlamentar,
Të nderuar ministra,
Të nderuar deputetë,
Projektbuxheti i vitit 2011 është përcjellë me vështirësi dhe shumë kundërshtime që nga fillimi i projektimit të tij si pasojë e shpërbërjes së Qeverisë së kaluar dhe në mungesë të

krijimit të Qeverisë së re dhe është prolonguar, duke thëlluar kështu më shumë hendekun e problemeve të shumta që bart me vete ky buxhet.

Projektbuxheti parasheh të hyrat e përgjithshme mbi 1 miliard e 467 milionë dhe ka zëra se këtij buxheti do t'i mungojnë eventalisht 70 milionë euro, të premtuara nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe 300 milionë euro të tjera që janë paraparë nga privatizimi i Postë- Telekomit të Kosovës, do të thotë këto 70 milionë euro, sipas tyre nuk do të vijnë në buxhetin e Kosovës, për shkak se është shkelur marrëveshja me Fondin Monetar Ndërkombëtar, ndërsa 300 milionë euro tjera janë për shkak të vonesave procedurale normale për shpalljen e tenderit për shitjen e PTK-së. Nuk do të mund të arrihet që brenda këtij viti, thuhet të realizohet shitja. Unë mendoj se këto vlerësime janë të hershme dhe të paragjykuara negativisht për shkak se negociatat me FMN-në ende nuk kanë përfunduar. Fundi i vitit ende nuk ka ardhur që të paragjykohet nëse do të shitet Posta apo jo dhe Qeveria është shëndosh e mirë duke përfunduar në kapacitetet e saja të plota. Sikurse edhe të na paraqitet deficitin buxhetor, unë e shoh si një sfidë për vendin tonë në kuptimin pozitiv të fjalës, sepse jemi lodhur nga kritikrat vendore dhe ndërkombëtare për qeveritë e kaluara në lidhje me suficitin e mjeteve që kishin vite me radhë dhe nuk dinin si t'i shpenzonin paratë.

Edhe pse është pjesë e botës së zhvilluar ekonomike, të ketë edhe deficite buxhetore, sepse projektet kapitale nuk mund të realizohen gjithmonë me balance buxhetore. Shumica e shteteve në rajon, por edhe ato perëndimore, hasin në deficite buxhetore, disa në shkallë më të ulët, e disa në shkallë më të lartë. Është e rrugës që të kritikohet në Parlament, por është e rrugës që edhe pozita dhe opozita të propozojnë zgjidhje konkrete në rast të deficitit buxhetor.

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe po që se tregohet se ky buxhet nuk do të mund ta bartë tërë barrën e ngarkuar, ju lutem gjithmonë ka zgjidhje, nëse jemi serioz dhe bashkërisht e mbështesim Qeverinë në gjetjen e zgjidhjeve. Nga konsultat e mia me një grup ekspertësh të tregut financiar, del se edhe sikur të vijë deri te një deficit buxhetor, kjo çështje do të jetë e menaxhueshme dhe sigurisht që nuk do të vijë deri te një krizë qeveritare, siç pretendojnë shumë opinione. Sipas këtyre konsultave, me këta ekspertë këshillohet që 1.8 miliardë euro asete të Kosovës, të depozituara jashtë vendit, në tregjet financiare perëndimore që përbëjnë më se 46% të GDP-së së vendit, një pjesë e tyre aq sa do të çmohet, eventalisht të jetë deficitin buxhetor, të kthehen dhe të investohen në tregun financiar kosovar.

Unë propozoj që të ngrihenn grupe ekspertësh në nivel qeveritar dhe të formojnë një grup të analizimit evental të deficitit buxhetor dhe të punojnë në përgatitjen e borxhit publik, të punohet në kthimin e një pjese të aseteve nga jashtë, jo t'i humbim ato asete, jo t'i shesim ato asete, por t'i investojmë në bono thesar, do të thotë në letra me vlerë dhe ta rifinancojmë buxhetin shtetëror në rast nevojë. Ne nuk do të bëjmë asgjë më shumë se sa që kemi bërë deri tani dhe ajo është, që këto asete t'i investojmë prapë në letra me vlerë, por jo jashtë vendit me normë të interesit prej 0.5%, por në vendin tonë, mandej me një normë interesi më të favorshëm se që i kemi investuar në Perëndim.

Të nderuar deputetë,

Sipas këshillave të këtyre ekspertëve thuhet se edhe nëse nuk vjen deri te deficitit buxhetor shtetëror, kthimi i një pjese të aseteve nga Perëndimi në Kosovë është tepër i rëndësishëm dhe i nevojshëm për fillimin e aplikimit të politikës monetare nga ana e Bankës Qendrore të Kosovës, si dhe aplikimin e instrumenteve të politikës monetare siç është emetimi i bono- thesarit. Me emetimin e bonove të thesarit, lëshimin e tij në tregun financiar të Kosovës, ne jo vetëm që do të mund të zgjidhim krizën eventuale të deficitit buxhetor, por ne do të mund t'i ulim edhe normat e interesit të bankave që tani kanë arritur në 14% , si dhe do të mund të ulemi dhe ta kontrollojmë inflacionin që tani ka arritur në shifrën 9.1%, përderisa Banka Qendrore Evropiane rekomandon që të mos kalohet norma prej 2% të inflacionit. Edhe sikur të mos të na dakordohen këto ndihma, minimumi që ne presim nga institucionet financiare ndërkombëtare është që së paku t'i riorientojnë asistencat e tyre në përgatitjen e infrastrukturës operationale vendore për fillimin e emetimit të letrave me vlerë në Kosovë, në mënyrë që të parandalohet deficitit eventual buxhetor, të ulen normat e interesit dhe inflacioni.

Është e vërtetë se buxheti ka një diferencë të mjeteve në raport me atë që është paraparë të shpenzohet dhe atyre që do të grumbullohen, por qe deri në fund të vitit jam shumë optimist që ekzekutivi, në krye me kryeministrin Hashim Thaçi, do të arrijë ta gjejë një solucion të kënaqshëm për të gjithë dhe me këto do të arrijë të mbajë një bilanc buxhetor dhe jo ndonjë deficit të madh. Andaj, të nderuar kolegë, ju ftoj që me kokë të ftohtë të analizojmë këtë projektbuxhet dhe ta miratojmë kur të paraqitet në votim, sepse kjo është një kërkesë që standardi i popullatës së Kosovës duhet të përmirësohet, është e vërtetë që me ndihma sociale që nga paslufta është mbajtur ky popull. Asnjë qeveri nuk ka marrë guxim të prekë në rritjen e pagave, prandaj guximi i kësaj Qeverie nuk duhet të dekurajohet, por duhet të mbështetet dhe të inkurajohet se është në interes të qytetarëve. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Unë kisha thënë ta racionalizoni kohën.

Fjalën e ka deputeti, Bahri Thaçi.

BAHRI THAÇI: Ju faleminderit!

I nderuar kryetar i Parlamentit,

Të nderuar deputetë,

Atë që e kisha ndërmend ta them, shumica u tha sot, unë do të mundohem të jem i shkurtër.

Dëshiroj që fillimisht të potencoj faktin se tanimë kanë kaluar disa muaj nga koha kur Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësive obligon Qeverinë ta miratojë këtë dokument. Ua rikujtoj një deklaratë të ish-ministrit të Ekonomisë që thoshte se "buxheti është i gatshëm". Gjatë fushatës politike kuptuam se për partinë që sot udhëheq Qeverinë e Kosovës, buxheti nuk ishte i gatshëm dhe koha më e volitshme për përgatitjen e buxhetit ishte gjatë kohës kur ajo ishte në dorëheqje dhe gjatë fushatës elektorale.

Tani situata e krijuar..., loja me emocionet e qytetarëve të Kosovës, dëshira për t'u përdhosur institucionet duke e vënë opozitën para aktit të kryer e cila duhet një kulturë, se është po ashtu pjesë përbërëse e këtyre institucioneve, nuk duhet lejuar që të na ndikojë gjykimin tonë. Edhe ky dokument që sot e kemi para vetes, ka mangësi të shumta dhe reflekton të njëjtat tipare si i tërë procesi që na solli diskutimin e tij sot, më 25 mars në këtë Parlament. Ky dokument nuk tregon mjaft qartë prej nga vijnë mjetet për të ndaluar deficitin prej miliona euro, thuhet nga donatorët, thuhet nga financimi i njehershëm, thuhet nga ndryshimi i bilancit bankar. Pyetjet janë të thjeshta: a mund të themi se paratë nga donatorët dhe nga shitja e PTK-së ose shitja e aseteve tjera, vijnë po me të njëjtën siguri, siç i shpenzon Qeveria paratë për projektet kapitale, të cilat me kontratat jemi të obliguar t'i paguajmë.

Në çfarë baze, në çfarë kriteri është vendosur që dikujt t'i ngritet paga e dikujt jo? Në çfarë bazash janë bërë këto diferencime? Kemi mbi 400 mijë të papunë, për të cilët ky buxhet nuk ofron asgjë. Qeveria thotë se dëshiron ta përmirësojë mirëqenien e qytetarëve, e ju rikujtojmë se qytetarë të Kosovës janë edhe këta 400 mijë të papunë, për të cilët Qeveria do të duhet të kujdeset shumë më shumë. Unë çdo herë do të jem për ngritjen e pagave, por vendimet për qytetarët i marrin institucionet legjitime që ata i kanë krijuar me dije, me luftë dhe me votë. Jam që çdo ngritje të jetë e qëndrueshme, që nuk e vë buxhetin në rrezik dhe rrjedhimisht rrezikon edhe ato pak paga që qytetarët i marrin sot.

Jam që vlerësimet se kujt i rriten pagat dhe sa të rriten, të mos bëhen me kalkulime politike apo partiake, por mbi bazat e arsyeshmërisë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!
Fjalën e ka deputeti Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Përshëndetje për të gjithë!
Përshëndetje për ju zoti kryetar!
Deputetë të zgjedhur,
Normalisht që buxheti edhe debati rreth buxhetit do të futet në debatet më të rëndësishme të këtij parlamenti, jo për shkak se duhet të ndodhë diçka më ndryshe, por për shkak të konotacionit çfarë i ka dhënë Qeveria. Unë këtu po shoh që kryeministri nuk është këtu dhe ashtu ishte para zgjedhjeve, kryeministri në largim, në ikje, dhe tash po vazhdon ta aplikojë këtë, në ikje.

Sidoqoftë, nuk kemi se si t'i shmangemi, t'i komentojmë edhe ato çfarë i tha kryeministri duke iu drejtuar deputetëve të Kuvendit. Një nga ato çfarë iu drejtua kryeministri, që për momentin nuk është këtu, është në fjalën e tij, është që e thotë që "ne sot nga pasojat e të së kaluarës, jemi vendi më i varfër në rajon". Unë pajtohem pjesërisht, që nga pasojat e së të kaluarës jemi vendi më i varfër në rajon, por jo vetëm nga e kaluara e largët, por edhe nga e kaluara e qeverisjes që sapo ka ikur. Pra, edhe nga mandati i parë i kryeministrit, ne si pasojë jemi vendi më i varfër për shkak të keq menaxhimit, keqqeverisjes, për shkak të jo seriozitetit, i cili edhe këtu po manifestohet edhe mbi të gjitha edhe për shkak të korrupsionit, pse jo.

Aksioma që shpeshherë kush jep vërejtje, është kundër një projekti, mendoj që duhet të demantohet një herë e përgjithmonë, sepse ne kemi parë se kur kemi dashur ta dimë se sa kushton autostrada, na është thënë se ne jemi kundër autostradës dhe dua t'ia konfirmojmë secilit që ne nuk jemi kundër autostradës, ne jemi për autostradën, por ne duhet ta dimë sa i kushton Kosovës kjo.

Po ashtu, edhe për buxhetin, nëse ne shohim vërejtje shumë serioze, e dimë që po vazhdon të përdoret kundër atyre që japin vërejtje për këtë buxhet, se kush jep vërejtje për këtë buxhet, është kundër këtij buxheti dhe aq më tepër ata që shqetësohen për pagat, nëse pyesin për pagat, rrjedhimisht akuzohemi që jemi kundër pagave. Dhe, ne duhet t'ia konfirmojmë edhe një herë që ne nuk jemi kundër rritjes së pagave, ne duam që pagat të rriten jo vetëm aq sa është thënë, por edhe më shumë, por gjithsesi të mbështetura mbi kritere.

Në fjalimet e mëhershme, jo vetëm të kryeministrit, por edhe të ministrave të veçantë, u dëgjua këtu një lloj fushate: "Votoni për 70 mijë, votoni për të ardhmen, votoni diku të ngjashme" tamam sikur në fushatën elektorale që kjo të bën të mendosh që nuk ka përfunduar fushata elektorale dhe nuk kanë përfunduar akoma ato premtime çfarë vërtet nuk do të mund të realizohen kurrë në këso rrethanash. Nga shefi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës dëgjova që familjet e dëshmorëve deri më tani kanë qenë në mëshirën e fatit. Citoj edhe një herë: "familjet e dëshmorëve deri tani kanë qenë në mëshirën e fatit". Unë pajtohem plotësisht që vërtet familjet e dëshmorëve kanë qenë dhe po vazhdojnë të mbesin në mëshirën e fatit dhe ne nuk duam që më të jenë në mëshirën e fatit, por ne duam që jo siç u tha, citoj sërish: "Qeveria po ua shtrinë dorën e tyre", por ne duam që ata t'i ndihmojnë shtetit, ashtu siç i kanë ndihmuar në luftë dhe që t'i ndihmojnë shtetit ashtu siç kanë ndihmuar në luftë, dhe që t'i ndihmojnë shtetit qysh i kanë ndihmuar në luftë, duhet të krijohen shumë rrethana më të mira për ta. Më lejoni të fokusohem pak a shumë në atë çfarë ka paraparë Qeveria në këtë projektbuxhet për dy mekanizma, siç janë mekanizmat e sigurisë, Policinë e Kosovës, për Ministrinë e Brendshme dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe për çudi ministrin e Brendshëm dëgjova që fliste me shumë entuziazëm për fermerët dhe i shqetësuar shumë për fermerët dhe duhet ta dijë ministri i Brendshëm që para se të jetë i shqetësuar për fermerë, se të gjithë jemi të shqetësuar për ta, duhet të jetë i shqetësuar se sa të ushqyer janë policët e Kosovës, se sa të trajtuar janë policët e Kosovës, se sa trajtohet Policia e Kosovës në rrafshin financiar.

Më lejoni t'ua kujtoj se Qeveria nuk ka paraparë dhe po vazhdon të mos i parasheh financimet esenciale të cilat Policinë e Kosovës e bëjnë polici efektive, funksionale. Njëra ndër ato që nuk po vazhdon, apo po vazhdon të mos i parasheh asnjëherë Qeveria edhe gjatë kësaj radhe për policët e Kosovës, është pagesa apo buxheti për pagesa të orarit shtesë dhe të rrezikshmërisë në punë dhe më lejoni t'ju them që orari shtesë në Policinë e Kosovës nuk paguhet asnjëherë, ai kompensohet me ditë të lira, që nuk do të duhej të ishte kështu për njësitë më elite dhe më të ndjeshme të Policisë së Kosovës dhe po ashtu nuk paguhet rrezikshmëria në punë, sidomos e njësive elite të intervenimit të shpejtë dhe të intervenimit të parë dhe mbi të gjitha nuk paguhet rrezikshmëria në punë

dhe as puna shtesë e njësive të hetimeve, sidomos për njësitë e hetimeve për krime të rënda.

Buxheti për këto dy ministri, sidomos për Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe për FSK-në, Njësinë së Forcave të Sigurisë së Kosovës nuk është aspak i mjaftueshëm. Nëse krahasohet me objektivat e Qeverisë në këto fusha, një përqindje shumë e madhe natyrisht është destinuar për paga dhe mëditje, një pjesë tjetër e destinuar për mallra dhe shërbime, të cilat nuk specifikohen askund se çka përbëjnë në të vërtetë. Po ashtu, në buxhetin për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, kjo Ministri ka një buxhet të ulët në krahasim me aspiratat e saj për profesionalizëm, arritjen e kapaciteteve se është njëra ndër aspiratat më të mëdha jo vetëm të Forcës të Sigurisë së Kosovës, por sidomos të të gjithë qytetarëve të Kosovës, si dhe aspirimin për anëtarësim në Programin për Partneritet për Paqe. Po ashtu, prapë mungon vizioni i investimeve në projekte kapitale, e mbi të gjitha nuk ka ndonjë investim të karakterit mbrojtës ushtarak, si karakteri bosht i strukturës së Forcës së Sigurisë së Kosovës. Pra, e theksoj edhe njëherë që nuk ka investime serioze në karakterin mbrojtës ushtarak të Forcës të Sigurisë së Kosovës. Sa i përket këtij karakteri, është paraparë që si karakter mbrojtës ushtarak apo karakter ushtarak, është quajtur një investim jo shumë i madh në radio-lidhje, pajisje teknike në një shumë prej 2 milionësh.

Diçka që mendoj që ne duhet ta kemi shumë të qartë, apo të na sqarohet këtu, është paraparë një shumë jo në përputhje me atë çfarë duhet të jetë sa i përket blerjes së mjeteve të blinduara për Forcën e Sigurisë së Kosovës, pra e theksova që edhe kësaj radhe nuk ka fund edhe nuk janë paraparë mjete për blerjen e mjeteve të blinduara, një e drejtë që i takon Forcës së Sigurisë së Kosovës edhe me legjislaturën e tanishme. Pra është paraparë, nëse nuk gaboje është paraparë një 50 mijë euro në këtë drejtim dhe ne duhet ta dimë që autoblinda nuk kushton më lirë se sa një xhip i ministrit, pra ne duhet ta dimë që është paraparë një shumë kaq e vogël, shumë, shumë qesharake. Në përgjithësi, në buxhetin e Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës mungon kreativiteti, mungon edhe elementi ushtarak mbrojtës. Kërkoj edhe një herë që kur mendohet për investimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës, të mendohet edhe në karakterin e kësaj force dhe të mos vazhdohet ashtu si më parë dhe tani në këtë projektbuxhet që Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës apo Forca e Sigurisë së Kosovës të trajtohet si një organizatë e cila vetëm duhet të mbahet në këmbë, një organizatë për të cilën vetëm njofton që ta mbajmë gjallë përderisa nuk parashihet ndonjë investim kapital e aq më tepër në karakterin e saj ushtarak.

Pra, po ashtu edhe për Ministrinë apo për Policinë e Kosovës, duhet të jemi shumë më serioz dhe buxheti i cili nuk është i vogël si buxhet në dukje të parë, por kur krahasohet orientimi i këtyre mjeteve buxhetore, mendoj që në kanalet më serioze nuk është ndihmuar Policia e Kosovës. Ne e përkrahim çdo rritje dhe e mbështesim çdo rritje të pagave, qoftë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, sepse ata meritojnë edhe më shumë se sa është paraparë madje, po ashtu edhe për policët e Kosovës, por ne duhet ta dimë që policët e Kosovës barazi me rritjen e pagave bazë, duhet të investohet dhe duhet të parashihen mjete buxhetore për ata policë të cilët vërtetë po rrezikojnë jetën e vet për t'i ruajtur jetën e qytetarëve të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Projektbuxheti të cilën ju e keni prezantuar për aprovim, më së paku i përngjanë një buxheti të konsoliduar. Ky është një buxhet diskriminues, një buxhet me deficit, me një buxhet të aranzhuar, e nëse mund të shprehemi edhe i shpenzuar në vitin 2010.

Pagat.

Nuk ka koment, premtimet e fushatës dhe mosmarrëveshje me FMN-në .

Mallrat dhe shërbimet.

Kategoria e mallrave dhe e shërbimeve, në mes të nivelit qendror dhe atij lokal është tejet diskriminuese për nivelin lokal, sepse ngas 161.2 milionë euro, vetëm 26.2 milionë euro janë për nivelin lokal apo vetëm 16.2. të mallrave të shërbimeve janë destinuar për nivelin lokal, ku konsideroj se janë të pamjaftueshme dhe tejet diskriminuese për 37 komuna, më 43.600 të punësuar, e niveli qendror ka të punësuar 35.000. Ky buxhet i limituar në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve për komunat ua pamundëson atyre kryerjen e shërbimeve të drejtpërdrejta të qytetarit, ku ata ballafaqohen çdo ditë si dhe në secilin fund vit buxhetor kanë obligime të shumta të papaguara nga komunat.

Investimet kapitale.

Nga vlera e shpenzimeve kapitale prej 448 milionë e 136 mijë për vitin 2011, ky projektbuxhet tregon qartë se Qeveria ka harxhuar këtë buxhet ende pa e aprovuar, sepse obligimet apo siç e quani ju, projekte në vazhdim nga viti 2010, është vlera prej 395 milionë apo 88.15%, ndërsa vetëm 53 milionë e 94 mijë janë projekte të reja apo vetëm 11.85%. Ju zotëri, keni shpenzuar taksat e qytetarit pa vendim nga organi kompetent, e ai dihet kush është, është Parlamenti i Republikës së Kosovës. Ju zotëri, keni shpenzuar apo aranzhuar për shpenzim pa autorizim mbi 88% të mjeteve të dedikuara për shpenzim në këtë vit buxhetor, apo më mirë të shprehemi, ju zotëri, me këto mjete financiare keni blerë kolltukët tuaj nga skamnorët, të cilët sot nuk e kanë mirëqenien dhe janë në prag të ekzistencës së tyre dhe të familjeve të tyre. Ndërsa, kur e shikojmë shtrirjen e këtyre projekteve, me të vërtetë është për të ardhur keq, sepse kemi një disproporcion të theksuar në mes të regjioneve dhe komunave. A thua a janë edhe ata Kosovë?

Nëse e shikojmë këtë projektbuxhet në aspektin e investimeve në infrastrukturë rrugore, në komunën e Deçanit e vërejmë vetëm një projekt rruge në vlerë prej 171 mijë euro, ndërsa ajo rrugë është asfaltuar vitin e kaluar, në kohën e fushatës, mendoj në rrugën Carrabreg-Beleg, ndërsa rruga për fshatin Voksh, që është e theksuar në të njëjtin projekt, është e asfaltuar para 3 ose 4 viteve. Në komunat ku udhëheq partia e juaj, zoti kryeministër, ose zoti zëvendëskryeministër, keni investime milionëshe, e për koincidence, të gjitha të kryera apo të aranzhuara në vitin 2010. Askund në programin e arsimit nuk vërehet as edhe 1 euro investime në shkollat e komunës të Deçanit, me përjashtim të një salle sporti në Strelc, e cila ka filluar punën para një viti dhe ka vetëm

skeletin dhe muret, ndërsa në komunat ku ju udhëhiqni, ka investime miliona euro në shkolla dhe në pajisje shkollore.

Askund nuk kemi , qoftë edhe 1 euro investime në shëndetësi në komunën e Deçanit. Shtrohet pyetja: A janë edhe ata banorë të Republikës së Kosovës? Nëse po, Qeveri, largojeni egoizmin dhe ndajeni pjesën e tyre që u takon, sepse edhe ata janë taksapagues të Republikës së Kosovës, edhe ata kanë të njëjta të drejta sikur qytetari i Skenderajt, i Malishevës dhe qytetarët e tjerë të Republikës së Kosovës.

Gjendja në sektorin e shëndetësisë është e rëndë, si rrjedhojë e problemeve të trashëguara me vite, probleme këto të cilat nuk janë marrë si prioritet i Qeverisë, përkundër deklarimeve permanente. Nga ky projektligj për buxhetin vërtetohet se shëndetësia vazhdon të mos jetë prioritet i Qeverisë. Buxheti për shëndetësi me 79 milionë, jo vetëm që nuk është zhvillimor, por vështirë që do të mbajë edhe performancën e deritashme. Krahasuar me buxhetin e vitit 2010, i cili ka qenë 72 milionë, rezulton që kemi ngritje prej 6 milionë e 239 mijë, rritje kjo e cila është e pamjaftueshme të mbulojë premtimet për rritje të pagave të punëtorëve shëndetësorë prej 30%.

Qeveria gjithmonë e ka shpallur si prioritet shëndetësinë, ironike kjo, sepse në realitet ka ndodhur e kundërta. Gjendja në mënyrë permanente është përkeqësuar nga viti në vit, e sidomos në periudhën pas pavarësimit të Kosovës, gjatë qeverisjes së kaluar. Problemet me të cilat ballafaqohen institucionet shëndetësore janë të shumta: mosfunksionimi i Institutit të Onkologjisë dhe Kardiokirurgjisë, gjendja shumë e rëndë në klinikat e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, spitaleve rajonale, qendrave kryesore të mjekësisë familjare, menaxhimi, infrastruktura, aparatura shëndetësore, furnizimi me barna dhe material shpenzues. Furnizimi i dobët i institucioneve shëndetësore me medikamente dhe material shpenzues nga lista esenciale e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë, furnizim ky i cili nuk kalon 20% të kërkesave të institucioneve. Në veçanti janë të prekur kategoritë, pacientët që kanë nevojë për citostatik, që kushtojnë, e nuk ekziston asnjë mundësi që pacienti t'i blejë për arsye të çmimit të lartë dhe të gjendjes ekonomike në të cilën gjendet popullata e Kosovës.

Gjithashtu, problem shumë i madh është furnizimi me insulinë i pacientëve, që kanë ndodhur që me muaj të tërë pacientët nuk janë furnizuar me insulinë, e kjo ka ndodhur si pasojë e mosmenaxhimit adekuat, përsëritjes së tenderëve për furnizim, që është bërë dukuri në Ministrinë e Shëndetësisë.

Buxheti për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve si dhe shpenzimeve komunale, gjithashtu është shumë i ulët, buxhet ky i cili, duke marrë parasysh ndryshimet e çmimeve në tregun kosovar, do të lejojë funksionimin e institucioneve shëndetësore vetëm në 6 mujorin e parë dhe pas kësaj periudhe pritet kolapsi financiar për të gjitha institucionet shëndetësore. Nga projektligji për buxhet, gjithashtu shihet se në vazhdimësi buxheti për trajtim të pacientëve jashtë vendit mbetet i njëjtë, 2 milion. Kjo tregon se Ministria e Shëndetësisë nuk ka në plan zhvillimin e shërbimeve deficitare në Kosovë, që është në kundërshtim me prononcimet publike të zyrtarëve të Ministrisë së

shëndetësisë, madje ka pozicione absurde në Projektligj. Sa për shëndetin mental, ndahet dyfishi i buxhetit të Qendrës Klinike Universitare Stomatologjike të Kosovës ose dyfishi i buxhetit të spitalit të Vushtrrisë dhe spitalit të Ferizajt.

Një dikaster me rëndësi të veçantë, siç është Inspektorati Shëndetësor i Republikës së Kosovës, i cili bën mbikëqyrjen e jashtme profesionale të të gjitha institucioneve shëndetësore në Republikën e Kosovës, në vend që të përkrahët dhe të stimulohet nga menaxhmenti i Ministrisë së Shëndetësisë, ndodh e kundërta. Ky projektbuxhet jo që nuk garanton zgjedhjen e problemeve me të cilat ballafaqohet shëndetësia, por do t'i thellojë edhe më tepër këto probleme dhe kam frikë që do të hyjmë në një rreth të mbyllur ku edhe pas juve vështirë do të gjendet dalja nga kjo krizë në të cilën jeni duke e dërguar sektorin shëndetësisë.

U thirrën shumë në rritjen e pagave për familjet e dëshmorëve, invalidëve dhe kategorive tjera. Ne jemi pro, por jo sipas matematikës suaj. Një pyetje: Çfarë beneficimesh kanë veteranët e luftës nga ky projektbuxhet? Apo beneficion i vetëm është t'i burgosim, t'i shantazhojmë dhe familjet e tëra t'i lëmë në mëshirën fatit. A ky është shpërblimi për sakrificën e tyre? Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Fikrim Danka.

FIKRIM DANKA: Sayın Meclis Başkanı, sayın başbakan yardımcısı, değerli bakanlar ve sayın milletvekilleri, hepinizi saygıyla selamlıyorum

Sağlık ve Çalışma Sosyal Komisyonu olarak 2011 yılı bütçesini, bizim alanımız olan ve çalışma sosyal bakanlıklarına ayrılan bütçelerini incelediğimizi ve komisyonda bu konular üzerinde tartıştığımızı bildirmek istiyorum. Kosova'da sağlık sektörün gereken ve istenilen düzeyde olmadığını, yıllardır birikmiş olan sağlık problemlerinin acilen çözülmesi gerektiğini ve hükümet olarak ve öncelikli sektör olarak belirlenmesini talep etmekteyiz. Bunu talep ederken Kosova'nın bulunduğu ekonomik durumu da göz önünde bulundurarak imkanlar dahilinde çözümlerin üretilmesi ve hükümet ile meclisin koordineli çalışması gerektiğinin kaçınılmaz olduğuna inanmaktayız. Hastanelerimizde ilaç sıkıntısının yaşandığı, bazı tedavilerin hastanelerimizde yapılmadığı ortadayken, halkımızın sağlık sigortadan mahrum olması bizleri derinden endişelendirmektedir. Bu yüzdendir ki sağlık sektöründe, ciddi adımların hükümet tarafından atılması gerekmektedir. Hükümetin, sağlık sektöründe çalışanların maaşlarının artırması bizleri sevindirmektedir. Bu sektörde çalışma şartlarının da düzeltilmesi için adımların en kısa zamanda atılması gerektiğini de ifade etmek istiyorum. Sonuç olarak, sağlık bakanlığına ayrılan bütçenin yukardaki sorunların çözülmesine yeterli olmadığını açıkça ifade etmek istiyoruz ve bu bütçenin genel olarak, özellikle ilaç alımlarında bütçenin yetersiz olduğunu tespit ederken komisyon olarak, bunun artırılmasını talep etmekteyiz. Kabul edilen ve önerilen 2009-2013 yılı bütçe planlamasındaki seviyeye ulaşması da bizim için yeterli olacaktır.

Bunun yanında sosyal bakanlığında bütçe artışı olumlu seviyede sađlandığını ve ıkacak olan emekliler yasasıyla yeniden deęerlendirilerek emekli maaşlarında artış sađlanması beklentilerimiz arasındadır.

Tüm bunlar bütenin ikinci okunuşuna kadar komisyon olarak, hem büte komisyonu hem de maliye bakanlığında grüşölerek, bunun dölzeltmesini daha doęrusu istenilen seviyeye ulaşmasını talep etmekteyiz.

Ben dięer milletvekili hakkını da kullanarak, topluluk adına daha doęrusu toplum adına ek bir talepte bulunmak istiyorum. oęunlukta olmayan toplulukların yasayla öngöröl haklarının gerekleşmesinde büte ile ilgili konuları gaz önünde bulundurulması ve yasaların yürürlüęe gemesindeki bütenin gereklilięine önem verilmektedir. Aynı zamanda Mitrovia’da Türk Költür Merkezi’nin yapılması için Költür Bakanlıęı tarafından gerekli bütenin, proje kapsamında ayrılması grup adına daha doęrusu partimiz adına ve milletvekilimiz adına talep etmekteyiz. Bunu da bir önerge olarak büte komisyonuna sunacaęız. Teşekköl ederim

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Teuta Sahatqija

TEUTA SAHATQIJA: Ju faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Projektimi i buxhetit nga ana e Qeverisë dhe shqyrtimi i tij në parlament paraqesin një ngjarje tepër të rëndësishme për do shtet, sepse ka të bëjë me secilin njeri dhe buxheti në të vërtetë do të duhej të paraqiste programin e Qeverisë, prioritetet për këtë vit, por edhe vizionin për vitet që vijnë. Buxheti duhet t’i tregojë kahet zhvillimore, kujdesin për shtresat sociale, qasjen dhe kujdesin e Qeverisë ndaj shtetit.

Në fjalimin e kryeministrit, në fillim gjatë paraqitjes së buxhetit, mu dok që është një fjalim i fushatës dhe mu dok një fjalim patetik, kur u mundua që gjithë ështjen e buxhetit ta parqet si rrogat dhe ta paraqet se unë jam ai i miri i cili po i rrisë rrogat, ndërsa këta të këqijtë e opozitës, janë ata të cilët nuk po lënë me ua rritë rrogat edhe tash mu dok pak patetik, por kur u qua edhe një herë, kur e pa që diskutimet për buxhet kanë të bëjnë me gjërat tjera e jo vetëm me rrogat, atëherë mu dok e pandershme, e pandershme ndaj qytetarëve të Kosovës që të vazhdohet në atë mënyrë.

Qytetarë të Kosovës, LDK-ja, e si pashë, edhe të gjitha partitë tjera opozitare, nuk janë kundër rritjes së rrogave, përkundrazi ne mendojmë që kryeministri duhet ta mbajë fjalën, jo ta rrisim 20% , 18% e tjera, por ashtu si ka premtuar, ta mbajë, t’i rritë 50, 30 t’i rritë aq sa ka thënë. T’i gjejmë paratë ku duhet edhe t’ju rritë, ta mbajë fjalën.

ështja e dytë të cilën e ngriti kryeministri, ishte avazi për autostradën. Të nderuar qytetarë, këta të opozitës janë kundër “Rrugës së kombit” e tjera e tjera. Autostrada ka kaluar në këtë Kuvend. Të gjithë e kanë miratuar. Prandaj, përsëri është e pandershme ndaj qytetarëve që të abuzohet me rrogat e vogla të tyre, që të abuzohet me pozitën e tyre edhe të blihen poenët e lirë politik, se nuk jemi në fushatë. Ky buxhet të cilin po e shqyrtojmë sot, në start hynë me deficit, me deficit të madh, ku shpenzimet janë me qindra miliona më të mëdha se hyrjet, është një buxhet pa strategji dhe prioritete

zhvillimore. Me mjete financiare të cilat nuk i kemi, për të cilat kanë folur edhe Banka Botërore edhe Komisioni Evropian, edhe FMN-ja, mos të flasim për postën, e të kthehem edhe një herë, qysh nuk po gëzoheni ju që po rriten rrogat. Po, po gëzohemi që po rriten rrogat, sidomos do të gëzohen shumë ata 25 -30 vjeçar që e paraqesin numrin më të madh të papunëve, kur arsimtari, nëna ose baba nuk do t'i jep 1 euro, por 1,5 të dalë për të pirë makiato në kafe, se nuk ka punë.

Sot, para së gjithash kemi para vetes një buxhet shpenzues skajshmërisht, jo buxhet zhvillimor. Për çdo shtet, e sidomos për një të varfër çfarë është Kosova, është tepër i rëndësishëm aspekti i zhvillimit ekonomik, i hapjes së vendeve të punës, të projekteve kapitale të cilat do të ndihmojnë dhe fuqizojnë biznesin privat vendor, nga tatimet e të cilave mbahet ky shtet.

Në të vërtetë, ne i favorizojmë bizneset publike, i gjuajmë paratë në bunarë dhe ato gjenerojnë humbje, marrin kredi prej këtij buxheti dhe nuk i kthejnë. Ky ka qenë edhe premtimi i partive të koalicionit gjatë fushatës dhe pikë kinse kyçe për hyrje në Qeveri të partive të koalicionit dhe bisedimeve të gjata për dakordimin për çështje programore, ekonomike, zhvillimore. Po del se e vetnja pikë programore gjatë bisedave, ishte zënia e pozitës së presidentit dhe rehatimi i disa njerëzve nëpër ministri. Nga ky material shohim se komunat kanë zvogëlim drastik të projekteve kapitale, vazhdim të atyre ekzistuese dhe pak ose aspak projekte të reja zhvillimore, që paralajmëron kohë të vështirë për bizneset edhe për punëtorët e tyre, për punëtorët të cilët do të jenë në pozitë edhe më të rëndë.

T'u kthehem edhe një herë rrogave, se ishte insistimi i ministrit dhe i kryeministrit edhe nuk çuditem që kthehet edhe një herë kur e sheh që po devijon biseda, të thotë e të kthehet edhe njëherë dhe të tregojë që rrogat janë ajo. Ne jemi për rritjen e rrogave për të gjithë, prej 160 mijë apo sa punëtorë janë, jo vetëm 70 mijë, por edhe të atyre 90 mijë të tjerëve të cilët sot nuk e gëzojnë të drejtën e rritjes së rrogës. Shteti ruhet edhe mbahet me qeverisje të mençur, me luftë kundër dukurive negative, me rritjen e mirëqenies, me avancim të biznesit, me rritjen e miqësive me shtetet e organizatave të rëndësishme botërore. Pra, shteti ruhet nga konsekuencat e dëmshme, për të me kredibilitet edhe në aspektin buxhetor. FMN-ja tash do t'i ketë takimet e veta, ku do të analizohet kredibiliteti i këtij buxheti e sa është kredibil për FMN-në, kemi dëgjuar mjaft. Do të shohim edhe shpresojmë që do të tejkalohet edhe që Kosova të mos dalë jashtë rrjedhave e të jetë në gjendje që të rinegociojë edhe një herë marrëveshjen me FMN-në.

Në fakt, këtu nuk po flasim vetëm për qëndrueshmërinë e buxhetit 2011, i cili prapëseprapë do të jetë më i lehtë se ai i vitit 2012 edhe 2013, buxhet i cili nuk do të kisha pasur dëshirë që të jetë buxhet i cili do ta vështirësojë, të mos them falimentojë shtetin. Vetë premtimi i rrogave parciale ishte vendim diskriminues, i cili përjashtoi një numër të qytetarëve të Kosovës nga rritja, premtim që e shtoi valën e shtrenjtimit, e cila i ka prekur të gjitha shtresat, edhe atyre që ju ka premtuar rritje, atyre 70 mijërave, dhe atyre 90 mijërave të cilët nuk e kanë fatin. Punëtorëve fatlum që bien në kategorinë e kësaj natyre, do t'ju rriten rrogat, do t'i marrin ato me vonesë dhe me përqindje tjetër,

pjesa më e madhe e punëtorëve do të diskriminohen dhe nuk do t'ju rriten rrogat se nuk kanë pasur fat të jenë aty.

Strukturat tjera të cilat do të përfitojnë prej Ligjit të punës dhe ligjet tjera, a për pensionistët dhe të pa punët janë ata të cilët mbesin, biznesi, duke pasur parasysh zvogëlimin e projekteve kapitale nëpër komuna, së paku ai biznes që nuk ka lidhje me Qeverinë, pasi projektet zhvillimore nëpër komuna dhe në nivelin qendror janë reduktuar, do ta kenë vështirë.

Do të mbesim pa pasurinë, pa PTK-në, e nuk e di çka do të shesim vitin e ardhshëm me këtë buxhet të ashtuquajtur zhvillimor. Do të na kthej pas në raportet me FMN-në, do të çrregullojë stabilitetin e shtetit apo situatën e ngjashme me Greqinë apo Irlandën, kur shpenzimet kanë qenë më të mëdha se sa të hyrat, por dallimi me këto dy shtete është se ato janë pjesë e BE-së dhe si të tilla, kanë ndihmë dhe trajtim tjetër, të cilin ne fatkeqësisht nuk e kemi.

Po, në qoftë se Qeveria, e cila ka dalë nga abuzimi industrial i votave dhe pritet të vazhdojë me tendencat e abuzimit me paratë e tatim paguesve, do të vazhdojë me abuzimin e buxhetit edhe të ardhmërisë sonë. Ne jemi që buxhetin ta votojmë, atë buxhet i cili do të ketë ndryshime substanciale, të cilat do të sigurojmë qëndrueshmërinë dhe si pozita, ashtu edhe opozita janë për qytetarin. Nuk është e drejtë edhe privilegj vetëm i pozitës të mendojë për qytetarin, për të gjithë dhe ne atë jemi duke e bërë këtu në Kuvendin e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!
Ministri Bedri Hamza e ka fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Ju faleminderit, zoti kryetar!
Me qëllimin më të mirë, do të thotë, edhe kritikën i pranojmë si kritika qëllimmira, mirëpo kemi nevojë t'i japim disa sqarime.

Numri i të punësuarave në sektorin publik në Kosovë, i projektuar me këtë projektbuxhet është 77.761. Nuk është 160 mijë, është diferencë shumë e madhe.

Deficiti buxhetor, ju lutem shumë, ne kur flasim për deficitin buxhetor, duhet t'i kemi dy dallime, deficitin primar, i cili është i paraparë në 226 milionë, mirëpo nëse e shikojmë bilancin bankar në fund të vitit, nëse projeksionet zhvillohen kështu qysh i kemi parashikuar, nuk kemi deficit, por e kemi bilancin bankar 476 milionë, që ndoshta mund të ngrisim të kundërtën e kësaj pyetje, të themi a është i lartë për këtë vit, mirëpo nëse shikojmë periudhën afatmesme makro fiskale, vjen duke u zvogëluar duke rënë në 260 milionë në vitin 2010.

U ngrit çështja e zvogëlimit të investimeve kapitale në komuna, nuk qëndron. Është rritur grandit për komuna në raport me vitin 2010 për 24%, është ngritur deri në 300 milionë dhe...

(Ndërhyrje)

... jo zotëri, më fal, jo, dhe prej vendit të lutem mos fol! Tash po t'i shpjegoj...

KRYETARI: Ministër, vazhdoje diskutimin, mos u ndiko nga të tjerët.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Ju faleminderit, shumë!

...ndarja bëhet në bazë të formulës së grandeve që i parasheh Ligji për menaxhimin e financave lokale, është grand i përgjithshëm, grand i arsimit edhe grand i shëndetësisë. Prandaj, mbi bazën e kësaj formule të grandeve, sa herë ka rritje të hyrave, atëherë 10% e grandit të përgjithshëm, domethënë, shkon në nivelin komunal dhe si të rriten të hyrat përgjithshme, rritet automatikisht në bazë të formulës edhe grand i për komuna. Prandaj, nuk është veç si rezultat i rritjes së pagave, por është dhe si rezultat i rritjes së të hyrave të përgjithshme. Ju faleminderit, shumë!

KRYETARI: Replikë. Deputetja Teuta Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA: Ju faleminderit, kryetar!

Ju faleminderit, ministër, se më patën mbetur edhe disa sende pa i thënë, e mu dha rasti. 77 mijë janë të paraparë. Sa janë transferet e rrogave? Transferet e rrogave janë në atë masë sa barazohen me 160 mijë rroga që jepen. Cilat janë ato rroga, qysh i keni shti ato rroga, a i keni shti si rroga, a i keni shti si raste të ndryshme, ato ju i dini më së miri?

E dyta, sa i përket kornizës afatmesme të shpenzimeve, ajo kornizë është votuar këtu. Ky buxhet nuk përkon me atë. Edhe tjetër, reforma në shërbimin publik, reforma e vendeve të punës e tjera, nuk është bërë edhe këto rroga dhe ky parashikim në bazë të çkahit është bërë? A është dashur së pari të bëhet reforma e pastaj të shpërndahen rrogat edhe të mos fshihen ata 90 mijë të tjerë me mënyra të ndryshme të pagesave. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Vazhdojmë. Jo, nuk e humba renditjen, por po shkoj mbi bazën, nëse e përcillni, mbi bazën e Rregullores dhe duke iu dhënë kohë të barabartë grupeve parlamentare në Kuvend.

Fjalën e ka deputeti Albin Kurti. Lexojeni rregullën 40 të Rregullores së Kuvendit!

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Nuk është e rëndësishme ajo që do ta ndryshojë Qeveria e Kosovës këtë vit, por ajo që Qeveria e Kosovës nuk e ka ndërmend ta ndryshojë as në këtë vit. Para se të jenë të rëndësishme linjat buxhetore nëpër nënsektorë dhe dallimet me vitin e kaluar, është i rëndësishëm orientimi i njëjtë i politikës ekonomike të Qeverisë. Projektligji për buxhet na tregon vetëm një gjë të re përbrenda konceptit të vjetër në nenin 4 të tij, duan ta shesin PTK-në, ndërmarrjen më fitimprurëse të Kosovës pas luftës, për t'i dhënë hov privatizimit, projektit dominant të Kosovës, pas luftës. Shitja e PTK-së është e dëmshme për punëtorët e PTK-së, është e dëmshme për qytetarët e Kosovës dhe është e dëmshme për shtetin e Kosovës. PTK-ja nuk duhet të privatizohet. Së pari, PTK-ja ka rëndësi zhvillimore strategjike. Së dyti, PTK-ja ka kapacitet të konsiderueshëm të gjenerimit

financiar, së treti, PTK-ja vazhdimisht ka qenë dhe është ndërmarrje fitimprurëse dhe, së katërti, telekomunikacionet janë edhe çështje e sigurisë nacionale dhe e sovranitetit.

Privatizimi i egër në Kosovë na ka sjellë luftën e secilit kundër secilit, që përkthehet në luftë të secilit kundër të gjithëve. Nëpërmjet këtij privatizimi, e përbashkëta po sulmohet deri në pamundësim të saj. Përgjatë këtyre 12 vjetëve, me sundimin ndërkombëtar në Kosovë nuk e kishim as minimumin e demokracisë, por e kishim maksimumin e privatizimit. Dikur mungesa e statusit, e tash mungesa e njohjeve, janë paraqitur si pengesa për shumëçka në Kosovë, por asnjëherë për privatizimin. Shitjen që UNMIK-u ua bëri ndërmarrjeve shoqërore, tash Qeveria po ua bën ndërmarrjeve publike. Privatizimi i shndërroi fabrikat në qendra tregtare, kurse Kosovën në një vend që konsumon, por nuk prodhon. Privatizimi i këtillë nuk e shndërroi pronën në kapital, por më parë ndodhi e kundërta, kapitali u shndërrua në pronë, sepse ndërmarrjet u shitën si objekte të vdekura e jo si kapacitete prodhuese.

Duke qenë të shpronësuar e pa prodhim, deficitit tregtar në Kosovë u bë më i madh se vet buxheti i Kosovës, kurse të hyrat nga diaspora janë po aq sa importi legal e ilegal nga Serbia. Thjeshtë, nuk mund të ketë zhvillim ekonomik pa koncentrik të kapitalit. Kosova është vendi ku kapitali qarkullon tek sa koncentrohet diku tjetër.

Prej qeveritarëve kosovarë, por edhe prej disa diplomatëve ndërkombëtarë na thuhet që ndërmarrjet publike duhet të shiten, meqë aty po vidhet. Pushteti po thotë që nuk është e mundur të ndalen hajnat, përveç se duke e shitur atë që hajnat do ta vjedhin, mirëpo ky është dorëzim i pushtetit para hajnave. Ne duhet t'i ndalim hajnat dhe hajninë dhe jo ta shesim pasurinë, meqë hajnat me siguri do ta vjedhin atë. Pushteti që dorëzohet para hajnave, e merr anën e hajnave. Ky lloj privatizimi është plaçkitje, sepse në emër të parandalimit të hajnisë po kopjohen dhe po emitohen hajnat. Ajo që është e të gjithë qytetarëve, po bëhet e pronarit të një korporate të huaj, të cilit i sillen rrotull qeveritarët e Kosovës, sa për t'i mbledhur dromcat që bien aty.

Korrupsioni i politikanëve në Kosovë është suplement dhe produkt i privatizimit të tillë çfarë e patëm në këto vitet e pasluftës. Zhvillimi ekonomik në Kosovë ka qenë vetëm zhvillim i privatizimit, prandaj nuk ka shndërrim të rritjes ekonomike të mirëqenies sociale. Po shiten gjigantët ekonomik dhe mandej ato para po përfundojnë tek ata që eksportojnë te ne, meqë ne jemi vetëm konsumatorë, pa prodhim vendor. Kjo i bie njësoj sikur ta shesësh shtëpinë shumë lirë dhe pastaj me ato para ta paguash qiranë e shtrenjtë në po të njëjtën shtëpi. Edhe privatizimi i PTK-së synohet të bëhet, thuajse ndodhemi para ndonjë apokalipsi. PTK-në duan ta shesin shpejt e shpejt, pa marrë parasysh fort çmimin, e kur thonë që PTK-ja vlen prej 300 deri në 600 milionë euro, natyrisht se ajo përfundon te kjo 300 milionë euro, në rastin më të mirë. Pra, ekziston njëfarë gjendje mendore e panikut paraapokaliptik të qeveritarëve kosovarë, thuaja se Kosovën do ta godasë ndonjë meteorë ose ndonjë cunami dhe tash duhet të shesim gjithçka sa më parë. Në fakt, pikërisht kjo mënyrë e sjell apokalipsin duke e bërë Kosovën vend të pajetueshëm, vend me mjerim të papërbalueshëm për shumicën e me luks të pa imagjinueshëm për pakicën, sepse ky privatizim nuk është një gjë, por ajo është një

marrëdhënie, marrëdhënie midis shoqërisë dhe publikut që shpronësohen, në njërin anë, dhe korporatave, bankierëve dhe politikanëve që pasurohen, në anën tjetër.

Privatizimin në Kosovës nuk e ka sjellë liberalizimin, përveç se bartjen e monopolit publik te monopoli privat dhe nuk u bë privatizimi në sferën e menaxhimit apo të shërbimeve, por në atë të pronës. Shteti mund të mos e ketë namin e mirë si menaxher, por si pronar ai ka biografi shumë të mirë. Kurrsesi nuk bën të ngatërrohet menaxhimi e shërbimet me pronësinë, sepse janë gjëra krejtësisht të ndryshme. Privatizimi në jetën politike dhe institucionale në Kosovë e ka pasuar privatizimin në ekonomi dhe jo anasjelltas. Qeveritarët vendorë dhe burokratët ndërkombëtarë i kanë privatizuar pasuritë dhe kapacitetet prodhuese në Kosovë, janë dakorduar që t'i privatizojnë tokën, nëntokën dhe të ardhmen tonë përmes bordeve dhe natyrisht që në ecje e sipër i kanë privatizuar partitë, institucionet dhe historinë, janë hedhur në privatizim hapësira dhe koha jonë, duke mos menduar fare paraprakisht për privatizimin. Tash privatizimi është bërë mënyra e vetme përmes së cilës mendohet. Një Kosovë e këtillë nuk po shkojë drejtë Bashkimit Evropian të shekullit XXI, po drejt Amerikës Latine të shekullit XX.

Qeveria e Kosovës nuk mund të na ndihmojë aspak për kurrfarë zhvillimi ekonomik për mirëqenien e qytetarëve pasi që ajo i konsideron ndërmarrjet ekonomike të Kosovës si një barrë nga e cila duhet të lirohet. Kosova është bërë një vend në të cilën shumë më kollaj njeriu e humb vendin e punës, se sa që mund ta gjejë një vend të ri të punës. Pagat dhe asistencë sociale në Kosovë nuk u jepet qytetarëve për të pasur ata jetë të dinjitetshme, por për të mos u ngritur kundër Qeverisë dhe rendit ekzistues.

Zhvillimi socio-ekonomik duhet të jetë plan, kurse privatizimi eventualisht pjesë e planit dhe jo privatizimi të jetë pikënisje, kurse zhvillimi ekonomik eventualisht pasojë. Ashtu siç pat konstatuar profesor Ismet Hamiti, themelues i “Valës” 900, me privatizimin si një të vërtetë shkencore, me privatizimin si argument të vetvetes, ngjan veç se privatizimi i profitit dhe nacionalizimi i humbjeve. Nuk është e rastësishme që duan ta shesin telefoninë mobile dhe atë fikse, që punojnë me fitim, kurse Postën fizike që punon me humbje, t’ia lënë Kosovës.

Rruga e kombit, do të mund të financohej nga fitimi i PTK-së, por jo duke e shitur PTK-në. Aq i madh është fitimi i PTK-së, sa që mund t’i kemi të dyja. Asfalti ynë i rrugëve kombëtare, përderisa nuk kemi fabrika prodhuese kombëtare e as kontroll të territorit të kufijve shtetëror, është në shërbim të fabrikave të shteteve të tjera, të kombeve të tjera. Nga 32 maune, sa i kam numëruar përgjatë rrugës Prishtinë – Pejë, kohë më parë, vetëm 4 prej tyre kanë qenë të Kosovës dhe njëra ishte e një filiale të një kompanie të huaj në Kosovë. Me këso politikash, Kosova është bërë si një kazino, ku vijnë paratë për të shkuar me shpejtësi. Prandaj, përfundimisht, pa sovranitet për shtetin, pa prodhim për ekonominë dhe pa kufi për territorin, Kosova nuk mund të shpëtohet gjatë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Kymete Bajraktari.

KYMETE BAJRAKTARI: Ju faleminderit, kryetar!

I nderuar kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Duke analizuar me vëmendje Projektligjin për buxhet, kornizën afatmesme buxhetore 2011-2013, nuk është vështirë që të arrihet një konkluzion se Projektbuxheti për vitin 2011 dhe korniza afatmesme buxhetore 2011-2013, nuk përmban politikën buxhetore që përkrahin zhvillimin ekonomik të Kosovës, për të cilin ka nevojë aq shumë Kosova, por kjo nuk do të jetë në fokusin tim, sepse kolegët e mi, e sidomos ekonomistët i dhanë komentet e veta të argumentuara se ky buxhet thëllon varfëri në Kosovë, se ky buxhet assesi nuk hap perspektiva zhvillimore. Por, unë sot do të argumentoj vazhdimësinë e padrejtësive dhe diskriminimit që kanë bërë propozuesit e këtij projektligji qytetarëve të një komune. Komuna e Suharekës do të jetë shembull tipik i kësaj injorance buxhetore dhe më duhet para jush, të nderuar deputetë, të bëj transparente se për komunën e Suharekës për vitin 2011-2012-2013 nuk është paraparë asnjë projekt i ri nga buxheti për investime kapitale. Po ritheksoj, asnjë projekt i ri as për vitin 2011, as për vitin 2012 dhe as për vitin 2013. Disa projekte që figurojnë në vijat buxhetore janë paraparë me kornizën buxhetore 2009-2012 dhe atë në Ligjin për buxhetin 2010, janë paraparë që të përfundojnë. Të njëjtat figurojnë edhe në Projektligjin për vitin 2011.

Shembull tipik është buxheti për shkollën fillore në Gjinovc. Buxheti për këtë shkollë është paraparë në Ligjin për buxhet 2010, dhe atë i tërë buxheti. Pra, nëse e shikojmë Ligjin për buxhet të vitit 2010, tabela 4, kodi i projektit 11256 emërtimi, ndërtimi i shkollës fillore Gjinovc, ku e kap shumën në vlerë prej 1 milion e 270 mijë euro. Ky buxhet është bartur në Projektligjin për buxhet të vitit 2011-2013. Të 5 projektet e propozuara në kornizën afatmesme 2011-2013, fatkeqësisht, janë shembuj të tillë. Më duhet edhe njëherë të konfirmoj se asnjë projekt të ri në Projektligjin për buxhet dhe kornizën afatmesme buxhetore 2011-2013, nuk është paraparë. Shpresoj të mos jetë kështu edhe për komunat tjera, ku Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës nuk është në pushtet. Propozoj që së paku tri propozimet që komuna e Suharekës ia ka drejtuar Komisionit për Buxhet dhe Financa, të hyjnë në Projektligjin për vitin 2010 dhe kornizën afatmesme buxhetore 2011-2013, e këto janë: ndërtimi i shkollës fillore në Muglan, me bashkëfinancim, që kap vlerën prej 158 mijë euro; zona industriale me vlerë 1 milion euro, rruga në Jezerc-Grejkoc - 1.8 milionë euro. Kjo është një kërkesë minimale sa për t'u thënë qytetarëve të komunës të Suharekës se edhe Suhareka është në Kosovë. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI: Ju faleminderit! Ministri Ramë Buja e ka fjalën.

MINISTRI RAMË BUJA: I nderuar zoti kryetar,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Kolegë ministra dhe të nderuar e të respektuar deputetë,

E di që debatet për buxhetin janë gjithmonë nga pak të nxehta, kudo në të gjithë kuvendet, parlamentet, sejmët e botës. Edhe kështu dua të besoj edhe këtu se kështu ndodh edhe te ne. Asgjë e veçantë, asgjë e jashtëzakonshme, por jam i prirë që t'i kuptoj shumë racionalisht dhe arsyeshëm këto diskutime, sepse dua të besoj në qëllimin e mirë të të gjithëve. Por, më thoni ju mua, cili është Parlamenti i botës që nuk thuhet kështu ngjashëm si te ne, sepse prioritetet janë caktuar dika, e s' janë caktuar dika, ka të

drejtë këndeje e s' ka të drejtë andej dhe unë pajtohem edhe me këtë logjikë, por dua të besoj fillimisht që, megjithatë, debati të përfundojë aty ku e dëshirojmë të gjithë bashkë.

Por, unë për një motiv tjetër dola këtu. Këto pak kohë sa jam ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, kam bërë pak vizita nëpër Kosovë dhe nuk kam pasur qare pa dalë në foltore, sepse kam porositur e arsimtarëve, 28.000 sish e më shumë që s' janë të një partie, janë të të gjitha partive, por që janë shumë falënderues për Qeverinë e Republikës së Kosovës për këtë rritje që është bërë, për rrogat e tyre, kështu që unë edhe për këtë motiv dola dhe unë jam shumë i sigurt që, duke ju respektuar juve kur thatë fjalën e juaj, po ju them që absolutisht të gjithë nga pozita dhe opozita kanë qenë falënderues dhe shtrëngues dore. Kështu që, unë ju them që të keni kujdes maksimal për këtë gjë, sepse janë njerëz më të ndjeshëm, por dhe më simpatikët për ne, sepse na i mësojnë gjeneratat që do të vijnë dhe padyshim që ka refleksione të këqija, po unë dua të besoj përsëri që ju, dua të besoj në mendësinë e juaj, në diskutimet e juaja, në racionalitetin e juaj mendimor dhe veprues që në fund të na rezultojë mirë kjo gjë. Prandaj, u përmendën edhe çështje tjera. Është dashur të ndalet inflacioni. E po, mirë, unë jam njëfarë ekonomisti teorik, do të kisha dashur që kjo të ndodhte dhe në këtë logjikë të veprimit ekonomik global se si mund të bëhej kjo, përsëri ka shpjegim dhe gjithsesi është shumë i arsyeshëm ai shpjegim që mund të bëhet.

U përmend po kështu se çështja e investimeve të ndara andej e këndeje, se ne kemi paraparë zhvillim ose buxhet zhvillimor 5.3%, bile na e prishi këtë terezi Fondi Monetar Ndërkombëtar, nuk na besoi se jemi, se do të zhvillohemi 5.3, por 5.5, na tha. Nuk e di, unë kam besimin që ata dinë më mirë dhe i kanë matur më mirë gjërat dhe dua të besoj, jo pse nuk besoj tek ne, por besoj te ata, sepse thanë 5.5 dhe më pëlqen kjo. Mund të kenë gabuar ata, por unë nuk besoj se të kenë gabuar ata.

Çështja tjetër që dua ta ngrejë, është çështja e Suharekës që me kryetarin e komunës u pamë që në derë dhe më tha -ministër, dhe unë gjithsesi i thashë se krejt të mundshmen do të bëjmë që të realizohet ajo që është si projekt dhe tri shkolla janë për Suharekën, nuk shmangur Suhareka. Janë një e mesme dhe dy fillore që i kemi në objektivin tonë për të realizuar. Prandaj, unë besoj që të mos hidhërohen këtu deputetët që janë këtu nga Suhareka, pozitë, opozitë, sepse në fakt ky është realiteti, domethënë, që ne do ta bëjmë, do ta analizojmë.

Çështja tjetër që unë dua ta ngrejë, me respekt për ju që s' keni kurajo të dëgjoni, më kanë thënë po kështu mësuesit që t'ju falënderoj edhe juve deputetëve, pavarësisht a do ta aprovojnë apo nuk do ta aprovojnë buxhetin, por më thanë se jemi të sigurt, jemi shumë të sigurt që deputetët e Parlamentit të Republikës së Kosovës, si përfaqësues tonë, do ta votojnë buxhetin e Kosovës, Ligjin për buxhetin e Kosovës. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI: Ju faleminderit! Për replikë është paraqitur deputetja Kimete Bajraktari.

KYMETE BAJRAKTARI: Po, zoti ministër është shumë e vërtetë që në komunën e Suharekës janë në ndërtim e sipër tri shkolla, mirëpo fatkeqësisht tash ato janë të

parapara në Projektbuxhetin 2009-2012, ndërkaq në buxhetin 2011 nuk e kemi asnjë investim kapital të ri. Dhe, çka është ma e keqja, shkolla e Gjinovcit është paraparë të përfundohet në vitin 2011, unë nuk e di kur përfundohet se në vitin 2011 nuk kishte fare investime në atë shkollë.

Tjetra, shkolla e Merlanit ka qenë, është një shkresë e ish- ministrit të Arsimit, i cili e ka konfirmuar se do të bashkëfinancojnë, ajo absolutisht nuk është në projekt. Faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!
Fjalën e ka deputeti Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: Të nderuar deputetë,
Mendoj se ne kemi para vetes një sfidë jo të vogël, sepse po diskutojmë buxhetin me tre muaj vonesë, domethënë edhe nga ana tjetër po diskutojmë një buxhet që, si duket, duhet të zgjidhë shumë probleme edhe ka shumë probleme brenda tij.

Problemi i parë që unë shoh, ka të bëjë me faktin se sa ky buxhet korrespondon me situatën makro-ekonomike, trendet që janë në vijim e sipër dhe trendet që priten në situatën makro-ekonomike të vendit. Problemi kryesor është se ky buxhet është jashtë kornizës së shpenzimeve afatmesme, e cila është aprovuar diku, mos gabofsha, në qershor të vitit 2010 dhe ende korrigjimet në atë kornizë nuk janë bërë.

Duket se është krijuar një praktikë jo e mirë që qeverisja fiskale dhe makro-ekonomike mos të jetë shumë e bazuar në kornizat e shpenzimeve afatmesme dhe ky dokument i rëndësishëm, pra korniza e shpenzimeve afatmesme shpeshherë të konsiderohet si një dokument formal ose vetëm për orientime globale. Mendoj se një qasje e tillë do të na qojë në kriza sikurse kjo që e kemi ose që mund ta kemi për arsye se korniza e shpenzimeve afatmesme i jep disa prioritete të cilat duhet të ndiqen disa vite me radhë. Në qoftë se ato prioritete nuk ndiqen disa vite me radhë dhe korrigjohen me buxhete vjetore, atëherë ne nuk mundemi të ndërtojmë politika konsistente makro-ekonomike dhe politika të harmonizuara në lëvizjet makro-ekonomike, prandaj kjo situatë, ky problem është vrojtuar në mënyrë tejet kritike në Raportin e progresit të Komisionit Evropian, ku është thënë se politikat makro-ekonomike në Kosovë edhe politikat fiskale janë ad-hoc dhe jo shumë konsistente. Prandaj, mendoj se një nga detyrat themelore para Qeverisë është që sa më shpejtë, sa më shpejt këtë situatë ashtu të re që është krijuar me buxhetin e sivjetmë, me atë që e ka paraprirë buxhetit dhe asaj që do të vijë pas këtij buxheti, duhet të na sjellë një kornizë të re të shpenzimeve afatmesme e cila duhet të jetë obligative dhe e cila duhet të krijojë prioritete që do të ndiqen. Përndryshe, çështjet që kanë të bëjnë me cilësinë e politikave makro-ekonomike dhe stabilitetit makro-ekonomik dhe vërejtjet që vijnë në këtë drejtim, duhet të merren tejet seriozisht nga Qeveria dhe akterët tjerë.

Problemi numër dy, ka të bëjë me atë se sa është, sa janë projeksionet në këtë buxhet harmonike. Vetë një inventarizim i shkurtër i shifrave që e shoqërojnë këtë buxhet, tregon se këtu kemi probleme, derisa rritja ekonomike projektohet 5.3% ajo nominale

diku 8%, mos gabofsha, të ardhurat e buxhetit rriten 12.2%, shpenzimet 19.3%. Pra, shpenzimet e buxhetit janë gati tri herë, pra përqindja e rritjes së shpenzimeve është tri herë më lartë se sa përqindja e rritjes ekonomike ose afër tri herë më e lartë. Vetë kjo tregon një mos konsekuencë një lëvizje jo të logjikshme e cila mund të prodhojë mos stabilitet brendapërbrenda buxhetit ose, për shembull, nëse ne kemi projektuar rritjen e importit 6%, kurse të hyrat në kufi duhet të rriten 18.5%, përkundër faktit se e di se është rritur akciza në gjysmën, por ky efekt që duket tash i mirë, do të vijë duke rënë në gjysmën, pjesën e dytë të vitit, tregon prapë për një disharmoni. Prandaj, do të ishte mirë që këto gjëra të shikohen me seriozitet dhe në kornizën e re të shpenzimeve afatmesme, patjetër të vijmë deri te një harmoni më e madhe edhe deri te prodhimi i një stabiliteti makro-ekonomik, përndryshe ne do të vijmë prej problemit në problem dhe përsëri do të ballafaqohemi me nevojat që të marrim vendime ad-hoc dhe politika ad-hoc ekonomike.

Për shkak të këtyre lëvizjeve që i kemi, ne ballafaqohemi seriozisht me deficitin buxhetor. Ky është një problem, domethënë, për të cilin duhet të jemi të vetëdijshëm, është deficieti 170 milionë, përkatësisht 226 me ato dy komponentë tjerë dhe ky deficit, pra, mund të jetë më i problematizuar për shkak të asaj mosharmonisë midis treguesve ekonomik për të cilët fola unë. Mund të jetë problematik nëse nuk arrijmë marrëveshje me Fondin Monetar Ndërkombëtar edhe më problematik, por mund të jetë problematik edhe nëse nuk realizohen ato të hyrat e njëhershme që pra, si duket janë nga privatizimi e dihet se Qeveria dhe Banka Qendrore edhe kryeministri dhe ministri i Financave e kanë nënshkruar aranzhmanin me Fondin Monetar Ndërkombëtar të 6 tetorit. Ky aranzhman duhet të rinegociohet, pavarësisht se duket se ka një progres, duket se ka disa shenja që janë biseduar, por prapëseprapë prapa të gjitha formulimeve që mund të dëgjojmë sot edhe në këtë sallë, por edhe kumtesave edhe informatave që marrim nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, këtu mund të kemi probleme serioze dhe negociata jo fort të lehta. Ne duhet të jemi të vetëdijshëm sot për këtë problem dhe ne si Kuvend, meqenëse ne nuk e lidhim marrëveshjen, ne as nuk e kemi nënshkruar atë marrëveshjen as nuk e kemi ratifikuar atë marrëveshje, ne duhet ta mbajmë përgjegjëse Qeverinë që t'i rregullojë marrëdhëniet me Fondin Monetar Ndërkombëtar, sepse nuk është problemi vetëm i menaxhimit të buxhetit, problemi është edhe me besimin e investitorëve në vendin tonë dhe me mundësinë që të shfrytëzojmë edhe burime edhe kredi tjera. Prandaj, më duket se Qeveria merr një barrë shumë të rëndë, një përgjegjësi shumë të rëndë në negociata mjaftë të vështira me Fondin që do të pasojnë. Prandaj Qeveria, pra duhet të jetë e vetëdijshme për këtë dhe duhet Parlamenti ta obligojë sot dhe të kërkojë përgjegjësi prej saj çfarë cilësie të marrëdhënieve po ndërton me Fondin dhe me institucionet tjera financiare ndërkombëtare.

Çështja e të ardhurave të njëkohshme apo privatizimit, mendoj se ky është një problem vetë privatizimi i ndërmarrjeve publike, është një problem tejet serioz, është problem aq serioz sa që ne nuk guxojmë të kalojmë sipërfaqësisht ... ose të fusim nene në ligjet caktuara. Privatizimi i ndërmarrjeve publike shumë të rëndësishme, duhet të jetë produkt i një konsensusi elementar bazik në shoqëri, konsensus i pozitës, opozitës dhe shoqërisë civile. Nëse nuk ka durim që të bëhet një debat serioz, i argumentuar lidhur me privatizimin e aseteve aq të rëndësishme, siç është Telekom, apo siç është rrejt

apo siç është “Kosova C”, ne mund të krijojmë tensione politike dhe sociale në Kosovë. Nuk besoj se i duhen askujt ato tensione politike- sociale. Prandaj, duhet të kemi durim, duhet të vijnë materialet në Kuvend, duhet të diskutohen dhe në këtë drejtim duhet të shihet edhe neni 4, nuk di atë nen, unë nuk po mund ta kuptoj, unë nuk e kuptova që ai është zëvendësim për një debat që ka mbetur borxh në Kuvend të aprovohet strategjia e PTK-së. Nëse ai nen e zëvendëson atë, unë nuk e kuptova, prandaj neni 4 duhet të sqarohet këtu. Unë e di që strategjia e PTK-së duhet të vij edhe një herë në Kuvend dhe duhet të diskutohet edhe një herë në Kuvend. Ne duhet të jemi të qartë këtu për çka po vendosim edhe si po vendosim, përndryshe privatizimi i ndërmarrjeve publike dhe fondet që krijohen nga ndërmarrjet publike, nga privatizimi duhet të vendosen në një fond të veçantë, në nënlllogari në buxhetin e Kosovës dhe ajo nënlllogari duhet të shpenzohet në mënyrë transparente dhe me destinacione vetëm për ligj, të përcaktuar me ligj. Nuk mund të shpenzojmë mjetet e privatizimit, ndërmarrjeve publike për paga ose për shërbime, për mall, sepse ne krijojmë jostabilitet, sepse vitin tjetër nuk i kemi këto të ardhura, a i kemi krijuar obligimet për këto. Prandaj unë mendoj se na duhen ndryshime edhe në Ligjin për ndërmarrje publike, ku duhet të rritet roli i parlamentit, të rritet transparenca edhe të përcaktohen destinimet për çka mund të shpenzohen fondet e privatizimit të ndërmarrjeve publike ku kanë hise gjenerata e sotme dhe gjeneratat e ardhme dhe nga ai privatizim dhe investimi i atyre mjeteve duhet të përfitojnë të gjithë qytetarët e Kosovës.

Një çështje tjetër që është problem në këtë buxhet, është se taksa për shfrytëzimin e pasurive natyrore që quhet tantimë, është zero sivjet. Shtrohet pyetja: a shfrytëzohen pasuritë natyrore në Kosovë, sivjet? A ekziston një ligj sado që ai ligj nuk është i mirë, domethënë e ka një tantimë, një taksë minimale...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Fadil Demaku, le të përgatitet deputetja Rita Hajzeraj.

FADIL DEMAKU: I nderuar kryetar i Parlamentit,
I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministër, ministra,
Të nderuar deputetë,

Premtimet e kryeministrit për rritje pagash për sektorët më të ndjeshëm të shoqërisë sonë dhe bërja e tyre vendim, duke i përfshirë në buxhetin e këtij viti, është vetëm vazhdim i punës dhe përgjegjësisë së Qeverisë ndaj qytetarëve të vendit tonë në përputhje me rrethanat kohore që jemi duke i kaluar.

Gjitha kundërshtimet e këtyre ditëve më rikthejnë në tri vitet e kaluara kur Qeveria e Republikës së Kosovës, ka realizuar projekte të mëdha të infrastrukturës e sidomos në rrugë e shkolla, ku u krijuan kushte më të mira jetese për qytetarët e vendit, duke krijuar qasje të barabartë në trajtimin e tyre nga ana e saj. Premtimet e Qeverisë së kaluar dhe realizimi i të gjitha atyre projekteve të dukshme dhe të prekshme nga qytetarët, i kishte zënë të papërgatitur skeptikët dhe opozitën e kaluar, të cilët ishin ngutur me parashikimet e tyre të gabuara, që janë bërë të zakonshme në vendin tonë. Në

mungesë të arsyes së vërtetë për t'i kundërshtuar projektet madhore, dolën me deklarime publike e fushata mediale se më prioritare se rrugët e shkollat, qenka mirëqenia dhe standardi më i lartë. Ata nuk e dinin se kjo nuk ishte punë fushate, por ishte strategji e Qeverisë për mandatin e saj 4 vjeçar në forcimin e të gjitha hallkave të shtetit që kërkon konsolidim dhe forcim të vazhdueshëm, përtej deklaratave të mëdha dhe fjalëve të bukura, ngritja e pagave për familjet e dëshmorëve dhe invalidëve të luftës është veprimi më i duhur.

Të nderuar deputetë,

Askush nuk mund ta akceptojë këtë më shumë se sa vetë përfituesit e drejtpërdrejtë, jo nga aspekti material, por si mbikëqyrje dhe mirënjohje e vazhduar nga shteti për të cilin u sakrifkuan. Ngritja e pagave për Policinë e Kosovës, nuk ka të bëjë vetëm me standardin e të jetuarit të kësaj kategorie, por si rritje e përgjegjësisë dhe angazhimit në punë, çka reflekton në sigurinë tonë të përditshme për një ambient të qetë dhe të sigurt. Të gjithë jemi të bindur për nevojën imediate të rritjes së cilësisë së shërbimeve ndaj pacientëve, rritja e pagave të punonjësve të shëndetësisë, ndikon drejtpërdrejt në favor të këtyre shërbimeve.

Krijimi i hapësirave të nevojshme dhe rritja e pagave të mësimdhënësve, e bën që ata të jenë në nivel të lartë të përgjegjësisë për zbatimin e plan-programeve arsimore dhe avancim të dijes. Ky është investim në të ardhmen e këtij vendi. I gjithë ky projekt është për t'u përshëndetur që ka mundur të gjejë zbatim dhe të gjithë duhet t'i gëzohemi dhe natyrisht se duhet përkrahur. Të mendojmë përtej kundërshtimeve të petkut partiak, por të veprojmë në përgjegjësi para qytetarëve të vendit, të instalojmë logjikën se qëndrimet që janë në interes të shoqërisë, pavarësisht nga cila palë iniciohen, duhet të përkrahen nga të gjithë. Dhe, fare në fund të fjalë sime, dua të shtoj se projektbuxheti i propozuar këtu nga ana e Qeverisë, përcjell një mesazh të qartë tek të gjithë qytetarët, pa dallime partiake, hapa të tjerë se Qeveria është e përkushtuar dhe po tregon seriozitet në përmbushjen e premtimit të saj, nëse do të angazhohet siç ka bërë edhe më herët në nxjerrjen e vendit nga nivelet e tranzicionit, nga pikëpamja e parametrave ekonomik, në një ekuilibër të ri makro-ekonomik që garanton zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe social për vendin. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Rita Hajzeraj- Beqaj.

RITA HAJZERAJ- BEQAJ: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Sot po flasim për Projektligjin për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011. Ky buxhet nuk është i bazuar në parametra buxhetorë, ka ngarkesa buxhetore të cilat e rrezikojnë ekonominë e vendit. Ky buxhet i propozuar paraqet shumë të dhëna të supozuara dhe jo të matshme dhe tërë kjo është si rezultat i mungesës së strategjisë nacionale të zhvillimit ekonomik të vendit. Pra, në këtë buxhet janë paraparë të hyrat dhe shpenzime me supozime të paqëndrueshme. Tek të hyrat e përgjithshme paraqitet se do të ketë rritje në krahasim me vitin 2010, e tërë kjo si rezultat i supozimit të ngritjes së bazës tatimore dhe rritjes së importit, sepse do të ketë investime publike shtesë. I tërë

ky proces është në kundërshtim me supozimin, sepse nëse kemi rritje të bazës tatimore, do të kemi zvogëlim të importit dhe kjo është në kundërshtim me procedurat e importit si dhe është një politikë e ngritjes së bazës tatimore e cila është ndëshkuese për bizneset në Kosovë, e cila do të zvogëlonte likuiditetin të këto ndërmarrje si dhe mundësia e falimentimit dhe shuarjes së këtyre ndërmarrjeve me këto politika, do të paraqiste një trend eksponencial.

Sipas këtij buxheti dhe projektimit të tij, s' do të ketë investime të huaja dhe private. Efektet e këtij do të jenë: rritja e deficitit, shtimi i disiplinës ciklike selektive përmes ATK-së, presion të ndërmarrjet publike për ta anketuar dividendën për mbushjen e buxhetit të Republikës së Kosovës. Ja për shembull, tek të hyrat tatimore, vendore në krahasim me vitin 2010, kemi rritje rreth 18.10% e tërë kjo argumentohet se me ndryshimin e Ligjit të TVSH-së dhe me aplikimin e arkave fiskale, do të ketë rritje. Mirëpo, kjo që ceket është e pamatshme si dhe bizneset po ngarkohen me tatime shtesë të cilat mund të shihen në raportin e Administratës Tatimore, ku vetëm për vitin 2010, ka pasur 59 milionë tatim shtesë për bizneset e kontrolluara në vitin 2010, ku pothuaj se 60% të bizneseve janë në konteste gjyqësore e të cilat mund të jenë lëndë të humbura për Administratën Tatimore, e që kjo reflektohet te kthimet, të cilat janë paraparë të jenë shumë të vogla. Pra për vitin 2011, janë paraparë kthime vetëm prej 32 milionë, ndërsa vetëm për TVSH për vitin 2011, janë mbi 28 milionë euro, të cilat janë tatime për të cilat duhet të realizohet rimbursimi.

Mosnënshtrimi i Marrëveshjes nga FMN, rrezikon që të mos kemi të hyra në masën prej 167 milionë si dhe risku buxhetor rritet edhe më shumë. Pra, ky buxhet është i konstestueshëm edhe nga FMN-ja.

Te resorët ministrorë, nëse e shikojmë buxhetin i cili ndahet Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrinë e Shëndetësisë e ka marrë si shembull, atëherë prapë shohim se kjo Ministri dhe ky resor kaq i rëndësishëm, ende do të vuajnë nga mungesa e buxhetit. Po ashtu nuk dalin premtimet e kryeministrit se ky resor për këtë vit do të jetë prioritet dhe pat deklaruar se buxheti për këtë Ministri, do të jetë afër rreth 180 milionë euro, ndërsa nga kjo ndarje kemi vetëm 79 milionë euro për shëndetësi, pra të paktën edhe këtë vit, qytetarët e Kosovës nuk do të kenë mundësi t'i gëzohen ndarjes së tillë buxhetore. Harrova ta përmend edhe Spitalin e Mitrovicës, i cili do të kishte pak më shumë përparësi dhe ka kërkuar një shtesë buxhetore më të madhe, bile sipas parametrave në bazë të cilëve është bërë planifikimi i këtij buxheti për Spitalin e Mitrovicës, në tetor të vitit të kaluar, pra do të ishte e qëlluar që ky buxhet për Spitalin e Mitrovicës të rritet dhe jo përkundrazi të zvogëlohet.

Te niveli komunal po thuhet tek te gjitha komunat ku të hyrat vetanake janë më të vogla, grandet qeveritare janë më të mëdha. Ndërsa, po e marrë shembull Prishtinën e cila ka më së shumti të hyrave vetanake, në vend që të shpërblehet kjo komunë pra merr shumë më pak grande qeveritare, e që nuk do të duhej të ndodhte kështu. Po të shihen ndryshime buxhetore të cilat i kanë bërë shumica e komunave të udhëhequra nga PDK në këtë rast, tregojnë që projektet e vitit 2010, që kanë qenë në participim me grande qeveritare, janë bartur në vitin 2011. Andaj, bazuar në atë çka e cekta edhe më lart,

kemi një buxhet i cili është në kundërshtim me parimet e buxhetit, e tëra kjo që prezantohet tek të hyrat ashtu edhe tek shpenzimet është e bazuar në supozime dhe në shifra fiktive, të cilat janë në kundërshtime me parimet e buxhetit. Edhe një pyetje e kisha për ministrin e Arsimit, nuk kam qare, sepse e tha dhe vazhdimisht po na ofendon, sepse mësuesit i kanë dhënë një porosi për deputetët e Parlamentit që ta votojnë buxhetin dhe t'i risin pagat, ndërsa neve jemi për rritjen e pagave. Mirëpo e kam një pyetje se çfarë kanë thënë të papunët, zoti ministër? 60% i të papunëve a ju kanë dhënë porosi të na jepni neve apo ju kanë dhënë juve porosi? Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Agim Kuleta, le të përgatitet deputeti Xhevdet Neziraj.

AGIM KULETA: Zoti kryetar i Kuvendit,

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Edhe kësaj radhe sikur vazhdimisht deri më sot, ne si deputetë të kësaj legjislature po përballemi me një situatë kur duhet të marrim një vendim për një çështje urgjente, të marrim një vendim të orëve të fundit dhe po ashtu sikur gjithmonë, midis dy zgjidhjeve të këqija të vendosim për atë që ne e konsiderojmë më pak të keqe.

Kjo situatë është rezultat i një qasjeje jo të pafajshme të Qeverisë ndaj Kuvendit, një qasje që synon përhapjen në këtë institucion të asaj që unë do ta quaja sindromi i urgjencës. Ky sindrom po bën që propozimet e Qeverisë të trajtohen nga Kuvendi si çështje të rëndësishme për t'u votuar për shkak të kohës e jo për shkak të përmbajtjes. Përrjashtim nuk po bën as ky projektligj për të cilin po diskutojmë sot. Duke qenë se jemi në prag të muajit prill, muaj për të cilin nuk ka buxhet të miratuar, tentohet që të detyrohemi që fatin e buxhetit të një viti t'ia nënshtrojmë nevojës së ngutshme të buxhetit mujor.

Kësaj praktike, nuk ka emër që i shkon më mirë se sa emri shantazh. Prandaj, para se të shpales qëndrimet e Lëvizjes për Bashkim lidhur me çështjet kryesore që kanë të bëjnë me Projektligjin për buxhet, dua të shpreh pakënaqësinë time si deputet lidhur me këtë praktikë të derisotme të Qeverisë. Pas analizës së kujdesshme që i bënë këtij projektligji të buxhetit, ne e kemi gjetur në mesin e shumë vërejtjeve, katër prej tyre si shumë serioze. Vërejtja e parë ka të bëjë me mospërputhjen midis të hyrave totale dhe shpenzimeve totale. Duke qenë se si të hyra totale janë llogaritur rreth 1 miliard e 264 milionë, ndërsa shpenzime 1 miliard e 434 milionë dhe kur kësaj ia shtojmë shpenzimet për pagesa të jashtme dhe kredidhënie, bilanci i përgjithshëm rezulton me 226 milionë euro deficit fillestar. Ky deficit synohet të mbulohet përmes dy burimeve kryesore, financimit nga jashtë dhe privatizimit të ndërmarrjeve publike.

Duke pasur parasysh përkeqësimin e kohëve të fundit të raporteve midis Qeverisë së Kosovës dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar, e për pasojë rrezikimin e përfitimit nga ky financim i jashtëm, e gjithashtu duke pasur parasysh se ende nuk kemi përgjigje të qartë nëse do të bëhet ky privatizim apo në çfarë kushtesh do të bëhet, miratimi i këtij buxheti në varësi kaq të thellë nga këto burime kaq të pasigurta, bën që Kosovën ta shtyjmë të ecën nëpër një litar nën të cilin shtrihet një humnerë e thellë pa fund.

Kjo logjikë e udhëheqjes së shtetit është logjikë sot për nesër, është qeverisje me xhepa jashtë apo në rastin më të mirë - qeverisje e centëve të fundit. Vërejtja e dytë ka të bëjë me orientimin e politikave ekonomike të vendit. Me projektligjin në fjalë shihet se Qeveria ka paraparë që për vitin 2011 nga të hyrat doganore, përkatësisht nga importi buxheti i Kosovës të përfitojë 831 milionë euro, që përbën 2/3 e të hyrave të brendshme, ndërsa nga të hyrat vendore 261 milionë euro. Deri në vitin 2013, pritet që të hyrat nga dogana të rriten për 73 milionë, ndërkohë që të hyrat vendore pritet të rriten vetëm për 35 milionë euro. Kjo pasqyrë e thjeshtë na bën po kaq të thjeshtë ta kuptojmë se kah po shkon ekonomia e këtij vendi. Ky orientim i politikave bën që ky vend ta konsolidojë edhe më tepër statusin e vet si një vend konsumator, si një përbindësh i mallrave të huaja.

Në këtë vazhdë, mënyra e ndarjes së buxhetit nuk garanton kurrfarë perspektive për zhvillimin ekonomik të vendit. Injorimi i politikave që do të nxitnin lindjen dhe zhvillimin e prodhimit të vendit, bën që tregu ynë të vazhdojë të mbetet një treg i mirë, jo konkurrent as në vendete e rajonit e lere më të jetë i aftë për të përballuar konkurrencën në tregun Evropian që përbën një prej kushteve, plotësimi i të cilit është i domosdoshëm në rrugën e trumbetuar nga të gjitha qeveritë e derisotme drejt BE-së.

Pikërisht kjo qasje, pra duke thelluar hendekun midis të hyrave nga doganat dhe atyre vendore në favor të të parave, tregon se ne jemi duke ecur në kahe të kundërt dhe me kalimin e viteve në këtë aspekt, ne nuk do t'i afrohem BE-së, por do t'i largohemi asaj. Ky është treguesi më i qartë se sa shumë ëndërr është ëndrra evropiane e Kosovës, për të gjithë, kjo qasje ndaj ekonomisë, është garancia më e mirë për ne si qytetarët e këtij vendi se edhe për shumë kohë do të vazhdojnë të vuajnë nga varfëria e papunësia e thellë, nga arsimi i kualitetit të dobët dhe shërbimet jocalësore shëndetësore, është garanci e sigurt që ushqimi ynë i përditshëm do të varet nga disponimi i vendeve fqinjë për të na e shitur atë. Është garancia më e sigurt që për ne siguria ekonomike nuk do të jetë kur e garantuar. Vërejtja e tretë ka të bëjë me çështjen e rritjes së pagave për kategoritë e caktuara të shërbyesve. Lëvizja për Bashkim nuk është aspak kundër rritjes së këtyre pagave, sikundër edhe të gjithë deputetët e tjerë këtu, përkundrazi në këtë gjendje të rëndë ekonomike, me rritje të përditshme të çmimeve, jeta e qytetarit është rënduar aq shumë sa që një rritje e të ardhurave të tyre është e domosdoshme për ta përballuar atë, problemi qëndron te motivi i kësaj rritjeje. Kjo rritje është thjesht rezultati i motiveve shumë të ngushta partiake, argument i pakontestueshëm për këtë, është se në kornizën afatmesme nuk ka qenë e paraparë një rritje e tillë dhe arsyeja pse në këtë kornizë nuk ka qenë e paraparë një rritje e tillë është e dukshme se në kohën e hartimit të kësaj kornize, nuk ka qenë e paraparë mbajtja e zgjedhjeve të përgjithshme të jashtëzakonshme në vend.

Gjithashtu, konsiderojmë se vetëm rritja e pagave është marrje vetëm me menaxhimin e pasojave, e jo marrje me eliminimin e shkaqeve të problemeve ekonomike në vend.

Vërejtja e katërt ka të bëjë me çështjen e futjes në mënyrë të klandestine të çështjes së privatizimit të ndërmarreve në Projektligjin për buxhet.

Privatizimi i ndërmarrjeve të caktuara është çështje e veçantë dhe duhet të trajtohet si e tillë. Ajo nuk mund të trajtohet me indiferentizmin që do të mund t'ia lejonin vetes me rastin e shitjes së një kilogrami domatesh në treg. Aq më tepër, ngjyrën e kontrabandës ja jep fakti se projekti për privatizimin e PTK-së, nuk ka arritur të marrë miratimin e Kuvendit dhe legjislaturën paraprake. Prandaj, për t'i ikur rishqyrtimit që do të mund të kishte përgjigje të padëshiruar, propozuesi i këtij projektligji ka futur në mënyrë të heshtur dhe të ndërvarur në projektet e tjera të parapara me këtë projektligj për buxhet. Kur kësaj ia shtojmë faktin që mos votimi i këtij projektligji bën që pas disa ditësh Kosova nuk do të ketë buxhet të miratuar për të kryer pagesat, atëherë e tërë kjo ndërmarrje e Qeverisë merr formën e pastër të një shantazhi ndaj deputetëve. Me këtë synohet që deputetët të nxirren para situatës në të cilën ose duhet ta miratojnë buxhetin ose ta shtyjnë vendin në krizë dhe në këtë situatë unë i ftoj deputetët e nderuar të mos e bëjnë as njëren e as tjetrën. Kjo dilemë duhet të zgjidhet nga ai që e ka shkaktuar dhe ne duhet t'ia japim rastin për këtë. Ju faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kryesisë, zoti Xhavit Haliti

XHAVIT HALITI: Ju faleminderit! Fjalën e ka Xhevdet Naziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Ju faleminderit, i nderuar zoti kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Ministra të nderuar,

Unë do të ndalem në disa çështje ekonomike në lidhje me buxhetin 2011, buxhet të cilin jemi duke e miratuar duke vrapuar për shkak të situatës dhe rrethana në çfarë kemi ardhur. Unë besoj që edhe Komisioni i Buxhetit, edhe Parlamenti, në të ardhmen do të kenë kohë më tepër të shqyrtojnë një projektbuxhet ashtu siç i ka hije. Në secilin projektbuxhet, të secilit shtet duhet të caktohen prioritetet dhe ato prioritetet, duhet të shohim se këtë vit a do të kemi shëndetësi më të mirë dhe më cilësore, a do të kemi arsim më të mirë dhe më cilësor, a do të kemi një ulje të papunësisë, a do të kemi punësim të mëtutjeshëm, a do të kemi një shkallë të rritjes të zhvillimit të ekonomisë dhe shumë çka tjetër? Mirëpo, prioritetet në Kosovë, prej viti në vit po ndërrojnë, po ndërrojnë për shkaqe se Kosova nuk ka strategji të zhvillimit ekonomik dhe gjersa vendet tjera kanë strategji të zhvillimit ekonomik dhe të integritit, me qëllim që të përafrohen ndaj shteteve të Bashkësisë Ekonomike Evropiane, ne ende nuk e kemi bërë as hapin e parë rreth strategjisë së zhvillimit ekonomik dhe në kuadër të kësaj Qeverie ka shumë ekspertë të ekonomisë që për një kohë shumë të shkurtër mund ta bëjnë këtë strategji dhe nuk po a bëjnë, bile të na mbajnë ligjëratat nëpër shkolla të ekonomisë dhe të tregut të lirë, ndërsa unë kisha dëshiruar që ata të veprojnë, se treg i lirë nuk do të thotë që të flasim vetëm fjalë, por ai duhet të funksionojë në vepër. Ndërsa ne jemi me një ekonomi ku edhe mallin tonë nuk po mundemi ta këmbëjmë në shtete tjera, do të thotë jemi në ekonomi primitive, ku është bërë këmbimi i mallit- mall, sepse po na bllokoi edhe Serbia edhe Maqedonia ta qesim mallin jashtë Kosove. Do të thotë këto janë probleme dhe që edhe vetë ministri i ka pasur gjatë përpilimit të buxhetit dhe unë e përgëzoj ministrin se e ka pasur bukur vështirë t'i përpilojë ata numra të rritjes së pagës, t'i qetë në buxhet. Nuk është lehtë për arsye se janë jep deklarata politike dhe deklaratat politike është shumë lehtë të thuhet në përqindje dhe më vonë është shumë vështirë të zbatohen

në praktikë. Unë e përgëzoj për punën që e ka bërë dhe ishalla i del mbar kjo, nuk hime në konflikt me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Diçka tjetër që do të bisedoja është edhe qëndrueshmëria buxhetore, është se secili ekonomist e ka cekur dhe duhet ta cekë qëndrueshmërinë buxhetore për arsye që në start po themi - jemi në deficit buxhetor. Po parashihet 19% rritje nga të hyrat doganore. Në ekonomi e di që secili shtet, shtetet e zhvilluara nuk varen nga të hyrat doganore, mirëpo ne jemi në zhvillimin e tillë ekonomik, ku zhvillimi ekonomik kryesisht është nga të hyrat doganore, do të thotë nga ato të hyra që edhe pa u shitur malli, inkasohet. Gjithashtu po parashihet edhe, që Administrata Tatimore të ketë 18% të hyrave më shumë se sa në vitin e kaluar. Unë besoj që kështu të jetë dhe është mirë të jetë, por shumë është më mirë që të luftohet ekonomia informale dhe të funksionojë dogana në pikën 1 she 31, në veri të Mitrovicës, se përndryshe nuk do të realizohet kjo që është paraparë. Duke e marr për bazë në mënyrë kronologjike se pjesa e parë e inkasimit edhe të të hyrave nga doganat edhe të hyrave nga tatimet, në pjesën e parë është shumë më e madhe se sa në pjesën e dytë, atëherë jemi të gjithë skeptik si ekonomistë në lidhje me qëndrueshmërinë buxhetore.

Do të shëtis pak nëpër ministri dhe do të ndalem në Ministrinë e Punëve të Brendshme, e cila gjatë viteve të kaluara nuk e kanë ndarë asnjë mjet buxhetor për riintegrimin e të kthyerve nga diaspora, për arsye se Ministria ka nënshkruar disa marrëveshje për shkak të liberalizimit të vizave dhe fatmirësisht sivjet është paraparë një buxhet, i cili nuk do të jetë i mjaftueshëm për integrimin e njerëzve që do të kthehen nga diaspora dhe që është një prej kushteve të para për liberalizimin e vizave. Gjithashtu Ministria me famshme në këtë Qeveri, Ministria e Komuniteteve, e cila që nga viti 2004 funksionon dhe që ka bërë ndërrime të mëdha në këtë Ministri, kryesisht paratë i harxhon për komunitetin serb dhe tani projektet janë prapë për këtë komunitet, duke marrë për bazë edhe komunat ku jetojnë dhe veprojnë tani me decentralizim, komunat serbe, atëherë ky buxhet do të harxhohet vetëm nga ky komunitet, ndërsa komunitetet tjera ishalla ju merr vera e nxehtë dhe mund të absorbojnë rrezet. Seriozisht po them, unë si përfaqësues i komunitetit egjiptian, që sa vite ka shumë pak projekte që nga kjo Ministri për komunitete dhe kthim bëhet në këtë drejtim, ndërsa goja këtu është plotë të drejta për komunitete dhe minoritete. Nëse përmendet, është mirë të definohet se është për komunitetin serb, duke marrë për bazë se edhe ata menaxhojnë edhe me Zyrën pranë Kryeministrit, përfaqësuesi është i komunitetit serb edhe në Komisionin për Komunitete përfaqësues i komunitetit serb, do të thotë në të gjitha strukturat që kanë të bëjnë me minoritete, edhe me buxhet harxhohen për këtë komunitet. Prandaj, unë parashoh që të ketë projekte shumë detale, që të ketë projekte edhe për komunitete tjera se edhe ata janë pjesë e Kosovës, se janë komunitete që kanë kontribuar dhe kanë nënshkruar pavarësinë e Kosovës, janë komunitete që kanë kontribuar dhe kanë nënshkruar Kushtetutën e Kosovës, ndërsa po përfitojnë mu ata njerëz që as nuk e kanë nënshkruar Kushtetutën e Kosovës, që nuk e kanë nënshkruar pavarësinë e Kosovës dhe në pikëpamje buxhetore janë duke përfutuar më shumë. Edhe përfundimisht do të ndalem në Ministrinë e Bujqësisë. Unë e di që ka rritje të subvencioneve, por Ministria e Bujqësisë duhet të ketë subvencione më shumë për arsye se nëpërmes bujqësisë, mund të bëhet punësimi se Kosova nuk mund të zhvillohet industrialist aq shumë, por mund

me bujqësi ta rritë numrin e të punësuarve, por çka është edhe më kryesorja, ne më shumë se gjysmën e buxhetit e harxhojmë produkte ushqimore të cilat merren nga shtetet e rajonit e sidomos nga Maqedonia dhe Serbia dhe produkte këto që mund të prodhohen në Kosovë. Prandaj, me një kujdes më të madhe ndaj Ministrisë së Bujqësisë do të rritet edhe numri i të punësuarave, do të rritet edhe një kredibilitet që do të ketë që ekonomia e Kosovës, bile mundet ta mbanë vetveten, por e kemi parasysh se në këtë vit po parashihet që do të ketë kriza ushqimore për arsye të shumë gjërave tjera, atëherë besoj që Ministria e Bujqësisë duhet ta ketë një prioritet më të madh dhe ndoshta ministri do të jetë edhe më i angazhuar kur ka buxhet edhe më shumë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Kryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Zëvendëskryeministër, se nëse i përhëndes me radhë të gjithë zëvendëskryeministrat deri në fund të mandatit, deri këtu duhet t'i qesim karriget se kanë për t'u bërë shumë. Ne sot po debatojmë një ligj, i cili në këtë vit kalendarik është një ndër projektligjet më të rëndësishmet dhe po shihet edhe tendenca e debatit në çfarë kahe dëshiron që vetë kryeministri ta drejtojë apo edhe Qeveria, ashtu edhe ne, duhet që edhe në atë formë të flasim, sepse ka shumë tema që duhet t'i trajtojmë. Po e fillojmë nga ajo që e mira e këtij vendi është se jemi vend demokratik dhe nuk jemi vend i cili udhëhiqet nga një parti politike, sepse po të dëgjohen vetëm deklaratimet e kryeministrit dhe ministrit në këtë rast për zhvillim, do t'ia kishte lakmi edhe vendet që janë në hov të zhvillimit shumë më të madh ekonomik, ndoshta edhe Kina edhe Indonezia do të ishin shumë të kënaqur me ato që ju i proklamoni sot para Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të Kosovës.

Investimet private, e tha ministri do të shtohen në një aspekt të qëndrueshëm si rezultat i krijimit të një midisi të favorshëm që është krijuar në Kosovë. Ndërsa, raporti i Bankës Botërore, zotëri ministër, Kosovën e radhitë të fundit për një krijim të mjedisit për zhvillim të biznesit. Të mos kesh vizion për planifikim, është e njëjtë apo e qartë do të planifikosh qëllimshëm dështimin. Këtë po e bëni ju zotëri kryeministër, sepse po të krahasohet Projektbuxheti i vitit 2010, me këtë draft shihet se pothuaj se të gjitha projektet po përsëriten, dhe të gjitha po barten prej viti në vit dhe nuk janë të realizuar. Sigurisht që ju do ta ngrehni këtë çështje dhe do t'i sanksiononi ministrat, sepse edhe ashtu keni bërë edhe në të kaluarën, i keni sanksionuar të suksesshmit ju, jo ata të pasuksesshmit dhe them shkurt se ky buxhet nuk është buxhet i zhvillimit dhe nuk mund të jetë zhvillimor, me këtë rritje ekonomike e cila po bëhet apo edhe tentohet të realizohet me vendin tonë. Tani ne vijmë para dilemave, unë si deputet, kolegë të nderuar, duke marr parasysh momentin shumë kritik në të cilin kemi ardhur si shtet, apo më mirë të them se na ka sjellë kjo Qeveri, ne jemi në dilemë shumë më të madhe se a ta aprovojmë këtë buxhet apo të shkojmë në krizë edhe më të thellë, t'i zhblllokojmë bizneset apo ta vazhdojmë krizën, t'i rrisim pagat të cilat janë rritur apo nuk janë rritur

në nivelin e premtuar të rritës apo ta vazhdojmë krizën sociale? T'i themi po këtij propozimi të Qeverisë, i cili na ka sjellë para një dileme shumë të madhe ku humbet kredibiliteti i Kosovës para faktorit ndërkombëtar, sidomos Fondit Monetar dhe Bankës Botërore.

Zoti kryeministër, t'i thuhet dikujt se jeni kundër autostradës, është me të vërtetë joreale, sidomos atyre që vetë e kanë promovuar këtë ide dhe këtë projekt, ndërsa ju vetëm emrin ia keni ndërruar nganjëherë edhe kahen ashtu siç ka dëshiruar Qeveria. Prandaj, deklaratimet e juaja sot që i paraqitët, me të vërtetë do të mbesin vetëm fjalë, sepse realiteti është më ndryshe. E kuptojmë dikasterin qeverisës, Ministrinë për Ekonomi dhe Financa, sepse me të vërtetë e ka pasur vështirë dhe duhet të lavdërohet në këtë rast për përgatitjen e këtij projekt-propozimi dhe në mënyrën si si është sjell gjendja deri me tani.

Të thuhet, zoti kryeministër, se janë rritur investimet kapitale apo 40% të buxhetit të investimeve kapitale shfrytëzohen... të qytetarit, duhet të thuhet se edhe 40% të shpenzimeve kapitale drejtohen vetëm në infrastrukturën rrugore apo vetëm në një projekt i cili është autostrada Vërmicë-Merdare, dhe asnjëherë deri më tani Qeveria e Kosovës, përkatësisht Ministria e Infrastrukturës nuk ka ofruar një informatë më të detajuar për kohëzgjatjen e projektit, koston dhe mënyrën e financimit. Raportet ndërmjet të hyrat dhe shpenzimet, japin një mosharmonizim i cili ka një mbulesë jo edhe aq bindëse dhe që janë paragjykuese. Përkrahja nga Këshilli i Evropës, nga Banka Botërore, huazimet nga jashtë, huazimet nga brenda dhe nga FMN-ja, për të gjitha këto mungon përgjigja dhe do të mbesin vetëm shpresë të cilat mund ta mbulojnë këtë deficit buxhetor. Për t'i ndihmuar Qeverisë, unë do ta propozoj që mund ta gjejmë mënyrën e cila e mbulon deficitin buxhetor dhe e vetmja shpresë është që të aprovohet sa më shpejtë apo të nxirret ligji për konfiskimin e pasurisë të fituar në mënyrë të paligjshme apo me kriminalitet, sepse do të konfiskohen gurthyesit e pushtetarëve, bazat e asfaltit, ndërtesat shumëkatëshe, landroverat, taoregat, mercedesat që nuk kanë bazë të prejardhjes apo të përfitimit. Prandaj, ne do t'i ndihmojë Qeverisë si parti opozitare me ide shumë konstruktive, sepse jemi në shërbim të qytetarëve dhe të këtij vendi. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Idriz Vehapi.

IDRIZ VEHAPI: I nderuar zoti kryesues,

Zoti kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Draftligji për vitin 2011, të cilin po e diskutojmë sot, siç dihet, ka kaluar nëpër një procedurë të zgjatur. Mendoj se duke pasur parasysh këtë si dhe faktin se buxheti është njëri nga dokumentet më kapitale në jetën institucionale të shtetit, na ngarkon të gjithëve me një përgjegjësi të lartë gjatë shqyrtimit dhe diskutimit të tij. Besoj se tek të gjithë ne, duhet që të dominojë qasja se interesat shtetërore duhet të ngritën

mbi ato individuale apo edhe partiake. Me këtë rast, do të ofroj arsyet kryesore që më shtyn të shpreh bindjen time të plotë se ky draft buxhet duhet të miratohet. Në radhë të parë mendoj se draftligji është i përgatitur në nivel të kënaqshëm, qoftë si strukturë përmbi të gjitha si përmbajtje. Në buxhet janë të përfshira të gjitha prioritetet e Qeverisë. Me këtë projektbuxhet, të hyrat për këtë viti parashihen të jenë 12.3% më shumë se sa vitin e kaluar. Është me rëndësi të përmendet edhe rritja e planifikuar ekonomike prej 5.3%, si indikator i qartë i zhvillimeve pozitive. Pastaj me këtë projektbuxhet, parashihet ngritje në kategorinë e shpenzimeve kapitale, ngritje në kategorinë e pagave dhe mëditjeve, ngritje në kategorinë e subvencioneve dhe transfere dhe zbritje në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve dhe kjo me qëllim të ngritjes të nivelit të kursimeve.

Të nderuar deputetë,

U fol mjaft shumë edhe për çështjen e privatizimit. Kosova si shtet është përcaktuar për modelin e organizimit shoqëror, i cili për bazë ka lirinë dhe ekonominë të bazuar në treg, ky është kusht por edhe kufizimi për të gjitha veprimet e politikat që duhet të ndërmerren. Nga ana tjetër, nevojat tona për zhvillim dhe rrjedhimisht për kapital, janë shumë të mëdha, ndërsa infrastruktura e trashëguar është relativisht e varfër. Edhe pse brenda këtyre viteve kemi arritur mjaft, nuk duhet harruar se si shtet ende i ri, kemi nevojë që të mobilizojmë resurse financiare, në mënyrë që zhvillimi i vendit të ndihmohet me hyrjen e investimeve dhe kapitalit nga jashtë. Ne nuk kemi kohë të presim edhe vite të tëra që vetëm të adresojmë mirëqenien e qytetarëve tonë, ne duhet të veprojmë tani. Duhet të jetë e qartë se hyrja e një investitori ndërkombëtar me emër dhe reputacion të lartë, do të ishte një shembull shumë i mirë edhe për investime tjera serioze në Kosovë, të cilat do të ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik të vendit dhe përmirësimin e kualitetit të jetës të qytetarëve të Kosovës, hapjen e vendeve të reja të punës dhe rritjen e standardit jetësor në përgjithësi. Është e qartë se ekonomia e zhvilluar është parakusht esencial për një shtet të fortë dhe që ofron mirëqenie për qytetarët. Bazuar në faktin se kompanitë publike në mbarë botën janë treguar më pak të suksesshme se sa kompanitë private në ofrimin e shërbimeve të telekomunikacionit për këtë arsye, shumica absolute i vendeve kanë privatizuar operatorët e tyre të Telekomit dhe kanë liberalizuar tregjet e tyre, andaj edhe ne nuk duhet të hamendemi në këtë drejtim. Në anën tjetër, të gjitha garancitë janë të parapara me ligjet e Republikës së Kosovës dhe me procedurat e ndjekura, përfshirë edhe këtë diskutim të sotshëm dhe atë të mëhershëm në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni që të them disa fjalë edhe për pozicionin e pagave dhe mëditje pasi që kjo çështje është diskutuar mjaft, shumë nga të gjitha anët e sidomos e parë nga perspektiva e negociatave me FMN-në. Në projektbuxhet për paga dhe mëditje, janë planifikuar 383 milionë euro ose 23% më shumë se sa në vitin 2010. Kjo rritje parashihet përfshirë sektorët e administratës publike siç janë: punëtorët e arsimit, mjekët, shërbyesit civil, policët, zyrtarët e shërbimit korrektues, të gjitha kategoritë e dala nga lufta, dhe kategoritë tjera. Rritja e pagave në të gjithë këta sektorë, do të ketë efekte të shumta pozitive dhe ajo nuk konsiston vetëm në përmirësimin mirëqenies së të punësuarave, por edhe në ngritjen e kualitetit të punës si dhe në ngritjen e cilësisë së shërbimeve të

ofruara për qytetarët. Si rezultat i të gjitha këtyre veprimeve, do të përmirësohet edhe më tutje efikasiteti i punës së institucioneve të cilat do të jenë në gjendje që sa më mirë t'i plotësojnë kërkesat për përballimin e sfidave të shumta që i kemi para nesh.

Të nderuar kolegë deputetë,

Personalisht do ta mbështesë projektbuxhetin e ofruar, sepse jam thellë i bindur se ai është dokument i mirë i përgatitur, është në interes të të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe i tillë edhe në funksion të plotë të zhvillimit të vendit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Të nderuar kolegë deputetë,

Sa për fillim, desha t'ju informoj se Komisioni për Legjislacion, në shqyrtimin e projektbuxhetit, me shumicë votash ka konstatuar se neni 4 i këtij projektbuxheti bie në kundërshtim me ligjet tjera pozitive në Kosovë, në radhë qëparë me Ligjin për ndërmarrjet publike në Kosovë dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, prandaj ka rekomanduar Qeverisë së Kosovës, si sponsorizues i këtij ligji, dhe Kuvendit të Kosovës që ky nen i këtij ligji të hiqet.

Tash më lejoni të vazhdoj si deputet i Parlamentit të Kosovë dhe si përfaqësues i qytetarëve të Kosovës. Ne do të kemi parasysh se po flasim për buxhetin, flasim për disa çështje shumë praktike. Pikë së pari, buxheti është një plan shpenzimesh relativisht të sigurta dhe një plan të hyrash relativisht të pasigurta. Në Kosovë sivjet kemi disa grupe shpenzimesh që nuk mund të shkurtohen dhe nuk mund të riprogramohen. Tri janë kryesore: pagat në sektorin publik, programet e asistencës sociale dhe fatura e autostradës. Këto nuk mund të shkurtohen as nuk mund të riprogramohen, pastaj vazhdojnë shpenzimet tjera publike në shëndetësi, arsim dhe resorët tjera të domosdoshme si Policia, Forca e Sigurisë e të tjera. Po ashtu edhe një element tjetër i shpenzimeve janë edhe shpenzimet e domosdoshme për mallra dhe shërbime të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Pra, ne e kemi një moment ku kemi shpenzime të sigurta dhe kemi të hyra të pasigurta. Kemi shpenzime të sigurta mbi 1 miliard e 400 milionë, ndërsa kemi të hyra 1.2 miliard, ky është problemi me të cilin ne përballemi sot. Në qoftë se e marrim si mirëqenë këtë buxhet që na është premtuar, na del ky rezultat, pra rezultati është që kemi 1.4 miliard shpenzime dhe 1.2 miliard të hyra. Çka duhet bërë ne? Ne duhet të gjejmë një situatë mbi të cilën duhet të dilet nga kjo krizë, sepse kjo Qeveri me këtë buxhet që e ka propozuar para Kuvendit të Kosovës, po e fut vendin në krizë buxhetore për 226 milionë euro, që do të thotë janë 226 milionë euro që nuk ekzistojnë. Në qoftë se këtyre 226 milionë euro që nuk ekzistojnë ia shtojmë edhe një pjesë të faturës se është 300 milionë euro nga të hyrat e menjëhershme që na është thënë që janë të hyra nga privatizimet e ndryshme që mund të vijnë. Para disa ditësh Ministri i Financave, në Grupin Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës se tha se mund të jetë privatizimi i Postës, por mund të jetë edhe privatizimi i Distribucionit të KEK-ut apo privatizimet tjera si të hyra të menjëhershme. Kjo zotërinj është një problematikë shumë e madhe, ne kemi një disbalanc buxhetor. Ky disbalanc buxhetor duhet të mbulohet dhe si të mbulohet? Nuk ka shans të mbulohet me këto projeksione që

i ka dhënë Qeveria, sepse bie që minimalisht kemi 500 milionë euro mungesë dhe Qeveria mundohet ta kamuflojë këtë çështje në dy elemente kryesore. Kamufliimi është se Qeveria pretendon se deputetët e opozitës apo deputetët tjerë këtu prezent po insistojnë që të mos rriten pagat. Deputetët e Parlamentit të Kosovës, me aq sa dëgjova unë sot këtu, po insistojnë të gjithë njëzëri që pagat duhet të rriten, mirëpo Qeveria duhet të garantojë që të kemi stabilitet financiar, të kemi stabilitet makro-ekonomik, të kemi stabilitet zhvillimor dhe të kemi stabilitet në sistemin e bankave. Të gjitha këto së bashku, duhet të garantohen. Mirëpo, me projektbuxhetin që është propozuar këtu, asnjëra prej tyre nuk garantohet. Nuk garantohet sistemi makro-financiar, nuk garantohet sistemi zhvillimor ekonomik, nuk garantohet se ne do të kemi një qasje proaktive zhvillimore në këtë vend dhe si mungesë e garancisë zhvillimore, ne i kemi disa çështje. Çështja e parë, sektori kryesor që janë investimet kapitale, investimet kapitale për këtë vit, pjesa më e madhe tyre, pjesa dërmuese janë të koncentruara vetëm në një projekt, një projekt i cili e merr shumicën e të hyrave për investime kapitale dhe ky projekt ka shkaktuar që ne sot kemi krizë, krizë në kuptimin ekonomik, në sektorin e ndërmarrjeve ndërtimore. Sot ndërmarrjet ndërtimore si investitorët më të mëdhenj dhe si punëdhënësit më të mëdhenj në sektorin privat në Kosovë, janë në krizë sepse ta kanë hyrë dhe kanë marrë obligime dhe kanë bërë investime, duke marrë kredi në banka. Sot jemi në një situatë ku këto ndërmarrje nuk mund t'i kthejnë kreditë e tyre dhe krijohet situata ku realisht po rrezikohet edhe qëndrueshmëria e bankave. Bankat janë në një situatë të cilat e kanë dhënë alarmin. Një indikator shumë i vogël që mund t'ua jap. Në komunën e Prishtinës, në vitin e kaluar për projekte 30 apo 40 mijë euro edhe në komunat tjera, ishte vështirë t'i gjejë dy ose tri kompani që konkurrojnë. Sot për një projekt 30 apo 40 mijë euro, konkurrojnë mbi 40 kompani, sepse këto kompani kanë parë se nuk mund të gjejnë punë nga sektori publik dhe këto kanë kompani kanë investuar në mjete dhe pajisje, kanë investuar dhe në staf profesional dhe sot këto kompani janë para falimentimit dhe si rezultat i drejtpërdrejtë i ndërhyrjes qeveritare, duke ndikuar që të kemi një situatë të tillë.

Neve na u tha këtu se është shumë e rëndësishme që të kemi, ta kalojmë këtë buxhet dhe si rezultat i këtij buxheti të krijohet predispozita pozitive për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe social të këtij vendi. Absolutisht nuk krijohen predispozita të qëndrueshme për zhvillim, as social, as ekonomik e as financiar atë këtij vendi. Ky buxhet e shtie këtë vend në krizë. Një element shumë i rëndësishëm i këtij buxheti si pjesë i financimit të menjëhershëm, është thënë se duhet të jetë Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, që është propozuar edhe me Ligjin për buxhetin, neni 4. Ligji për buxhetin realisht rrezikon edhe qëndrueshmërinë ekonomike, mirëpo realisht e rrezikon edhe të ardhmen e Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës. Mirëpo, kjo situatë që është, ne duhet të propozojmë edhe zgjidhje, cila është zgjidhja? Zgjidhjet mundën të jenë të ndryshme e një element shumë i rëndësishëm që gjithsecilit mund t'i bie në mend, e kemi rrugën pse ta shesim Postën që mundet ta financojë vetëm një të tretën e rrugës, çka do të shesim nesër, vitin e ardhshëm që të financojmë 2/3 tjera? Ta shesim rrugën vetë, pse mos te japim rrugën me koncesion apo na thoni se rruga nuk ka cost - benefit pozitiv dhe duke mos pasur cost -enefit pozitiv nuk mundemi ta shesim. Çka do të shesim vitin e ardhshëm? Do të shesim Distribucionin, që ta paguajmë pjesën tjetër, prandaj kjo logjikë e investimeve të aseteve shtetërore në projekte të veçanta

është një logjikë që nuk jep predispozita për zhvillim të qëndrueshëm as ekonomik dhe as social. Sot jemi në një krizë ekonomike, pse, kriza ekonomike dihet për disa arsye. Nxjerrja e parasë nga tregu.

Qeveria e Kosovës ka pasur të depozituara në bankat e Kosovës mbi 158 milionë euro, në bankat komerciale, këto kanë qenë si depozita kryesisht të Postë- Telekomunikacionit të Kosovës dhe të Aeroportit të Kosovës. Në vitin e kaluar janë tërhequr 87 milionë euro, këtë vit 40 milionë euro, sot bankat e Kosovës kanë në dispozicion si depozita të Qeverisë 11 milionë euro, që i bie 93% e depozitave qeveritare në sektorin privat janë tërhequr, që i bie se sistemi bankar në Kosovë, shumë shpejt mund të jetë në krizë, ashtu siç është në krizë buxheti i Kosovës, ashtu siç është në krizë ekonomia e Kosovës, me një inflacion për produktet bazë ushqimore që janë ushqimi buka dhe vaji, mielli dhe benzina apo si nafta si derivate kryesore për investime në bujqësi, janë me një rritje mbi 30%. Dhe, sot pretendohet që mund të kemi një rritje pagash, një rritje pagash e cila është realisht më e ulët se sa që është rritja e inflacionit. Ky inflacion ka devalvuar jetën e çdo qytetari në Kosovë, ky inflacion po keqëson kualitetin e jetës të gjithsecilit qytetar në Kosovë dhe kjo Qeveri është përgjegjëse për këtë veprim që po bën. Sot ne dëgjojmë këtu fjalë të madha, patriotizma dhe dëshira të mëdha për rrugët kombëtare, për investime kombëtare. Ne jemi për rritje të pagave, sepse kjo rritje e pagave duhet të bëhet se është dëmtuar interesi i qytetarëve të Kosovës, me një deklaram të tillë dhe me një veprim që e ka marrë kjo Qeveri. Kjo Qeveri ka marrë veprim në zyra partiake të rrisë paga, kjo është e papranueshme, politikisht e papranueshme, juridikisht e kundërshtueshme, logjikisht e paarsyeshme. A ka logjikë kjo Qeveri? Kjo Qeveri e ka humbur arsyen, kjo Qeveri ka humbur përkrahjen qytetare dhe kjo Qeveri po shtyn në krizë vendin, po e shtyn në krizë vendin, sepse pretendon që ka përkrahjen qytetare. Përkrahjen qytetare e ka marr me vjedhje votash, jo me marrje votash drejtpërdrejtë nga qytetarët e Kosovës. Prandaj jemi në një situatë të tillë ku ne sot duhet ti themi ndal krizës dhe për të ndalë krizën duhet ta ribalancojmë buxhetin Për ta ribalancuar buxhetin, duhet të ulemi dhe të diskutojmë. Për të diskutuar duhet ta heqim nenin 4 se neni 4 rrezikon drejtpërsëdrejti një aset publik që vitin e kaluar 87 milionë të hyra fitim. Këtë vit ia kemi marrë 40 milionë euro. Duam ta shesim krejt për 300 milionë euro, çka bëhet në këtë vend, ku shkon ky vend? Sot ne kemi, Qeveria na thotë që në po i rrit rezervat shtetërore në Bankën Qendrore për 470 milionë euro. Ku janë ato para? Ato para, 470 milionë euro janë të investuara jashtë. Ku janë 750 euro të privatizimit? Krejt...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ju faleminderit zoti deputet, ka kaluar koha!
Fjalën e ka për sqarim, ministri Besim Beqaj.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar kryeministër,
Kabinet qeveritar,

Po më vjen mirë se qysh është pasditja edhe disponimet po shtohen, por të gjitha diskutimet të cilat duhet të bëhen para Kuvendit dhe para qytetarëve, duhet të jenë të

argumentuara, jo vetëm të ngritin pyetje, por qytetarët e vendit kërkojnë përgjigje për gjitha ato pyetje të cilat ju i ngritët dhe ne si Qeveri, kemi dhënë përgjigje gjatë tri viteve të kaluara dhe do të japim përgjigje edhe gjatë këtij viti. Por, ju lus edhe një herë të gjithëve kur flasim për ligjshmërinë, kur flasim për kushtetutshmërinë, kur të flasim për ekonominë, të nisemi në terma real, mos të nisemi në termat të cilat janë filozofik. Unë këtu dëgjova edhe thëniet që në vend se të flasim për evazion fiskal, flasim për invazion fiskal, në vend që buxheti po aprovohet në bazë të projekteve, zotërinj të nderuar buxheti aprovohet në bazë të projekteve. Asnjë buxhet në botë nuk aprovohet në bazë të keshit. Ajo logjikë e vetëplotësismit, ajo logjikë e ekonomisë, e cila konsideron se çdo gjë duhet ta bëjë vetëm në duar të shtetit, ajo ka kaluar dhe mendoj se duhet të jemi shumë konzistent dhe kjo është përcaktimi i modelit të ekonomisë çfarë Kosova dëshiron ta bëjë dhe e di se në të gjitha radhët e deputetëve kemi edhe njerëz të cilët kanë ardhur nga biznesi. Ju lutem bisedoni në pauza me ta dhe pyetni: Sa ndikon rritja e pagave të cilat ne i kemi paraparë në bizneset e tyre, në rritje dhe në angazhim. Prandaj, të kemi kujdes, të hiqemi nga debatet e nxehta dhe vetëm për qëllime opozitare.

Lidhur me nenin 4, që po thirrreni që është jokushtetues, që po thirrreni që është në kundërshtim me ligjin, zotërinj të nderuar, neni 4 do të riformulohet, nuk është në kundërshtim me asnjë normë kushtetuese, na tregoni cila është norma kushtetuese. Neni 10 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës thotë se Kosova është e përcaktuar për një ekonomi të tregut, ku qarkullimi i lirë i kapitalit do të jetë pjesë themelore e çdo zhvillim. Prandaj, asnjë shkelje, të asnjë norme kushtetuese, as ligjore as të Ligjit për ndërmarrjet publike, neni 9.2 dhe 9.1 nuk shkelen me këtë, deri të formulimi të cilin neve do ta bëjmë, sepse po diskutohet këtu që ka shkelje dhe po tentohet në mënyrë, zotërinj të nderuar posaçërisht ata deputetë të cilët kanë qenë dhe partitë të cilat kanë qenë pjesë e këtij, e kompozicionit paraprak qeveritar, e dinë sa është diskutuar për këtë proces, e dinë se cilit, e tërë ecuria e këtij procesi qysh ka shku dhe nuk është kjo çështje sodit, por është çështje që diskutohet që 4 vite. Prandaj, vendimi, neni 4 do të mbetet në buxhet, në Ligj të buxhetit dhe ai do të riformulohet dhe do të riformulohet sipas një natyre që ne kemi menduar që do të thotë se vendimi i Qeverisë nr. X, i datës 11 mars të vitit 2011, për privatizimin e Postës dhe të Telekomit të Kosovës i bashkangjitur si aneks i këtij ligji miratohet nga Kuvendi dhe hyn në fuqi së bashku me këtë ligj. Ky miratim i përmbushë kërkesat ligjore të përcaktuara nga neni 1, 9.1 të Ligjit për ndërmarrjet publike. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Mirë zoti Gashi replikë, nuk e di për çka veç, okej.
Arben Gashi, për replikë e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Besoj, ministri që pretendon se është edhe njohës i ekonomisë, duhet ta dijë se bizneset kryesisht funksionojnë mbi bazën e pritshmërisë dhe pritshmëria e biznesit se do të ketë më shumë pare prej Qeverisë në treg, ka shkaktuar edhe një inflacion, i cili për produktet bazë në Kosovë, është mbi 30%. E di zotëria, ndoshta duhet ta di të paktën se inflacioni bazë në vendet e eurozonës është 1 deri në 2% maksimalisht. Në Kosovë jemi me 30%. 4% e kemi për çdo produkt që konsumohet, tash le të kthehemi te elementi kryesor Komisioni. Komisioni ka diskutuar dhe ka vendosur me shumicë votash që Projektligji për buxhetin e Republikës së Kosovës, neni

4 ku thuhet që vendimi i marrë i Qeverisë, në muajin mars për privatizimin e Postës dhe të Telekomunikacionit SHA, me këtë ligj hyn në fuqi dhe mbyllet me kaq. Komisioni në konsultimet e veta që ka bërë, ka konstatuar se ky nen bie në kundërshtim drejtpërsëdrejti me nenin 9 të Ligjit për ndërmarrjet publike në Kosovë ku thotë se Qeveria e Kosovës mund t'i privatizojë të gjitha asetet publike dhe të krijojë komision ndërministror, deri këtu jemi në rregull, mirëpo ky vendim për privatizim duhet të shkojë në Parlamentin e Kosovës për aprovim dhe ky vendim duhet të vijë si i veçantë në Parlamentin e Kosovës, sepse është një aset strategjik shtetëror për Kosovën. Nuk mund të vijë si pjesë aneks i një ligji tjetër dhe të kamuflohet me kamuflazhe të tilla. Ju zotërinj që keni hyrë në obligime personale dhe në obligime tjera përpara kalkulimeve që keni bërë, merreni vet ato për sipër. Ky Kuvend nuk guxon të marrë këso obligimesh për sipër që të shesë asete shtetërore për teke individuale. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Kundër replikë, zoti Beqaj.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Unë me të vërtetë po befasohem. Unë nuk pretendoj të jem ekonomist, por jam ekonomist dhe shifrat të cilat ti po i jep lidhur me inflacionin 30%, ndoshta jeton hala në kohën e ish-Jugosllavisë, ku inflacioni ishte me 30, 40 e me gjëra tjera. Të lutem, i ke institucionet e vendit të cilat japin statistika dhe do ta shohësh se a kemi inflacion aq zëmardh apo jo. Lidhur me nenin dhe ligjshmërinë, mendimin të cilin Komisioni respektues e ka dhënë, në mesin e dy leximeve, unë besoj se do të harmonizoheni dhe do ta ndryshoni, por edhe njëherë para qytetarëve duhet të heqim natyrën e dogmave të cilat tentojnë për ta dezinformuar popullin në raport me krizën ekonomike dhe gjërat tjera.

Të nderuar zotërinj,

Kosova në vitin e kaluar ka pasur rritje ekonomike 4%. Në këtë vit është e projektuar 5.5%, është rritje reale ekonomike dhe nëse ju çka jeni ekonomistë, duhet ta dini çka është rritja reale ekonomike, jo do të thotë të flisni me shifra të rrugëve dhe të xhepave. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Ju lutem, e keni pasur radhën, e keni kryer. Fjalën e ka ministri Bedri Hamza.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Ju faleminderit, kryesues!

U ngritën disa çështje që konsideroj që kanë nevojë për sqarim dhe shpjegim. U tha të hyra të pasigurta. Janë të hyra shumë të sigurta. Unë besoj në profesionalizmin e shumicës së deputetëve sot që janë këtu në sallë, por për disa kisha lutur që ta nxjerrin digitronin derisa të flas dhe t'i mbledhin. Nëse kemi paraparë që të hyrat administrohen nga Administrata Tatimore do të jenë 261 euro, nëse në vitin 2010 kanë qenë 221 milionë euro, ia shton rritjen ekonomike nominale, ia shton shtesat të cilat do të vijnë si rezultat i ngritjes së pagave dhe pagesën e tatimit në të ardhurat individuale, ia shtonë diferencën e cila do të jetë si rezultat i investimeve kapitale në këtë viti dhe në vitin paraprak dhe vjen te 261. U ngritë këtu çështja se deficitit buxhetor do të jetë minus 500 milionë euro. Nëse të hyrat e rregulla për buxhetin janë të parapara në nivel 1 miliard e 164 milionë euro, ndërsa shpenzimet janë të parapara në nivel 1 miliard e

424 milionë euro, nëse i shtohet bartja nga viti a 2010 në vitin 2011, del se të hyrat e parapara për financimin e njëhershme dhe të hyrat të cilat janë si rezultat i përkrahjes buxhetore, vetëm sa shkojnë në rezervën buxhetore.

U ngritë çështja tjetër, investimet kapitale.

Investimet kapitale nuk janë të koncentruar vetëm në një projekt. Ai është projekt kapital të cilin ne e kemi investuar dhe vazhdojmë të investojmë, mirëpo ka edhe qindra, mijëra investime tjera, sepse vlera e atij projekti për ekzekutimin e punimeve është 225 milionë, ndërsa pjesa tjetër prej 572 milionë shkon në projekte tjera.

U ngrit tërheqja e depozitave,

45 milionë euro depozita të deklaruara në këtë vit, janë depozita të cilat e kanë pasqyrën e rrjedhës së parasë dhe janë të paraparë që të vijnë në buxhetin e Kosovës, pa e rrezikuar qëndrueshmërinë e sistemit financiar. Në sistemin financiar kemi edhe rritje të depozitave edhe rritje të kredive. U mundua, u tentua të paktën që të amortizohet rritja e pagave. Nuk amortizohet rritja e pagave në këtë mënyrë. Rritja e pagave ka ndodhur në shkallë të specifikuar sipas vendimit të Qeverisë, ndërsa projeksionet makro-fiskale të llogaritura nga ekspertë është që këtë vit inflacioni në mesatar të jetë 5.3%. Prandaj, këto janë shifrat reale, këto janë shifra shumë profesionale ekzakto dhe tentimi për të ikur dhe manipuluar nga këto shifra, të qon në përfundim të gabuar. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Fetoshi.

ALBANA FETOSHI: Ju faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë

Draftbuxheti i hartuar nga Qeveria e Kosovës nuk është aspak zhvillimor, shumë pak investime në sektorin e prodhimit që kanë për bazë zhvillimin ekonomik të vendit dhe mundësojnë rritjen ekonomike, zhvillimin e qëndrueshëm, rritjen e punësimit dhe rritjen e mirëqenies për të gjithë qytetarët. Nëse ndalemi pak tek të hyrat vetanake të komunave, fuqizimi i komunave nënkupton jo vetëm delegim të përgjegjësive në ofrimin e shërbimeve publike. Të përzgjedhurit në nivel lokal, do të fuqizohen vetëm atëherë kur ata, përveç përgjegjësive për ofrimin e shërbimeve publike, ofrojnë edhe përgjegjësinë për grumbullimin e mjeteve të domosdoshme buxhetore për financimin e këtyre shërbimeve.

Kjo do të reflektonte edhe në dallimin në nivel lokal në ofrimin e menysë të shërbimeve publike, që më tepër përputhen me preferencat e votuesve lokal. Duke e bartur barrën e financimin e shërbimeve publike, qytetarët kanë edhe më tepër interes që të monitorojnë me kujdes elitën politike të zgjedhur me votën e tyre. Në rastin e draft-buxhetit për vitin 2011, praktikë kjo që është provuar edhe në vitin e kaluar, shohim diçka jo serioze por edhe të rrezikshme. Kështu përderisa qytetarët e komunave me shumicë shqiptare ndajnë një pjesë të të ardhurave të tyre drejtpërdrejt për financimin e shërbimeve publike edhe nivel lokal, jo nuk po ndodhë me komunat me shumicë serbe. Kështu për komunën e Zubin Potokut, Qeveria ka ndarë mbi 2 milionë euro, ndërkaq kontributi i

vetë komunës del të jetë qesharak me vetëm 7 mijë e 800 euro ose 0.4% gjatë gjithë vitit. Kjo do të thotë se bizneset e vendosura nuk i paguajnë këtij buxheti asnjë taksë komunale, që pronarët e patundshmërive në këtë komunë nuk i paguajnë këtij shteti asnjë cent në tatim në pronë dhe taksa të tjera, por që edhe ata nuk paguajnë as edhe një cent për dokumentet e nxjerra nëpër zyrat civile, që kjo Qeveri na bindë se i ka hapur nëpër këto komuna.

Leposaviqi është edhe më keq në këtë drejtim. Aty Qeveria jonë zemërgjerë ka ndarë rreth 3 milionë euro, përderisa kontributi i vetë komunës është vetëm 7 mijë e 600 euro, ose 0.25%. Pjesa tjetër është 99.75%, dalin të jenë dhuratë nga taksapaguesit e komunave tjera ku qytetarët e njohin dhe e respektojnë shtetin e tyre si dhe i njohin detyrimet që kanë ndaj të njëjtit shtet. Ngjashëm është situata edhe në Zveçan, Kllokot dhe Ranillugë, për të arritur kulmin, në komunën e Parteshit, i cili do të përfitojë rreth 1 milion euro nga taksapaguesit kosovarë, pa u lodhur që të grumbullojë as edhe një cent të vetëm nga banorët e fshatit. Argumenti se është fjala për komunat e krijuara rishtazi, është i paqëndrueshëm, meqë edhe Juniku, apo Hani i Elezit janë komuna të reja, por atyre u janë kërkuar menjëherë fillimi i grumbullimit të të hyrave vetanake. Ky favorizim i qartë i qytetarëve në baza etnike është shumë shqetësues, sa më e madhe mosnjohja e shtetit aq më madh kontributi i taksapaguesve që e njohin këtë shtet për financimin e aktiviteteve të mosnjohësve. Një situatë e tillë ka ekzistuar vetëm në vitet e '90-ta ku qartë obligimet e qytetarëve ndaj shtetit janë caktuar në baza etnike. Një diskriminim i tillë edhe ka sjellë deri te konflikti i fundshekullit në vendin tonë. Përpiluesit e këtij buxheti, do të duhej ta kishin të paktën të qartë se po lëndojnë principin bazë të politikave fiskale, atë të trajtimit të barabartë të qytetarëve. Qytetarët në rrethanat e njëjta do të duhej të bartin barrë të ngjashme në financimin e sektorit publik.

Nëse ndalemi tek qëndrueshmëria makro-fiskale dhe te pagat. Qeveria e Kosovës pretendon se ka përpiluar një draftbuxhet që është në funksion të zhvillimit ekonomik dhe që garanton qëndrueshmëri fiskale të vendit. Edhe pse pranon se rritja ekonomike duhet të vijë nga sektori privat, ajo po ashtu pranon se në vitin e kaluar, për herë të parë ia ka ndalë t'i detyrojnë bizneset private t'i ulin investimet në raport me vitin paraparak.

Qeveria që po promovon qëndrueshmërinë fiskale, duhet të rikujtohet si qëndrueshmëria arrihet duke forcuar Administratën Tatimore që të grumbullojë më shumë të hyra brenda shtetit e jo duke rritur rolin e Doganave të Kosovës. Kjo Qeveri ka arritur të ngrejë në 78% proporcionin e të hyrave tatimore të grumbulluara nëpër pikat doganore, përqindje kjo të cilën veç tjera, hasim edhe në fazën e parë të revolucionit industrial më shumëse 200 vite më herët. Kjo Qeveri radhit faktorët që kanë ndikuar në rritjen e shpenzimeve buxhetore prej afërsisht 20% në krahasim me vitin 2010. Ajo krahas rritjes së shpenzimeve kapitale, që në fakt është auto rruga përmend edhe një faktor tjetër që nuk mund të interpretohet ndryshe vetë se si margaritari i mendësisë së saj. Është fjala dhe po përdoret për shkrimin e saktë të Qeverisë, për mbështetjen e shtuar financiare për punonjësit e sektorit publik. T'u japësh paga nëpunësve në sektorin publik, del të jetë mbështetje për ta, mu siç është paga e ndihmave sociale. Siç duket kjo Qeveri nuk dëshiron ta kuptojë se buxheti nuk është pronë e saj dhe se

punonjësit e sektorit publik i meritojnë pagat e tyre, e nuk i marrin ato si mbështetje apo si lëmoshë nga Qeveria. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Kryeministri Thaçi e ka kërkuar fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Ju faleminderit!

I nderuar kryesues,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Kam dëgjuar me vëmendje diskutimet e të gjithë deputetëve, me përjashtim të një periudhe të shkurtër kohore kur isha në takim me ministrin e Jashtëm të Austrisë, për çka edhe isha i obliguar që të mos jem në sallë.

E ritheksoj edhe njëherë se ky buxhet është buxheti i Kosovës, është buxheti i qytetarëve të Kosovës, është buxheti ynë. Si rezultat kemi ardhur në këtë projektbuxhet, si rezultat i qeverisjes së mirë, efektive, efikase, sundimit të ligjit, të luftës së pa kompromis kundër korrupsionit, krimit të organizuar, trafikëve, një ekipi qeveritar e të konsoliduar dhe më efektiv mund të them në historinë politike të Republikës së Kosovës. Prandaj, ky është buxheti i zhvillimit ekonomik të Kosovës, e ritheksoj edhe njëherë, buxhet i reformave të thella demokratike, buxhet për Kosovën evropiane dhe euroatlantike, buxhet për rritjen e mirëqenies sociale të qytetarëve. Unë, me qëllim kam punuar që të vë balancën në mes investimeve kapitale dhe rritjes së mirëqenies sociale të qytetarëve. Investimet kapitale vetëm sa janë rritur edhe pse kemi marrë vendime për rritjen e mirëqenies sociale të qytetarëve, prandaj, këto vendime kanë qenë të studiuara shumë mirë, të menduara prej ekspertë vendorë dhe atyre të Kosovës që presin aprovimin tuaj pa dallime partiake, por edhe etnike. Ky buxhet do të jetë në shërbim të të gjithë qytetarëve me gjithë territorin e Republikës së Kosovës, do të jetë në shërbim të shtetit të Kosovës, do të jetë një shërbim të rritjes të mirëqenies sociale të qytetarëve. Dikush mund të thotë se e kanë deklaruar edhe më herët se ndodhin ngritje më të vogla të pagave në shtetet moderne, ne nuk kemi arritur në atë start, ju e dini të gjithë për çka se jemi të fundit të lirë në rajon që kemi fituar lirinë dhe e kemi shpallur pavarësinë, për këtë arsye edhe jemi ballafaquar me vështirësi të tilla, por ju ftoj të gjithëve le të guxojmë të marrim vendime të mëdha bashkërisht për të mirën e shtetit dhe të gjithë qytetarëve. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Po, po me radhë, se jeni shumë ju të LDK-së, jeni paraqitur. Zoti Hamiti e ka fjalën. Po, po në rregull është, në rregull, veç me radhë.

SABRI HAMITI: Respekt për kolegun Xhavit Halitin, më është përmendur emri, besoj se Rregullorja e lejon.

Ne dëgjuam kryeministrin. Unë e respektoj kryeministrin e Republikës së Kosovës, sepse është kryeministër i vendit tim. Ai tha që e ka për detyrë ta bëjë, ta institucionalizojë projektin e tij partiak në zgjedhje dhe unë e respektoj, që ai do. Mirëpo, nëse ai, shumë mirë është, respekto dhe përpiqu ta institucionalizosh. Por, meqë jemi në pluralizëm politik, atëherë mos kërko konsensus në Parlamentin e Republikës së

Kosovës për projektin tënd politik që do ta institucionalizosh, sepse e ke pozitën që thotë -jo, çka po thua ti, dhe kjo është normale.

(Ndërhyrje)

Do të deklarohej kur të vjen koha!

E dyta, problemi i autostradës. Unë e thashë edhe herën tjetër, po e them edhe një herë. Shumë mirë që po ndërtohet, është mirë që të kemi para ta ndërtojmë bash prej fillimit e në fund, veçse unë tash kam pyetje konkrete. Ju i përmendet, i keni për këtë vit të rezervuara 250 milionë për atë rrugë dhe thatë “nëse ka nevojë, do të japim dhe më shumë” dhe unë e di pse e thatë, sepse Bechtel&Enka është një ndërmarrje e fuqishme, mund të bëjë punët e veta në katër - pesë pjesë përnjëherë, atëherë është mirë që t’i bëhet transparente këtij Kuvendi sa mund të punojë Bechtel & Enka dhe sa para i lypë brenda këtij viti, se unë e di që ata me fuqinë e vet mund të bëjnë punë edhe për më shumë se kaq para dhe a i kemi ato para, që të mos japim penale, sepse unë sa di, unë kontratën nuk e kam, por fjalët thonë se jepet penalitet i madh nëse nuk je i zoti të paguash para për atë që ke bërë kontratë dhe kjo është mirë të thuhet këtu, nëse nuk bëhet totalisht transparente ajo kontratë, pikat e domosdoshme të dalin në Kuvend, do të bëhen transparente. Kjo është pyetje që duhet të marrë përgjigje këtu. Ndërsa, sa i përket, edhe një herë po them, projekteve, instituciolazimit të projekteve partiake me të cilat konkurrojnë, unë i respektoj, jemi në pluralizëm, qoftë kur këto koalicionë që krijohen, krijohen për ta pasur shumicën dhe shumica krijohet për të krijuar politika qeveritare dhe ajo që mbetet pakicë, kushtimisht bën oponencën, kjo është normalja, ndërsa ajo shumicë, qoftë edhe kur krijohet si pakicë e votës qytetare dhe këtë unë po e shfrytëzoj rastin, zoti kryeministër ta them këtu, sepse kam dëgjuar një deklaratë tuajën që e ka keqinterpretuar problemin e pakicës të votës qytetare me pakicën si etnitet...

(Ndërhyrje)

...Hiq Dellit ti, Delli s’është kryeministër i Kosovës. Unë nuk kam detyrë të komentoj Dellin as askënd, unë po flas për kryeministrin e vendit tim. Mos i ngatërroni pakicën e votës qytetare, sepse shifrat janë, mblihdni – zbritni, i gjeni, dhe pakicën si etnitet për t’i thënë dikujt pastaj një formulim që unë nuk dua ta përmend, se është i rëndë dhe është pa lidhje dhe është i keq. Ju faleminderit!

Drejtimitin e seancës e merr zoti Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit

KRYETARI: Unë i kam tri replika dhe pastaj kryeministri e ka fjalën. Veç, Sabriu e ka shfrytëzuar më shumë se dy minuta. Fjalën e ka Ismet Beqiri. Mirë, urdhëro. Kryeministri, kundër replikë.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Zoti Hamiti, dini të jeni edhe hajgaregji i mirë nganjëherë, por edhe unë vlerësoj mendimet gjithashtu, ju e dini, edhe personalisht, edhe profesionalisht.

Shkrimet e të tjerëve dhe mendimet e të tjerëve, qëndrimet e të tjerëve mos i prezanto si të mijat sa i përket kush është pakicë e kush është shumicë në Kosovë, nënë një.

Sa i përket autostradës, e ritheksoj edhe një herë, autostrada do të vazhdojë së punuari, është duke vazhduar dhe është duke u punuar 24 orë në ditë nga konzorciumi Bechtel & Enka, që ka qenë një proces jashtëzakonisht dhe i paparë në rajonin tonë të transparencës. Natyrisht se ky projekt është duke vazhduar së punuari edhe para kohe, në afat rekord dhe ky është sukses pikërisht edhe i Qeverisë, por natyrisht edhe i investimeve transparente dhe efikase dhe të një standardi më të lartë përëndimor dhe kjo duhet të vlerësohet. E kemi nisur këtë projekt kur kemi qenë në bashkëqeverisje apo në koalicion bashkë me LDK-në dhe unë e vlerësoj dhe falënderoj edhe ish presidentin Sejdiu dhe të gjithë ministrat që kemi punuar bashkërisht dhe grupin parlamentar që e ka përkrahur dhe mbështetur vendimet që kanë qenë në interes të shtetit dhe të gjithë qytetarëve. Ndërsa, sa i përket pluralizmit, natyrisht se është fat që prej 10 qershorit 1999 e tutje kemi mundësi për të ndërtuar pluralizëm në Kosovë. Por, në të njëjtën kohë, çdo kund në botë në projekte të mëdha kombëtare afrohen dhe përafrohen pikëpamjet edhe të pozitës, edhe të opozitës. Kjo ishte një ofertë dhe kërkesë e imja, por vendimi është i juaji dhe unë do ta vlerësoj shumë vendimin tuaj, por ishte oferta e mbështetjes tuaj për autostradën dhe rritjen e pagave. Ju thatë, ne do të marrim vendim dhe e ndajmë mendimin nga ju dhe kjo është keq. Ju faleminderit!

KRYETARI: Kundër replikë 1 minutë, deputeti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Edhe një herë, respekt për kryeministrin e Republikës së Kosovës. Ai mund të bisedojë, të sugjestionojë atë që mundet, por ai e di që unë jam pak më i vjetër se ai dhe ato si ha. Ai që i hanë, i hanë. Në pluralizëm është shumica që propozon buxhet. Është e drejta e saj ta arsyetojë. Shumica nuk guxon të sigmatizojë asnjë njeri që nuk mendon si ai, as para publikut, as para askujt, prandaj ekzistojnë projekte të ndryshme, prandaj ekziston shumicë dhe pakicë parlamentare, kështu që të gjithë deputetët e kanë të drejtën e ndërgjegjes dhe të programit të partive politike të sillen në këtë parlament qoftë për ligj të buxhetit, qoftë për të gjitha të tjera. Një buxhet i një vendi, është buxhet i një shumice parlamentare dhe nuk ka të bëjë me projektet nacionale, mos e përzieni...

KRYETARI: Regjia, kryeministri e ka fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAQI: Përsëri, në dash po përmendi emër, në dash nuk po përmendi emër, por i nderuari zoti Hamiti, sinqerisht është dhe unë e vlerësoj vjetërsinë me virtyt, por jo me vlerë dhe ide politike dhe respekt njerëzor. Duhet bërë dallimin në mes virtyteve, respektit njerëzor dhe vlerës së idesë politike. Për mua, përsëri e ritheksoj edhe tash, është e frikshme, e rrezikshme ideja pakicë e shumicë. Buxheti është në shërbim të të gjithë qytetarëve, jo vetëm të shumicës parlamentare apo të shumicës së të zgjedhurve të popullit të Kosovës.

Tash, pyetja shtrohet shumë thjeshtë dhe është shumë e qartë: shumica vendos, është e vërtetë, por në të njëjtën kohë qëndrimi është shumë i qartë, je mbështetje e

Projektbuxhetit 2011 për përmbylljen e autostradës, për rritjen e pagave, për buxhetin e zhvillimit ekonomik, Kosovës Evropiane dhe e rritjes së mirëqenies sociale, po ose jo, kjo përcaktohet me votë, jo me deklaratat tona.

KRYETARI: Ju faleminderit! fjalën e ka Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Unë mendoj që kryeministri, normal, po e merr fjalën, sepse po mundet ta marrë fjalën shpesh edhe po provokon. Unë konsideroj që absolutisht ka provokime, sepse edhe e mbështesë atë që u tha më herët, stigmatizime. Ju nuk keni të drejtë të na tregoni neve se si do të jetë, a do të jetë “për” apo “kundër”, mund ta thoni mendimin tuaj, por sot po flasim për Ligjin për buxhetin, nuk po flasim veç për paga. Mos tentoni ta thjeshtësoni këtë problem vetëm në këtë drejtim, në mënyrë që të krijohet përshtypja që të gjithë të tjerët, opozita këndej dhe andej janë kundër rritjes së pagave. Po ua them për të satën herë gjatë kësaj seance, kjo nuk qëndron. Ne jemi për rritje të pagës, por ju nuk e keni mbajtur premtimin në vlerën dhe lartësinë që e keni thënë dhe këtë e dini. Nëse dilni dhe thoni që tri kategoritë që i keni premtuar 50, 40, 30 po e realizoni, na po të aplaudojmë, po kjo nuk është e vërtetë, e para.

E dyta, thatë është Qeveria më e mirë në historinë e politike të Kosovës. Ngadalë he burrë, se asnjë punë nuk e keni kryer! Po, ku më e mira në historinë politike të Kosovës, asnjë punë, kur as buxheti nuk është miratuar. Kjo është me të vërtetë për t’u habitur. Si mund ta vlerësosh që është Qeveria më e mirë, kur ende asnjë të vetmen punë nuk e keni bërë, si kundër edhe tek privatizimi. Po ne e dimë të gjithë dhe të gjithë jemi për ekonomi të lirë të tregut, e kemi thënë, dhe ju e dini çfarë keni tentuar si Qeveri herën e kaluar të bëni me privatizimin e Postës. Në të njëjtën mënyrë për një derë tjetër po doni edhe tash ta bëni. Ne të gjithë, unë jam i bindur kemi për të qenë për privatizim, por transparent, të hapur dhe këtij Kuvendi t’i prezantohet çka po dëshirojmë të bëjmë. Ju e dini po ashtu, zoti kryeministër, që këtu kurrë autostrada nuk është qitur ta dimë, edhe sot nuk dihet kah shkon autostrada, ju këtë e dini. Kur është prezantuar këtu çmimi i saktë i autostradës? Kurrë, asnjëherë! Së paku, unë jam në mandatin e dytë, asnjëherë, asnjëherë nuk e dimë asnjëri prej nesh sa saktë kushton! Prandaj, janë çështje madhore, nuk janë aq të thjeshta, siç po mendoni dhe po dëshironi për t’i thjeshtësuar. Ndërkaq, nuk është obligim i opozitës për t’ua krijuar numrat. Nëse i krijoni numrat, votoni si ua merr mendja, është problem i juaj, sikur që është edhe çështje e jonë, por vota nëse është kundër, nuk është votë kundër pagës, por është votë kundër një buxheti, i cili edhe nëse i heqim krejt ato paga që nuk janë pjesë e buxhetit, është buxhet i cili absolutisht nuk ka perspektivë zhvillimore për këtë vend. Ju faleminderit!

KRYETARI: Unë po kërkoj që regjia ta kontrollojë kohën, siç e ka në Rregullore. Fjalën për replikë e ka Rita Hajzeraj-Beqaj.

RITA HAJZERAJ - BEQAJ: Ju faleminderit, kryetar!

Respekt për kryeministrin. I bashkohem fjalës apo thënies të profesorit tonë të nderuar Hamiti.

I përmendi prurjet. Edhe vetë PDK-ja është rezultat i frymës pluraliste politike në Kosovë dhe shumica e anëtarëve të PDK-së, aty që i shohim ulur, përpara kanë qenë pjesë e forumeve shumë të rëndësishme të LDK-së, të cilët tashmë janë PDK. Sa i përket thirrjeve të ministrave ndaj deputetëve për rritjen e pagave qytetarëve tanë, ju po trokitni në derë të hapur. Ne nuk jemi kundër rritjes së pagave. Nuk trokitet në derë të hapur, dera është e hapur për rritje të pagave, por ju këto paga nuk po i arsyetoni dhe po e gënjeni qytetarin e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Replika e tretë, Tetuta Sahatqija. I ke kryer, i nderuari deputet, replikat. Fjalën e ka deputetja Teuta Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA Ju faleminderit, kryetar!

Ka prurje të reja shumë edhe ato të vjetrat që e përbëjnë atë bazën, po ka edhe shumë të reja, energji të madhe edhe mirë që jam pjesë e kësaj.

Për rrogat dhe për autostradë, thashë edhe kur nuk ishit aty. Për rroga dhe autostradë, ne nuk jemi kundër, prandaj nuk e di pse po mundoheni, zoti kryeministër, t'ia paraqitni qytetarit se na jemi kundër. Ne nuk jemi kundër. Autostrada është kryer në mandatin e kaluar, është votuar, prandaj nuk ka nevojë të kthehet prapë. Edhe për rrogat, asnjëri prej deputetëve të opozitës nuk tha dhe kjo politikë: "ky është vendimi im edhe unë do ta realizoj, unë e kam bërë buxhetin", po tregon në vazhdimësi që politika e juaj është eksploduese, është përjashtuese.

Ju, si kryeministër, nuk jeni kryeministër i PDK-së, ju edhe Qeveria e juaj duhet të sillet si kryeministër dhe si Qeveri e Kosovës, ashtu si po deklaroni, por me këtë mënyrë, që unë këtë do ta qoj pa marrë parasysh a jeni ju këtu, apo nuk jeni këtu, sikur që e kaluat Rezolutën, sikur që e kaluat pa konsensus edhe për presidentin dhe të gjitha, nuk japin mesazh të mirë që jeni inkludues, por përkundrazi, që jeni përjashtues dhe kush është për buxhet, është për Kosovë evropiane. E, për çka jemi ne të tjerët, për Kosovë aziatike, a? Ne të gjithë jemi për Kosovë evropiane edhe ajo nuk duhet të vihet në dyshim. Kush është për buxhet, është për Evropë, kush nuk është për buxhet, ai le të shkojë në Afrikë, në Azi!

KRYETARI: Ju faleminderit!

E ka fjalën kryeministri.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: E para, unë besoj që është një kundërthënie në mes qëndrimit të zotit Hamiti dhe Teutës, sepse zoti Hamiti tha - nuk shkon me konsensus kjo punë, ju po kërkonit tash konsensus. Për mua ishte, nga ana ime ishte kompliment edhe për Ritën, edhe për ju Teutë, rikthimi në identitetin e LDK-së, dhe ishte thjeshtë një kompliment në kuptimin më pozitiv të mundshëm dhe në asnjë rrethanë në kuptimin e polemikës pse keni lëvizur në atë drejtim. Ndërsa, përsëri te pagat, te autostrada dhe te privatizimi.

Unë ju ftoj, për secilën çështje jam i gatshëm edhe si kryeministër, edhe si Qeveri të vijmë në Kuvend dhe pikë për pikë t'i diskutojmë dhe të hapim debat për të gjitha çështjet një nga një, jo të gjitha përnjëherë dhe të mos i diskutojmë asnjëherë deri në fund.

Okej. Unë e kuptoj edhe atë shefin e Grupit parlamentar të LDK-së që tha se nuk do të votojmë “për”, të kuptoj se nuk keni premtuar dhe nuk keni prezantuar para qytetarëve atë që e kemi prezantuar ne, duke fituar edhe besimin qytetar, por nuk besoj se të gjithë ata njerëz që sot presin vendimin tonë të përbashkët, të kuptojnë dhe të mirëkuptojnë. Por, mos harro se përsëri do të dalim para tyre. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ismet Beqiri. Urdhëro, fjalën e ka Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Po, po luajmë lojë parlamentare dhe unë mendoj se kjo është krejt në rregull edhe kështu qysh po zhvillohet, absolutisht. Ka mendime programore, ka artikulime individuale. Në këtu nuk jemi makinë, por jemi njerëz me bagazhe të ndryshme të dijes dhe të shprehjes dhe ky është sharmi i parlamentit dhe vendosja koncesuale dhe vendosja me shumicë, janë dy gjëra. Vendosje koncesuale ka shumë rrallë në parlamente shumë partiake. Ne e kemi pasur një konsensus, kur e kemi shpallë pavarësinë e Kosovës dhe mirë kemi bërë, por të gjitha variantet tjera të zhvillimit kërkojnë variante të mendimit, prandaj krijohet pakica dhe shumica në parlament. Kjo është abecedë, përtej kësaj ne nuk mund të dalim. Qemë ne sot në opozitë, ose nesër në pozitë, kjo është themelore dhe këtë duhet ta kuptojnë ...

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet! Vazhdojmë debatin. Replikat i kryem. Fjalën e ka deputetja Alma Lama.

Keni të drejtë për të reaguar, si replikë, edhe kur nuk të përmendet emri, por mendoj që i kryem replikat.

ALMA LAMA: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Më në fund, ma dhatë fjalën, sepse e kam kërkuar që në fillim të seancës. Me të vërtetë ky Parlament po bëhet shumë i mërzitshëm jo vetëm për qytetarët e Kosovës, që po e ndjekin dhe shumë qesharak me këto lloj replikash dhe kundër replikash, pa asnjë lloj vlere, por po bëhet i mërzitshëm edhe për neve që jemi këtu.

Lajmi kryesor që do të dilte nga kjo seancë është ky, që buxheti i Kosovës këtë vit të ketë të ardhurat kryesore nga taksat doganore. Kjo do të thotë që kontrabanda nëpër dogana është zvogëluar. Ende nuk kam dëgjuar një përgjigje se pse kjo kontrabandë është lejuar deri tani, meqë paska pasur mundësi të vihet, pra, nën kontroll dhe u mor kjo masë dhe vetëm tani, mirëpo në vend të kësaj kontrabande, që po tentohet t’i vihet fre nëpër dogana, kemi kontrabandimin e shitjes së Postës së Kosovës.

Gjithsesi duhet të kujtojmë që debati i sotëm për buxhetin po zhvillohet nën hijen e konstatimeve që u bënë dje nga Agjencia Antikorrupsion, e cila raportoi për disa qindra denoncime, që lidhen me çështjen e korrupsionit, e për miliona euro keqpërdorime dhe është kjo pika ku dua të ndalem unë, lufta ndaj korrupsionit, i cili në të gjitha raportet vendore, ndërkombëtare rezulton si një nga brengat më të mëdha të qeverisjes në Kosovë vitet e fundit. Do të veçoja këtu Raportin e progresit, të dalë në nëntor të vitit të shkuar, i cili thotë shprehimisht se informacionet e vlefshme nxjerrin në pah mospërputhje në mes të ardhurave dhe pasurisë së zyrtarëve të lartë të Kosovës. Ky është një tregues për korrupsionin e përhapur në nivelet më të larta, i cili vazhdon. Ky fakt

nuk është ndjekur nga një debat publik, hetimet nga trupat e rëndësishme duke shfaqur këtu fare qartë mungesën e vullnetit politik për ta luftuar korrupsionin. Kjo, pra, ishte situata për vitin e shkuar. Duke pasur parasysh zotimet e kryeministrit aktual, për një luftë ndaj korrupsionit, të kujtojmë këtu edhe strategjinë kundër korrupsionit të proklamuar me pompozitet të madh, e po kështu si një nga pikat prioritare për sa i përket synimit për integritet evropian, pyetja legjitime tani është se si e ka gjetur veten lufta ndaj korrupsionit në buxhetin të cilin na e ka sjellë sot kryeministri.

Në rast se e bëjmë një analizë të këtij projekti të buxhetit, në lidhje me paratë që janë ndarë për institucionet që kanë kompetencë ta luftojnë korrupsionin, pra Policia, Prokuroria dhe gjykatat, do të shohim se dokumenti që na është servirë në Kuvend, nuk i ka kushtuar asnjë vëmendje të veçantë kësaj çështjeje. Krimi financiar sot për sot është krimi më i ndërlikuar dhe kërkon ekspertizë të madhe. Institucionet e drejtësisë përballen çdo ditë me nevojën për ekspertë të kësaj fushe.

Mirëpo, për sa kohë që ndahet një buxhet serioz, siç ka ndodhur edhe këtë vit, ku për shembull prokurori i shtetit ka vetëm 4.6 milionë euro në dispozicion, nga të cilat 3.1 milionë euro janë paga dhe mëditje, atëherë nuk kemi as pse të shpresojmë për një luftë serioze ndaj korrupsionit. Për të kuptuar më mirë domethënien e kësaj shifre, mjafton të kujtojmë se reklama për Kosovën, e mbani në mend besoj, ajo për evropianët e rinj, e cila synoi t'ia ndreqë Kosovës imazhin nëpër botë, ka kushtuar plot 5 milionë euro.

E them këtë për të vë në vëmendje të të gjithëve se imazhi i korrupsionit që ka sot Kosova nëpër botë është shumë më i rëndë dhe nuk mund të ndreqet me reklama. Pra, lufta e korrupsionit ka nevojë për miratimin dhe përmirësim të ligjeve aktuale, të cilat kanë mangësi të mëdha për çfarë po ndodhë, ndërkohë që Qeveria e Kosovës paguan miliona euro për konsulencë për privatizime të ndërmarrjeve publike. Për krijimin e ligjeve më të mira për këtë vend, mungon ekspertiza dhe kjo sepse buxheti nuk ndan mjete për këtë kategori tepër të rëndësishme.

Nga ana tjetër, rritja e transparencës së institucioneve për mënyrën se si e përdorin paratë publike, do të duhej të ishte prioritet i Qeverisë dhe të kishte gjetur reflektimin e tij edhe në këtë buxhet. Kjo do të thotë se do të duhej të ishte bërë më shumë në avancimin e sistemit elektronik, në të cilin do të duhej të publikoheshin gjithnjë e më shumë dokumente zyrtare, siç bëjnë vendet e zhvilluara, e po kështu në lidhje me kualifikimet e zyrtarëve që kanë për detyrë të merren me implementimin e Ligjit për qasjen mbi dokumentet zyrtare. Ajo çfarë ndodh aktualisht në institucionet e Kosovës, është fshehja e dokumenteve të rëndësishme zyrtare ndaj publikut dhe mediave. Dhe, tek e fundit, këto lloj strategjie për t'i bërë transparente do të na ndihmonin të gjithëve për të hequr dyshimet për korrupsionin.

Ja, pra, pse buxheti do të duhej të ishte kujdesur për të investuar në këto shërbime, mirëpo nuk mund të themi se ky buxhet është treguar dorështrënguar kur vjen puna tek shpërblimet me poste të llojllojshme.

Kosova është vendi me buxhetin më të vogël në rajon, ka të ardhurat më të pakta për kokë banori, ka papunësinë më të lartë, por mund të mburret se ka kabinetin qeveritar me përmasat më groteske në Evropë, me 18 ministra, 5 zëvendësministra, dhe së shpejti edhe me 30 zëvendësministra, pa harruar këtu duzinën e këshilltarëve.

Le të bëjmë një krahasim të thjeshtë. Italia, për shembull, me 61 milionë banorë, i ka vetëm 13 ministri, ndërsa Gjermania, me 81 milionë banorë, i ka vetëm 14 ministri, ndërsa Kosova me 2 milionë banorë, i ka 18 ministri. Kjo fryrje e kabinetit në mënyrë të tillë të panevojshme, që kushton qindra mijëra euro, e cila është bërë në shprehje të plotë me të ardhurat, nuk është gjë tjetër veç se një politikë korruptive, e cila synon që të shpërblejë gjithkënd me paratë e publikut vetëm e vetëm që t'i sigurojë një jetë më të gjatë qëndrimit në pushtet.

Qytetarët e Kosovës duhet ta kuptojnë se këto praktika çojnë në një devijim të madh nga koncepti themelor i qeverisjes, sepse në këtë rast shteti është vënë në dispozicion të individit e jo e kundërta, pra të vihet individi në dispozicion të shtetit.

Por, si i thonë një fjale, edhe çdo e keqe, e ka nga një të mirë, kryeministri sado që jo në përqindjen e premtuar gjatë fushatës, me këto poste ministrash, zëvendëskryeministrash e zëvendësministrash e ka zbutur disi papunësinë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Burim Ramadani.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuara deputete dhe deputetë,

U dëgjuan shumë fjalë këtu, sidomos prej kryeministrit sa i përket guximit, por projektbuxheti që e kemi përpara nuk reflekton kurrfarë guximi për t'i ndalur humbjet që janë shkaktar dhe dëmtimet që i janë shkaktuar buxhetit gjatë vitit të kaluar, po edhe në vitin 2009 dhe në vitin 2008.

E dimë fare qartë se buxheti është prej kushteve kryesore për të jetësuar projektet dhe varësisht se cilat janë prioritetet, aty edhe vendosim buxhetin, që do të thotë varësisht prej kur e kemi qëndrimin tonë si subjekte politike dhe si qeveri, në këtë rast, aty edhe e vendosim edhe buxhetin.

Edhe nëse e marrim saktë këtë formulim që njerëzit e botës së menaxhmentit e njohin mirë, e shohin fare qartë se kjo qeveri po vazhdon të mos ketë prioritet ose, të themi, të harrojë vendosjen e autoritetit të shtetit në krejt territorin e vendit, zhvillimin e sigurisë sonë të përgjithshme, luftën kundër krimit të organizuar dhe luftën kundër korrupsionit.

Thënë shkurt, qeveria nuk ka buxhet për ta shtrirë autoritetin në krejt territorin e vendit, sidomos në pjesë ku bandat e qeverisë së Serbisë, por edhe bandat vendore po e bëjnë ligjin, thënë shkurt, Qeveria nuk ka buxhet për ta luftuar dëmtimin e buxhetit. Edhe ky është buxhet tepër i madh, sepse kjo e pamundëson edhe rritjen e të hyrave. Nëse flasim për rritjen e të hyrave përmes performancës më të mirë të doganave, atëherë nuk shohim

asnjë element në projektbuxhetin e Kosovës se pikat doganore do të vendosen në pikat kufitare 1 dhe 31 në veri.

Doganave iu janë ndarë 100 mijë euro për rinovimin e pikave doganore dhe nëse me këto 100 mijë euro do të ndërtohen dy pika doganore në veri, 1 dhe 31, atëherë kjo duhet vlerësuar, por dihet qartë se kjo nuk është fare e vërtetë, pra nuk do të ketë.

Në të njëjtën kohë, nuk ka tek Policia e Kosovës, tek Ministria e Punëve të Brendshme nuk janë futur asnjë cent për ndërtimin e pikave ose rindërtimin e pikave kufitare 1 dhe 31, përkundër faktit se në vitin e kaluar kanë qenë 800 mijë euro për Policinë kufitare. Sa u përket pajisjeve të avancuara për mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, në këtë vit kemi rënie të këtyre mjeteve në 500 mijë euro, edhe pse ministria në vitin e kaluar e ka vlerësuar se për vitin 2011 i duhen për Policinë kufitare 1 milionë e 700 mijë euro dhe i ka dhënë tash 500 mijë euro.

Ministri Rexhepi shkoi, por është shumë me rëndësi ndoshta ai të shohë strategjinë e ministrit të Drejtësisë se si nxirren paratë brenda Qeverisë, sepse kjo është një gabim i madh, pra kemi 1 milion e 200 mijë euro më pak për Policinë kufitare se sa që vetë ajo Ministri ka kërkuar gjatë vitit ose i ka vlerësuar gjatë vitit të kaluar.

Është e qartë se gjatë kësaj periudhe kemi dëgjuar shumë vlerësime se sa po investohet në veri të Kosovës dhe po ju them disa shifra shumë shkurtimisht sa i përket veriut të Mitrovicës, si komunë e Mitrovicës, pra jo për komunat tjera në veri të Kosovës.

Kemi tek rindërtimi i shtëpive të djegura investime në veri, kodi 83069, 25 mijë euro dhe rindërtimi i shtëpive të djegura investime në veri, kodi 83085, 374 mijë euro.

Investime kapitale për projekte në veri për shëndetësi i kemi vetëm 15 mijë euro, që do të thotë në tërësi i bien 414 mijë euro që do të investohen sipas këtij projektbuxheti në veri të Mitrovicës, në kohën kur ne e dimë fare qartë dhe shihet edhe në projektbuxhet se s'është asnjë cent për atë strategjinë e famshme të integritit të veriut, edhe pse janë premtuar disa herë jo 4, jo 5 milionë, por këto nuk janë futur në këtë projektbuxhet.

Do të thotë, është e qartë se nuk ka vullnet edhe nuk ka përcaktim buxhetor për sundimin e ligjit, për zbatimin e ligjit në krejt territorin, për vendosjen e parametrave kryesorë, parakushteve kryesore për të ruajtur buxhetin dhe për të ruajtur edhe ekonominë vendore. Nuk mund të ruhet ekonomia vendore nëse prej një pjese të kufirit të Kosovës futen mallrat pa dogana dhe kjo normalisht që i shkakton humbje të mëdha buxhetit të Kosovës.

Për të kërkuar votën dhe, nëse guxoj të përdor logjikën e njëjtë sikur kryeministri, nëse jemi për ose kundër këtij buxheti, atëherë duhet të themi se kush është për një buxhet që nuk parasheh kthimin e veriut në kontroll, kush është për një buxhet që nuk parasheh vendosjen e pikave kufitare atje, kush është për një buxhet që nuk parasheh vendosjen doganës atje, kush është për një buxhet që për Policinë e Kosovës i ulë mjetet për hetime, është shumë e mirë që ka një rritje të kategorisë për paga dhe mëditje në policinë

e Kosovës, kjo duhet përshëndetur, por është shumë larg zbatimit të ligjit të Policisë së Kosovës, respektivisht nenit 60, ku flitet për beneficionet, kompensimet dhe privilegjet e oficerëve policorë dhe normalisht se do të duhet të shikohet qartë edhe të kërkohej qartë dhe unë si deputet i kërkoj Qeverisë së Kosovës për ta votuar këtë projekt buxhet që të ndajë gjatë kësaj periudhe, deri në leximin e dytë, të ndajë 5 milionë për strategjinë e integritetit të veriut menjëherë, të ndajë mjetet e nevojshme për rindërtimin e pikave kufitare doganore atje gjatë këtij viti dhe mos të pres as deri në rishikim, të ndajë buxhetin, mjetet për rindërtimin e pikave doganore atje, të ndajë mjetet e mjaftueshme për funksionimin e Agjencisë Kosovare për Inteligjencë. E dini se kërkesat janë shumë më të mëdha se sa që janë ndarë, duhet të paktën edhe 3 milionë euro t'i ndahen Agjencisë Kosovare për Inteligjencë, deri sa janë ndarë më pak se 3 milionë tash, të ndajë shumë më shumë buxhet për investime në veri dhe mundësimin e kthimit të qytetarëve të Kosovës atje, prej ku janë dëbuar dhunshëm dhe, normalisht, të ndajë ose të vendos një politikë tjetër edhe përmes aspektit buxhetor, pra të ndajë mjetet e nevojshme për vendosjen e sistemit të tenderimeve online në të gjitha fazat, si një prej parakushteve kryesore për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, sepse kjo ka qenë bregma ma e madhe e Qeverisë së kaluar, të dy partive bashkë. Kjo duket se do të vazhdojë sipas këtij projektbuxheti, sepse ky projekt buxhet nuk i jep rëndësi as nuk i jep prioritet zbatimit të ligjit.

E dimë qartë se këto vërejtje, unë besoj shumë esenciale të një fushe të caktuar, që është sundimi i ligjit, janë tepër të rëndësishme edhe pse qytetarët e Kosovës janë lodhur tashmë me kriza të njëpasnjëshme që i keni bërë gjatë qeverisë së kaluar, e duket se do të ketë kriza të vazhdueshme edhe gjatë kësaj qeverie.

Unë besoj se me këto përmirësime, të paktën në fushën e sundimit të ligjit, duhet të kalohet menjëherë në mënyrë që ne ta votojmë buxhetin e Kosovës dhe atë jo për hatër të Qeverisë, por për hatër të qytetarëve të Kosovës që të mos ketë edhe një krizë tjetër edhe më të madhe, por përmirësime duhet bërë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Bekim Haxhiu e ka fjalën. Le të përgatitet Ymri Ahmeti.

BEKIM HAXHIU: I nderuari kryetar,

I nderuar kryeministër,

Zëvendësministra, ministra,

Kolegë të nderuar deputetë,

Diskutimin tim lidhur me Projektbuxhetin për vitin 2011 do ta fokusoj në disa pika të përgjithshme, por që në vete përmbajnë përmbajtjen thelbësore të këtij buxheti, të cilin e ka përgatitur Qeveria e Republikës së Kosovës dhe të cilin si deputetë, pas shqyrtimit mbështetës e mbështes. Përveç që është një buxhet i mirë, ai është edhe i lehtë për të kuptuar edhe nga laikët e ekonomisë, për çka e përgëzoj për punë zotin ministrin e Financave, Bedri Hamzën.

Miratimi i buxhetit tashmë të dizajnuar, që e kemi përpara, nënkupton në radhë të parë një hap përpara zhvillimit ekonomik të Republikës së Kosovës për faktin se kemi një buxhet më të madh, më të fuqishëm, më të konsoliduar.

Miratimi dhe përkrahja për këtë buxhet, që kemi në dorë sot, nënkupton ngritjen e kapaciteteve shtetërore, shtim të efikasitetit dhe kualitetit të shërbimeve publike për faktin se me ngritjen e të ardhurave për mjekët, shërbyesit civilë, policët, zjarrfikësit, familjet e dëshmorëve dhe lëmitë tjera të shoqërisë, kjo pa dyshim që për shumë ekspertë brenda këtij kontingjenti do të dokumentojë më shumë dinjitet e motivim për punë, normalisht, edhe ngritje të përgjegjësisë profesionale për të qenë në shërbim të qytetarit.

Këta që nuk ishin në gjendje të bëjnë asnjë rritje pagash, tani tentojnë prapa kundërshtimit për PTK-në, raporte me FMN-në, të bllokojnë mirëqenien qytetare.

U kujtojmë zotërinjve nga Lidhja Demokratike, se i pari që i ka prishur raportet me Komisionin Evropian është kryetari i partisë së tyre, i cili ka humbur miliona euro të Komisionit Evropian, mjete të cilat sot po i shfrytëzon komuna e Mitrovicës për shkak të gasjes pozitive që ka pasur me Komisionin Evropian.

Përkrahja e këtij buxheti do të nënkuptojë edhe më shumë avancime në ndërtimin e infrastrukturës rrugore. Kemi këtu parasysh projektin kombëtar, autostradën që na lidhë me Shqipërinë dhe na krijon dalje në det. Askush në ndërdijen e tij nga ne nuk mund të mendojë ndryshe, pos që ky projekt jo që është i domosdoshëm, por ndoshta çdo vonesë do të ndikojë në zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Përkrahja e këtij buxheti, të nderuar deputetë, do të thotë përparim me standardet dhe integrimin në Bashkimin Evropian. Kemi këtu parasysh numrin e projekteve dhe orientimet buxhetore që do të kontribuojnë në arritjen e standardeve të Bashkimit Evropian.

Kritikuesit tanë i akuzojnë për ftohje të raporteve me FMN-në, ndërsa dje thoshin se nuk duhet të jemi servilë të ndërkombëtarëve. Vërtet përkrahi fuqishëm zotin Thaçi, ngase ai me rritjen e pagave dëshmoi se për qytetarët e këtij vendi di të bëjë raporte dhe të bashkëpunojë edhe me ndërkombëtarët në raporte partneriteti për të mbrojtur interesat e qytetarëve të vendit.

Përkrahja e këtij buxheti do të ndikojë edhe në zhvillimin më të madh për kulturën, rininë dhe sportin për faktin se kemi ngritje të buxhetit për këto fusha. Ky buxhet vendos bazë të mirë që më në fund këto fusha të kenë një zhvillim dhe për afrimin e drejtë të plotë dhe të domosdoshëm ndërkombëtar qoftë në kulturë, film, muzikë e në veçanti në sport, ku përmes këtyre veprimeve do të ngrisin imazhin dhe do të tregojmë shpirtin kulturor e sportiv të Kosovës.

Do të ndalem pak këtu, nja dy tri çështje. Sporti deri më tani ka qenë i lënë anash dhe këta që sot e kritikojnë dhe thirren në emër të ardhmes së rinisë, kanë investuar në sportin e Kosovës vetëm për një vit të planifikuar më përpara 3 milionë euro për palestra

sportive, ndërsa në futbollin, si sportin më masiv, kanë investuar vetëm 160 mijë euro. Kjo ka qenë një diskrepancë e madh dhe ato palestra që i kanë investuar janë tmerrësisht të projektuara dhe të dizajnuara keq, ku vendin për shikues e kanë paraparë prapa fushave dhe koshave. Përpara e kanë pasur interesin personal.

Ju kujtoj se vetëm Federata e Futbollit të Kosovës i ka nja 24 mijë anëtarë dhe ka dashtë një sugjerim më i mirë. E mbështes në projektligjet e kësaj ministrie Ligjin për sponzorim me ndryshimin e Ligjit për sportin, do t'i hap një rrugë dhe zhvillim sportit të Kosovës, ndërsa edhe sportistët kosovarë do të jetojnë dinjitetshëm.

Mbështes këtë buxhet dhe përkrah projektin për vazhdimin e punimeve në ndërtimin e kompleksit memorial "Adem Jashari" dhe mendoj se këtu duhet të shtohen edhe një pjesë e investimeve për mirëmbajtjen e kompleksit dhe pranimit të stafit të këtij memoriali. Gjithashtu, kur jemi te kultura, përkrahi investimet në trashëgiminë kulturore dhe në restaurimin e objekteve kulturore, por ka edhe një vend, edhe një vend tjetër, një restaurim i cili është i domosdoshëm, të cilin zoti Selimi e harroi, për restaurimin e Akademisë së parë ushtarake të UÇK-së në Açarëvë, ngase zoti Selimi sot po mendon për autobllinda, ndërsa e ka harruar akademinë e fshatit të tij.

Ka edhe vende tjera të cilat në Kosovë dhe në Drenicë kanë nevojë të restaurohen, e në veçanti mullinjtë shumëvjeçar të Kopiliçit e të Kuçicës, që janë mulli mbi dyqind vjeçar apo kulla e Shaban Manxhollit dhe shumë objekte tjera kulturore që kanë nevojë të restaurohen dhe të përgatiten për të ardhmen tonë.

U tentua të manipulohet këtu me shifra nga ana e opozitës. Në krejt botën demokratike bëhet garë me përqindje për t'i ofruar mirëqenie qytetarit, vetëm këtu te ne një parti ofron alternativë për mirëqenie të qytetarëve me shifra të sakta për rritjen e saj, ndoshta të tjerët e kundërshtojnë pa kurrfarë oferte alternative. Ndodh që në perëndim edhe për 2, 3 % të shtyhen partitë se cilat do të bëjë një mirëqenie më të mirë për qytetarët, këtu te ne jo.

U tha se në Suharekë nuk ka planifikim për investime. Shikoni të dhënat në projektbuxhet. Mbi 4 milionë e gjysmë euro janë të parapara për investime kapitale për vitin 2011 për Suharekën, nuk ka ndarje të buxhetit në baza politike regjionale, faktet flasin, investimet kapitale për komunën e Skenderajt janë të planifikuara 2 milionë euro, ndërsa për Besianën 6 milionë euro, 4 milionë më shumë janë për Besianën.

Pastaj, e bëjmë dhe një krahasim me 5 komuna që i udhëheq PDK-ja dhe 5 tjera që kanë partitë tjera. Për investimet kapitale në Skenderaj, Drenas, Malishevë, Vushtri, Mitrovicë, të cilat i udhëheq PDK-ja, janë planifikuar 17 milionë e 900 mijë euro, ndërsa për komunat që udhëheqin subjektet tjera Besianën, Rahovecin, Pejën, Suharekën, Gjakovën, janë planifikuara për investime kapitale për vitin 2011 - 25 milionë e 400 mijë euro. Që i bie në komunat të cilat nuk i udhëheq PDK-ja ka 4 milionë e gjysmë investime më tepër se komunat që i udhëheq PDK-ja.

U tha këtu një dallim në paga në mes të shërbyesve civilë dhe atyre të cilët janë në ndërmarrjet publike. Paga mesatare në ndërmarrjet publike është diku afër 800 – 850

euro, ndërsa të shërbyesve civilë afër 270, u tha që është 40 herë më e madhe se sa është ky dallim.

Unë i kuptoj disa këtu që me matematikë dhe me ekonomi kanë probleme për shkak se sigurisht që ekonominë më të madhe apo matematikën më të madhe e kanë bërë me blerjen e ndonjë kante me ngjyra kundër sprejit për të zhgarravitur nëpër Kosovë, por realisht nuk është ndonjë matematikë e cila vlen të vlerësohet në këtë Parlament. Faleminderit!

KRYETARI: Replikë, deputeti Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Ne vetëm deshëm ta sqarojmë zotin komandant Kamishi, a s'di, ashtu i thotë vetit, po më duket, që ne nuk do të shpenzojmë shumë kohë të merremi me të, që t'ia sqarojmë edhe popullit të Kosovës, për deri sa ky të mos jep dy sqarime elementare që i ka me drejtësinë në Kosovë. Të na tregojë pse është arrestuar në vitin 2008 dhe pse e ka në Policinë e Vushtrisë lëndën për kërcënim me armë për një të mitur, këtë gjë duhet ta shpjegojë dhe, tjetra është që të japë përgjegjësi kur ka qenë si nënkryetar i Federatës së Futbollit, për keqpërdorimin e fondeve aty. Përderisa të mos i kryej këto dy punë, ne as që do të lodhemi të merremi me të. Faleminderit!

KRYETARI: Bekim Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Nuk është kjo shpifja e parë e këtyre të "Vetëvendosjes" në raport me mua. Asnjëherë nuk kam qenë i arrestuar në Vushtri. Kam qenë i ndaluar, që është një fakt, dallon shumë kjo, zoti Konjufca, dhe mund të them lirisht që në jetën time, se keni bërë edhe shkrime tjera nëpër internete e sende, jam i gatshëm me çdo njërin prej jush të "Vetëvendosjes" sa ai përket karakterit tim dhe emrin sigurisht ma di, edhe këtë pseudonim që e kam marrë, nuk kam qenë të thirrem në të, për shkak se në listën e Partisë Demokratike kam qenë me emër e mbiemër, po atë pseudonim e kam ngritur me mund e me gjak. Sa i përket armëmbajtjes, nëse ti Glauk ke qejf me përmend shumë për Mitrovicë, po ajo ka qenë, atë ditë kur jam ndaluar për një armë, kam qenë në pjesën veriore të Mitrovicës, me një manifestim të një dëshmori që i është ngritur busti atje, që ti për fat të mirë ke qejf të flasësh për atë pjesë, por nuk e ke guximin asnjëherë të shkosh atje dhe....

(Ndërprerje)

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë. Fjalën e ka deputeti Imri Ahmeti, le të përgatitet Florim Krasniqi.

IMRI AHMETI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar kabinet qeveritar, deputetë të nderuar,

Për shkak të ekonomizimit të kohës, do të provoj t'i bie telegrafikisht asaj që unë kam menduar ta them edhe për shkak se shumë çështje janë përsëritur. Megjithatë, e para që dua të ripotencoj, nëse është potencuar dhe nuk e kam dëgjuar, është vonesa e dërgimit të këtij projektbuxheti për nga kalendari, që mendoj ka pasur mundësi ky projektbuxhet të

vjen në fillim të marsit e jo vetëm edhe tri ditë pune që kanë mbetur deri në skadimin e kohës kur mund të procedohen të dalat apo shpenzimet në thesarin e Republikës të Kosovës.

Nuk e di a është bërë kjo me qëllim apo jo, por mendoj se vetëm tri ditë pune janë deri kur mund të mbyllet ky proces dhe kujtoj që kjo nuk do të duhej të praktikohet dhe nuk do të duhej të ndodhë.

E dyta, u dëgjuan shumë fjalë që ky buxhet sjell zhvillim ekonomik dhe janë ndër fjalët që më së shpeshti përsëriten edhe nga kryeministri, zoti Thaçi, por në realitet krejt del e kundërta, sepse ky buxhet nuk adreson politika të qëndrueshme zhvillimore dhe, si i tillë, nuk garanton stabilitet fiskal, u tha nga shumë diskutues.

Ky projektbuxhet, në fakt, nuk adreson zgjidhjen e çështjes me interes për një jetë më të mirë të qytetarëve, por promovon vazhdimin e rritjes së papunësisë, shtimin e varfërisë, vazhdimin e territ, nuk garanton edukim cilësor, shëndetësi cilësorë e të tjera.

Krijohet përshtypja se ky buxhet vërtet është ajo hijeshia pranverore që Qeveria po i servon shoqërisë, përkatësisht shtetit tonë. Për të mos përsëritur çështjet, unë do të potencoj vetëm disa çështje që u thanë këtu dhe unë nuk pajtohem.

E para, nuk mendoj që projektbuxheti i përfshin të gjitha premtimet, sepse do të ishte mirë që të përfshiheshin të gjitha premtimet. E kujtoj kryeministrin dhe të gjithë të tjerët, besoj është ende e freskët, premtimi i miliona eurove në fushatën e fundit për investime kapitale nëpër komuna, diku 60 milionë, diku 100 milionë e më tepër për investime kapitale. Duke e shikuar tabelën këtu të investimeve kapitale të komunave, vjen se ky premtim as 10 për qind nuk është përmbushur, e lëre më 100%.

Mos harroni, tani jemi edhe në një krizë të inflacionit, që u tha nga shumë diskutues, dhe është edhe një premtim i kryeministrit, bile, bile edhe i ministrit të Ekonomisë, nëse s'harrojmë, që TVSH-ja për bukën do të zbritet, kështu është deklaruar, prej 16 në 9%, mos gabofsha, është deklaruar dhe kjo nuk ka ndodhur, përkundrazi çmimet e bukës dhe të artikujve të tjerë deficitarë po shkojnë edhe më lartë.

Në një prononcim këtu të kryeministrit u tha që Suhareka e Prizreni kanë arsye të votojnë për projektbuxhetin, sepse e kanë autostradën si investim kapital. Shtrohet pyetja çka bëjnë komunat tjera, siç është Lipjani, Ferizaj dhe shumë komuna të tjera, të mos përmendi me emra. Nëse edhe autostrada është hequr anej, atëherë cili është motivi jonë, personalisht edhe i imi, edhe i qytetarëve që unë i përfaqësoj këtu, ta votoj këtë buxhet.

E treta, ky buxhet promovon jo barabarësinë e qytetarëve, nuk është i drejtpeshuar. Shikoni të hyrat vetanake të komunave në proporcion me grandin qeveritar dhe do të shihni që ka komunë që me të hyrat e veta vetanake merr pjesë me 33%, ndërsa ka komunë e cila nga grandin qeveritar financohet me 99%. Kjo nuk është një ndarje e drejtë

dhe është e padrejtë ndaj qytetarëve të pjesëve tjera që financojnë për komuna, të cilat nuk inkasojnë të hyrat komunale.

E katërta, ky buxhet promovon rritjen e papunësisë dhe destimulon gjenerime të vendeve të punës, rritja e subvencioneve dhe rritja e numerikisht, po them numerikisht e kategorive që përfitojnë nga subvencionet, për mua paraqet një shqetësim dhe një sinjal jo të mirë. Edhe 12 vjet pas lufte neve na rriten kategori që përfitojnë ndihma sociale dhe 12 vjet pas lufte neve na rritet numerikisht numri i invalidëve të luftës. Kjo është për shqetësim dhe, për mendimin tim, Qeveria po përpiqet që përmes këtyre kategorive të subvencioneve të sistemojë dhe të stimulojë rrjetin e vet të simpatizantëve në terren.

Po përpiqem ta shkurtoj. Buxheti nuk adreson sfidat të cilat lidhen me agjendën Evropiane, edhe pse dimë të jemi shumë për integrimet evropiane, por shumë pak ka të bëjë me këtë temë, as politikat që lidhen me shpëlarjen e parave të drogës, të luftimit të krimit të organizuar, të terrorizmit, me risocializimin e kategorive të përfshira në dukuri negative, me mbrojtjen e të dhënave personale dhe çështjet e tjera.

Edhe një herë, me qëllim që të ekonomizojmë kohën, unë mbështes qëndrimin e Grupit tim Parlamentar dhe gjithsesi jemi që ky buxhet t'i rikthehet Qeverisë dhe është mirë që Qeveria njëherë e përgjithmonë të mësohet që çdo projekt kur vjen këtu, e ka mundësinë të shqyrtohet dhe të ndryshohet, nuk do të thotë pikë për pikë ashtu siç e ka pru edhe të kalohet.

Ne jemi për atë që të rishqyrtohet edhe një herë ky projektbuxhet, për aq sa ka hapësirë dhe mundësi. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, kryeministër!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Vetëm një sqarim Imri, jo polemikë. Unë mendoj jo vetëm Prizreni po... Mirë de, s'prish punë! Jo vetëm Prizreni dhe Suhareka, por gjithë Kosova ndihen mirë me fillimin e ndërtimit të autostradës dhe mua më vjen shumë keq që është bërë halë në sy dhe refuzim ndërtimi i kësaj autostrade, por jo vetëm ato territore që do të kalojë autostrada se, tek e fundit, ajo kalon trup e tërthor Kosovës.

Ndërsa, sa i përket votimit apo diçka tjetër, ju do të keni edhe një motiv tjetër shtesë, sepse autostrada e re prej aeroporti në drejtim të Shkupit do të kalojë nëpërmes territorit të Shtimes, të Lipjanit, Ferizajt, Kaçanikut dhe Hanit të Elezit. Faleminderit! Dhe ju jeni të informuar si ish anëtar i Qeverisë.

KRYETARI: Florin Krasniqi e ka fjalën.

FLORIN KRASNIQI: I nderuar, zoti kryetar,

Unë, do të ishte dashur t'iu drejtohem - të nderuar deputetë edhe e nderuar qeveri, por këtë s'mund ta bëj sepse një pjesë e mirë e deputetëve këtu kanë ardhur me vota të vjedhura dhe kjo Qeveri është krejtësisht servile. Prej kah vi unë, serviliteti dhe vjedhja

nuk janë vlera dhe nuk janë nder, atëherë do t'ju drejtohem si - zonja e zotërinj, ashtu si jeni, të ndershëm e të pandershëm.

Pak më shumë se 3 vjet më parë u shpall pavarësia e Kosovës. Unë jam pjesë e diasporës, e të gjithë u eksajduam, u gëzuam për këtë shpallje, e vetmja gjë, e vetmja gjë pozitive që u pa në këtë shpallje të pavarësisë. Kjo pavarësi nuk e kishte tërësinë territoriale, e kishte krimin e organizuar shumë të mirë...

KRYETARI: Florin, e kemi buxhetin...!

FLORIN KRASNIQI: Po, e di këtë, por e vetmja gjë pozitive ishte qëndrueshmëria fiskale. Qëndrueshmëria fiskale ishte e vetmja dritë e këtij shteti të ri e të varfër, andaj kjo qeveri, kjo qeveri të vetmen gjë që e patëm e mori. Na e propozoi një buxhet, i cili me garancion do ta bankrotojë Kosovën. Me garancionin më të madh, edhe këta e dinë, edhe na e dimë, edhe miqtë, edhe armiqtë tanë ndërkombëtarë e dinë se ky buxhet, ky buxhet do ta bankrotojë këtë shtet më të ri të Evropës, më të varfrin.

Andaj, po sikur këto 300 milionë dollarë të austradave e të gjitha këtyre shpenzimeve që i kanë bërë, në ngritjen e shkollave, të rrugëve për të marrë mito, të ishin investuar në energjetikë ose në miniera, çfarë zhvillimi ekonomik do të kishte ky vend, por sa do të përfitonin këta keqbërës? Andaj, këto para, shumica e këtyre parave investohen ose në rrugë, ose në shkolla. Këtu këta kanë një përqindje shumë të madhe, nuk u dhemb zemra këtyre për rrugë as për shkollat. Këtyre u dhemb zemra për miton që marrin prej këtyre investimeve. Andaj, ky buxhet garanton, garanton bankrotimin e shtetit të Kosovës.

Edhe një gjë. Në komisionin që unë kryesoj për Inteligjencë, ka më pak se 3 milionë euro. A dini pse? Pse këta e kanë shërbimin e vet me 300 milionë euro, çka iu vyen ky shërbimi informativ i Kosovës, që është themeluar me ndihmën e ndërkombëtarëve, që veç rrugën ua zë. Po, nuk ka për të zgjatur kjo. Ju garantoj, se populli besnik, bujar, punëtor e fisnik i Kosovës nuk ka për t'i duruar më, nuk ka për t'ju duruar më, boll, i erdh fundi. Faleminderit!

KRYETARI: Ju lutem, ju lutem! A ta përmendi emrin? Urdhëro, Shaip, replikë dy minuta. Shko në vend, Florin!

SHAIP MUJA: A bën një replikë?

KRYETARI: Urdhëro!

SHAIP MUJA: Nëse është hajn dikush, është hajn ky. Edhe nëse ka nevojë, nëse ka nevojë për hidrocentrale për t'i hapur, unë e luti kryeministrin t'i hap edhe disa, t'ia mbyll gojën. Ky është një denoncues, në shtetet normale ky nuk guxon të jetë kryetar i Komisionit të AIK-ut. Ky denoncon vetë dhe ky parlament duhet ta revokojë kryesimin e tij, sepse për kë ky raporton, cilat janë sferat që ky i raporton?

Prandaj, nuk ka nevojë të na shitet si patriot, ne e njohim mirë kush është ky dhe nuk kishim lejuar që të marrë të drejtën të etiketimeve të Partisë Demokratike dhe të Qeverisë.

KRYETARI: Faleminderit! Kundër replikë, një minutë, Florin Krasniqi.

FLORIN KRASNIQI: Kush është ky që bën muhabet kështu kundër meje? Në qoftë se unë kurrë në jetën time nuk jam akuzuar, e lëre më të më gjejnë fajtor për krim, unë i denoncoj hajnat, njerëzit që me djersen e popullit, me djersën e popullit shumë të vuajtur të Kosovës jetojnë jetën më luksoze të mundshme. Atë ju e bëni për gjithë ditë, në sytë e të gjithë qytetarëve të Kosovës. Unë i kam fituar hidrocentralet me mund e me konkurrencë shumë të madhe. Unë e kam ndërtuar hidrocentralin e parë në Kosovë, pa infrastrukturë ligjore, me përpjekje shumë të mëdha, e me ndihmën e Shteteve... Kam marrë kredi prej Shtetit Amerikan. Është e vetmja kredi që ka ardhur dhe e vetmja kredi... Ti me hidrocentralet e mia mos u merr, se e vetmja kredi që ka ardhur prej ..., e vetmja kredi. Unë kam pru investime në Kosovës, unë punoj në Kosovës, unë punoj, unë nuk vjedh, unë nuk jam hajn. Ku i merrni ju paratë, kjo është pyetja ime për ju. Ju jeni hajna, unë nuk jam hajn, unë jam punëtor, unë punoj me nder e me ndjerës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Florin, të lutem, kontrolloje fjalorin. Latif Gashi e ka fjalën, replikë.

LATIF GASHI: Faleminderit, zoti kryetar!

Ky zotëri për çdo ditë bën nga një krim. Ky veç flet dhe nuk shkon ku duhet të shkojë dhe të lajmërojë atë që ky e di. Bën akuza pa asnjë fakt, bën raporte e shumë gjëra të tjera. Ky zotëri adresën e ka gjykatën, prokurorinë e jo t'i terrorizojë me rrenë e me shpifje qytetarët e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Jo, ju lutem... Jo, një minutë kundër replikë, Shqip, veç ju lutem, mos dilni jashtë temave.

SHAIP MUJA: Nuk ka nevojë të përdoret foltorja për qëllimet dhe egot e akumuluar personale të një individi pa vlerë. Ne nuk kemi nevojë t'i shpalosim vlerat këtu. Qytetarët e Kosovës sot janë duke pritur nga ne një reflektim intelektual për të mirën e tyre. Ky dhe shumë të tjerë të cilët nuk kanë shpalosur vlera, janë të votuar nga populli, prandaj ne po çojmë mesazh që nuk kemi interes të përgjithshëm mbi qasjen që bëhet për problemin që jemi mbledhur, por reflektojnë egot e veta.

Ne kur kemi qenë dikush, ti ke qenë dikush prapë, por me vlerat të cilat mund t'i dish fort mirë. Unë të thërras të flasësh në mënyrë konstruktive, po jo etiketuese këtu. Ne njihemi shumë mirë, Kosova është shumë e vogël, qoftë në ilegalitet kur kemi qenë, qoftë çfarë financimi ti ke bë, kush je...

(Ndërprerje)

KRYETARI: Faleminderit! Jo, e ke harxhuar...Burim, nuk tu ka përmendur emri ty. Jo, jo, ju lutem, a! Edhe ashtu po duhet t'u them që gjithë replika është bërë jashtë rendit të ditës. Ju lutem, të jeni në rend të ditës, edhe kur të replikoni, të jenë në rend të ditës. Ato akuzat, nëse i keni, kush i ka, Parlamenti nuk është për to, është prokuroria, urdhëroni dorëzoni në prokurori, prandaj sot po e debatojmë, po ua përkujtoj edhe një herë, Projektbuxhetin për vitin 2011. Fjalën e ka deputeti Arsim Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Para se të shpreh opinionin tim, dëshiroj të përkujtoj se në Rregullore është një institucion që quhet gjuha jashtë parlamentare dhe është mirë ta lexojnë të gjithë deputetët dhe ta kontrollojnë pak fjalorin, sepse Parlamenti është për të diskutuar, jo për të ngritur akuza që nuk janë objekt i shqyrtimit të parlamentit.

Fillimisht, po i kthehem fjalisë së ministrit të Financave, një fjali jashtëzakonisht e mirë në fillim, kur ai tha se ky është një buxhet i mundësive, jo buxhet i dëshirave dhe mendoj se ashtu edhe duhet ta trajtojmë.

Unë kisha për ta shikuar këtë projektligj në kontekstin e tranzicionit ekonomik në të cilin po kalon Kosova, një proces që është domosdoshmëri duke pasur parasysh orientimin e Kosovës që të ndërtojë një shoqëri të ekonomisë së tregut. Dhe, padyshim se ky tranzicion ka filluar, po s'ka përfunduar dhe janë tri momente që do ta përcjellin këtë tranzicion.

Momenti i parë është transformimi i pronës, që është një proces demokratik, një proces që e kanë përfunduar shumica e shoqërive të tregut. Elementi i dytë është një konkurrencë e lirë, që duhet të futet në Kosovë dhe duhet të përfundojë, dhe elementi i tretë është heqja e monopolit të Qeverisë ndaj ndërmarrjeve publike.

Unë e vlerësoj këtë projektligj si një përpjekje të qëlluar për balancimin e shpenzimeve publike dhe është e drejtë legjitime e Qeverisë që të ndërtojë ekuilibrat e shpenzimit të buxhetit dhe unë mendoj se këto ekuilibra janë ndërtuar jashtëzakonisht mirë dhe janë marrë parasysh dy kritere: kriteri i parë është ruajtja e kontinuitetit të zhvillimit ekonomik dhe kriteri i dytë është përmirësimi i mirëqenies sociale të qytetarëve.

Në këtë kontekst është jashtëzakonisht inkurajuese që Qeveria e Republikës së Kosovës pas investimeve të mëdha në infrastrukturë ka vendosur që prioritet, në pajtim edhe me premtimet legjitime që janë dhënë me rastin e fitimit të zgjedhjeve, në epiqendër të vendos mirëqenien sociale të qytetarëve dhe është për t'u vlerësuar dhe përshëndetur fakti që me miratimin e këtij projektligji hapet rruga për ngritjen e pagave, ngritjen substanciale e cila përkundër kësaj ngritje ende bën që këto paga të jenë të ulëta.

Gjithashtu, vlerësoj shumë që është ruajtur tempoja e zhvillimit ekonomik, për shkak se nuk janë pakësuar mjetet e parapara për investime kapitale, e në mënyrë të veçantë është për të përshëndetur përkushtimi i Qeverisë për të vazhduar projektin madhor të ndërtimit të autostradës.

Në anën tjetër, vlerësoj qëlluar rrudhjen e pozicionit të investimeve në shërbime dhe mallra dhe kjo është jashtëzakonisht mirë sepse në periudhën e pasluftës kemi pasur shpeshherë edhe pozicione të fryra sa i përket shërbimeve dhe mallrave dhe Qeveria tani ka bërë jashtëzakonisht mirë që ka shkuar kah ngushtimi i shpenzimeve logjistike në favor të mirëqenies sociale të qytetarëve. Gjithashtu, është shumë inkurajuese dhe është për të përshëndetur qasja e Ministrisë së Financave për futjen e një fryme menaxheriale te disa institucione, siç është Universiteti i Prishtinës, mandej institucionet shëndetësore dhe unë do të inkurajoja që kjo logjikë menaxheriale dhe praktikë e mirë perëndimore të provohet edhe në vendet e tjera që institucionet që gjenerojnë të hyra të mos jenë gjithmonë barrë e buxhetit, mos të jenë vetëm subjekte buxhetore konsumuese, por në një mënyrë që ato të hyra që i gjenerojnë duke ushtruar veprimtarinë e tyre legale, edhe t'i menaxhojnë. Dhe është jashtëzakonisht mirë, unë i kam parë këto praktika të mira në vende tjera dhe kanë pasur jashtëzakonisht sukses. Është mirë që është filluar në këta dy sektorë, por unë apeloj që të vazhdohet edhe me sektorë tjerë, në mënyrë që mos të jenë barrë këto institucione publike gjithmonë e buxhetit të Kosovës.

Kam dy propozime, të cilat janë shumë të rëndësishme, për të mundësuar realizimin e këtyre balancave apo ekuilibrave buxhetorë, që të kihet parasysh për një pako të masave ekonomike, kjo vlen sidomos për Ministrinë e Ekonomisë, për pako të masave ekonomike që të mbahet nën kontroll procesi i inflacionit, sepse kjo është shumë e rëndësishme për të mundësuar rritjen reale dhe praktike të pagave që do të bëhen me këtë dhe, çështja e dytë, meqenëse ne po i diskutojmë dhe po e miratojmë Projektligjin në muajin prill, pra në muajin e katërt, pra jemi me tre muaj vonesë, mbetet obligim që me rastin e rishikimit të buxhetit të balancohen ekuilibrat buxhetorë, varësisht nga realizimi i buxhetit në gjashtë muajt e parë dhe mbetet që të jetë një mundësi e rishikimeve buxhetore, varësisht nga prioritetet dhe varësisht nga efikasiteti i njëjsteve buxhetore në shpenzimin e investimeve kapitale.

Po e përfundoj. Unë mendoj se kemi një projektligj të balancuar, ka mundësi që me rastin e leximit të dytë apo amendmentimit të përmirësohen disa pozicione, por përgjithësisht është për t'u përshëndetur fakti që Qeveria e Kosovës përmes këtij projektligji ka realizuar dy qëllime strategjike, pra ka mundësuar kontinuitetin e zhvillimit ekonomik duke siguruar konstruksion financiar për vazhdimin e investimeve kapitale, sidomos të investimeve madhore, siç është ndërtimi i autostradës dhe, në anën tjetër, me të drejtë Qeveria në epiqendër ka vendosur mirëqenien sociale, pra është koha që pas tri viteve pavarësi, qytetari të përmirësojë kualitetin e jetës dhe ky buxhet jep mundësi të tillë. Faleminderit!

KRYETARI: Para se t'ia jap fjalën deputetit Ekrem Kryeziu, ju njoftoj që janë për diskutim të lajmëruar edhe 30 deputetë. Fjalën e ke, deputet Eqrem Kryeziu!

EQREM KRYEZIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë nuk do të heq dorë nga konsistenca ime që t'ju kërkoj leje të përshëndes kryeministrin, zëvendëskryeministrin dhe të tjerët sikur në kohë të lumtura të idilës përpara dhe ma përkujtoi zotëri Skender Hyseni këtë virtyt të konsistencës dhe unë e kapa pastaj menjëherë.

Sa i përket buxhetit, edhe këta të mitë u çuditën kur thanë Eqrem Kryeziu do të flasë për buxhet sot. Dibidus jam këtu, unë s'kam lidhje me buxhet, por si do qoftë, do të përpiqem të jem pak më rozë, do të thotë të flas në emër të kompromisit gjithëkombëtar dhe gjithëminoritar, të flas diçka më me optimizëm.

Këtu ka disa lëvizje pozitive. Për shembull, deputeti Pacolli, i vetëshpallur president, shkoi në një fshat dhe dha rrogën edhe 10 familje për një mandat pak a shumë e zbuti varfërinë e tyre. Mirëpo, kjo është lëmoshë, natyrisht, nuk përkon me qasjen institucionale, por sido qoftë më mirë një trumcak në dorë, se sa një pulëbardhë për hava.

Mirëpo, edhe po më vjen mirë që tash nuk ka transmetim drejtpërdrejt, se ata të moshës fëmijërore nuk është mirë të më dëgjojnë, edhe pse jam shumë optimist, por një optimizëm goxha i gjatë.

Sa vjet i duhen praktikisht deputetit Pacolli që të zbusë varfërinë në Kosovë? Në qoftë se janë 500 mijë familje, atij i duhen më së paku 50 mijë mandate, që bëjnë 200 mijë vjet. Unë edhe kisha për t'i hyrë kësaj rruge, sepse jemi njerëz që s'jemi dorëzuar kurrë, apo, pa marrë parasysh format e rezistencës të cilat me të drejtë këtu... Do t'i hyja, por vallë po them, a do të jenë gjallë njerëzit që e kanë pa cullak shokun Tito për të vazhduar këtë trend, kështu që prandaj po them, më mirë është që nuk ka transmetim drejtpërdrejt dhe jam më i lirë kështu, madje kisha për ta rekomanduar RTK-në...

KRYETARI: Ta kesh parasysh fjalorin parlamentar!

EQREM KRYEZIU: Jo, unë nuk po shpifi kurrëgjë! Nuk po shpifi kurrëgjë, e tash të them të drejtën, sa i përket këtij buxheti këtu, unë e di që zoti Thaçi, për të cilin natyrisht kam respekt, nuk e ka në qejf, si të them, lëvizjen populiste ose presionet populiste, mirëpo diçka mu duk, ndoshta pse jam lodhur, mu duk si një presion populist, tha - shokë, ja votojeni, ja ju jeni koftra! Kjo, të them të drejtën, nuk më erdhi mirë mua, mirëpo mund t'i lejohet edhe Homerit që të dremitë ndonjëherë, përkundër urtisë së madhe. Sepse ne të gjithë e dimë që askush në Shqipëri nuk ka qenë kundër piramidave, megjithatë piramidat e shkatërruan krejt.

Prandaj, duke mos qenë unë shumë ekspert për çështje ekonomike, po dua të them që të mos jetë një projekt piramidal i buxhetit ky, që do t'i kushtojë Kosovës. Unë me dëshirën më të madhe do t'i besoja ministrit Hamza se do të rritet ekonomikisht Kosova, do të ketë një rritje për 5%, por a mundet dikush prej jush që jeni përgjegjës, madje edhe kur ka qenë LDK-ja bashkë, mos të harrojmë kush e ka pasur përgjegjësinë, pash zotin, se nganjëherë po mistifikohen gjërat krejt, a do të mundet dikush prej jush të thotë se varfëria do të zbutet? Mua më intereson kjo, sepse edhe pse nuk jam njeri i numrave, mundeni edhe mos t'i besoni ato vitet që i thashë 200 mijë vjet, megjithatë e di që në qoftë se do të manipulosh, atëherë përdor statistika shumë të sakta. Këtë e di. Kështu që në qoftë se garantoni se varfëria do të zbutet, atëherë me të vërtetë do të ishte një ngushëllim i madh sepse, shikoni, është e vërtetë që zoti Thaçi tha - njerëzit më kanë dhënë votën, por është gjithashtu e vërtetë, ka edhe zëra, unë s'po them ashtu, unë veç po

qes teza këtu në Parlamentin e nderuar, ka zëra se praktikisht premtimi elektoral ishte praktikisht për rritjen e rrogave, ishte njëfarë lloj blerje e votës, madje jo me paratë e zotit Thaçi, as të Pacollit, se edhe ai nuk jep, por me paratë e vet votuesve, madje edhe ato që s'i kishin, por me paratë që do të hyjnë në kredi ata për t'i marrë, sepse 70 mijë punëtorë civilë bëjnë 140 mijë vota bashkë me gratë ose me burrat, ose në qoftë se janë homoseksualë, ne jse me gjininë e tyre. Kështu që këtu ka teza dhe antiteza. Unë nuk po dua të them se besoj qind për qind në to, por unë po ju lus që, sidoqoftë, të jemi të kujdesshëm, mos të lëmë përshtypjen e një projektbuxheti piramidal, aq më tepër duke lëkundur shtyllat e bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare financiare, sepse ende pa u bërë pjesëtarë të tyre, lëvdoheshim jo veç ne, por edhe miqtë tanë amerikanë se do të bëhemi anëtar. Dhe, tash, menjëherë në qoftë se i tundim ato shtylla, për të cilat nuk po them se unë dëshiroj të jem servil, po unë jam shumë i sigurt se ata nuk ia kanë inati Hashim Thaçit, aq më pak neve opozitës së gjorë. Po i thonë, vërejtjet po thotë, qysh shkon ecuria, thjeshtë ekonomike e një vendi premtues, si Kosova.

Në këtë kuadër, lutja ime është që në Kosovë vërtet të funksionojë parimi i shanseve të barabarta, veç mos të jetë kjo i shanseve të gjithë neve që të jemi shumë të varfër. Ju faleminderit shumë, zoti kryetar!

KRYETARI: ... së paku na bëri për të qeshur, mirë është kjo. Deputeti Liburn Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: I nderuar, kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Projektligji për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011 hoqi çdo dyshim se do të ndërrojë diçka në këtë vit në kursin e qeverisjes dhe që Kosova do të mund disi të drejtohet më në fund drejt zhvillimit ekonomik.

Unë do të flas për Projektligjin për buxhetin për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë, Zhvillimit Rural, si dhe për Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, dy aspekte këto që do të duhej të trajtoheshin bukur me prioritet, e në fakt për të dyja buxheti i parashikuar është tejet i ulët dhe i pandryshuar nga viti i kaluar, madje i ulur kur bëhet fjalë për Ministrinë e Mjedisit.

Për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural parashihet të ndahen 13.7 milionë euro, e që në përqindje i bie 0.97% dhe nuk paraqet ndryshim me vitin e kaluar. E kjo në krahasim me vendet fqinje është përqindje shumëfish më e vogël.

Derisa ne po e diskutojmë buxhetin, çmimi i bukës dhe i produkteve elementare po rritet dhe po rritet tepër më shumë se në vendet e tjera të rajonit. Në vendet tjera çmimi i bukës po mbahet në saje të rezervave që kanë shtetet, ndërsa tek ne mungesa e prodhimit vendor të drithërave dhe posedimit të rezervave çmimi i bukës rritet tej mase duke u bërë i pa përballueshëm për qytetarët që po varfërohen çdo ditë.

Një gjë e tillë ishte tejet e parashikueshme edhe para projektligjit edhe sot kur po diskutojmë. Çmimi i bukës po rritet dhe po rritet në vazhdim dhe mosndërhyrja serioze në këtë çështje paraqet mos kokëçarje për gjendjen e krijuar.

Në raport të UNDP-së që na u prezantua këtu në Kuvend ditë më parë në objektin e Kuvendit, desha të them, thuhet ndër tjera se varfëria rurale është përkeqësuar për 50% nga viti 2000. Kur e krahasojmë këtë me pasurimin e lartë të një grupi tejet të vogël të njerëzve, vërejmë se shkaktohet një kontrast tejet i lartë në mes shtesave shoqërore dhe kjo politikë po ndiqet viteve të fundit dhe vazhdon me hapa shumë të shpejtë. E ne për këtë u dashka të heshtim pasi kështu po e thonë shkollat më ekonomike të ministrave. Meqë qenka shkolla juaj ajo që e solli këtë gjendje, atëherë bukur keq i kemi punët, pra. Kur na flasim ata për shkollat prej nga vijnë, në arsyetimin dhe promovimin e vazhdimin të kësaj gjendje është tejet e qartë, i tillë është orientimi ideologjik i tyre, ndërsa unë do të doja t'i ktheheshim ca realitetit dhe gjendjes së re të krijuar në terren dhe ta lëmë ideologjinë le të pres pak.

Serbia e ndaloi pra eksportin e grurit dhe nuk do të na jap më bukën tonë të përditshme. Serbia pra e ndal bukën kur do ajo, edhe përkundër që ne ia shtrojmë asfaltin deri në Merdare dhe ia mundësojmë lidhjen me detin që është ëndërr e saj, e edhe përkundër që i shkojmë në negociata sa herë ajo të ketë nevojë, e ky realitet nuk është vetëm sot i tillë, ishte edhe në vitin që shkoi, e edhe më herët.

Çka do të bëjë Qeveria për të siguruar bukën për qytetarët me 0.97% buxhet të ndarë dhe nga këto, ku 3.8 milionë shkojnë në shërbime këshillimore dhe vetëm 2.1 milionë në subvencionimin në kulturat bimore, 1.5 milionë për subvencion të blegtorisë, kur kemi parasysh se shumica e fermave të Kosovës ka falimentuar në mungesë të subvencioneve dhe atë jo subvencion për ushqime, por drejtpërdrejt për krerët e bagëtive. Premtimet e dhëna bujqve në prostatat e vitit të kaluar as për së afërmi nuk mund të plotësohen kur bëhet fjalë për subvencionimet e kërkuara nga ata. Sidomos atyre iu premtua subvencionimi i kamatave nga bankat, kur ata kërkuan këtë të drejtë, kur ata kërkuan fillimisht me të drejtë një bankë agrare, e në buxhet nuk figuron një subvencionim i tillë.

Edhe këtë vit, me këto subvencione të pakta, rrezikojnë të mbillen sipërfaqe të pamjaftueshme të grurit, e që i bie se në vitin tjetër do të kemi të korrura të pakta dhe, rrjedhimisht, varësia nga Serbia për bukën do të vazhdojë edhe në vitin tjetër. Qysh tash po e shohim pra rezultatit e negociatave.

Kur flasim për pyllëzimin, në vitin e kaluar shumë e bujshme ishte fushata – çdo qytetar një fidan, një fidan i mbjellë. Fushatë kjo e cila mbeti me ato fidanët e mbjellë në ekran, me ca të tjera që nuk e kalon numrin katërshifror. E kur e kemi parasysh shkatërrimin e pyjeve që ndodh çdo ditë dhe gjendjen e mjerueshme të pyjeve, gjendje kjo që nuk mund të riparohet pa trajtim serioz shumëvjeçar, Qeveria ndanë 200 mijë euro për pyllëzim, që është sa një e treta e Fondit për rroga të APK-së.

Zyrtarët nga Ministria e Bujqësisë na arsyetohen se po të kishim buxhet më të lartë, nuk do të mund ta shpenzonim për shkak se kemi mungesë të kapaciteteve absorbuese të

buxhetit. Dhe kjo mund të jetë, ndoshta është e pabesueshme, por po e zëmë se pse është ashtu. Rritja e fondit për subvencionim, kjo së paku nuk do të mund të bëhej. Me 50 euro për hektar, si i llogarisim këto 2.1 milionë euro, nuk ka stimulim për mbjellje të grurit dhe tjetra e parashikueshme ishte gjendja sot, dhe pse nuk punuat që në vitet e mëhershme për të arritur këto kapacitete që sot ne të kemi mundësi të kemi buxhet më të lartë.

Në anën tjetër, Ministria e Transportit ka kapacitete që t'i shpenzojë 276.9 milionë euro. Kur flasim pastaj për Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, duke e pasur parasysh nivelin e ndotjes në Kosovë dhe përkeqësimin e vazhdueshëm të gjendjes, Kosova gjithnjë e më e ndotur është çdo ditë, dhe ne kemi zbritje të buxhetit kësaj Ministrie në 0.61%.

Në Projektbuxhet përmendet rregullimi i shtratit të lumit Mirusha dhe Bistrica në Prizren. Është krejtësisht në rregull, është shumë e natyrshme që të rregullohet sepse është tejet e nevojshme që të rregullohen shtretër të lumenjve dhe të pastrohen lumenjtë e Kosovës për shkak të ndotjes, mirëpo këta dy lumenj pastrimi i tyre është tejet, tejet diçka simbolike me nivelin e ndotjes që Kosova sot e ka. Nuk trajtohen askund. Mbetjet industriale nëpër Kosovë, ku vetëm në Mitrovicë sot janë 70 milionë tonë. Nuk ka asgjë, as në aspektin e ndërgjegjësimit të qytetarëve për ambientin.

Pra, ajo që do të ishte e pranueshme kur është në pyetje buxheti, është larg prej këtij që trajtojmë neve sot. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nëse jeni dakord, e shqyrtojmë mundësinë që ta kryejmë sonte debatin, t'i zvogëlojmë diskutimet në 5 minuta, ose kush i ka fjalët e shkruara, të tërhiqet, të dorëzojë materialin dhe të votojmë. A jeni dakord që të shkojmë me 5 minuta. Hajde, shkojmë në votim, pra.

Kush është për, që debati – diskutimet të jenë 5 minuta? Faleminderit!

A ka kundër? Faleminderit!

Shumica ishin “për” dhe tani e tutje diskutimet janë nga 5 minuta. S’pati nevojë për t’i numëruar, se votat u panë.

Fjalën e ka deputetja Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Nga diskutimet që u bënë sot në këtë seancë, të gjithë e pamë se ky projektbuxhet i përpiluar, i hartuar nga Qeveria, në shpenzimet kapitale, në projektet kapitale u pa që kishte projektuar këtu mbi 70% projekte që ishin në vazhdim. Me një fjalë, çka do të thotë kjo? Kjo Qeveri vetë ka projektuar që të punojë për dje, do të thotë mbi 70% sot punon për dje. Çka donë të thotë, punët janë duke ecur përpara.

Komuna e Gjakovës është një ndër komunat e Kosovës e cila nga lufta e fundit doli me shkatërrimet më të mëdha ekonomike, në njërën anë, dhe me shkatërrimet dhe humbjet më të mëdha njerëzore, në anën tjetër.

Përkundër përpjekjeve të vazhdueshme të qeverisë lokale atje për përmirësimin e infrastrukturës dhe të jetës së qytetarëve në përgjithësi, komuna ka ngecje të theksuara në zhvillimin ekonomik, e gjithë kjo si pasojë e mospërkrahjes së mjaftueshme të institucioneve të Kosovës, përkatësisht Qeverisë së Kosovës.

Ndonëse Gjakova ju gëzohet shumë investimeve gjithandej komunave tjera nëpër Kosovë, anashkalimi që ju bëhet rreth 160 mijë banorëve të komunës së Gjakovës është i papranueshëm. Ky anashkalim bëhet kryesisht nga Qeveria e Kosovës, sepse kjo qeveri vazhdimisht i ka premtuar kësaj komune për një përkrahje më të madhe, gjë që nuk ka ndodhur. Për këtë të dhënë flasin më së miri projektet të cilat nuk kanë gjetur përkrahje nga Qeveria as në projektbuxhetin për të cilin po debatojmë sot. Po i përmendi vetëm disa prej tyre.

Premtimet e bartësve të institucioneve, duke filluar nga ish presidenti dhe kryeministri i vendit për ndërtimin e kompleksit memorial në Meje, ku më 27 prill të vitit 1999 ndodhi masakra më e madhe në Kosovës, kanë mbetur vetëm në nivelin e premtimeve. Projekti edhe sot e kësaj dite ndodhet në zyrën e kryeministrit dhe të njëjtin nuk e shohim as në projektbuxhetin e këtij viti. Është vërtet e dhimbshme që qindra familjarë të asaj ane, që lirisë së Kosovës ia falën më të dashurit e tyre, edhe këtë vit do të jenë të anashkaluar dhe të injoruar nga kjo qeveri.

Pastaj, për kryeministrin që kur po vjen po bën pak publicitet dhe nuk po mund të rri në një vend, po ia rikujtoj se vitin e kaluar, përkatësisht në muajin nëntor, në inaugurimin e punimeve në lagjen Ali Ibra në Gjakovë, në një takim që ka pasuar pas atij inaugurimi me kryetarin e komunës, i ka premtuar që do të bashkëfinancojë në projektin për tri hyrjedaljet e kësaj komune në vlerë prej 25 milionë, vlerë e pa përbalueshme për komunën e Gjakovës dhe, mbi të gjitha, sipas sugjerimeve të tij është thirr edhe mbledhja e kuvendit dhe në momentin e fundit është anuluar kjo mbledhje për shkak të angazhimeve që kishte kryeministri në atë kohë dhe kjo marrëveshje nuk ka ndodhur asnjë herë, pra ka mbetur me ato premtimet e fushatës.

Në anën tjetër, në tabelën 3.2 tek projektet kapitale të nivelit qendror përmenden ndërtimi i shkollës së mesme në Gjakovë dhe asfaltimi i rrugës Guzë-Devë, projekti i paraparë pra, siç thashë edhe më herët, që të dyja në vazhdim, por mbi të gjitha, rruga Guzë – Devë është një projekt i përbashkët i Ministrisë së Transportit dhe komunës së Gjakovës, marrëveshje e nënshkruar më 12 nëntor 2009, do të thotë projekt që ka filluar që më 2009 dhe sot e kësaj dite është i pa përfunduar.

Gjithashtu, edhe rruga Batushë-Koshare, ku ndodhen varrezat e dëshmorëve të kombit, e filluar tash e 3 vite, ende është e pa përfunduar, ndërsa nuk shohim se është paraparë në këtë projektbuxhet asnjë cent për këtë rrugë. Sa për dijeninë tuaj, tash e disa vite, si pasojë e mungesës së kësaj rruge, nga familjarët e dëshmorëve ka pasur nisma edhe për tërheqjen e dëshmorëve për t'u rrivarosur nëpër vendlindjet e tyre.

Në komunën e Gjakovës, në verën e vitit 2009 shumë hektarë të mbjellë nga kultura bujqësore u dëmtua nga breshëri. Gjithashtu, edhe në korrik të vitit 2010 më shumë se 1316 hektarë tokë e mbjellë me kultura bujqësore u dëmtua skajshmërisht nga breshëri. Dëmet, sidomos në vitin 2010, ishin të konsiderueshme, pra diku përafërsisht sipas ekspertëve, mbi 927.540 euro. Kompensimi i këtyre dëmeve në këto dy vite nuk u bë në asnjë cent, edhe pse ...

(Ndërprerje)

KRYETARI: Faleminderit deputete! Hajde, një minutë, deputetes!

TEUTA HAXHIU: Edhe pse pajtohemi që investimet dhe kompensimet janë bërë në komunat e tjera, në komunën e Gjakovës, me aq shumë dëme, nuk është bërë ky kompensim i tillë.

Dhe, një gjë e tillë, për t'ia rikujtuar edhe një herë Qeverisë, anashkalimit që është bërë në këtë projektbuxhet, këtij anashkalimi nuk i ka shpëtuar as komuna e Junikut. Komuna e Junikut, e cila është një komunë e re, në grandet stimuluese për komunat e reja Graçancia përfiton rreth 3 milionë euro. Dhe, merreni me mend, komuna e Junikut, si komunë e re, asnjë cent. Kjo bëhet për të privilegjuar shumë qytetarët, që nuk janë asnjëherë të barabartë në Kosovë. Dhe, në projektbuxhetin e Kosovës gjithashtu kjo komunë ka kërkuar dy projekte, që Qeveria i ka premtuar që do t'i përkrah, por nuk janë paraparë.

Dhe, për ta përfunduar, kjo qeveri në këtë projektbuxhet tregon edhe një herë se nuk ka program të balancuar për komunat e Kosovës dhe nuk ka qasje të njëjtë për rritjen e mirëqenies së qytetarëve në mënyrë proporcionale.

(Ndërprerje)

KRYETARI: Faleminderit, deputete! Fjalën e ka deputetja Valbona Dibra.

VALBONA DIBRA: I nderuar kryetar i Kuvendit,
I nderuar Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Projektbuxheti për vitin 2011, i dorëzuar nga Qeveria e Kosovës në duart tona ditë më parë, tregon të ketë rritje si në të hyra, ashtu edhe në shpenzime, krahasuar me buxhetin e vitit 2010. Të hyrat rezultojnë të kenë rritje mbi 12% apo 138 milionë, ndërsa shpenzimet kanë rritje mbi 19%, gjegjësisht 232 milionë.

Planifikimi i këtyre të hyrave është bazuar në përmbushjen e planeve vjetore të dy institucioneve më të rëndësishme të mbledhjes së të hyrave, doganës dhe administratës tatimore.

Kjo rritje e të hyrave është edhe si rezultat i luftimit të ekonomisë jo formale. Është shumë e rëndësishme të ceket se në këtë projektbuxhet është përfshirë rritja e pagave për

mësimdhënësit, familjet e dëshmorëve dhe invalidëve të luftës për 50%, për Policinë e Kosovës 40%, për shërbyesit civilë, shërbimin korrektues, sektorin e shëndetësisë dhe zjarrfikësit 30%.

Rritja e pagave është një nga vendimet më të guximshme të Qeverisë së Kosovës. Kjo rritje e pagave është një motivim për punëtorët që padyshim do të ndikojë në ngritjen e performancës dhe po ashtu ndikon në përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve.

Ne jemi dëshmitarë që kohëve të fundit po diskutohet se ngritja e çmimeve po ndikon në devalvimin e pagave edhe pse të ngritura. Kjo, sipas mendimit tim nuk qëndron, nuk është e arsyeshme për faktin se ngritja e çmimeve nuk është duke ndodhur vetëm në Kosovë, por në nivel botëror.

Raporti i muajit mars, konkretisht i datës 3, i Organizatës Botërore të Ushqimit FAO, tregon për rritje të çmimeve të disa produkteve ushqimore deri në 70%, krahasuar me shkurtin e vitit 2010. Prandaj, rritja e pagave është rritje e domosdoshme për shërbyesit e Kosovës, është rritje për mësuesit tanë, për policët tanë, për invalidët e luftës, për ata që i shërbejnë Kosovës, për ata që i shërbyen Kosovës atëherë kur iu nevojiti më së shumti, për ata që i shërbejnë Kosovës çdo ditë.

Çështje tjetër shumë e rëndësishme është vazhdimi i projektit kombëtar autostrada Morinë – Merdar, për të cilën në këtë projekt janë planifikuar 225 milionë.

Për mua, si ekonomiste, dhe besoj për secilin prej neve këtu, ndërtimi i infrastrukturës rrugore është njëri nga parakushtet kryesorë të zhvillimit ekonomik të një vendi. Me këtë dua të them se nuk ka projekte të mëdha, por vendime të mëdha. Autostrada është një vendim i madh dhe një mburrje e madhe për gjithë popullin e Kosovës.

Pikë tjetër po ashtu shumë e rëndësishme, është subvencionimi i sektorit të bujqësisë. Kjo ndërlidhet me faktin që çmimi i drithërave, produkteve ushqimore është ngritur në tërë botën dhe pikërisht ky projektbuxhet stimulon prodhimin vendor me subvencionimin e disa sektorëve të rëndësishëm të bujqësisë në Kosovë.

Duke marrë parasysh të gjitha që u cekën më lartë, ftoj të gjithë kolegët deputetë që ta përkrahin dhe njëkohësisht ta votojnë këtë projektbuxhet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ali Sadriu, le të përgatitet deputeti Afrim Kasolli.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

U tha shumëçka dhe unë mendoj ta shkurtoj diskutimin tim nga ajo që isha i përgatitur ta them.

Çdo punë, çdo proces, çdo lojë që hyn pa rregulla, rezultatet janë të vogla dhe sjell komplikime të mëdha.

Vetvetiu që i hyhet një procesi, siç është drafti për buxhetin, pa rregulla, janë të natyrshme të gjitha këto që unë dëgjova këtu dhe më vjen keq që kanë dëgjuar edhe të tjerët.

Unë kam menduar se ka kaluar koha kur buxheti hartohet pa një kornizë afatmesme, që do të jetë një orientim, një kornizë që ka të paraparë vizionin për të gjitha resurset dhe mundësitë e zhvillimit të kapaciteteve tona, në të i ka edhe prioritetet.

Buxheti është politik, por buxheti është edhe profesional dhe çdo ndërhyrje e cilës do në tjetrën, shkakton çrregullime.

Unë po vërej këtu se ka ndërhyrje, ka ndërhyrje dhe si mund të bisedojmë për një proces zhvillimor, kur kontestohen kufijtë buxhetor. Kufijtë buxhetor nuk duhet t'i takojnë tërësisht politikës. Politika duhet të japë vizionin, profesionalistët janë ata që në bazë të parametrave makro - ekonomikë vijnë deri te kufijtë buxhetorë. Ato përcillen gjatë gjithë vitit fiskal, ndërsa në vitin vijues, nga janari deri në prill, ata prezantojnë indikatorët makro - ekonomikë dhe Ministria e Financave, në bashkëpunim me Qeverinë, do të duhej që t'i hartojë kufijtë buxhetorë dhe t'i diskutojë edhe me partnerët ndërkombëtarë, në këtë rast Fondin, Bankën, por edhe të tjerë të cilët janë të kyçur në këtë proces.

Korriku, duhet t'iu themi lamtumirë kufijve buxhetorë, pra aty ku i kemi të siguruar sa do të jenë pagat, sa do të jenë mallra e shërbime, sa do të kemi investime kapitale, sa do të kemi subvencione. Po t'i kishim bërë na këto, dhe unë besoj se janë bërë, diku në shtator ka qenë një marrëveshje, ne nuk do të ishim këtu.

Pjesa politike, po ashtu shumë e rëndësishme, është shumë normale, çdo qeveri duhet ta implementojë projektin e vet, por projektin duhet ta harmonizojë me kornizën afatmesme, qoftë edhe në privatizime, qoftë edhe në procese tjera dhe nuk guxon të ketë ndërhyrje në vitin fiskal, si ky rast, shitje e njëhershme. Çka kuptojmë prej saj, kush mund ta sqarojë atë, çka mund të themi nëse thuhet - në tetor pagat do të jenë kaç? Unë në periudhën prej shtatorit deri në fund të vitit e kuptoj si një ring, ku kryeministri dhe ministri i Financave duhet ta luajnë rolin e referit, ndërsa ministrat duhet të garojnë se cilët prioritetë duhet të jenë dhe të kenë prioritet karshi të tjerëve.

Këtë nuk po e shoh unë, e pash pak. Po të kishte ndodhur kjo, do t'i kishim trajtuar ndryshe problemet.

Kjo qeveri ka dhënë tri prioritetë, ka dhënë zhvillimin ekonomik, ka dhënë qeverisjen e mirë dhe ka premtuar ngritjen e mirëqenies sociale.

Unë, në pika të shkurtra, meqë e kufizuat kohën, do t'ju them se sa është në funksion të kësaj. Si mund të flasim për një proces të qëndrueshëm të zhvillimit ekonomik, kur kemi këso ndërhyrjesh, kur këtë vit nuk e kemi qëndrueshmërinë fiskale, e të mos flas për vitet

tjera, ku Kosovën e presin sfida dhe më të rënda të kësaj natyre. Të gjithë ne, njohjet edhe më të thella të Kosovës, numerike, po edhe avancimin e FSK-së në ushtri, janë diçka që e presim si i verbëri sytë, por këto ne jemi të vetëdijshëm se kanë kosto buxhetore dhe a po mendojmë ne për një qëndrueshmëri, nëse mendojmë në këtë drejtim. Kudo të jenë, ato ambasada që do të blihen janë të kostos, a i kemi paraparë ne ato, sa i kemi paraparë ne ato?

Po dal te qeverisja e mirë. Në material është...

(Ndërprerje)

KRYETARI: Hajde, edhe një minutë, regjia!

ALI SADRIU: Në projekt material e kemi se për investimin e rrugës – autostradës janë të parapara për këtë vit 225 milionë, a është kështu, zoti ministër? Kryeministri këtu na thotë se ka 250 milionë, unë e kuptoj ku i ka, se i ka lënë edhe 23 milionë i ka lënë atje për eksproprijim dhe mund t'ua marrin njerëzve tanë, se ata s'kanë çka bëjnë, bëjnë poterë, a ia prishim livadhin, a ia prishim shtëpinë, s'është me rëndësi shumë, do t'i rrimë atij investitori karshi, pastaj është e paraparë në nenin 14 që të ketë ndërhyrje buxhetore, të hyhet në xhepa të tjerëve dhe të merret e të qitet diku tjetër, nën arsyetime të caktuara, që unë mendoj se është skandaloze dhe s'duhet lejuar, prandaj nga këto vrime sigurisht ai mendon që do ta plotësojë dhe do ta plotësojë, por ky mentalitet i takon mentalitetit të kaluar, si dhe....

(Ndërprerje)

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Vazhdojmë! Jam dakord, por mendoj që t'i përmblihdni fjalët në 5 minuta dhe janë të mjaftueshme. Fjalën e ka deputeti Afrim Kasolli.

AFRIM KASOLLI: I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Projektligji i buxhetit të Kosovës, i hartuar nga Qeveria e Kosovës për vitin 2011, ashtu si në shumë sfera të tjera të jetës shoqërore dhe ekonomike edhe në fusha që prekin atë të mirëqenies sociale, arsimit dhe kulturës, vuan nga një sërë deficitesh përmbajtjesore. Kështu, skema e propozuar e buxhetit për Ministrinë e Mirëqenies Sociale nuk ofron asnjë bazë adekuate për zbutjen dhe tejkalimin e gjendjes së mjerë sociale dhe ekonomike për shumicën e grupeve të rrezikuara sociale që jetojnë buzë greminës jetësore, madje për më tepër, ajo nuk ofron asnjë vizion për shtegdalje nga kriza sociale sepse në të vërtetë Kosova më shumë se sa në krizë ekonomike është edhe në krizë sociale.

Këtu vlen të përmendet një fakt ku sipas Entit të Statistikave, në krahasim me vitin e kaluar, çmimi i bukës është rritur për 42%, vajrat dhe yndyrat 47%, sheqeri afër 25%, pemët për 11%, kafja 12% e me radhë. Me këtë shtrenjtimi mesatar është afër 15 për qind për të gjitha produktet e konsumit ushqimor në këtë periudhë. Kështu, kjo rritje astronomike e çmimeve tregon se në fund të fundit edhe aty ku është premtuar se do të

ketë ndonjë rritje të ardhurave të shtuara, si të tilla nuk do të përkthehen në rritje të mirëqenies por thellim të varfërisë, pra në këtë kuptim më shumë këtu se për mirëqenie sociale kjo qeveri përkujdeset për mirëpasjen e shpurës politike qeveritare.

Shqetësim tjetër po ashtu mbetet edhe premtimi manipulativ për rritje të të ardhurave për shtresën e pensionistëve, që në të vërtetë ky vendim nuk është paraparë në mjetet financiare, nuk janë paraparë për implementimin e këtij vendimi. Me këtë rast, kjo qeveri tregon se sa e pa përgjegjshme është përballë kësaj shtrese të rrezikuar të shoqërisë, veçanërisht kur kihet parasysh fakti se këto të ardhura për vitin 2008 nuk janë rritur për asnjë cent, për vitin 2009 vetëm për 5 euro, kurse për vitin 2010 për asnjë cent, gjë që do të ndodhë edhe në këtë vit.

Po ashtu, buxheti i Qeverisë sa i përket politikës sociale nuk është fare transparent. Ai përmban shifra sa i përket shpenzimeve për çështje të ndryshme, por këto shifra nuk lejojnë asnjë mundësi për kritikë fundamentale për shkak se mungojnë disa të dhëna themelore, si për shembull, sa pensione do të ndahen në vitin 2011, sa pensione marrin pjesëtarët e TMK-së, sa pensione marrin invalidët e luftës, në bazë të cilave kritere është përcaktuar lartësia e pensioneve e kështu me radhë. Kjo formë e buxhetit i mundëson Qeverisë t'i përdorë mjetet sipas dëshirës dhe nevojave të partisë në pushtet e jo duke u bazuar në gjendje dhe nevojat aktuale. Për shembull, administrata qendrore me 60 punonjës shpenzon për mallra dhe shërbime 78.676 euro. ndërsa zyra e ministrit me vetëm 8 punonjës shpenzon për mallra dhe shërbime 60.000 euro, del se sikur 8 punonjësit e zyrës së ministrit jetojnë në Gjermani, kurse 65 punonjës të administratës qendrore, në Kosovë.

Në anën tjetër, përkundër sloganit të njohur, si të qeverisë së kaluar, ashtu edhe të kësaj qeverie se mbetet e përkushtuar për të ndërtuar një shtet të dijes, megjithatë praktika e kësaj qeverie e shprehur si në programin qeveritar, ashtu edhe në projektbuxhetin për vitin 2011, qëndron në shpërputhje të plotë me këtë slogan të sipër cekur, i cili si i tillë madje ishte huazuar dhe përvetësuar në mënyrë tejet naive nga skemat narrative të një mendësie pseudo-iluministe, me ç'rast në shumëçka ky model anakronik nuk përkon aspak me trende dhe raporte të dijes në kontekstin e zhvillimeve aktuale pistemike.

Prandaj, konfuzioni dhe jo transparenca e karakterizojnë edhe buxhetin e Ministrisë së Arsimit sa i përket këtij buxheti. Shikoni vetëm shembullin me shifrat 11029/208155-094959/6, ndërtimi i shkollës së mesme në Prishtinë, çmimi 235.863 euro. Parashtrohet pyetja, cila është ajo shkollë, gjimnaz, ekonomike, bujqësore apo çka tjetër. Shikoni po ashtu edhe një shembull tjetër 10572/208112-0732302/6, ndërtimi i objektit të shkollës së mesme të muzikës, këtu nuk është caktuar vendi se ku do të ndërtohet kjo shkollë, vetëm se janë parashikuar 600.000 euro. Nga këta shembuj të krijohet përshtypja sikur Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë është më tepër kompani ndërtimore, se sa ministri që merret me sigurimin e cilësisë si në mësimdhënie, ashtu edhe në mësimnxënie.

Dëshpërues në këtë buxhet po ashtu mbetet edhe fakti se instituteve iu mungon buxheti për realizimin e projekteve kërkimore, shkencore dhe veprimtarinë botuese, buxhet ky i cili parashihet me nenin 66 faqe 44 të Ligjit mbi veprimtarinë shkencore, pra e para, ky

buxhet shkel standardet ligjore sa i përket investimit mbi veprimtarinë shkencore dhe, e dyta, injoron pikërisht ato hallka themelore të arsimit ku sot prodhohet dija, sepse sot jemi dëshmitarë të trendeve që janë pikërisht institutet ato që e prodhojnë dijen, kurse sa i përket Universitetit të Prishtinës, buxheti total është i afërt me atë të vitit 2010, 15 milionë e 500...

(Ndërprerje)

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Po, deputet, ne u morëm vesh për 5 minuta... Vazhdojmë! Deputetja Duda Balje e ka fjalën.

DUDA BALJE: Zahvaljujem, gospodine predsedniče!

Poštovani vladini ljudi,

Poštovani poslanici,

Budžetska projekcija koja stoji ispred nas se može slobodno nazvati realnom ako se uzmu u obzir svi ekonomski ...i svi činioци u našoj zemlji, ali da napomenem da u svim zemljama u regionu i šire stanje nije bitno drugačije.

Predlog budžeta o kome raspravljamo poseduje vidan srednjoročni okvir u kome se navodi vladina fiskalna strategija i prioritetne politike i planovi potrošnje svih sektora pojedinačno.

Budžetski programi su u skladu sa usklađenim prioritetima čitavog društva. Kao primer navešću sektorske strategije koje su vrlo značajne za čitavu zemlju, zatim strateški planovi i drugo.

Uočava se vidno finansiranje pojedinih novih prioritetnih predloga potrošnje u cilju realizacije izvesnih lociranih ciljeva i u ošteta ostvarena ukidanjem ili smanjivanjem potrošnje na programe nižeg prioriteta ili nedovoljno učinkovitih programa.

Dakle, imamo budžet koji predstavlja ažuriran izveštaj o makro-ekonomskom i fiskalnom stanju, uključujući i makro - ekonomske i fiskalne projekcije. Mislim da smo svi jednako svesni potreba i urgentnosti usvajanja budžeta. Rečeno je da je Nacrt budžeta otvoren za prihvatljive modifikacije, a zatim za usvajanje, koje smatram kao najhitnije i najbitnije za našu državu. Zahvaljujem!

KRYETARI: Faleminderit! Hydajet Hyseni e ka fjalën. Le të përgatitet Sali Morina.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë e ministra,

Ju përshëndes, e përshëndes edhe këtë debat, sado që i vonuar dhe kjo vonesë determinon edhe qasjen edhe tonet, natyrisht. Po, deshëm të bëjmë qeveri e të prishim qeveri, të bëjmë zgjedhje e të prishim zgjedhje dhe u detyruam tani të diskutojmë për buxhetin tre muaj me vonesë. Dhe, duke pasur parasysh këto, mendoj që duhet votuar këtë buxhet. Edhe është punuar, marrë parasysh rrethanat, mirë, mendoj, prandaj mendoj që duhet votuar, po a ka vend për vërejtje, mendoj se po ashtu ka vend për vërejtje.

Do t'i them disa prej tyre. Së pari, edhe për mua nuk është lehtë e kuptueshme kjo ndërlidhja e çështjes së privatizimit, siç po themi, të postës me çështjen e buxhetit.

Së pari, unë zor e kam edhe ta kuptoj që është tamam privatizim, sepse privatizim do të ishte nëse bëhet privatizim i brendshëm, nëse mbetet megjithatë në Kosovë. Kësaj i thonë shitje. Dhe, po e përsëris, nuk më duket logjike që të shitet, si të thuash, të pritet pema për t'ia marrë frytet. E di që dikush do të më thotë, po, është e domosdoshme, na kanë thënë miqtë, na ka thënë zonja Hilari Klinton dhe dua ta theksoj se është shtrembëruar fjala e zonjës Hilari Klinton dhe çuditërisht as mediat nuk e kanë theksuar sa e si duhet. Porosia ka qenë e qartë, të privatizohen, anglisht – an efficient public companies. Kompanitë publike joeficiente. A është joeficiente posta, zonja e zotërinj? Nuk është. Dhe, të gjithë parametrat tregojnë se posta në Kosovë nuk mund të jetë jo efiçiente. Kemi po thuaj se gjysmën e popullsisë jashtë dhe hiq s' duhet të jesh ekspertë për të ditur se ajo do të ishte suksesshme. Fundja, pse do ta blinin të huajt nëse ajo do të prodhonte humbje?

Po, përveç tjerash, pse të lidhet kjo, e çka nëse ndërlikohet eventualisht shitja, është proces që s'mund të prejudikohet krejtësisht. Për më tepër, mendoj që kësaj i thonë pastaj - tigani në zjarr, e zogu në rremë. Do të ishte më mirë të ndahen këto çështje.

Po ashtu, një dilemë që jam i lirë ta them. Nuk e kuptoj, edhe përkundër gjithë atyre shpjegimeve që i kemi dëgjuar, pse vetëm autostrada jonë në këtë regjion duhet të bëhet me forca vetanake. Të gjitha pothuaj se janë bërë me burime të jashtme, kurse më shumë se ne do të qarkullojnë mallra të huajve, apo jo. Pse të mos provonim që megjithatë edhe ne të përfitonim, siç kanë përfituar të tjerët për rreth.

Megjithatë, vërejtjet, dilemat mbeten. Kam një..., telegrafikisht po i them, nuk më duket e drejtë që buxheti i Ministrisë së Jashtme të zvogëlohet, mendoj që së paku do të duhej ruajtur niveli. Kam parasysh edhe disa ndryshime që janë bërë, por s'më duken të mjaftueshme.

Mendoj, në Ministrinë e Arsimit do të duhej shqyrtuar sidomos pozita e shkencës. Këto ditë dëgjuam, ta zëmë, se pagat në Institutin Albanologjik të punonjësve shkencorë janë më të vogla se të arsimtarëve të shkollave fillore. A ka kuptim?

Dhe, një çështje që mendoj po ashtu do vëmendje të veçantë, është fusha e drejtësisë dhe ajo që është quajtur drejtësia tranzicionale. Mendoj që legjislacioni që është miratuar në Kuvend edhe obligon Qeverinë që të nxjerrë aktet nënligjore adekuate dhe të krijojë infrastrukturën për rregullimin, përveç tjerash, edhe të padrejtësive të së kaluarës, çështje që të gjitha vendet e kanë bërë dhe ne kemi mbetur.

Unë vij nga Gjilani me origjinë dhe jam i obliguar të theksoj edhe një fakt, një diskriminim që po i bëhet Gjilanit dhe gjithë Anamoravës. Madje, edhe në përfaqësim.

Ferizaj, Gjilani, Vitia, Kaçaniku, Kamenica nuk kanë asnjë ministër dhe jo vetëm kaq, por nuk kanë as projekte si vendet tjera. Pse kjo? U bë tepër, zonja e zotërinj. Dhe pse të mos ishte kjo rruga që insistohet me çdo kusht të shkojë deri në Merdarë, pse të mos shkonte në Preshevë dhe kjo pastaj të kishte edhe funksione tjera, që megjithatë do t'i ketë. As Presheva nuk është e trajtuar si e sa duhet.

Gjilanit i duhet mbështetje për projektin që është vital edhe për jetën, edhe për shëndetin, për lumin Mirusha dhe mendoj që Qeveria e ka mbështetur atë projekt, është përruar disa herë, prandaj s' duhet lënë në gjysmë.

Për të mos u zgjatur, ju falënderoj dhe pres që këto të merren parasysh dhe ato që merren parasysh, me këto vërejtje dhe me ato që u thanë, unë e mbështes buxhetin. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Aurora Bakalli e ka fjalën.

(Ndërhyrje)

KRYETARI: Sali Morina, pastaj ti Aurora.

SALI MORINA: I nderuar kryetar i Kuvendit,
Të nderuar kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Do të fokusohem në dy çështje, do të thotë lidhur me çështjen e Ministrisë së Mjedisit dhe po ashtu çështjen e Ministrisë së Bujqësisë, sepse jam nga ai komision.

Çështja e mjedisit në Kosovë edhe për se është alarmante, nuk renditet në mesin e prioriteteve të Qeverisë. Kjo është e dukshme nga ndarja e buxhetit, ku për çështjet e mjedisit buxheti është në rënie nga viti në vit. Për derisa në tërë botën për çështjen mjedisit dhe ndryshimit klimatike çdoherë e më tepër është duke iu dhënë prioritet.

Qeveria me këtë ndarje të buxhetit për fushat e mjedisit nuk përkon me prioritetin numër një të Qeverisë – integritet evropian, përderisa në Evropë mjedisi është një ndër prioritetet e para, kurse në Kosovë është prioriteti i fundit. Është e vërtetë që mjedisi nuk duhet të jetë vetëm preokupim i Qeverisë, por i të gjithë qytetarëve, mirëpo Qeveria nuk duhet të kontribuojë në situatën aktuale jo të mirë të mjedisit duke licencuar eksploatuesit e zhavorrit në shtretërit e lumenjve, gurthyesit, prerjen e pyjeve pa menaxhim të mirëfilltë, lejimin e ndërtimeve të egra në tokat pjellore, ndotjen e ujërave nga mos trajtimi i ujërave të zeza apo edhe lejimi i ndërtimit dhe ofrimit të kompanive të ndryshme për vlerësimin e mirëfilltë të ndikimit të tyre në mjedis. Ne shquhemi për miratimin e strategjive dhe të ligjeve të avancuara në fushën e mjedisit, por vuajmë nga implementimi i tyre në praktikë dhe kjo është si pasojë - buxheti i pamjaftueshëm për këtë ministri.

Toka e bukës e kthyer përmbys nga ndërtimet e egra, malet e zhveshura nga prerjet e egra të pyjeve, lumenjtë e shkatërruar dhe ato ujëra të ndotura detyrojnë Qeverinë që të marrë urgjentisht masa ndaj këtyre shkaktarëve.

Nëse ne nuk e degradojmë tokën e bukës dhe stimulojmë punën e saj, atëherë ne nuk do të kemi nevojë që të importojmë grurë dhe miell nga vendet e regjionit, kryesisht nga Serbia dhe Maqedonia, por si rrjedhojë nuk do të kishte nevojë të shtrenjtohet buka sot në Kosovë, e cila në krahasim me vitin e kaluar do të thotë është e dyfishuar.

Toka nuk është kah degradohet e pakohet vetëm nga ndërtimet e egra, mirëpo nga eksploatimi i zhavorrit në shtretërit e lumenjve dhe prerja e pyjeve është kah mundësohet erozioni dhe vërshimet në tokat e pëlleshme. Kjo duhet të ndalet.

Një problem tjetër është alarmante edhe niveli i ndotjes së ajrit kryesisht në Prishtinë dhe qytetet përreth termocentralit, si Obiliqi dhe Fushë Kosova. KEK-u për këto vende prodhon më tepër ndotje se sa rrymë.

KEK-u si ndotës më i madh në Kosovë duhet të qeveriset me përgjegjësi dhe duhet të bëjë më shumë e më tepër për të mos ndotur ajrin në Kosovë. Qytetarët po paguajnë rrymën, por jo edhe ndotjen.

Në bazë të projektbuxhetit të propozuar, do të thotë, ndërmarrjet publike, është ndarë një shumë bukur e madhe nga ky buxhet dhe nga kjo Qeveri dhe kjo i bie që qytetari i Kosovës ta paguajë rrymën do të thotë dy herë, e para, si obligues i shpenzimit të rrymës dhe, e dyta, në kuadër të këtyre subvencioneve si taksapagues e paguan dy herë rrymën.

Resurset natyrore në Kosovë, fuqia e re punëtore dhe qasja e lirë dhe e afërt me tregun e Bashkimit Evropian sugjerojmë që Republika e Kosovës ka mundësi të mira për prodhimin dhe eksportimin e produkteve bujqësore, por në mungesë të buxhetit, kjo nuk ndodh.

Bujqësia gjithmonë ka qenë sektori kryesor në ekonominë e Kosovës, por ka shënuar rënie. Me rënien e produkteve bujqësore, deficiti tregtar i agro-ushqimit u rrit, duke e shkaktuar një bazë të dobët për konkurrencë. Importet e agro-ushqimit janë të mëdha dhe ende janë në rritje. Importet bujqësore nga partnerët tregtarë të Kosovës, të cilët përfitojnë nga prodhimi dhe subvencionet në eksport, i vë bujqit e Kosovës në situata të pa favorshme. Sektorit të bujqësisë i mungon një qasje adekuate në kredi, aktualisht ato janë, por me kamata shumë të mëdha dhe janë të pafavorshme për bujqit. Aktualisht, prodhimtaria dhe të ardhurat nga bujqësia janë të ulëta si rezultat i investimeve jo të duhura nga ana e Qeverisë dhe, realisht, do të thotë kërkesa ime ishte që për buxhetin e mjedisit të rritet ky buxhet dhe po t'i merr shifrat nga viti 2009, Ministria e Mjedisit ka pasur mbi 13 milionë euro buxhet, në vitin 2010 ka pasur mbi 11 milionë, ndërsa në vitin 2008 e ka një buxhet mbi 8 milionë.

Edhe në Raportin e progresit do të thotë është paraqitur në krahasim me ministrinë tjera sugjerim dhe kërkesë që buxheti për Ministrinë e Mjedisit duhet rritet dhe duhet të jetë

prioritet. Dhe, njëkohësisht, po ashtu edhe për Ministrinë e Bujqësisë si buxhet i tillë është i pamjaftueshëm, sepse po qe se e merr në total të buxhetit të Qeverisë, del se Ministria e Bujqësisë ka më pak se 1% buxhet, ndërsa Ministria e Mjedisit ka shumë më pak sesa 1% buxhet. Prandaj, do të ishte mirë të kihen parasysh, sepse edhe si komision parlamentar ne kemi dërguar ...

(Ndërprerje)

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Aurora Bakalli!

AURORA BAKALLI: Faleminderit, i nderuari kryetar i Kuvendit, Kabinet qeveritar, Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës, Diskutimi im do të jetë i shkurtër dhe do të përqendrohem vetëm në sasinë e Projektbuxhetit të Qeverisë së Kosovës, të paraparë këtë vit për sektorin e shëndetësisë, i cili arrin vlerën prej rreth 79 milionë euro.

Nga këndvështrimi im si mjeke dhe duke qenë në rrjedha të një situatë shumë të rëndë në të cilën ndodhet aktualisht shëndetësia kosovare, konsideroj se ky buxhet i paraparë për shëndetësinë është i pamjaftueshëm.

Buxheti i shëndetësisë për vitin 2011 është rreth 6 milionë e 240 mijë euro më i lartë se ai i vitit të kaluar. Një rritje prej afër 6 milionë e 800 mijë euro shkon për paga dhe mëditje, ndërkohë që në Kornizën afatmesme të shpenzimeve për periudhën 2011 – 2013 nuk ka pasur planifikim për një rritje të tillë.

Rritja e pagave për punonjësit shëndetësorë padyshim se ka qenë e nevojshme duke pasur parasysh të ardhurat e tyre të ulëta, mirëpo për mua mbetet enigmatike pse një gjë e tillë nuk ka qenë e paraparë me Kornizën afatmesme të shpenzimeve, madje as deri në vitin 2013.

Në anën tjetër, e shoh shqetësues faktin se buxheti për shëndetësi i vitit 2011 parasheh një rritje të investimeve për mallra dhe shërbime për rreth 1 milionë e 700 mijë euro, ani pse sipas Kornizës afatmesme të shpenzimeve ka qenë e planifikuar një rritje në këtë segment për afër 3 milionë euro.

Shpenzimet kapitale kanë pësuar rënie nga rreth 10 milionë e 157 mijë në vitin 2010, në 7 milionë e 900 mijë për vitin 2011. Këta dy zëra buxhetor, pra mallra dhe shërbime, si dhe shpenzimet kapitale i shoh si kyç në kuptim të përmirësimit të cilësisë së shëndetësisë dhe konsideroj se sasia e tyre përball një shëndetësie të rrënuar, çfarë është kjo e jona, alarmon edhe për një vit shumë të rëndë për shëndetësinë në Kosovë.

Nëse analizojmë sasinë e buxhetit që ndahet për shëndetësi në proporcion me buxhetin e gjithmbarshëm të Kosovës, del se ky buxhet paraqet 5.5% të buxhetit të përgjithshëm. Si mjeke, do të dëshiroja që kjo përqindje të jetë më e lartë. Por, për ta bazuar këtë dëshirë me arsye, kam analizuar se si bëhet kjo ndarje në vendet në rajon.

Bazuar në statistikat botërore të shëndetësisë të vitit 2010, të lëshuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, Qeveria e Shqipërisë ndanë 9.5% të buxhetit për shëndetësinë, ajo e Serbisë 13.2, e Bosnjës dhe Hercegovinës 13.5, e Maqedonisë 14.1%, e Kroacisë 17.6%, ndërsa e Malit të Zi 26.4%. Po ju rikujtoj edhe një herë, sasia – përqindja e paraparë për shëndetësi në projektbuxhetin të cilin e kemi para vetes është 5.5%.

Në anën tjetër, shpenzimet e Qeverisë sonë për kokë banori për shëndetësi vlerësohen të jenë rreth 45 dollarë amerikanë, vlerë kjo prapë shumë më e ulët se sa për vendet e sipër përmendura. Kështu, Qeveria e Shqipërisë shpenzon 101 dollarë amerikanë për shëndetin e një banori, ajo e Maqedonisë 182, e Bosnjës dhe Hercegovinës 225, e Serbisë 252, e Malit të Zi 314 dhe e Kroacisë 878 dollarë amerikanë.

Vetëm sa për ilustrim, në këtë drejtim prinë Qeveria e Luksemburgut, e cila investon 6.763 dollarë amerikanë për shëndetin e një banori. Ndërkaq, afërsisht sa Qeveria jonë..., në shëndetësi shpenzojnë edhe qeveritë e Azerbejxhanit, Bolivisë, Egjiptit, Irakut, Nikaraguas, Paraguait e Zimbabvesë.

Shifrat që prezantova para jush, konsideroj se janë pasqyrë e qartë e interesimit që shpreh Qeveria e Kosovës për përmirësimin e sektorit publik shëndetësor, sektor ky veçanërisht i rëndësishëm për popullatën tonë, ku papunësia arrin shifrën prej rreth 45% dhe varfëria e skajshme arrin deri në 15%.

Po të merrej seriozisht kjo situatë e rëndë në shëndetësi, konsideroj se do të duhej të trajtohej si e tillë dhe si hap i parë i domosdoshëm, padyshim që është ndarja e një pjese më të madhe të buxhetit për shëndetësinë, pra thjeshtë duke ndjekur shembujt e vendeve fqinjë, sepse u tha këtu më parë nga na ana e anëtarëve të kabinetit qeveritar se ne duhet t'i ndjekim shembujt e rajonit e të mos ikim më larg.

Pra, druaj se edhe këtë vit, kur buxheti për mallra dhe shërbime vazhdon të jetë i ulët, ne si punëtorë shëndetësorë do të vazhdojmë të përballemi me mungesën e madhe të barërave dhe materialit shpenzues në institucione publike shëndetësore ku punojmë.

Si duket, duhet të shpresojmë në mrekulli, që ta nxjerrim shëndetësinë nga mjerimi në të cilin gjendet sot. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Gëzim Kelmendi, le të përgatitet deputeti Elmi Reçica.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Fillimisht ju falënderoj dhe njëherësh për këtë tematikë e cila është shqyrtuar sot në Kuvendin e Kosovës, padyshim që është e një rëndësie të veçantë dhe kërkon një qasje serioze nga gjithë ne. Njëherësh përgëzoj Qeverinë për punë që ka bërë dhe vendimin që ka marrë për rritjen e pagave, kategori të cilat veç tash u përmendën, duke përfshirë arsimin, shëndetësinë, shërbimet publike, familjet e dëshmorëve dhe të gjithë të tjerët që

unë mos t'i përmendi me radhë tash, duke pasur parasysh kontributin e tyre që kanë dhënë dekada me radhë në Kosovë dhe njëherësh dhashtë zoti i madhëruar që ky vendim dhe kjo rritje të mos jetë vetëm e tanishme, por edhe në të ardhmen për arsye se kjo kategori e punëtorëve në nivel të Kosovës duhet që të arrijë, nëse jo t'i tejkaloj, së paku të nivelizohet me pagat e punëtorëve tjerë në rajonin për rreth Kosovës.

Unë çka desha të ngre këtë rast në Parlamentin e Kosovës, është se gjatë shqyrtimit të Projektligjit për buxhetin 2011, kam vërejtur gjithashtu se ndarja e buxhetit në nivel komunal pak sa është jo proporcionale. Në këtë rast duhet të ndalem edhe pikërisht nga komuna ku vij, një ndër komunat më të mëdha në nivelin e Kosovës, komuna e Pejës, konkretisht, ku shihet qartë se komuna e Pejës është barazuar me shumë komuna tjera më të vogla në nivel të Kosovës dhe buxheti i saj nuk i plotëson nevojat duke pasur parasysh se Peja ka kaluar një situatë të vështirë gjatë luftës dhe pas luftës, pasi që ka qenë një ndër qytetet më të dëmtuara në kontekstin material dhe në infrastrukturën e saj. Kështu që deri në shqyrtimin e dytë, kërkoj një mirëkuptim të plotë që edhe një herë të parashihet buxheti për komunën e Pejës, i cili është shumë më i vogël në raport me komunat të cilat janë proporcionalisht të afërta me komunën e Pejës. Faleminderit!

KRYETARI: Elmi Reçica.

ELMI REÇICA: Në emër të racionalitetit, unë po heq dorë, po e dorëzoj diskutimin me shkrim, zoti kryetar! Faleminderit!

KRYETARI: Mirë, faleminderit! Vazhdojmë! Atëherë fjalën e ka Nazane Breca.

NAZANE BRECA: Faleminderit, kryetar!

I nderuari kryetar,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Përkundër dëshirës së sinqertë, nuk pretendoj se do të mund të them diçka krejt të re në lidhje me shëndetësinë kosovare, vendin e saj në agjendën e Qeverisë së tashme apo gjendjen shëndetësore të popullatës kosovare me qenë se realiteti fatkeqësisht është po thuaj se aq i zymtë dhe aq i pa shpresë tash e më shumë se një dekadë.

Do të dëshiroja dhe do të isha sinqerisht shumë e lumtur sikur të bindesha se e kam gabim, por fatkeqësisht, shumë çka më bind se në fakt kjo është gjendja me të cilën pothuaj se jemi mësuar dhe në të cilën aq shumë jemi përshtatur apo, më mirë të them, jemi stërkequr sa ndryshimi i këtij komoditeti të rrejshëm na shqetëson dhe frika nga ndryshimet na përmban nga çdo lëvizje.

Refreni - shëndetësia është prioriteti i Qeverisë sonë, është po aq, në mos më tepër i konsumuar dhe de mode, sa edhe refreni - do të kemi rrymë 24 orë. Këto dy refrene që më shumë ishin parulla para zgjedhore e deri më sot, kanë edhe një të përbashkët të veçantë. Në fushatën parazgjedhore gjithmonë konstruktohen në kohën e ardhshme, deri sa me të ngritur në pushtet, sikur humbet kuptimi i kohës dhe mund të dëgjohen dhe konstruktohen vetëm në kohën e kaluar. Shkaktarët e këtij transformimi konceptual edhe

ngatërrimi kohor janë nga më të ndryshmet, por kurrë përgjegjësi e Qeverisë dhe e atyre që me slogane të tyre boshe rrëmbyen votat e zgjedhësve të ndershëm.

Përkundër optimizmit dhe energjisë me të cilën i është rrekur punës ministri i ri i Shëndetësisë, zoti Agani, propozim buxheti i Qeverisë së tashme nuk më jep asnjë shpresë se me këtë qeveri dhe me këtë ministër do të jetë më ndryshe. Rritja simbolike e buxhetit për shëndetësi bëhet krejt e pa rëndësishme dhe e pa vlerë, krahasuar me shkallën e frikshme të shtrenjtimit të kohës së fundit të produkteve elementare për jetë, që erdhën si reaksion për rrethanat tona natyrshëm në proklamimet krekosëse për rritje pagash. Kjo rritje është qesharake nëse krahasohet me premtime bombastike para zgjedhore për rritje të buxhetit për shëndetësi prej 30 deri në 100%. Natyrisht, do të thoni asgjë e re. Ato ishin vetëm premtime para zgjedhore, po pajtohem, le ta lëmë këtë në ndërgjegjen e atyre që kanë ndërgjegje.

Mungesa e plotë e vizionit të kësaj qeverie për kahe të zhvillimit të sistemit shëndetësor kosovar, mund të vërehet më së miri në distribuimin e kësaj shume simbolike të buxhetit për shëndetësi. Në vend që të ndiqet rruga e investimit të resurseve të kufizuara aty ku më së shumti dhe në mënyrë më të leverdishme zgjidhen problemet shëndetësore, pra në kujdesin parësor shëndetësor, ne vërejmë ulje të buxhetit në këtë nivel të kujdesit shëndetësor për 12%.

Madje as shoqëritë më të pasura të botës nuk i lejojnë vetes luksin e investimeve aty ku kanë qasje më pak individë dhe aty ku dobia është më e vogël dhe për një numër simbolik individësh, por logjika e mbrapsht e investimeve parapakisht të destinuara për t'u hedhur në pakshim, sikur është bërë logjikë e natyrshme pushteti, që kështu vazhdon lojën të sillemi sikur po bëjmë diçka dhe në këtë mes me siguri mbetet diçka edhe për ne.

Kjo logjikë e mbrapsht gjen mbështetje edhe më të fuqishme në uljet e ndjeshme të mallrave dhe shërbimeve për Inspektoratin Farmaceutik dhe Shëndetësor të Kosovës. Kjo e bën të pa qenë deklarativ dhe retorikë boshe përkushtimin dhe deklarin e kësaj Qeverie dhe Ministrisë së saj të Shëndetësisë për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore. Kush vallë do ta mbikëqyr këtë proces të gjatë, të mundimshëm dhe shumë sfidues, nëse investimet në dy inspektoratet kyçe për përmbushjen e këtij misioni do të privohen nga 14, respektivisht 20% të buxhetit të tyre të vitit paraprak edhe ashtu absolutisht të pamjaftueshëm, apo mbase pretendohet se kemi arritur atë shkallë pjekurie, kur nuk ka nevojitet mbikëqyrje dhe vetë kontrolli do të bëjë punën e vet. Të gjithë do ta dëshironim këtë, që fatkeqësisht sot duket krejt utopi.

Duket e bukur për sy dhe sakrificë fisnike ulja e buxhetit për shërbimet e administratës qendrore, mbase kjo ulje dhe uljet tjera në sektorët e lartpërmendur janë menduar për të mbuluar rritjen për 30% të pagave të punonjësve të shëndetësisë.

Kam frikë se llogaritja është bërë mbrapsht dhe logjika e zhvendosjes së peshores nga një sektor në tjetrin nuk do të prodhojë asgjë tjetër, pos zbehje edhe më të madhe të cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe humbje definitive të besimit në ditë më të mira për shëndetësinë kosovare.

Krejt në fund, po presim me padurim zbatimin e formulës magjike që do të përdorë kjo Qeveri për rritjen aq të dëshiruar dhe të domosdoshme të pagave të profesionistëve shëndetësorë, pa e rritur buxhetin dedikuar shëndetësisë. Me siguri, ky do të jetë një model i papranueshëm....

KRYETARI: Faleminderit! Jo, u krye ministër! E kemi 5 minuta, jemi marrë vesh. Urdhëro, ministër!

MINISTRI FERID AGANI: I nderuari kryetar i Kuvendit,

I nderuari kryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Me vëmendje dëgjova gjithë debatin, e natyrisht në veçanti diskutimet që kishin të bënin me pjesën e buxhetit për sektorin e shëndetësisë dhe me mirëkuptim të plotë i prita të gjitha vërejtjet që u dhanë. Besoj se është bërë e qartë se në sektorin e shëndetësisë jemi në një periudhë të tranzicionit, kalimit nga një mënyrë të menduarit, në një mënyrë tjetër të menduarit, pra për një shëndetësi moderne, e cila do të bazohet në parimet e ekonomisë së tregut, e jo në modele të centralizuara të financimit nga buxheti qendror.

Në masë të madhe buxheti për vitin e ardhshëm e reflekton këtë tranzicion dhe unë për këtë kërkoj edhe mirëkuptim të punëtorëve shëndetësorë dhe të deputetëve të Kuvendit të Kosovës, sepse është e pamundur që të bëhet prerje momentale e buxhetit dhe të parashihen zgjidhje tjera buxhetore në situatën kur e gjithë kjo kërkon një kornizë të re legislative dhe kërkon veprime konkrete brenda Ministrisë së Shëndetësisë dhe në tërë sektorin shëndetësor, të cilat do të sigurojnë që shëndetësia të fillojë të financohet jo vetëm nga buxheti qendror, por edhe nga burime të tjera, në radhë të parë nga një sistem i sigurimeve shëndetësore dhe burime tjera alternative të financimit.

Prandaj, edhe në këto ditë në vijim ne do të mendohejmë si ministri që të punojmë me Komisionin parlamentar për Buxhet dhe Financa, duke pasur parasysh edhe rekomandimet dhe vërejtjet e juaja, duke bërë racionalizime të brendshme brenda buxhetit dhe me një riplanifikim dhe punë edhe më intensive të provojmë të gjejmë zgjidhje të cilat deri diku do të prekin dhe do t'u përgjigjen vërejtjeve të juaja.

Për hir të sqarimit të opinionit, vetëm dua të theksoj, me gjithë respektin për të gjitha ato të dhëna të sakta që u paraqitën nga deputetët për një disproporcion të qartë ndërmjet financimit të shëndetësisë në Kosovë dhe në shtetet e rajonit dhe më gjerë, megjithatë ne kemi të bëjmë me një përqindje prej 7.8% të ndarjes së buxhetit të përgjithshëm, sepse në ato kalkulime nuk është marrë pjesë, nuk është marrë parasysh edhe grandit i komunave që jepet për shëndetësi, pra kujdesi parësor dhe, megjithatë, jemi prapë në fund të listës së shteteve të cilat ndajnë për shëndetësi atë që e meriton.

Unë, po ashtu e kam parasysh shumë që Ministria e Shëndetësisë, më në fund, do të lirohet dhe këtë unë do të angazhohem gjatë tërë këtij viti që të lirohet nga roli i saj i menaxhuesit financiar të sistemit shëndetësor dhe të sigurojë një autonomi maksimale të

institucioneve publike shëndetësore dhe t'u sigurojë atyre një pozitë sa më të barabartë të konkurrencës në sektorin privat.

Pra, problemet janë evidente, problemet janë të shumta, shtrihen nga niveli politik e deri te niveli menaxherial në institucione, por në një bashkëpunim me ju të vazhdueshëm dhe me propozime konkrete ligjore që do t'i keni, unë shpresoj deri në fillim të muajit qershor për diskutim dhe shqyrtim, shpresoj se do të gjejmë së bashku rrugëdalje nga kjo situatë dhe që viti i ardhshëm do të na pret me një kornizë më të fovorshme dhe me një perspektivë më të ndritur për shëndetësinë Kosovare. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Veç t'ju njoftoj se katër deputetë i kanë deponuar diskutimet e tyre: Hasime Krasniqi, Latif Gashi, Lumnije Morina dhe Elmi Reçica.

Atëherë, vazhdojmë! Ramë Vataj e ka fjalën.

RAMË VATAJ: Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar i Kuvendit,

I nderuar zoti kryeministër,

Të nderuar zotërinj të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë do të mundohem të jem sa më i shkurtër, sepse u tha gjithçka, bile u tha edhe tepër çka që s'është dashur të flitet në këtë sallë.

Sot, kur po e diskutojmë miratimin e buxhetit të vitit 2011, sytë nga ne i kanë drejtuar më së paku 70 mijë veta që presin me padurim ngritjen e rrogave të tyre dhe nëse e marrim parasysh mesataren e familjes prej 4 anëtarëve, ata janë rreth 280 mijë vetë, që do të jenë në ankth se a thua është ndokush që nuk e dëshiron rritjen e mirëqenies së tyre.

Qe 11 vite shumica e kategorive të punëtorëve të Kosovës për punën që e kanë bërë janë paguar në mënyrë simbolike, nëse mund të themi janë mbajtur me ndihma sociale. Një kthesë e rritjes së pagave në mënyrë të ndjeshme është bërë në mandatin e kaluar qeveritar, shembull të mirë mund të marrim rritjen e rrogave të arsimtarëve prej 35 deri 47%, deri sa Qeveria e mëparshme për objektiv ka pasur përmirësimin e infrastrukturës rrugore, shkollore e të tjera, unë e përshëndes dhe e inkurajoj Qeverinë e tanishme për dhënien vetes për objektiv që në këtë mandat të realizojë rritjen e mirëqenies sociale të qytetarit, që do të jetë më e prekshme dhe gjithëpërfshirëse.

Kjo rritje në paga do të rrisë edhe dinjitetin e punëtorit, normalisht do të duhej rritur edhe aktivitetin e efektivitetin e punës, shërbimet më cilësore, mundësi më të vogël të korrupsionit, qarkullim më të madh të mallrave dhe mundësinë e blerjes që janë më të mëdha. Pra, të mirat janë të shumëfishta.

Prandaj, pres dhe shpresoj që të gjithë kolegët këtu të përkrahin qëllimin e mirë të Qeverisë për ngritjen e pagave të kategorive të punëtorëve sipas vendimit të saj dhe me këtë të kalojë edhe votimi i Projektligji për buxhetin e Republikës së Kosovës.

Besoj që ne do t'i tejkalojmë inatet personale dhe partiake për shkak të situatës në të cilën gjendemi, në mënyrë që Kosova të vazhdojë të zhvillohet krahas vendeve tjera të rajonit dhe të integrohet shpejt në Evropë.

Integrimin në Bashkësinë Evropiane mund ta kemi vetëm me sjellje evropiane, me kulturë pune evropiane, me dije, qasje parimore ndaj problemeve dhe duke punuar bashkërisht për të mirën e Kosovës.

E ndiej obligim, pasi vij si deputet i anës së Therandës, disa herë u përmend për mungesën e investimeve. Sa për dijeni të gjithë këtyre deputetëve, Qeveria e mandati të kaluar, që e ka udhëhequr po ashtu zotëri Thaçi, vetëm në komunën tonë, ku nuk ka qenë në pushtet, Partia Demokratike e Kosovës ka investuar diku 12 milionë në shkollë, diku 6 milionë në rrugë, infrastrukturë rrugore, ndërsa edhe tash e di që ka projekte që kanë filluar edhe me qeverisjen që e ka AAK-ja, ndërsa aq sa di të lexoj, sepse nuk jam ekspert i ekonomisë, këtu shkruan që investime në komunën tonë do të jenë diku 2 milionë e 529 mijë euro, vetëm në infrastrukturë rrugore, kanalizime. Që nuk ka projekte të reja, nuk është përgjegjëse qeveria t'i thotë Therandës- ju duhet projekte të reja e ta bëni këtë, por ata duhet të kërkojnë dhe po i shoh se ka me të vërtetë projekte të reja, për shembull, Qendra e Kulturës së Suharekës nuk ekziston, ai është projekt i ri që po e shoh se ka për t'u investuar prej Qeverisë.

Prandaj, sa për informim, po ashtu edhe në shkollë në Therandë do të jenë diku edhe 1 milionë e 200 mijë euro që do të vazhdojnë... Megjithatë, është qeveria që i jep ato të holla, ne nuk mund të ndërtojmë përditë shkollë, po sipas nevojave ndërtohen edhe shkollat.

Pra, këto janë sa për dijeni të Kuvendit, se megjithatë nuk ka ndarje të Qeverisë, financim nga buxheti i Qeverisë sipas partive të cilat e mbajnë pushtetin lokal.

Është edhe një tjetër për Ministrinë e Arsimit, që u tha nuk ka buxhet, për shkencë është ndarë 1 milionë prej Komisionit Evropian, me siguri ministri e ka marrë parasysh, e ka marrë në konsideratë këtë dhe e ka kursyer buxhetin e Qeverisë tonë. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Vazhdojmë! Hykmete Bajrami e ka fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Unë e kam një vërejtje fillimisht, kryetar... Nuk dua të llogaritis në pesë minutëshin. Nuk është e drejtë, ne që kemi mbetur në fund, i kemi dëgjuar 60 veta deputetë tjerë, të na merret e drejta e fjalës, të na shkurtohet fjalimi prej 10 minuta në 5 minuta. Na këtu kemi ardhur me votat e popullit e jo të deputetëve.

Unë e kuptoj që çka do që të propozon, tash të propozojë kryetari që të më përjashtojë prej Parlamentit, shumica votojnë dhe unë dal. Mirëpo, kjo nuk është e drejtë, kështu që unë i dua 10 minuta. Jam e Dukagjinit, kam mjaft zë edhe pa mikrofon e vazhdoj.

KRYETARI: Deputete, duhet ta lexosh Rregulloren. Kuvendi ka votuar dhe e ka këtë të drejtë, ti i ke 5 minuta dhe mendoj që mjaft është...

HYKMETE BAJRAMI: Unë e thashë, mund të provosh, thuaju a e përjashtoni Hykmeten prej Parlamentit, jam e sigurt i ke shumicën, më donë jashtë.

KRYETARI: Nuk e kam ndërmend ta bëj atë.

HYKMETE BAJRAMI: Jo, nëse do, nëse do ta provosh, provoje, por nuk është e drejtë. Nëse unë i kam dëgjuar 60 të tjerë, dua dhe unë e di këtu që ka shumë që nuk janë të interesuar të më dëgjojnë, mirëpo unë i flas elektoratit. Atëherë, po vazhdoj.

I nderuar kryetar,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Shpenzimi i parasë publike është përgjegjësia më e madhe që kanë institucionet e një vendi, sepse ka të bëjë me mbledhjen e parasë nga qytetarët dhe kthimin e tyre në formë të shërbimeve. Mirëpo, ka të bëjë me kthimin e shërbimeve në formë të barabartë me shpërndarjen e barabartë, është përgjegjëse për zhvillim ekonomik, për siguri, për mirëmbajtjen e marrëdhënieve ndërkombëtare me shtetet tjera, institucionet ndërkombëtare.

Buxheti i Kosovës nuk është as i kryeministrit, siç shpeshherë ai pa ndeh, as i qeverisë së tij e as i ne deputetëve. Buxheti i Kosovës, prej të cilit ndahen edhe pagat e beneficionet tona, është buxheti i qytetarëve, të cilin Qeveria e merr në formë të taksave e tatimeve të ndryshme dhe atë shpesh jo në formë të barabartë, po atij që i paguan, i merr shumë, e atij që nuk paguan, nuk i merr fare.

Buxheti, edhe pse koncept ekonomik, në rastin konkret është komplet politik. Këtë e kanë treguar edhe bisedat, natyra e bisedave çfarë i kemi zhvilluar sot. Ky buxhet vjen si derivat i një kampanje zgjedhore që ka për bazë realizimin e premtimeve të pa baza. Ky buxhet karakterizon paqëndrueshmërinë ekonomike dhe fiskale dhe përcillet me deficit e bazohet në supozime, e karakterizon mungesa e vizionit për zhvillim ekonomik dhe stimulim të sektorit privat.

Buxheti është komplet politik dhe si i tillë është i planifikuar që ta çojë vendin drejt një krize të thellë, më të thellë se sa jemi tani. Nuk po e përmendi deficitin, është 226 milionë, kemi 167 milionë që supozojmë t'i marrim nga një marrëveshje tashmë e shkelur, kemi një ligj paketë, me projektbuxhetin vjen edhe shitja e PTK-së edhe pse antiligjore, duhet të përmendim, do të thotë e tregon varshmërinë e këtij buxheti nga shitja e aseteve nacionale.

Mirëpo, kur jemi te shitja e PTK-së, patjetër duhet të përmendim si gabim të pa përmirësueshëm prejudikimin e vlerës së PTK-së, me qëllim ose pa qëllim, si rezultat i keq formulimit apo keqinterpretimit të gjithëve ne që jemi këtu prezentë dhe reflektimit që ka pasur në media, vlera e PTK-së tashmë është caktuar dhe ajo është 300 milionë dhe

askush nuk mund ta korrigjojë këtë, do të thotë për këtë gabim dikush duhet të marrë përgjegjësinë.

Buxhetin që e kemi para vetes do e çojë vendin në krizë dhe kriza do të fillojë me rishikimet buxhetore, por assesi nuk do të përfundojë në fund të vitit 2011, sepse ky buxhet do të ketë konsekuencat e veta edhe për vite të tjera. Çka në vitin 2012, kur nuk kemi asete nacionale për të shitur e potencialisht më pak donacione nga miqtë tanë ndërkombëtarë?

Neve nuk jemi kundër privatizimit të postës, jemi kundër formës dhe ngutisë e cila privatizohet. Privatizohet për të paguar faturat e rrogave. Gjithashtu, nuk jemi kundër rritjes së rrogave, mirëpo kritikojmë qeverinë për mos mbajtje të premtimeve, sepse rrogat nuk po rriten në bazë të premtimit, po në bazë të vendimit, rrogat një herë po zbriten dhe mandej po rriten.

Rritja e performancës së doganave dhe ATK-së në masë prej 20% mund të perceptohet edhe si performancë e dobët në të kaluarën, mirëpo edhe si ushtrim presioni në sektorin privat, e cila domosdoshmërisht do të çojë në tkurrjen e këtij sektori.

Një problem tjetër ka të bëjë me mosrespektimin e kornizës afatmesme të shpenzimeve, që tash në buxhet i kemi parë tejkalimet.

Me një fjalë, gjithçka po shkon mbrapsht, por problemi i buxhetit assesi nuk kufizohet në ato të natyrës deficitare që çdokujt i bie në sy. Problemet janë edhe të natyrës së shpërndarjes, mungesës së prioritetive dhe mungesës së vizionit për zhvillim afatgjatë ekonomik.

Mungesa e një strategjie zhvillimore po e vë në pah mungesën...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Deputetët e ri dhe deputetët e reja duhet vërtet ta lexojnë Rregulloren. Vazhdojmë! Sala Berisha-Shala e ka fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar!

Paj, të them edhe unë jam e Drenicës dhe i dua edhe pesë minuta, se më shkon zëri fort, diqysh s'po tingëllon, po, këtu jemi në Parlament dhe duhet t'i respektojmë rregullat dhe ato që parashihen në Rregulloren e Punës së Kuvendit.

Zoti kryetar,

Zoti kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë dhe të gjithë ju të pranishëm,

Dihet se jemi vonuar në miratimin e projektbuxhetit. Mendoj se të gjithë jemi përgjegjës për këtë, madje edhe moskufizimi i kohës së debatit po i ndihmon kësaj vonese dhe isha

në dilemë a e ndihmoj unë kompensimin e kohës në qoftë se heq dorë komplet nga diskutimi.

Të nderuar, sigurisht se për projektbuxhet flet në mënyrë afirmative pozita dhe po ashtu dihet se opozita bën të kundërtën. Kështu, krejt pak dalin të flasin më racionalist për këtë temë. Me fjalë tjera, debati rreth kësaj teme ka marrë atë rrjedhë, varësisht nga pozicionimet e deputetëve apo grupeve parlamentare. Shprehur ndryshe, ose thënë më së buti, i bie – ka dritë të mjaftueshme për ata që shohin dhe ka errësi të mjaftueshme për ata që nuk duan të shohin, po e përsëris, ata që nuk duan të shohin.

Të nderuar deputetë,

Qeveria po vazhdon në përmbushjen e premtimeve të veta konform programit të saj qeveritar. Në këtë rast, edhe në angazhimin e saj sa i përket rritjes së pagave. Me votën “pro” këtij projektbuxheti, dëshmojmë përkushtimin tonë për vazhdimin e projekteve kapitale, siç është projekti për rrugën e kombit, si dhe projektet tjera që nuk dua të marrë kohë e t’i përmend me radhë.

Risi e këtij projektbuxheti, krahasuar me vitet tjera, është se Qeveria kësaj radhe me të drejtë u ka kushtuar vëmendje edhe çështjeve sociale, duke vënë në prioritet përmes rritjes së pagave.

Mendoj se këtë prioritet duhet kuptuar si reflektim pozitiv shumëdimensional nga se përveç që do përfitojnë shumë familjeve përmes të punësuarve të tyre në këto segmente, e sidomos kategoritë e merituar të shoqërisë, siç janë familjet e dëshmorëve, invalidët, veteranët, punëtorët arsimorë, shëndetësorë e tjerë, por përgjithësisht qytetarëve tanë do t’u ofrohen shërbime më të mira. Natyrisht, motivimi është një nga elementet për punë cilësore.

Po shihet se qasjet për këtë temë veç ishin të ndryshme, sa i përket rritjes së pagave, është i pa peshuar mirë mendimi i një parafolësi në këtë debat, po mundohem ta parafrzoj – kjo rritje nuk u bë në saje të performancës së tyre në punë, por në saje të premtimeve elektorale. Shtrohet pyetja, a nuk ju duket, të nderuar kolegë deputetë, të menduarit ndryshe se ky kualifikim, arsyetim tingëllon pakëz ofendues për punëtorët e sektorit publik dhe të tjerët dhe ata nuk janë pak, 77 mijë të tillë, qytetarë tanë votues tanë. Kjo po i bie se punëtorët e këtij sektori meritojnë ndëshkim.

Buxheti është ky që është, të nderuar deputetë, dhe aq sa është, të gjithë do të dëshironim të ishte dhjetëfishi i tij, edhe po të ishte aq, zhvillimi ekonomik i një vendi nuk varet tërësisht nga buxheti i tij.

Zhvillimi ekonomik mendoj që varet edhe nga gatishmëria jonë kreative së bashku, mobilizimi i të gjithë neve për tërheqjen e donacioneve jashtë buxhetit, investimeve të jashtme dhe kjo është e mundur, madje është edhe obligim i yni të ofrojmë klimë të favorshme për këtë, qoftë përmes infrastrukturës ligjore, qoftë përmes rrugëve tjera duke hulumtuar dhe thithur donacione që ofron bashkësia ndërkombëtare, sidomos për fusha të caktuara, qoftë ambientale apo tjera.

Së shpejti në Parlament do ta kemi edhe strategjinë legislative, të cilën do ta miratojmë së bashku dhe ajo strategji duhet miratuar dhe duhet paraprish miratim i këtij projektbuxheti, ngase implementimi i asaj strategjie varet nga ky projektbuxhet.

Krejt në fund, ju ftoj të votoni pro këtij projektbuxheti dhe kontributin ta ofrojmë së bashku përmes sugjerimeve të komisioni përkatës. Faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Faleminderit! Ju njoftoj se deputeti Ramiz Lladrovci e ka dorëzuar diskutimin e tij.

KRYTARI: Fjalën e ka deputeti Anton Çuni.

ANTON ÇUNI: I nderuar kryetar,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,

Në momentin kur Kushtetuta e Republikës së Kosovës nuk është e jetësuar në tërë territorin e Kosovës, me çalime ekonomike, zhvillimin ekonomik, siguri të brishtë, me sfida të mëdha për integritet euro - atlantike dhe në momentin kur po zhvillohen bisedimet në mes të Kosovës dhe Serbisë për çështje teknike, ne sot diskutojmë për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011, i cili nga Qeveria supozohet se do të gjenerojë zhvillim ekonomik, sundim të ligjit, ambient të sigurt dhe të qetë, lëvizje të lirë e tjera.

Po ashtu, ne si shoqëri po sfidohemi me luftë speciale nga disa drejtime, posaçërisht nga fqinji ynë Serbia, me krim të organizuar, krime financiare, me korrupsion, tendermani, shpëlarje parash, shantazhe, reketime e tjera.

Institucionet, agjencionet dhe organizatat të cilat kanë për mision dhe detyrë të sigurojnë sundimin e ligjit për një ambient të sigurt dhe të qetë, kanë nevojë për fonde, pa të cilat ato janë jofunksionale, jooperacionale, jo profesionale, statike dhe të limituara. Me gjendje të tillë, ne nuk jemi atraktivë për investime, për biznese, investime nga jashtë, kreditime, donacione e tjera. Një gjendje e tillë është parajsë për struktura paralele, kriminale, paramilitare, avanturiste, dilera e tjerë, të cilët fatkeqësisht jo në masë të vogël po i shfrytëzojnë edhe buxhetet të cilat ne po i miratojmë në vazhdimësi.

Organet e drejtësisë, por edhe ato të sigurisë, Policia e Kosovës, Agjencioni i Inteligjencës së Kosovës, Forca e Sigurisë së Kosovës, po ashtu Shërbimi Doganor, Agjencioni për Antikorrupsion, përveç udhëzimeve politike, strategjive të zhvillimit dhe veprimt, kanë nevojë edhe për fondet e mjaftueshme, sepse vetëm atëherë do të krijohet një ndër parakushtet për implementimin e politikave dhe programeve ekonomike.

Përndryshe, ne po e rrezikojmë që çdo përpjekje e Qeverisë për zhvillim socio - ekonomik në situata të tensionuara, konfuziteti, pasigurie dhe anarkie në disa pjesë të Kosovës, do të jetë në dëm të qytetarëve dhe të institucioneve të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Nijazi Idrizi.

NIJAZI IDRIZI: I nderuar kryetar i Parlamentit,

I nderuari kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë,

Ky projektbuxhet paraqet anën e nevojave të mëdha të vendit, në njërin anë nevojën e zhvillimit ekonomik dhe në tjetrën nevojën e mirëqenies sociale.

Ekulibrimi i këtyre nevojave është jashtëzakonisht i madh në kushtet e mungesave buxhetore që i ka vendi ynë.

Sot shumë vende po përballen me krizën e prodhimit të ushqimit. Ky problem është bërë sfidë për shumicën e vendeve të botës, pothuajse të gjitha vendet kanë filluar t'i rihartojnë politikat favorizuese, përmes të cilave po synojnë që t'i nxisin jo vetëm fermat komerciale, por madje edhe ekzistenciale për prodhimin e ushqimit në vend.

Në një gjendje akoma më të rëndë ndodhet Kosova, e cila për shkak të problemeve të trashëguara me kornizën institucionale dhe me infrastrukturën fizike, nuk ka arritur të zgjerojë interesimin e fermerëve për prodhimin e ushqimit, e për pasojë nuk është arritur konsolidimi i fermave bujqësore. Kjo ka ndodhur për shkak se ky sektor për një kohë të gjatë është lënë në harresës pa politika dhe pa investime, madje edhe me investime simbolike.

Para disa muajve ne jemi dëshmitarë të rritjes së çmimeve të ushqimit, ndërsa ditëve të fundit jemi të kërcënuar nga rritja e sërishme e tyre për shkak të ndalimit të eksportit të disa produkteve ushqimore nga Serbia. Reagimi i vonuar i bizneseve për gjetjen e rrugëve të shpejta të furnizimit dhe mungesa e rezervave shtetërore janë dy arsye të pamundësisë së pengimit të kësaj rritjeje.

Për çdo vit rreth gjysmë miliardi euro hiqen nga Kosova për furnizimin e popullsisë me produkte ushqimore shumica dërmuese e cilave mund të prodhohen në vend. Në mandatin e kaluar, ç'është e vërteta, për herë të parë pat filluar mbështetja e fermerëve përmes subvencioneve dhe grandeve, të cilat patën ndikuar pozitivisht që të rritet interesimi i fermerëve për punë.

Me investimet në bujqësi nuk mund të arrihet ndonjë zhvillim spektakular ekonomik, por arrihet ajo më e mira - paqja sociale për të cilën në këtë kohë të trazuar kanë nevojë të gjithë. Me prodhimin e ushqimit në vend, paraja e qytetarëve do të mbetet këtu si kursim dhe do të hidhet në investime në fushat tjera të interesit.

Për më shumë, në këtë shekull bujqësia nuk ofron vetëm vlera ekonomike, por edhe vlera sociale, mjedisore, turistike e tjerë, nga të cilat përfitojnë të gjithë.

I nderuari kryeministër, është mirë që edhe tash të ndiqet shembulli i mandati të kaluar, në të cilin për çdo rishikim të buxhetit ju keni bërë rritjen e buxhetit për këtë sektor. Kjo

rritje do të jetë edhe një kontribut për nxitjen e mëtutjeshme të fermerëve që t'i aktivizojnë resurset e tyre për të prodhuar ushqim kualitativ për nevojat e tregut tonë.

Rritja e buxhetit për bujqësi i ka inkurajuar edhe donatorët aktualë, të cilët kanë investuar shuma të konsiderueshme në këtë sektor dhe i kanë të zotuar për Kosovën edhe disa dhjetëra miliona euro, shumica e të cilave janë grande për fermerët tanë.

Unë do ta jap edhe një koment dhe njëkohësisht e kam edhe një si kërkesë, për sqarim për një projekt afatgjatë, që ka filluar të zbatohet në Gjilan për largimin e ujërave të zeza në lumin Mirusha.

Për qytetarët e Gjilanit ky projekt nuk ka karakter vetëm social, por mbi të gjitha ka karakter shëndetësor e madje edhe human. Unë nuk e di se çka u bë me këtë projekt, por mesa e pash në tabelë, shumat për këtë projekt nuk janë të evidentuara për këtë vit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Sali Asllanaj e ka fjalën.

SALI ASLLANAJ: I nderuar kryetar,
Kryeministër,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Më lejoni që pas një debati të gjerë të provoj edhe unë të t hem diçka në këtë temë shumë të rëndësishme për Kosovën.

Unë mendoj që veç formulimi i buxhetit dhe fillimi i formulimit të tij ka ndodhur në mënyrë të pazakontë, ku kryeministri në fushatën elektorale sillej si me i pas xhepat plotë para, siç thuhet në popull, dhe shkepte sa mundte. Edhe në fund, hajde në fushatë elektorale doli ajo që pas asaj fushate morën një vendim në Qeveri, i cili të jepte për të kuptuar që s'ka Kuvend fare. Qeveria merr vendim, i ndanë, i rritë rrogat, të gjitha.

Unë mendoj që ka qenë një injorim i Kuvendit dhe tash po shihet që vërtet ka pasur nevojë të debatohet gjerë e gjatë dhe po shihet se asnjë prej deputetëve nuk e dëgjova që është kundër rritjes së rrogave, përkundrazi të gjithë janë për rritje të rrogave, por unë kisha shtuar edhe diçka. Unë mendoj se krahas kësaj rritje të dobishme për të gjitha ata të punësuar, ka qenë dashur të mendohet edhe për një kategori shumë vulnerabile dhe shumë, të themi, të moshës së tretë. Kemi nisur edhe na tash për të hy në moshë të tretë dhe sikur po harrojmë që pensionistët me 45 euro vërtet është e vështirë të paramendohet se si ia dalin në skaj.

Unë kisha dashur, domethënë, që të mendohet edhe për atë kategori, por në të njëjtën kohë kisha konstatuar që në një kulaç të vogël ..., atëherë gjithmonë ka fjalë shumë.

Diçka tjetër, kisha dashur të konstatoj edhe lidhur me marrëveshjen me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

I nderuar kryeministër, më kujtohet shumë mirë kur është arritur marrëveshja me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe me kryeministrin dhe ministrin e atëhershëm të Ekonomisë dhe Financave kanë folur me shumë entuziazëm, me shumë gëzim për një marrëveshje të tillë dhe tash sikur lehtë po hiqet dorë nga një marrëveshje e tillë, të cilën vërtet kisha dashur ta kuptojmë si një akt momental, por jo si zgjidhje të përhershme, sepse konsideroj që mund të jetë shumë jo e dobishme për Kosovën.

Diçka tjetër çka kisha dashur t'i jap rëndësi, është ajo që kam pritur personalisht që Qeveria pas një prioriteti të caktuar që ka pasur tri vitet e kaluara për arsimin, për infrastrukturën rrugore, do ta ndryshojë së paku dhe do të merr diçka që të jepet një prioritet bujqësisë, shëndetësisë, drejtësisë.

Jam zhgënjyer, sepse bujqësia përkundër një rritje të vogël buxhetore, mendoj që është shumë pak dhe konsideroj që derisa produktet e vendeve të huaja, produktet bujqësore dominojnë në tregun kosovar, mendoj që është shqetësim shumë i madh edhe për ministrin edhe për Qeverinë e Kosovës, por në të njëjtën kohë konsideroj që edhe për shëndetësinë, nëse sot ndahen 2 milionë euro për mjekim jashtë vendit, kurse afër 10 herë, 20 herë më tepër shpenzohen vetëm në spitalet e Maqedonisë për mjekim jashtë vendit, atëherë kisha dhënë për të kuptuar që vërtet humbjet tona janë shumë të mëdha.

Ju kisha lutur, zoti ministër, e keni një punë shumë të vështirë, por që të bëni maksimumin që shërbimet terciare t'iu ofrohen pacientëve tanë, qoftë në sektorin privat, qoftë në sektorin publik dhe në këtë mënyrë mendoj që mund të kursejmë shumë para të qytetarëve, qoftë përmes sigurimeve shëndetësore apo eventualisht duke menduar ndonjë participim të atyre që kanë mundësi të paguajnë, të themi 50% të asaj që paguajnë në Maqedoni.

Diçka tjetër lidhur me atë që u përmend Suhareka, nuk e kemi fajin që jemi shumë të Suharekës këtu, dikush me lëvdata dikush me kritika. Unë mendoj që ka vend për përmirësime, ka vend që vërtet në Therandë së paku edhe nja tri projekte janë shumë të rëndësishme dhe të veçanta. Ishte këtu ministri i Arsimit, ish ministri i arsimit deri më tash, i cili ka premtuar dhe ka dhënë një material të shkruar për një shkollë në fshatin Morlan dhe sikur edhe partneri i cili bashkëfinancon ka mbetur në një pozitë të palakmueshme dhe një tjetër që me ish ministrin e Tregtisë dhe Industrisë, zotin Zharku kam biseduar atëherë para dy tri vjet për zonë industriale, është një zonë e cila do të thotë shpirt, zemër për zhvillim ekonomik të komunës tonë, të ketë një prioritet të caktuar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, sepse vërtet mund t'i japë shtytje zhvillimit të madh të Therandës.

Me dëshirat më të mira që të realizohen këto, këto ide dhe këto projekte tuaja, ju kisha përsëndetur dhe ju dëshiroj sukses. Për ta votuar buxhetin, nuk do ta votoj sepse sikur ta votoja do të isha në PDK, unë jam në LDK, e kam një vizion, e kam një projekt krejt tjetër që e ka LDK-ja. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit, deputet, por keni parasysh se Kosova është një zonë. Vazhdojmë. Fjalën e ka deputetja Vjollcë Krasniqi.

VJOLLCA KRASNIQI: I nderuari kryetar,

Kabinet qeveritar,

Kolegë kuvendarë,

Nga parafolësit për afër dhjetë orë me vëmendje dëgjova vlerësimet e tyre për Projektligjin për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011. U vlerësua si buxhet deficitar, i krizës, i supozimeve, fiktiv, jo zhvillimor, shpenzues e tjerë, e tjerë, por pati të atillë që e thanë edhe të kundërtën.

Unë nuk do të doja të merresha me këto vlerësime, sepse u thanë mjaft, mirëpo në këtë sallë rrallë herë është trajtuar një nga brengat më të mëdha të një pjese të shoqërisë, në veçanti të rinisë, siç është sporti.

Pak më herët e trajtoi një koleg i imi, mirëpo pak në mënyrë shkarazi dhe pak a shumë në mënyrë superlative. Nuk e di pse ky segment kaq vital nuk ka trajtim më serioz dhe më fundamental, kur dihet se në Kosovë frekuenton një numër imponant aktivistësh.

Fjala vjen, në sportin e Kosovës me status sportisti superior janë 1.600 sportistë, të cilët burojnë nga 385 klube, kurse në grup moshat e sporteve të ndryshme përfshihen 29.708 të rinj dhe 6 mijë të reja gjë që të gjithë këta në mënyrë të organizuar zhvillojnë aktivitetin e tyre, për t'i ndjekur sipas një mesatareje për gjithë vitin mbi 200 mijë shikues.

Janë mbi 27 federata të ndara në dy grupe, të sporteve olimpike dhe jo olimpike, të cilat planifikojnë, organizojnë dhe zhvillojnë sportin ndër ne. Pra, me këtë sferë është e përfshirë një armatë e tërë e të rinjve dhe e të rejave, kurse ne ngurojmë të merremi me çështjet e tyre.

Nuk dëshiroj të tërheq paralele krahasuese me rajon, por getoizimi i sportit të Kosovës, që është plotësisht i paarsyeshëm nga ndërkombëtarët, shumë herë edhe nga vetë ne ka bërë që sporti të jetë i marginalizuar dhe shumë i varfër.

Duke u nisur nga përvoja dhe disa fakteve relevante, dëshiroj që t'ua tërheq vëmendjen në disa prej vrojtimeve rreth buxhetit të ndarë për një vit për sportin e Kosovës. Sigurisht se rritja e tij për afër 2 milionë do të jetë një shtysë dhe shpresë për të gjithë ata që marrin pjesë në organizimin dhe në zhvillimin e sporti tonë, por sigurisht se jo të gjithë do të mund të shijojnë të mirat nga ky buxhet, i cili për fat të keq, ashtu si edhe viteve të kaluara, po realizohet në mënyrë të përciptë ose sipas sistemit merre ose lë, sepse kanë qenë mundësitë, aq më keq që edhe vlerësimet buxhetore për vitet e ardhshme janë po të njëjta të këtij viti, andaj shpresat për sportistë janë të fundosura.

Të nderuar kolegë, jam koshiente për vështirësitë financiare, çështje që preokupon secilin prej nesh, por më duket se sporti si një hallkë e rëndësishme e zinxhirit të kësaj bote meriton më shumë mjete, por edhe vëmendje. Duket se për shumë kohë nuk jemi marrë me vështirësitë e shfaqura në sportin e Kosovës, të cilat reflektojnë tash e tri dekada dhe janë grumbulluar me vargje problemet që shpeshherë na duket si një nyje e pazgjdhshme.

Sot, kur flasim për miratim të buxhetit, na dalin para shifrat të cilat në të parë duken të kapshme, por vërtet janë modeste sepse gjendja e infrastrukturës është shumë e brishtë dhe e paqëndrueshme për të ndikuar edhe në stagnim të zhvillimit të sportit elitari. Pra, me një buxhet të tillë nuk shoh shumë rrugëdalje për përmirësimin e infrastrukturës e cila, për fat të keq, është e pa përballueshme, por që do zgjidhje të shpejtë.

Në projektet investuese janë paraparë ndërtimet e disa palestrave sportive nëpër komuna më të vogla, të cilat edhe një herë po buxhetohen. Janë të parapara edhe disa arnime nëpër stadione e palestra aktuale dhe që të gjitha këto të shtyjnë të mendosh për një qasje krejt tjetër të investimeve, duke pasur parasysh në radhë të parë sistemin publiko – privat, i cili në shumë vende të tjera ka dhënë rezultate, kurse në anën tjetër ne po vonohemi me miratimin e Ligjit për sponzorizim, që është një nga format e ndihmës së nevojshme që mund t'i ofrojmë sportit.

Të nderuar kolegë,

Unë vetëm i pikasa disa prej telasheve me të cilat përballet sporti ynë, kurse si nevojë apo domosdoshmëri paraqes edhe shpërthimin në arenën ndërkombëtare, gjë që për ndërkombëtarizimin e sportit nuk do të duhej të merreshin vetëm institucionet sportive, sepse tashmë sporti është çështje politike.

Pak më herët zoti Haxhiu zuri në gojë kryetarin e Prishtinës, kur tha se kryetari i juaj ka lëshuar mjete të Komisionit Evropian, të cilat kanë shkuar në Mitrovicë dhe ju them, zoti Haxhiu, se kjo pikërisht është bërë për shkak të mbajtjes në sirtar të Ligjit për kryeqytet, i bllokuar nga ana e juaj, ligj i cili do të rregullonte edhe statusin e Pallatit të Rinisë dhe të sporteve, sepse Komisioni Evropian...

(Ndërprerje)

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Salihe Mustafa, le të përgatitet diskutuesja e fundit për sot deputetja Afërditë Berisha – Shaqiri. Replikë, urdhëro zoti Haxhiu!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Më vjen mirë që edhe për sportin ka filluar në Parlament të diskutohet dhe atë më vjen mirë që jam prej deputetëve të parë që diskutova për sportin këtu dhe shoh që kam zgjuar edhe kërkësinë e koleges sime nga Federata e Futbollit, zonjën Vjollca, dhe për mos arritje deri tash në sportin e Kosovës, kulturë dhe për rini mos të harrojmë se prej ekzistimit të qeverive të pas luftës së Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës e ka udhëhequr Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe krejt këto kritika Vjollca duhet t'ia adresojë subjektit të saj politik, ndërsa pse është refuzuar marrëveshja me Komisionin Evropian, e di edhe Vjollca, s'ka pasur gatishmëri nga ana e kryetarit të komunës së Prishtinës, zoti Isa Mustafa. Fatbardhësisht që një gatishmëri e tillë ka ekzistuar nga ana e Avni Kastratit, në Mitrovicë, dhe ato mjete po investohen në Mitrovicë. Faleminderit!

KRYETARI: Bile duhet falënderuar këta të Prishtinës që ia kanë dhënë mundësinë Mitrovicës! Hajt, Vjollcë, një minutë! Regjia, fjalën deputetes Vjollcë Krasniqi!

VJOLLCA KRASNIQI: Zoti Haxhiu, kur thatë më herët se 2 milionë janë shtuar në buxhetin e Ministrisë së Kulturës dhe nuk desha ta them, sepse kjo është bërë pikërisht për shkak se tashmë është një ministër nga ana e juaj ministër i kësaj ministrie dhe këtë shumë prapë nuk e konsideroj që është e mjaftueshme për të mbuluar kërkesat e sportistëve dhe pikërisht arsyeja e mos investimit të Komisionit Evropian në Pallatin e Rinisë është çështja pezull e statusit të këtij pallati dhe për sa vite e ka udhëhequr Ministrinë e Kulturës Lidhja Demokratike e Kosovës, Qeveria e thashë shumë mirë më herët se e ka aplikuar sistemin, ose lëre, ose merre – këto i ke. Faleminderit!

KRYETARI: Vazhdojmë! Për fjalë është lajmëruar deputetja Blerta Deliu, po na kishe e mbyllëm, Blertë! Po, më fal Afërdita, që ta mora gati rendin! Deputetja Afërdita Berisha-Shaqiri.

AFËRDITA BERISHA-SHAQIRI: I nderuar, zoti kryetar,
Zoti kryeministër,
Anëtarë të Kabinetit qeveritar,
Të nderuar deputetë,
Buxheti i Republikës së Kosovës mbështetet kryesisht nga të hyrat tatimore. Meqenëse mbështetet nga të hyrat tatimore, atëherë duhet të kemi të qartë se vazhdon një presion i Administratës Tatimore ndaj bizneseve të vogla dhe të mesme për të realizuar të hyrat tatimore.

Prej këtyre bizneseve në këtë rast rrezikohen shumë familje që varen pikërisht nga këto biznese dhe duhet të kemi të qartë se shtetin nuk e përbëjnë vetëm mësimdhënësit, mjekët dhe policët, të cilët me të vërtetë e meritojnë këtë rritje, por shtetin e përbëjnë edhe kategori të tjera, edhe bota e biznesit, edhe ekonomisë, të cilët janë edhe promotori i zhvillimit të tërë shtetit dhe shoqërisë, e nëse Qeveria do të vjelë pa kufi këtë shtresë, rreziku për krizë ekonomike dhe sociale do të jetë edhe më i madh.

Sot po përsëritet disa herë që 70 mijë punonjës i kanë sytë nga ne. A thua sa është numri i atyre që nuk janë fare të punësuar, a thua çfarë presin ata sot nga ne.

Mendoj që institucionet e Kosovës, e sidomos Qeveria, duhet të bëjnë përpjekje për krijimin e kushteve më të mira për investime më të shumta, për zhvillimin e sektorit të bujqësisë, sepse ky sektor krijon vende të reja të punës. Duke shikuar komunën e Sharrit, si një nga komunat e cila ka predispozita dhe potencial shumë të mirë për zhvillimin e bujqësisë, nuk pash që kishte investime dhe subvencione, edhe pse subvencione kishte mbi 7 milionë. Shtrohet pyetja, a do të përfitojnë komunat nga këto subvencione, sa do të përfitojnë komunat nga këto subvencione dhe cilat komuna do të kenë fatin që të përfitojnë nga subvencionet e parapara për Ministrinë e Bujqësisë. Subvencione janë paraparë gjithashtu edhe kësaj here për ndërmarrjet në pronësi publike, e ato janë 34 milionë. Prandaj, mendoj që duhet të bëjmë përpjekje për zhvillimin e ekonomisë private, sidomos një përkrahje më të madhe dhe krijimin e kushteve më të favorshme për

zhvillimin e bizneseve të vogla dhe të mesme, që konsiderohen si gjenerator të rritjes ekonomike, si formë për krijimin e një stabiliteti financiar, ekonomik dhe social të vendit. Në të kundërtën, nëse shkohet me këtë logjikë të qeverisjes, kriza ekonomike e sociale është e pashmangshme dhe krejt çka do të bënte Qeveria, do të ishte shtrëngimi i egër i bizneseve të vogla dhe të mesme dhe rritja eventuale e TVSH-së.

Prandaj, mendoj se ka ardhur koha dhe mos të vonohemi për krijimin e një strategjie të zhvillimit ekonomik, që neve si deputetë mos të na prezantohen gjithmonë të dhënat e supozuara, por të kemi një strategji dhe të dimë qartë objektivat, prioritetet dhe si do të realizohen ato. Ju faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Salihe Mustafa e ka fjalën!

SALIHE MUSTAFA: I nderuar zoti kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Përfaqësues të Qeverisë së Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne përfaqësojmë subjekte të ndryshme dhe rrjedhimisht interesa në diversitet politik. Megjithatë, ne në radhë të parë përfaqësojmë interesat e qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe në këtë drejtim, përkundër dallimeve tona politike, besoj se duhet të pajtohemi për interesat e përgjithshme të qytetarëve të Kosovës.

Në këtë qasje të çështjeve, siç është sot rasti konkret për Projektligjin e Buxhetit për vitin 2011, ne duhet t'i kemi parasysh që vendimet tona të kenë ndikim në jetën, shëndetin dhe mirëqenien e qytetarëve tanë, ndërsa për sa i takon pjesës së Ligjit për rritje të pagave, ne duhet të kemi parasysh ata dhjetëra mijëra të punësuar në Sektorin Publik, që presin t'i marrin pagat tyre. Ne, si të zgjedhur të tyre, nuk kemi të drejtë t'i zhgënjejmë dhe t'ua mohojmë të drejtën që e kanë siguruar me punën e tyre. Ne duhet të përfaqësojmë interesat e përgjithshme të shtetit dhe të të punësuarve në sektorin publik.

Unë besoj se ky Projektbuxhet ka ardhur para nesh i analizuar dhe i peshuar mirë nga institucionet përgjegjëse qeverisëse për këtë fushë dhe ne nuk duhet të ndikohemi nga paragjykimet për raportet që do prishen me FMN-në dhe institucionet tjera ndërkombëtare financiare. Ne duhet, gjithashtu, t'i lëmë mënjane këndshikimet e ngushta, qofshin ato të karakterit politik apo grupor, por të përqendrohemi në interesat e përgjithshme të qytetarëve tanë dhe të punësuarve në sektorin publik, që duhet t'i realizojnë me Ligjin për buxhetin e vendit për këtë vit.

Unë pajtohem se ky Projektbuxhet është vërtet i guximshëm dhe është hartuar mbi bazën parashikimeve për të hyrat gjatë këtij viti, si të nevojave për shpenzimet që duhet të financohen nga buxheti. Ne duhet të kemi besim në kapacitetet tona shtetndërtuese e zhvillimore, si dhe në miqtë tanë ndërkombëtar që na kanë mbështetur në të kaluarën dhe vazhdojnë të na mbështesin në rrugëtimin tonë të zhvillimit dhe të integriteteve euro-atlantike, sipas vlerave që është ndërtuar bota demokratike.

Të nderuar kolegë,

Gjendja materiale e të Punësuarve në sektorin publik ka ardhur duke u përmirësuar dhe me këtë rritje tani ajo do bëhet edhe më e dinjitetshme.

Ne nuk mund të flasim për shërbime cilësore në arsim, në shëndetësi dhe në fusha të tjera, nëse njerëzit që janë të punësuar në këta sektorë të shtetit, nuk shpërblehen realisht për punën e tyre.

Më lejoni të theksoj se rritja e pagave në sektorin e shëndetësisë do mundësojë më shumë kualitet; më shumë besim dhe më shumë shëndet për qytetarët tanë, sepse punëtorët e shëndetësisë, si edhe të sektorëve të tjerë do ta shohin se në shtetin e tyre institucionet ekzistojnë për ta përmirësuar jetën e tyre. Me këtë ne dëshmojmë se jemi të përgjegjshëm dhe të përkushtuar për të përmirësuar cilësinë e jetesës së qytetarëve tanë.

Unë kam besim se ky Projektbuxhet e fuqizon besimin e qytetarëve në institucionet e këtij shteti, në të zgjedhurit e tyre, që jemi të obliguar t'i përfaqësojmë denjësisht interesat dhe nevojat e tyre.

Të nderuar kolegë,

Të gjithë, me sa kuptoj, po pajtohemi se duhet të kemi rritje të pagave, ndërsa hezitojmë nëse institucionet tona a do të mund ta realizojnë këtë. Ne duhet ta mbështesim Qeverinë tonë që, në bashkëpunim me institucionet ndërkombëtare financiare, të gjejnë zgjidhje për t'i tejkaluar pengesat eventuale për realizimin e këtij projektbuxheti.

I kuptoj shqetësimet e atyre që mendojnë se do të kemi vështirësi dhe pengesa për realizimin e këtij buxheti, por duhet inkurajuar dhe mbështetur institucionet tona që të mobilizojnë të gjitha kapacitetet për të grumbulluar të hyrat e nevojshme për këtë buxhet, si dhe të ushtrojnë disiplinë financiare dhe me nikoqirllëk të shfrytëzojnë paratë publike, me qëllim të zhvillimit të gjithëmbarshtëm të vendit dhe të mirëqenies sociale të qytetarëve tanë. Si rezultat, ne duhet të shikojmë realisht dhe të mbështesim këtë propozim të Qeverisë dhe do të kërkoja nga të gjithë që të vlerësojmë saktë se ky Buxhet është i Kosovës, nuk është i një partie, i një grupimi apo i Qeverisë.

Ky Parlament ka marrë jo pak herë vendime të rëndësishme dhe vendimet e rëndësishme janë të vlefshme nëse merren në kohën e duhur. Koha e duhur është tani, që mos t'i lëmë edhe më tej në situatë ankthi dhjetëra mijëra punëtorë që presin vendimin tonë. Ka momente dhe hapësirë kur mund të veprojmë si subjekte politike, në kuadër të programeve tona politike. Por, ka momente kur duhet të mendojmë dhe veprojmë për interesat e përgjithshme të qytetarëve tanë dhe ta arsyetojmë besimin që na kanë dhënë. Sot duhet të veprojmë për këtë.

Ju Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ministri i Bujqësisë e ka kërkuar fjalën. Blerand Stavileci e ka fjalën.

MINISTRI BLERAND STAVILECI: I nderuari kryeparlamentar,
I nderuari kryeministër,
Kolegë qeveritarë,

Të nderuar dhe të çmuar deputetë,

Së pari, desha t'ju përgëzoj të gjithëve për diskutimet konstruktive dhe racionale, kush më shumë e kush më pak, rreth buxhetit për vitin 2011, aprovimi i të cilit përbën një lajm të rëndësishëm për Republikën e Kosovës.

Siç e dini, nevoja për zhvillimin e sektorit të bujqësisë dhe mundësitë vazhdimisht kanë qenë në disharmoni me njëra tjetrën, mirëpo edhe përkundra kësaj vlen të theksohet se viteve të fundit, sidomos tri vitet e fundit, bujqësisë ka filluar t'i kushtohet rëndësi shumë më e madhe, duke zënë vendin meritë në mesin e përparësive prioritare.

Do të mundohem që shkurtimisht të paraqes një kronologji buxhetore që nga viti 2005. Për periudhën 2008 – 2010, buxheti i Ministrisë së Bujqësisë ka qenë 33.5 milionë euro, ndërsa në periudhën 2005 – 2007 ka qenë gjithsej 17.3 milionë, që do të thotë se për tri vitet e kaluara ka pasur rritje për 93.6%.

Po ashtu, vlen të theksohet se subvencionimi i fermerëve ka filluar pikërisht në vitin 2008, pra dhe vetëm të kthehemi ... ditë mbrapa, asnjë fermer deri në atë kohë nuk ka pranuar asnjë subvencion, asnjë grand.

Përveç dyfishimit të buxhetit në mandatin e kaluar dhe fillimit të subvencionimit, sivjet përsëri do të ketë rritje të buxhetit, e cila do të ketë efekt multiplikues, sepse mundëson edhe rreth 30 milionë të tjera nga komuniteti donator, prej të cilave, potencoj, dy të tretat e tyre janë grande, pra përkrahje e drejtpërdrejtë financiare dhe buxheti i kumuluar është rreth 44 milionë.

Vetëm gjatë vitit të kaluar ka pasur mbi 12 mijë e 500 fermerë të cilët kanë përfituar nga këto skema dhe me këto investime që jemi duke bërë sivjet presim që numri i tyre të dyfishohet, pra do të ketë diku rreth 25 mijë fermerë.

Procesi i ristrukturimit dhe fuqizimit të bujqësisë është një proces i gjatë dhe i vazhdueshëm. Duke marrë për bazë shkallën e lartë të papunësisë kundrejt kushteve shumë të favorshme për zhvillimin e bujqësisë, zhvillimi i së cilës konsiderohet si mundësi e mirë për krijimin e të ardhurave shtesë dhe gjenerimin e vendeve të reja të punës, mund të konkludojmë se çdo investim në këtë sektor do të kontribuojë drejtpërdrejt në zbutjen e varfërisë.

Prandaj, zhvillimi i mëtejshëm i këtij sektori me ritmet me të cilat ka filluar, është njëri nga prioritetet strategjike të Qeverisë. Platforma e qeverisjes së mëtejshme për sa i takon politikave bujqësore do të jetë e fokusuar në ristrukturimin e qëndrueshmërisë së sektorit, në përmirësimin e jetës në zonat rurale dhe zhvillimin e kapaciteteve të nevojshme institucionale për integrimin në Bashkimin Evropian. Në këtë drejtim, si objektiva kryesore strategjike do të jenë: rritja e mbështetjes financiare për sektorin, ndërtimi i tregjeve dhe depove për grumbullimin, ruajtjen, klasifikimin dhe shitjen e produkteve

bujqësore, zëvendësimi i produkteve të importit, si dhe përkrahja dhe promovimi i produkteve bujqësore me potencial eksportuese, ofrimi i shërbimeve këshillimore falas për të gjithë fermerët e Kosovës, si dhe zhvillimi i mëtejshëm institucional si parakusht për mbështetje dhe për afrim me Bashkësinë Evropiane.

Po ashtu, për arsye se kemi shumë çështje për të diskutuar rreth bujqësisë, mirëpo me qenë se mua më vjen mirë që një pjesë e deputetëve kanë diskutuar për bujqësinë, megjithatë unë do të doja që disa prej tyre t'i korrigjoja në kuptim të dhënies së informacioneve, sidomos nënkryetarin e Komisionit dhe disa të tjerë, informacione të cilat po ashtu mund të vini çdo ditë t'i merrni edhe në Ministrinë e Bujqësisë. Për hir të korrektësisë, pra subvencionet, më duket edhe një deputete tjetër, nëse nuk gaboj, e tha, në mungesë të informacionit, nuk janë 50 euro për hektarë, janë 100 euro për hektar, shërbimet këshillimore nuk janë 3.8 milionë, ato janë grande, shërbimet këshillimore janë një segment tjetër shumë i rëndësishëm për bujqësinë dhe të cilat ne do t'i ofrojmë në të ardhmen falas për të gjithë fermerët e vendit tonë.

Pastaj, thatë se buxheti nuk ka ndryshim, buxheti ka ndryshim të dukshëm. Natyrisht që nevojat dhe kërkesat janë të shumta, mirëpo me këtë ritëm ne besojmë shumë se në të ardhmen do të ketë shumë mundësi të reja. Ne vetëm sivjet do të kemi, ju thashë edhe më herët, efektin multiplikues të këtyre investimeve rreth 30 milionë të tjera dhe edhe në momentin kur ne po bisedojmë sot, unë kam edhe një lajm se Banka Botërore një projekt të cilin e pati nisur me 10 milionë, e ka ngritur në 20 milionë, prej të cilave dy të tretat janë grande, mbështetje e drejtpërdrejtë për fermerët...

(Ndërprerje)

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Jemi marrë vesh 5 minuta! Mendoj që radha është për ministrin e financave, zotin Bedri Hamza.

MINISTRI BEDRI HAMZA: I nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Krasniqi,
I nderuari zoti kryeministër,
Të nderuar zëvendëskryeministra,
Të nderuar ministra,
Deputetë të nderuar,
Më lejoni t'ju falënderoj për diskutimet e juaja mjaft konstruktive, pjesa dërmuese e tyre, për diskutimet e juaja shumë korrekte, shumë përmbajtjesore.

I vlerësoj shumë kritikën qëllimtare të cilat janë dëgjuar gjatë këtij debati.

Me të drejtë gjatë diskutimeve janë ngrit propozime, kërkesa për më shumë fonde, edhe për bujqësinë, edhe për shëndetësinë, edhe për arsimin, edhe për rininë, edhe për kulturën, edhe sportin. Të gjitha të arsyeshme.

Është vështirë të refuzohen kërkesat e organizatave buxhetore për më shumë fonde, sepse janë me të vërtetë pjesa dërmuese e tyre të arsyeshme. Mirëpo, e thashë, po e ri përsëris, se ky është buxhet i mundësive reale të Kosovës.

Ne i kemi evidencuar me kujdesin më të madh propozimet që janë dalë nga këto diskutime, kërkesat që janë dal nga këto diskutime dhe në procesin e ardhshëm, në diskutimet e ardhshme që do të zhvillohen në mes të dy leximeve, në punën që do të bëhet brenda komisioneve funksionale të Kuvendit, ne brenda mundësive reale buxhetore do t'i trajtojmë me kujdesin më të madh.

Më lejoni, në fund, që të kërkoj edhe votën e juaj, që të kërkoj edhe përkrahjen e juaj. Kam arsye për këtë, sepse ky buxhet megjithëse të gjithë dëshirojmë që të ishte edhe më i madh, të gjithë dëshirojmë që të ishte edhe më i fuqishëm, ofron shumë elemente të cilat neve na mundësojnë dhe na bëjnë të ndihemi mirë me rastin e votimit të tij. Garanton qëndrueshmërinë fiskale me të hyra të qëndrueshme.

Është e projektuar rritja ekonomike në bazë të parametrave realë dhe në bazë të indikatorëve makro – ekonomikë, që është ndër më të lartat në Evropë. Janë trajtuar çështjet sociale, çështja e pagave, çështja e pensioneve, çështja e kategorive të dala nga lufta, Ligji i punës, Ligji për kategoritë e dala nga lufta. Gjithashtu, ky buxhet garanton edhe trendin pozitiv të investimeve kapitale për 26% më shumë se sa në vitin 2010.

Duke ju falënderuar për kontributin e juaj, duke ju falënderuar për diskutimet e juaja mjaft përmbajtjesore dhe profesionale, unë edhe një herë shfrytëzoj rastin t'ju lus që këtë projektligj ta votojmë dhe të vazhdojmë punën tutje. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Replikë! S'ta ka përmendur emrin! Hajt, Liburn, dy minuta i ke replikë!

LIBURN ALIU: Në lidhje me subvencionimin për tokën, në projektbuxhet për subvencion për kultura bimore janë 2.1 milionë, ndoshta mund të jenë dikah grande më tepër, aty është 2.1 milionë dhe janë 43 mijë hektarë tokë që janë paraqitur për subvencionim, këtë e kemi folur me komision. Kur këto pjesëtohen, del 48.83 euro, kjo është vlera. Nëse ka diçka tjetër, në rregull.

Për sa i përket informacioneve, patjetër që do të takohemi dhe do të flasim, se kemi shumë interesim për të punuar në atë aspekt. Po ashtu, njëjtë është te këto investimet kapitale, 3.8 milionë është tek shërbimet këshillimore në projektbuxhet është kjo.

(Diskutime të dorëzuara me shkrim)

RAMIZ LLADROVCI: I nderuari kryetar i Kuvendit,
I nderuari kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,
Të nderuar kolegë deputetë,

Mjetet buxhetore, përkatësisht projektbuxheti që duhet ta aprovoj ky kuvend është tepër i rëndësishëm për Kosovën që të fillojë me financim publik normal pas shfrytëzimit të instrumentit të jashtëzakonshëm të 2 të 12 –të pjesë të buxhetit të vitit 2010, dhe vazhdimin të tij edhe për muajin mars. Kuvendi duhet ta aprovoj projektbuxhetin për

faktin se ky projektbuxhet paraqet impenjimin e Qeverisë për financimin e projekteve mbi bazën e prioriteteve dhe në funksion të qëndrueshmërisë së financimit publik, zhvillimit ekonomik dhe mirëqenies sociale në Kosovë.

Projekt buxheti për vitin 2011 në dimensionin e të hyrave me rritje prej 12.3% në krahasim me vitin 2010, bazohet në vlerësimet afatmesme të indikatorëve kryesor ekonomikë dhe në vlerësimet e rritjes së performancës së institucioneve përgjegjëse për mbledhjen e të hyrave siç janë: Doganat dhe Administrata Tatimore e Kosovës. Në këtë kuadër, të hyrat tatimore në raport me 2010 janë paraparë të jenë më të larta për 18.6%.

Në dimensionin e të hyrave projektbuxheti nuk mbështetet në të hyra të pasigurta dhe ky projektbuxhet nuk është projektbuxhet deficitar dhe se rritjet e shpenzimeve mbështeten mbi bazën e dy burimeve financiarisht të sigurta. Këto burime janë rritja e performancës në luftimin e evazionit fiskal dhe privatizimi i PTK-së.

Në lidhje me burimin e parë, përkatësisht rritjen e performancës për luftimin e evazionit fiskal, do të thosha se niveli i evazionit fiskal është aq i lartë saqë një rritje e lehtë e mbledhjes së të hyrave do ta kompensonte rritjen e shpenzimeve. Inkasimi i të hyrave nga tatimet për 18.6% më shumë sesa në vitin 2010 është inkurajues duke i marrë parasysh raportet e Shërbimit Doganor të Kosovës për ngritje të të hyrave kufitare prej rreth 35% gjatë dy muajve të parë të vitit 2011, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Kur jemi te rritja e performancës së institucioneve përgjegjëse për mbledhjen e të hyrave dhe luftën e tyre kundër evazionit fiskal, dua të theksoj se minimizimi i evazionit fiskal dhe sukcesi ndaj tij do të jetë i mundur vetëm me angazhimin e të gjitha institucioneve relevante në Kosovë. Qeveria duhet të kërkojë me ngulm ndihmë nga institucionet ndërkombëtare që ta ruaj unitetin e sistemit të saj doganor dhe të mbledhë dogana në pjesën veriore të Kosovës. Kjo e drejtë është e sanksionuar me të gjitha dokumentet relevante rreth statusit politik të Kosovës. Atje Kosova humbet miliona euro në formë të kontrabandës dhe kalimeve ilegale të kufirit. Ndërsa përbrenda theksi duhet të vihet në luftimin e vizionit fiskal në formë të mashtrimit, në vend të targetimit të obliguesve tatimor dhe kompanive kosovare të cilat janë duke u munduar që t'i binden ligjit.

Burimi i dytë potencial i financimit të shpenzimeve të rritura, projekt buxheti parasheh privatizimin e PTK-së. Mendoj se përmes privatizimit të PTK-së përveç se do të përfitohen shërbime më të mira, Qeveria e heq nga vetja menaxhimin e një kompanie të tillë si PTK-ja dhe në të njëjtën kohë, sigurohen edhe fonde shtesë për ofrimin e shërbimeve më të mira, në këtë kohë kur ne na nevojiten investime. Të hyrat që sigurohen nga privatizimi i PTK-së do të përdoren për financimin e autostradës, që është faktor kyç dhe stimulans kryesor për zhvillim ekonomik dhe integrues për Kosovën. Kosova nuk duhet të heq dorë nga ky projekt që Kosovën e afron në kohë dhe hapësirë me shtetet Evropiane dhe e bën substancialisht më të disponueshme në pikëpamje të investimeve dhe qarkullimeve ekonomike. Procesi i privatizimit të PTK-së, krahasuar me shtetet tjera është proces i vonuar dhe se ky proces duhet kryer me transparencë të plotë, sipas vlerës së tregut, dhe me sigurinë e vendit të punës për punëtorët e PTK-së.

Koncepti i përgjithshëm i privatizimit të PTK-së, sikurse në të gjitha shtetet tjera, mbi të gjitha bart në vete një ideologji e cila shpreh dëshirueshmërinë për të reduktuar, zvogëluar madhësinë e sektorit publik dhe ndikimin e tij në ekonominë e tregut. Kjo tregon dëshirën për të lejuar individët, subjektet dhe ndërmarrjet private të ndërmarrin aktivitete ekonomike në masën më të madhe të mundshme për arsye të rritjes së efikasitetit në ofrimin e shërbimeve, të menaxhimit më të mirë dhe eliminimin e gravitetit të korrupsionit.

Të nderuar deputetë,

Në dimensionin e shpenzimeve kapitale projektbuxheti në pjesën më të madhe të tij është produkt i projeksioneve dhe politikave të filluara në vitin e mëparshëm, (një ngritje prej 25.6% në krahasim me realizimin e shpenzimeve për vitin 2010) me përjashtim të theksuar të rritjes së shpenzimeve rrjedhëse që kanë të bëjnë me pagat (një ngritje prej 23% në krahasim me realizimin e shpenzimeve të vitit 2010). Ngritja e shpenzimeve kapitale reflekton kryesisht implementimin e projektit të autostradës, projekt ky i cili do të shkaktojë presione fiskale për Kosovës edhe për dy vitet e ardhshme, por që padyshim do të jetë në funksion të zhvillimit ekonomik dhe integrujes të Kosovës. Rritja e shpenzimeve rrjedhëse është refleksion i rritjes së pagave të shërbyesve civilë dhe transfertave sociale për kategoritë e dala nga Lufta dhe për minatorët, ka dal si domosdoshmëri vis-a-vis standardit dhe sigurimit të dinjitetshëm të mirëqenies sociale të domosdoshme të tyre. Rritjen e pagave të mbi 75 mijë shërbyesve civilë duhet kuptuar si domosdoshmëri në raport me koston e jetës dhe në funksion të rritjes së efikasitetit të shërbimeve publike dhe pse jo edhe si ndikim indirekt në zvogëlim të hapësirave për ballafaqim me korrupsionin.

Siç jeni të informuar, nga 7 deri me 15 mars në Kosovë ka qëndruar për vizitë me qëllim të shqyrtimit të parë të aranzhmanit Stand By misioni i FMN-së. Pas vizitës misioni ka deklaruar, citoj “Diskutimet mbi buxhetin e vitit 2011 kanë avancuar, por ato nuk mund të përmbylleshin gjatë vizitës së misionit dhe do të vazhdojnë në periudhën në vijim. Njëra prej çështjeve të mbetura është rritja substanciale në shumën e pagave të sektorit qeveritar që parashihet në këtë draft buxhet. “Rimëkëmbja ekonomike është në rrugë të mbarë kundrejt një rritjeje ekonomike dhe kreditimit të sektorit privat. Rritja reale ekonomike pritet të arrijë 5.5 % në vitin 2011”.

Nga kjo mund të konkludohet se në mes të FMN-së dhe Qeverisë ka pasur dhe duhet të vazhdojë të ketë partneritet të sinqertë. Mendoj se dallimet në qëndrime rreth nivelit të pagave janë dallime jo substanciale. Dallimi konsiston vetëm në mënyrën dhe kohën e realizimit, përderisa FMN-ja është për ngritje graduale përgjatë tri viteve, opsioni i qeverisë është për ngritje të tanishme ashtu që gjatë tri viteve të ardhshme të mos ketë ngritje. Kosova duhet të vazhdojë të jetë partner i sinqertë në raport me FMN-në dhe përgjatë gjithë kohës së realizimit të buxhetit të vitit 2011 duhet të dëshmojë para FMN-së rreth kapaciteteve financiare dhe aftësive mbledhëse që ka.

Shpenzimet publike të Kosovës nga viti në vit janë rritur sepse janë rritur funksionet shtetërore të Kosovës, përkatësisht nevojat publike të saj. Shpenzimeve publike të parapara me projektbuxhet janë indikator presioni mbi institucionet përgjegjëse që të gjejnë burime për financimin e shpenzimeve. Mirëpo, nga analizimi i përmbajtjes së këtyre shpenzimeve del se ato janë paraparë mbi bazën e kriterit të nevojës dhe kriterit të dobisë së financimit të një shpenzimi publik.

Në fund, mendoj se projektbuxheti i qeverisë duhet aprovuar sepse;

- a) do jetë në funksion të zhvillimit ekonomik të Kosovës, duke bërë të mundur që përmes shpenzimeve kapitale të ndikohet në rritje ekonomike;
- b) do të jetë në funksion të stabilitetit financiar, duke bërë të mundur një financim publik të qëndrueshëm të shpenzimeve shtetërore, dhe
- c) do të jetë në funksion të zhvillimit social, duke bërë të mundur financimin e nevojave sociale të shtresave të caktuara të popullsisë për atë sa mjetet buxhetore në dispozicion e mundësojnë këtë.

BLERTA DELIU – KODRA: I nderuar kryetar i Kuvendit,
Të nderuar deputetë,
Anëtarë të Kabinetit qeveritar

Së pari, dua të theksoj se Projektbuxheti i Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2011 reflekton qartë aftësinë planifikuese dhe menaxhuese të kabinetit qeveritar, për t'ju përgjigjur nevojave dhe kërkesave që sot shtrohen para institucioneve të vendit dhe qytetarëve të Kosovës në përgjithësi.

Rritja që reflektohet në këtë projektbuxhet prej 4% në raport me vitin e kaluar, në fakt është përgjigja më e mirë ndaj të gjitha parashikimeve skeptike për rritje buxhetore, e kur kësaj i shtojmë rritjen prej 6% e të ardhurave të të gjitha sektorëve, atëherë është lehtë të vihet në përfundim se Kosova po dëshmohet me një politikë konsistence, zhvillimore dhe kemi të bëjmë me një qeverisje që përmbush zotimet para qytetarëve të vendit.

Të nderuar deputetë,

Dua të theksoj se një performancë e tillë e planifikimit buxhetor çfarë po demonstron sot, është garanci më e mirë për qëndrueshmëri dhe stimulim fiskal, prandaj konsideroj se ndarja 572 milionë apo afër 40% e buxhetit për investime kapitale është sinjal i qartë i stabilitetit financiar, çka tregon se politika qeverisëse në vend vazhdon ta ruaj trendin e ngritjes së investimeve kapitale.

Inkurajues është fakti dhe duhet të theksohet se ngritja e buxhetit në mënyrë graduale është indikator i stabilitetit dhe i zhvillimit të qëndrueshëm përkundër influencës së krizës ekonomike globale.

Përfundimisht, mendoj se serioziteti dhe përgjegjësia e lartë qeverisëse në përgatitjen e këtij projektbuxheti tregohet fare mirë me shkallën e rritjes dhe ndarjen e buxhetit në

mënyrë uniforme dhe me një shtrirje proporcionale gati thuajse në të gjitha dikasteret ministrore.

Të nderuar deputetë,

Për fund, mendoj se Projektbuxheti i Qeverisë së Kosovës për vitin 2011 është projektbuxheti më i përgatitur që kemi pasur deri më tani.

Ju faleminderit!

ELMI REÇICA: I nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Krasniqi
I nderuari z. kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës, z. Thaçi
Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Qeverisë së Republikës së Kosovës,
Të respektuar kolegë deputetë,

Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2011 vjen si rezultat i përmbylljes së një procesi shumë të rëndësishëm dhe të planifikuar mirë sipas dikastereve qeveritare, edhe pse dihet mirëfilli se vonesat e deritanishme në këtë aspekt kanë rrjedhur si pasojë e rrethanave politike. Kujtoj se të gjitha planifikimet janë bërë në harmoni me prioritetet dhe objektivat e përcaktuara nga Qeveria, ku objektivat kryesore kanë të bëjnë me mbështetjen e politikave zhvillimore, sociale e integruese. Apo, thënë në mënyrë shumë më precize, prioritetet themelore qeveritare janë një “ofensivë ekonomike”, të cilat strukturohen në këto objektiva jetike për shtetin e Kosovës gjatë këtij viti buxhetor, që janë:

- Rritja ekonomike,
- Mirëqenia sociale e popullatës drejt përmirësimit të standardit të tyre jetësor,
- Fuqizimi i kapaciteteve institucionale dhe qeverisjes së mirë dhe
- Integrimet e vendit në mekanizmat ndërkombëtarë.

Nga prioritetet qeveritare shihet shumë qartë se buxheti adreson nevojat e ekonomisë së vendit, ku ruajtja e nivelit të lartë të shpenzimeve ka pikësynim kryesor krijimin e një ambienti më stimulues dhe më nxitës për investimet private brenda vendit, por sidomos nxitjen e investimeve të drejtpërdrejta nga jashtë, dhe pa e anashkaluar edhe një nxitje të gjithanshme edhe të investimeve publike. Dikush nga aktorët kritikues mendohet dhe trumbeton se buxheti është deficitar dhe shkon në shpenzime të shumta. Është e natyrshme që çdo qeveri synon ekuilibrin buxhetor, padyshim këtë e ka orientim edhe qeveria jonë dhe besoj plotësisht se ky ekuilibër do të arrihet nga ana institucioneve tona. Por, mos të harrojmë faktin se qeveritë tona të kaluara pothuajse çdo vit ishin të ballafaquar me fenomenin e suficitit buxhetor, e cila në asnjë ekonomi nuk është e pranueshme për ecjen e zhvillimeve ekonomike, e posaçërisht ekonomisë tonë, e cila ishte dhe është e etshme për para në drejtim të funksionalitetit ekonomik.

Unë kujtoj se buxheti i këtij viti pikërisht në destinacionin e shpenzimeve ka pikësynimin kryesor që të shkojë drejt përmirësimit të klimës investuese, drejt hapjes së mundësive të “paradhomave investuese” që janë infrastruktura rrugore dhe ajo energjetike, por edhe

drejt ruajtjes dhe përmirësimit të standardit jetësor të popullatës (që ishte një e ashtuquajtur kritikë nga partitë opozitare për këtë destinim të rritjes së pagave në sektorin publik, e harronin që ata vetë gjatë fushatave zgjedhore premtorin rritje pagash edhe deri në 100%).

Edhe objektivat tjera qeveritare që kanë të bëjnë me fuqizimin e kapaciteteve institucionale për Kosovën janë shumë të mirëseardhura, ngase dihet mirëfilli se në vendin tonë që nga periudha e pasluftës e këtej kemi pasur fenomene “jashtë ekonomike” që kanë përkeqësuar raportet e brendshme ekonomike. Ngase lufta e institucioneve në këtë drejtim besoj fuqishëm se hap dyert e investimeve të jashtme direkt, por edhe bën qasjen e integritimit të vendit tonë në organizmat ndërkombëtarë shumë më lehtë dhe më efektshëm. Në këtë kontekst unë propozoj që një shumë e caktuar e mjeteve buxhetore të ndahet edhe në këtë drejtim, duke përfunduar me asistencë profesionale humane e teknike mekanizmat relevant të instrumenteve politike ekonomike (inspektionin tatimor dhe inspektoratet tjera, PK, organet doganore, e pse jo edhe të themelohen mekanizma tjerë profesionalë që do të angazhoheshin në këtë drejtim), sepse tek e fundit të hyrat që do të sillleshin nga kjo “luftë me ekonominë informale dhe evazionin fiskal” jo vetëm që do të plotësonin shumën e përcaktuar nga Kryeministri dhe Qeveria për rritje pagash në sektorin publik, por edhe do të mbushej edhe më shumë arka shtetërore, pa e anashkuar fenomenin e krijimit të mirëbesimit në institucionet, nga bizneset që punojnë ndershëm, por edhe nga ana e qytetarëve tanë.

Në këtë buxhet shumë mirë është e adresuar edhe çështja e mirëqenies sociale të kategorive të rrezikuara të popullatës. Konsideroj se hapat drejt përmirësimit të pozitës sociale të këtyre kategorive duhet shkuar drejt përfundimit dhe reformimit të politikave sociale, sepse në këtë aspekt jam plotësisht i bindur se kemi edhe përkrahjen e fuqishme të donatorëve ndërkombëtarë, të cilët presin nga ne të ofrojmë projekte sociale. Jam i bindur se në këtë drejtim do të mund të bënim shumë më tepër, dhe nga mjetet e brendshme dhe ato të huajtura të donacioneve dhe ndihmave nga jashtë, me angazhimin e potencialeve tona dhe asistencës tjetër profesionale, do të mund të krijojmë jo objektiva për ruajtjen e “status quos” në këtë drejtim (duke u dhënë asistencë sociale), por do të krijojmë nga ata njerëz sistemin e punëzënies përmes projekteve sociale të punësimit, nga e cila do të lehtësohej barra e shportës sociale dhe do të vijmë deri tek zbutja e varfërisë së skajshme dhe të “varfërisë normale”.

Reformat sociale do të mund të bënim edhe në drejtim të kategorive tjera sociale të mbajtura, duke u ofruar atyre programe sociale drejt profesionalizimit dhe gjetjes së mundësive më të mira sociale për t’u bërë pjesë e tregut prodhues e konsumues jetësor.

Konsiderohej thellësisht se çdo qeveri në botë ka këto prioritetet buxhetore në politikën e saj qeveritare. Çdo qeveri synon përmirësimin e standardit jetësor të popullatës së vet dhe normalisht edhe rritjen ekonomike. Këto synime i ka edhe qeveria jonë.

Edhe pse plani i shpenzimeve të tërësishme mund edhe të quhet ambicioz, duke pasur parasysh se tejkalon nivelin e të hyrave të rregullta për vitin buxhetor, jam plotësisht i bindur se planifikimet buxhetore do të shërbejnë si nxitje për vlerësimin e mundësive

alternative të financimit (posaçërisht të hyrat që do të inkasoheshin duke luftuar informalitetin dhe evazionin fiskal, por edhe dukuritë tjera negative ekonomike), si dhe ruajtja dhe përforcimi i bashkëpunimit me institucionet financiare ndërkombëtare (FMN, BB dhe institucionet tjera), të cilat kujtoj se do të shprehin mirëkuptimin për objektivat tona makroekonomike e sociale, dhe do të kemi mbështetjen e tyre, edhe pse nga disa kjo trumbetohet se është humbur, por, besoj se ekzistojnë mekanizmat dhe mundësitë për riprogramime të nevojshme me këto institucione, të cilat kanë mirëkuptim për vendet që kanë probleme sociale, zhvillimore – ekonomike. Dhe, se bashkëpunimi në këtë drejtim, jo vetëm që është i rëndësishëm, por edhe i domosdoshëm për vendin tonë.

Është inkurajues fakti që edhe përkundër prezencës së krizës ekonomike botërore gjatë vitit të kaluar, vendi ynë ishte ndër të rrallët që shënoi rritje ekonomike të konsiderueshme, dhe se të hyrat vendore dhe ato nga kufiri nuk janë ndikuar nga kjo krizë. Edhe sistemi bankar tregon shenja të një stabiliteti monetar, prapë them përkundër fenomeneve jo të mira që kishin në tregun financiar global. Ekonomitë e të gjitha vendeve në Evropën Juglindore shënuan rënie nga më e larta prej 5.8% e regjistruar në Kroaci deri në më të ulëtën 0.8% në Maqedoni. Edhe viti 2010 nuk rezultoi të jetë pozitiv për të gjitha vendet në këtë regjion, ku Kroacia, Rumunia dhe Mali i Zi vazhduan të kenë rritje negative të BPV-së, kurse ekonomia e vendit tonë shënoi rritje pozitive, gjë që është shumë inkurajuese.

Nëse shikojmë në Projektionet ekonomike për periudhën 2011-2013, ato tregojnë për një rritje mesatare të GDP-së prej 5.1%. Kjo rritje është parashikuar të udhëhiqet nga rritja e konsumit, eksporteve dhe investimeve. Kontributin më të rëndësishëm në rritjen e GDP-së, brenda periudhës së parashikuar, pritet të vijë nga rritja e investimeve, si private e po ashtu edhe ato publike. Investimet private parashikohen të rriten me një normë mesatare vjetore prej rreth 13.4%, duke stimuluar rritjen ekonomike përgjatë periudhës raportuese. Në ndërkohë, kontribuues tjetër i rëndësishëm në ngritjen e normës së zhvillimit ekonomik do jetë ngritja e investimeve publike, të cilat në mesatare pritet të kenë një pjesëmarrje prej 12% në GDP (Bruto Produktin Vendor).

Në anën tjetër, sipas parashikimeve ekonomike nga qeveria, eksportet parashikohet të rriten gradualisht dhe pjesërisht ta kompensojnë rritjen e importeve. Si rezultat, bilanci negativ tregtar me jashtë parashikohet të bije, dhe për pasojë më pas do të kemi përmirësime në balancimet ekonomike midis eksporteve dhe importeve.

Për ndryshim nga pritjet dhe zhvillimet e mëhershme, indeksi i çmimeve të konsumit pritet të rritet gjatë vitit 2011, çka reflekton rritjen e çmimeve të importit dhe sjellin më pas inflacionin (dukuria e rritjes së çmimeve të importit dhe sjellin më pas inflacion i importuar), që nuk varet nga ne, por nga pasojat e ekonomisë globale (vetëm tronditjet politike në vendet e Lindjes së Afërt dhe Afrikë sjellin tronditje në çmimin e naftës dhe derivateve kësaj, që natyrshëm trondit edhe ekonominë e vendit tonë. Prandaj, kujtoj se planifikimet për rritje pagash nga ana e qeverisë janë në përputhshmëri të plotë në destinacion të ruajtjes së ekuilibrit social dhe shportës qytetarë të konsumatorit.

Parashikimi i indikatorëve makroekonomikë tregon se ekonomia e Kosovës pritet të shënojë një rritje mesatare prej afro 5% gjatë vitit 2011. Ky ritëm pozitiv i rritjes pritet të mbështetet nga politika ekspansioniste fiskale, ndërkohë që investimet private dhe eksportet parashihen të vijojnë me një rritje relativisht të qëndrueshme gjatë tërë periudhës parashikuese. Kjo rritje rezulton nga rritja e eksportit, investimeve dhe konsumit, kryesisht atij publik që vije si rezultat i rritjes së pagave në sektorin publik, dhe efektit të tij shumëfishues në ekonominë e Kosovës.

Konsumi privat gjatë periudhës së parashikuar pritet të rritet me një normë mesatare vjetore prej rreth 5%, që rezulton nga rritja modeste e remitancave si dhe lehtësimi i kredive për konsumatorë. Kjo reflektohet në një masë relativisht të madhe edhe në rritjen e vazhdueshme të importit të mallrave. Konsideroj se në këtë pikë do të mund të bënim edhe shumë, sidomos në përmirësimin e qasjes së institucioneve ndaj diasporës, sepse të hyrat nga remitancat janë një industri në vete, dhe nëse në ofrojmë projekte konkrete në ndihmë atyre (përmes këshillave ekonomike brenda vendit gjatë ardhjes së tyre në sezonin veror, dhe këshillimeve përmes formave të ndryshme jashtë vendit që do të organizoheshin nga misionet tona diplomatike jashtë vendit), atëherë padyshim të hyrat buxhetore do të mund të shumëfishoheshin dhe do të reflektohen edhe në investime dhe më pas në konsumin investiv, e jo në konsumin luksoz (dasma, ahengje, turizëm veror, sepse nuk kanë se ku t'i shpenzojnë tjetërkund mjetet).

Për sa u përket investimeve private, ato parashihet të rriten me një normë më të lartë në krahasim me vitet paraprake. Në veçanti investimet private pritet të rriten me një normë vjetore mesatare prej afro 13%, rritje kjo e cila rrjedh nga përmirësimi klimës së biznesit, lehtësimi i aktivitetit kreditor (i cili ishte tkurrur përgjatë krizës ekonomike botërore), si dhe nga rimëkëmbja e kërkesës së brendshme pas tejkalimit të efekteve të pjesshme të krizës ekonomike dhe financiare.

Nga ana tjetër, investimet publike parashikohen të rriten me një normë mesatare vjetore prej afro 9%. Këto investime konsiderohen të jenë edhe shtytësit kryesorë të rritjes së kërkesës agregate në veçanti gjatë vitit 2011. Padyshim që rritja më e theksuar e tyre pritet të ndodhë gjatë vitit 2011, kur ato pritet të arrijnë vlerën prej 572 milionë eurosh, apo të shënojnë një ngritje prej rreth 25% krahasuar me vitin 2010.

Sa i përket strukturës buxhetore të të hyrave, konsideroj se të hyrat e përgjithshme buxhetore për vitin 2011, që pritet të arrijnë shumën prej 1,264 milionë euro, japin shenja inkurajuese sepse ato janë rreth 12.3% më të larta se sa në vitin 2010. Pjesë e të hyrave të përgjithshme buxhetore për vitin 2011, ngjashëm me vitin 2010, është dividendat në vlerë prej 45 milionë euro, e cila pritet të deklarohet nga PTK dhe ANP. Ndërsa të hyrat tatimore, të cilat përfshijnë të hyrat nga tatimet në kufi dhe të hyrat nga tatimet brenda vendit pritet të arrijnë shumën prej 1,060 milionë euro, duke shënuar një rritje prej rreth 18.6% krahasuar me vitin 2010. Ndërsa që të hyrat jo-tatimore dhe të hyrat vetanake (komunale dhe qendrore), gjatë vitit 2011 pritet të arrijnë vlerën prej 159 milionë euro, duke shënuar një ngritje prej rreth 7.8% krahasuar me vitin 2010.

Të hyrat nga kufiri për vitin 2011 pritet të jenë 831 milionë euro, apo prej 19% më të larta krahasuar me vitin 2010, që po ashtu është mjaft entuziazmuese. Ky nivel i parashikuar i rritjes së të hyrave nga kufiri vjen si rezultat i supozimit të rritjes së investimeve kapitale gjatë vitit 2011.

Të hyrat vendore për vitin 2011 pritet të jenë 261 milionë euro, apo për 17.9% më të larta krahasuar me vitin 2010. Edhe kjo e dhënë tregon shenja të përmirësimeve të dukshme ekonomike e fiskale.

Jam i mendimit se thelbi i buxhetimit kualitativ duhet të qëndrojë edhe në ruajtjen e baraspeshës midis të hyrave dhe shpenzimeve brenda vitit, në mënyrë që të ruhet ekuilibri buxhetor makroekonomik. Për më shumë, ne duhet të jemi shumë të përkushtuar në ruajtjen e rezervave financiare, që është krijuar me këshillën FMN-së, rezervë kjo që na shërben si masë mbrojtëse ndaj efekteve të krizave eventuale (inflacioni apo dukuritë e tjera jo normale ekonomike) me të cilat mund të përballlet ekonomia e Kosovës.

Duke besuar fuqishëm se ky buxhet është më i miri i mundshëm për rrethanat dhe fuqinë ekonomike të cilën e kemi aktualisht, bëj ftesë që të votohet nga të gjithë deputetët e nderuar, në mënyrë që t'i mundësojmë Qeverisë dhe resorëve përkatës të saj që t'i përvishem punës dhe të vazhdojmë projektet e filluara që më parë dhe njëherësh të nisim projektet e reja ekonomiko – zhvillimore të cilat janë jetike për ecjen përpara të vendit tonë.

LUMNIJE MORINA: I nderuari kryetar i Kuvendit,
I nderuari kryeministër,
Zv. kryeministra, ministra,
Të nderuar kolegë deputetë,

Dua ta shpreh edhe unë mendimin tim lidhur me Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës, i cili na është ofruar sot për shqyrtim. Mendoj se ky projektbuxhet është hartuar me profesionalizëm të kënaqshëm dhe përkushtimin e nevojshëm për një parashikim dhe planifikim realisht, objektiv, por edhe progresiv dhe kjo është shumë e qartë dhe e dukshme kur shikohet parashikimi, planifikimi dhe ndarja e tij sipas organizatave buxhetore të Republikës së Kosovës.

Po ashtu, ky projektbuxhet tregon në mënyrë shumë të qartë dhe të dukshme angazhimin dhe përkushtimin e vendosur dhe të paluhatshëm të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndërtimin e një Kosove Evropiane; për një qeverisje të mirë, efikase dhe fektive; për rritjen e investimeve kapitale, aq sa e lejojnë mundësitë buxhetore; për rritjen e mirëqenies sociale për disa kategori të shoqërisë me gjendje më të rëndë ekonomiko – sociale.

Mbajtja e premtimit të Qeverisë për rritjen e pagave, tashmë gjendet i projektuar në projektbuxhetin për vitin 2011, i cili është një projektbuxhet realisht objektiv, optimist dhe progresiv dhe, si i tillë, duket të përkrahet dhe mbështetet nga të gjithë deputetët sepse është për të mirën e vendit dhe të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Familjet e dëshmorëve, veteranët e luftës, invalidët e luftës, punëtorët e arsimit, të shëndetësisë shërbyesit civilë, policët, zjarrfikësit, oficerët, doganorë, shërbyesit korrektues dhe sprovues si dhe pensionet për minatorë, me aprovimin e projektbuxhetit do t'i kenë pagat me rritje, ashtu siç u janë premtuar.

Siç po shihet, qeveria është e vendosur dhe e përkushtuar për trajtim të dinjitetshëm të të gjitha kategorive të shoqërisë, duke pasur parasysh edhe prioritetet plotësisht të arsyeshme për kategoritë e lartpërmendura, të cilat deri tash nuk e kanë pasur trajtimin adekuat.

Sot, kur po shqyrtojmë Projektbuxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011, e gjithë vëmendja e qytetarëve të vendit është drejtuar nga mbledhja e Kuvendit, duke pritur me ankth se çfarë do të vendosim ne për fatin e tyre për këtë vit. Unë mendoj se vetëm miratimi i projektbuxhetit është në përputhje me pritjet e të gjithë qytetarëve të vendit tonë nga ne dhe jam e bindur se vendimi ynë për miratimin e këtij projektbuxheti do të jetë vendim realist, objektiv, progresiv dhe në përputhje me interesin e të gjithë qytetarëve të vendit tonë dhe të ardhmen më të mirë të tyre dhe të vendit.

Të nderuar deputetë, ne jemi këtu për t'iu shërbyer qytetarëve dhe vendit, dhe në këtë rast, unë mendoj dhe jam e bindur se shërbimin tonë do ta kryejmë vetëm duke e miratuar këtë projektbuxhet. Në të kundërtën, nuk do ta arsyetonim besimin që na e kanë dhënë qytetarët për t'ju shërbyer atyre dhe vendit.

Ju faleminderit për vëmendje!

HASIME KRASNIQI: I nderuari zoti kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,
I nderuari zoti kryeministër, zëvendëskryeministra
Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë,

Sikurse kolegët e mi, edhe unë e mbështes fuqishëm projektbuxhetin e propozuar për vitin 2011.

Besoj dhe jam e bindur se edhe viti 2011, do të jetë një vit i suksesshëm nga pikëpamja e rritjes ekonomike.

Po ashtu, edhe pasqyrat makroekonomike dhe projeksionet për vitin 2011 – 2013, tregojnë një rritje mesatare të Bruto Produktit Vendor, ku rritja parashihet të udhëhiqet nga rritja e konsumit, eksportit dhe investimeve.

Duke pasur parasysh se si indikatorë i ecurive paraqitet edhe rritja e të hyrave të projektuara buxhetore për këtë vit, dhe argumentohet në vlerësimet afatmesme të indikatorëve kryesor ekonomikë, sidomos në performancën e mirë të treguar qysh në fillim të vitit, si te doganat e Kosovës, ashtu edhe të Administrata Tatimore e Kosovës.

Nga të hyrat e përgjithshme buxhetore për vitin 2011, shihet se ka një parashikim më të mirë se në vitin 2010, që do të ketë një rëndësi shumë të madhe për këtë projektbuxhet të propozuar, dhe besoj në qëndrueshmërinë e burimeve financiare të planifikuara.

Sa i përket shpenzimeve buxhetore, edhe gjatë këtij viti shihet se janë projektet kapitale ato që dominojnë, gjë që është normale.

Po ashtu, edhe rritja e pagave për shërbyesit civilë dhe kategoritë tjera nuk ka influencuar aspak në shkurtimin e shpenzimeve për projektet kapitale, si dhe kategoritë tjera të shpenzimeve.

Më vjen mirë që si deputete e Kuvendit të Kosovës kam mundësinë të jap mbështetjen time vendimit të kryeministrit dhe Qeverisë për ngritjen e pagave, vendim i cili është për përmirësimin e mirëqenies sociale të qytetarëve të Republikës së Kosovës, që për mua është prioritet.

Ju faleminderit!

LATIF GASHI: I nderuari kryetar,
I nderuari kryeministër, zëvendësministra, ministra,

Të nderuar deputetë,

Në këtë Projektligj për buxhetin e Republikës së Kosovës është paraqitur një standard i ri konform nevojave aktuale të vendit, për hartimin e të cilët është këshilluar Fondi Monetar Ndërkombëtar, përfaqësuesit e të cilit kanë vlerësuar performancën ekonomike dhe atë të sektorit financiar, diskutimet mbi buxhetin e vitit 2011 kanë avancuar. Këta përfaqësues gjithashtu kanë vlerësuar se rimëkëmbja ekonomike është në rrugë të mbarë kundrejt një rritje ekonomike dhe kreditimit të sektorit privat. Sipas tyre, rritje ekonomike pritet të arrijë 5.5 për qind në vitin 2011.

Sistemi bankar mbetet stabil dhe me kapital të mjaftueshëm në përgjithësi.

Po ashtu, ka pasur këshillime me grupe parlamentare, komisione parlamentare, që të inkorporojnë rekomandimet dhe propozimet e tyre në buxhet.

Duke pasur parasysh kohën dhe rrethanat, është për t'u përshëndetur ministri i Financave për mënyrën e hartimit, prezantimit të mirë, transparent dhe praktik të këtij projektligji.

Gjithashtu, është për t'u përshëndetur vendimi i Qeverisë për ngritjen e pagave:

1. Për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës prej 50%
2. Për Policinë e Kosovës prej 40%, prej 30%
3. Për Shërbimin Korrektues dhe Shërbimin Sprovues
4. Për shërbyesit civilë
5. Për oficerët doganorë dhe për personelin e Administratës Tatimore
6. Për sektorin e shëndetësisë.
7. Për zjarrfikësit

8. Si dhe ngritjen e pensioneve për minatorët sipas memorandumit të mirëkuptimit.

Të nderuar deputetë, ky vendim i qeverisë është progresiv, hap shtigje dhe fronte të reja duke ndërruar realitetin e mjerueshëm në Kosovë.

Ky realitet duhet ndërruar nga se është i pa durueshëm, mendoj se për këtë të gjithë pajtohemi edhe pse nga disa shihet se është i pa mundur, ashtu siç mendonin edhe për realitete tjera se janë të pa mundura të ndryshohen dhe qëndronin në vendnumërim.

Pra, nuk është lehtë, duhet së pari vetëdisiplinë, vetëpërgjegjësi, ballafaqim me probleme aktuale si pasojë e dëmeve dhe shkatërrimit të ekonomisë nga lufta.

Duhet një plan ambicioz i detajuar rreth ekonomisë informale, importeve të kontrabanduara që dëmtojnë bizneset e rregullta e në veçanti portat 1 dhe 31 të kufirit në veri të vendit tonë.

Duhet marrë masa të rrepta ndaj atyre që i shmangen pagim-tatimit, pa pasur nevojë për ngritje të normës tatimore, por vetëm me zgjerim të bazës tatimore.

Duhet kërkuar përgjegjësi të lartë të menaxhimit racional të buxhetit nga të gjitha institucionet e vendit.

Kosova po kalon fazën e tranzicionit të zhvillimit të saj, disa procese të ndjeshme që janë të domosdoshme të ndodhin, siç është privatizimi i ndërmarrjeve publike, të cilat procese duhet të jenë transparente. Kujdes të veçantë duhet të kenë për çmimin e privatizimit, për statusin e punëtorëve të këtyre ndërmarrjeve.

Të nderuar deputetë,

Rritja e pagave është e realizueshme dhe pa pasoja negative, por përkundrazi me pasoja shumë pozitive në ngritjen e përgjegjësisë të këtyre nëpunësve dhe të mirëqenies sociale të më se 70.000 familjeve të tyre.

Gjithashtu, është inkurajues edhe fakti se investimet kapitale do të kenë një trend pozitiv dhe do të jenë më të larta se sa viti paraprak

Ne e dimë se nevojat e Kosovës janë të mëdha, por edhe ky buxhet do të mundësojë një funksionim normal të shtetit të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Jemi tash në përfundim, por para se të votojmë, po e lexoj nenin 51 të Rregullores, paragrafi 3, bile pjesën e dytë të paragrafit 3:

“Ligjet, vendimet dhe aktet e tjera të Kuvendit konsiderohen të miratuara nëse për to votojnë shumica e deputetëve të pranishëm dhe që votojnë. Përjashtim bëjnë rastet kur në Kushtetutën e Republikës së Kosovës parashihet ndryshe”.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash, në parim, Projektligjin për buxhetin e vitit 2011. Prezentë janë 107 deputetë.

Konstatohet se me 67 vota “për”, 35 “kundër”, 2 “abstenime”, Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011.

Në bazë të Rregullores së Kuvendit, ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa, si komision funksional, si dhe komisionet e përhershme për ta shqyrtuar Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011, dhe Kuvendit t’i paraqesin raportin me rekomandime në afatin më të shpejtë të mundshëm. Dita e fundit, që mendoj duhet të miratohet ligji, është 31 mars i vitit 2011.

Komisionet funksionale mund ta shqyrtojnë Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011 nga aspekti i fushëveprimeve të tyre dhe amendamentet eventuale t’i paraqesin Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa.

Faleminderit për debatin dhe miratimin!

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i Propozim - vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Komisionin Qendror për Regjistrimin e Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave**

Komisioni funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media e ka shqyrtuar Propozim - vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Komisionit Qendror për Regjistrimin e Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Nëse ju jeni dakord, shkojmë menjëherë në procedurën e votimit. Mirë, atëherë përfaqësuesi i Qeverisë e ka fjalën. Ministri Mahir Yagcillar e ka fjalën.

MINISTRI MAHIR YAGCILLAR: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuari kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

Në bazë të Ligjit të regjistrimit, Qeveria propozon Komisionin Qendror të Regjistrimit, i cili duhet ta drejtojë dhe mbikëqyrë përgatitjen, organizimin dhe kryerjen e regjistrimit.

Komisioni Qendror i Regjistrimit përbëhet nga kryesuesi dhe 16 anëtarë të tjerë. Është propozimi i dërguar më herët, por ndërkohë besoj se kanë ndodhur edhe ndryshime në fazën e emërtimit të komisionit, por është propozimi i Qeverisë të procedohet më tutje në miratim në Kuvendin e Kosovës. Emrat janë në dokumentacionin e të gjithë deputetëve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Kryetari i Komisionit për Arsim, deputeti Idriz Vehapi e ka fjalën. Regjia, fjalën deputetit Idriz Vehapi.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Në pajtim me nenin 62.1 dhe 67 të Rregullores së Kuvendit të Kosovës, si dhe nenin 12.2 dhe 12.5 të Ligjit për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, si komision funksional, në mbledhjen e mbajtur më 21 mars 2011 vendosi që Kuvendit ti paraqet këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit të Kosovës të miratojë Propozim - vendimin e Qeverisë për emërimin e anëtarëve për Komisionin Qendror të Regjistrimit të Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave, me këtë ndryshim, si vijon:

Të zëvendësohet zoti Naip Vranezi, anëtar i Entit të Statistikave të Kosovës, me zotin Ibrahim Shabani, kryeshef i Entit të Statistikave të Kosovës.

Arsyetim:

Komisioni, gjatë shqyrtimit të Propozim - vendimit të Qeverisë lidhur me emërimin e anëtarëve për Komisionin Qendror të Regjistrimit të Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave ka shqyrtuar edhe propozimin e Qeverisë, përkatësisht të Ministrisë së Administratës Publike për zëvendësimin e zotit Nait Vranezi, anëtar i Komisionit Qendror të Regjistrimit, përfaqësues nga Enti i Statistikave të Kosovës, me zotin Ibrahim Shabani.

Meqë Nait Vranezi ka dhënë dorëheqje nga Enti i Statistikave të Kosovës, Ministria e Administratës Publike konform nenit 12.5 të Ligjit për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave ka propozuar anëtarin e ri, zotin Ibrahim Shabani, kryeshef i Entit të Statistikave të Kosovës, kryeshef aktual.

Të nderuar deputetë, propozoj të miratohet ky propozim - vendim me ndryshimin e propozuar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Lidhjes Demokratike, kush e kërkon fjalën? Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, shumë, kryetar!

Me gjithë respektin për kryetarin e Komisionit dhe për Komisionin, këtu kemi të bëjmë me emërimin e anëtarëve të Komisionit Qendror të Regjistrimit të Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave, propozim i ardhur nga Qeveria e Kosovës, jo vetëm ky ndryshim që është paraqitur apo jepet si rekomandim, por si komision në tërësi.

Ne edhe në vitin 2008 kemi votuar një komision qendror prej të gjithë anëtarëve, ndërsa komisioni është riemëruar apo është emëruar me 7.12.2010, domethënë kuptohet nëse kujtohet data e zgjedhjeve, i bien dy ditë para zgjedhjeve nacionale.

Çështja e dytë që ka të bëjë, është me nenin 22, ku thuhet, Qeveria e Kosovës, kuptohet për Ligjin për regjistrimin e popullsisë, brenda 15 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji i paraqet për miratim Kuvendit të Kosovës anëtarët e Komisionit Qendror të Regjistrimit, ndërsa sot jemi kuptohet me 25 mars.

Neni 24 i po të njëjtit ligj, thotë, obligohet Komisioni Qendror i Regjistrimit që 3 muaj para fillimit të datës së regjistrimit t'i aprovojë pyetëtorët dhe dokumentacionin përkatës për regjistrim, në harmoni me dispozitat e këtij ligji.

Tash, neve vijmë në lajthitje, cili komision i ka bërë, do të thotë, pyetëtorët dhe dokumentacionin, komisioni paraprak që ka qenë, komisioni ky që është emëruar pa vendimin, do me thënë pa e marrë votën e Kuvendit.

Dhe, çështja e tretë, ka të bëjë me deputetin Fikrim Danka, nga komunitetet tjera në Kosovë, a ka të drejtë deputeti që të jetë në komisionet qeveritare. Andaj, unë i ngre me shqetësim këto hipoteza dhe nuk dua që..., duhet të jetë edhe komisioni shumë parimor, të jepet kjo kronologji pse është vonuar, të jepet arsyeshmëria pse është ndërruar komisioni i cili ka qenë dhe si ka ardhur deri te ky ndryshim. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Në emër të “Vetëvendosjes”, deputeti Afrim Hoti e ka fjalën.

AFRIM HOTI: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Regjistrimi i popullsisë është një proces i rëndësishëm, i cili shërben si bazë për planifikim dhe zbatimin e politikave të përgjithshme zhvillimore në vend me karakter politik, ekonomik, social, kulturor. Sipas këtij procesi, përcaktohet se çfarë përbërje të popullsisë ka në Kosovë, përfshirë edhe aspektet socio - ekonomike të saj. Për këtë arsye, është shumë e rëndësishme që ky regjistrim të reflektojë kontekstin ekonomik, social, politik dhe historik të vendit dhe të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare për regjistrimin e popullsisë.

Ajo çka kemi parë deri më tani nga ky proces, na bën të brengosemi sepse baza ligjore, aspektet organizative teknike dhe paqartësitë mbi pronësinë e këtij procesi mund të sjellin pasoja politike afatgjate për rendin tonë.

Ky regjistrim thuhet se do të bëhet pazar me Ligjin për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave, por në anën tjetër fare nuk i bëhet e ditur qytetarëve të vendit se ai në fakt bëhet edhe sipas pakos së Ahtisarit, e më konkretisht, i bazuar në Propozimin gjithëpërfshirës për marrëveshjen për statusin e Kosovës, të datës 2 shkurt 2007.

Në nenin 14 pika 1 të kësaj pakoje thuhet qartë se regjistrimi i popullsisë do t'i nënshtrohet vëzhgimit ndërkombëtar dhe se i lejohet Republikës së Serbisë dhe vendeve tjera përreth ta autorizojnë regjistrimin, përmes një agjencie ndërkombëtare të, siç thuhet, atyre refugjatëve dhe personave të zhvendosur që dëshirojnë të kthehen në Kosovë.

Ky nen krijon standard të dyfishtë, sepse gjersa në njërën anë Ligji për regjistrimin e popullsisë ia mohon regjistrimin si rezident bashkatdhetarëve, sipas të cilit, në kuadër të popullsisë rezidente futen vetëm individët që kanë jetuar për një periudhë kohore më shumë se 12 muaj para ditës së regjistrimit.

Në anën tjetër, përmes këtij neni u jepet mundësia që të regjistrohen si banorë të Kosovës të gjithë serbët që regjimi i Millosheviqit i pat zhvendosur në Kosovë...

KRYETARI: Afrim, ju lutem, nuk e kemi në rend të ditës këtë, e kemi komisionin, ju lutem!

AFRIM HOTI: ... gjatë luftërave në Kroaci e në Bosnje, e të cilët nuk jetojnë në Kosovë.

Neni 3 pika 1.2 e Ligjit për regjistrimin e popullsisë flet për listën suplementare që do të përdoret për të regjistruar popullsinë jo rezidente, që në këtë rast është fjala për bashkatdhetarët tanë të cilët punojnë jashtë vendit.

KRYETARI: Deputet, nuk je në rend të ditës!

AFRIM HOTI: Kjo listë e ka vetëm një funksion, atë të mashtrimit të opinionit... që të dhënat e saj nuk futen në numrin e përgjithshëm të popullsisë, por kjo formë e regjistrimit të bashkatdhetarëve bëhet për të krijuar përshtypjen që edhe ata do të jenë pjesë...

KRYETARI: Regjia, ia ndërpret fjalën deputetit! S'je në rend të ditës, shko në vend. Mos ta teprojmë tash këtu, jemi, një komision e kemi, është plotësuar komisioni, komisioni ka qenë prej fillimit, mendoj se deputetët që kanë qenë në mandatin e kaluar duhet ta dinë.

Në emër të AAK-së, kush e do fjalën? Faleminderit!

Në emër të Koalicionit Kosova e Re? Deputeti Ibrahim Makolli e ka fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryetar!

Si duket, këtu nuk është diçka në përputhje me propozim - vendimin që e ka sjellë Qeveria dhe me rendin e ditës, sepse atje thuhet për zëvendësimin e një anëtari që vjen drejtpërdrejt nga pozita që e ushtron, kryeshefin e Entit të Statistikave, ndërkaq në rend të ditës është emërimi i anëtarëve të komisionit. Anëtarët e komisionit ekzistojnë, janë miratuar në këtë Kuvend, ndërkaq tash kemi të bëjmë vetëm me zëvendësimin e një anëtari në këtë komision dhe asgjë më shumë. Të faleminderit!

KRYETARI: Shikoni, kur e kemi miratuar më herët këtë komision, ka pas 11 anëtarë, tani janë bë disa ndryshime, janë bërë disa ministri dhe tash kemi me emra e mbiemra të ri edhe të njerëzve që i kanë ndërruar funksionet, prandaj kemi për ta miratuar një

komision, që është plotësim i komisionit dhe që faktikisht ai e ka krye punën e vet, por megjithatë formalisht ne duhet ta kryejmë këtë formalitet edhe për faktin se Parlamenti – Kuvendi nuk ka funksionuar, ju e dini kur është bërë shpërndarja e tij. Kjo është një çështje që duhet ta kuptojmë ose deputetët e mandatit të kaluar e dinë se pse është ky ndryshim. Urdhëro, Sabri Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Është mirë që të sqarohen sendet në Kuvend. Nuk ka nevojë të krijohen mosmarrëveshje për sendet që janë të qarta. Është e vërtetë që raporti i Komisionit lë përshtypjen, sepse është i ndërtuar keq raporti që na u paraqit, që problem është sepse është ndërruar një njeri. Nuk është kjo. Këtu propozohet një komision i tërë, që Kuvendi duhet ta votojë.

Ndërkohë, ashiqare Qeveria e ka gjetur një njeri në listën që e ka propozuar që duhet të ndërrohet, ky është problem tjetër.

Ne sot këtu votojmë për një komision. Është çështje krejt tjetër që ky komision thotë që Qeveria e ka ndërtuar në dhjetor dhe vjen të aprovohet sot.

Unë, si institucionalit, mendoj që nëse duhet të bëhet një regjistrim, duhet të ketë një komision dhe s'hezitohet që të them se duhet të ndërrohet komisioni dhe do ta votoj komisionin.

Problemi është që Qeveria nuk po shpjegon, në këtë rast, ministri i resorit. Duhet të dilet në Kuvend, t'i thuhet këtij Kuvendi - po, është zgjeruar komisioni, është bërë në bazë të filan nenit të filan ligjit, komisioni është profesional, nëse është, është komision i deleguar prej institucioneve, të gjithë deputetët kanë të drejtë t'i dinë këto shënime dhe është normale që në një Kuvend, ku votohet një komision i tillë, të bëhen këto njohuri.

Dhe, unë edhe një herë po lyp, nëse ministri i ka këto informacione, le të dalë, le të thotë, filani është prej këtij institucioni, fisteku prej këtij dhe ne do ta votojmë komisionin, sepse nuk ka logjikë të mos votohet komisioni.

Është punë krejt tjetër, që ju e dini shumë mirë, që jemi ngutur ta kalojmë atë ligj gjashtë muaj përpara, sepse ligji thotë që komisioni formohet gjashtë muaj përpara.

Megjithatë, ne jemi para një procesi që nuk guxon të udhëhiqet pa një komision të votuar në Kuvend dhe unë them që Kuvendi duhet ta votojë, por ne kërkojmë shpjegime. Ju lutem, ministër i resorit, shpjego!

KRYETARI: Urdhëro, ministër! Nëse s'i ke emrat ti, ne i kemi emrat.

MINISTRI MAHIR YAGCILLAR: Edhe një herë, faleminderit! Ndoshta ka qenë edhe një gabim teknik, sepse dokumentacioni nuk është përcjellë edhe te unë, unë mendova që komisioni do të shpjegohet. Vërtet, ligji i regjistrimit të popullsisë është aprovuar në mandatin e kaluar, por në muajin nëntor është nënshkruar edhe nga presidenti, kështu që ka hyrë në fuqi. Brenda 15 ditëve është dashur të aprovohet. Nga Qeveria ka shkuar

kërkesa, por në ndërkohë kanë ndodhur ndryshimet politike, kështu që edhe unë jam i mendimit që komisioni duhet të aprovohet sipas propozimit të Qeverisë, por ushtruesi i detyrës në ndërkohë zoti Nait Vrenezi ka dhënë dorëheqje, kështu që tash është momentalisht ushtrues i detyrës zoti Ibrahim Shabani. Kështu që emrat e komisionit mund të lexohen, unë para meje nuk kam momentalisht emrat. Momentalisht nuk i kam, sepse është në dokumentacionin e komisionit dhe të deputetëve.

KRYETARI: Faleminderit! Unë i lexoj emrat! Mos ta ndërlikojmë këtë, unë po i lexoj emrat që i kanë deputetët dhe realisht komisioni raportin nuk e ka dhënë mirë:

- Rifat Blaku, vjen nga Zyra e kryeministrit,
- Naim Fetahu, nga Ministria e Administratës Publike,
- Sanije Himaj, Ministria për Ekonomi dhe Financa,
- Haki Xhaferi, Ministria e Bujqësisë,
- Besnik Osmani, Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal,
- Shkumbin Kastrati, Ministria e Punëve të Brendshme,
- Fitim Gllareva, Ministria e Punëve të Jashtme,
- Murat Meha, Agjencioni Kadastral i Kosovës,
- Gazmend Çitaku, Ministria e Drejtësisë,
- Isa Ukella, Ministria e Komunitetit dhe Kthim,
- Naim Vrenezi, zëvendësohet me emrin që e tha kryetari i Komisionit, do të thotë kryeshefi i Entit të Statistikave të Kosovës,
- Gjon Aleksandar, Zyra Civile Ndërkombëtare,
- Karin Mars Moler, Komisioni Evropian,
- Nebojsa Angjellković, komuniteti serb,
- Fikrim Danka, komunitetet tjera,
- Mark Krasniqi, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, dhe
- Burim Ejupi, Shoqëria Civile.

Këta janë emrat e komisionit, për të cilin ne duhet të votojmë. Urdhëro, fjalën e ka deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Tash po mungon vetëm përgjigja a ka të drejtë deputeti të jetë aty? Po ju lus! Fikrim, mirë de, unë kryetarin po e pyes. A ka të drejtë ky këtu, edhe votohet për komision, edhe është deputet. Veç të sqarohet, a ka apo s'ka të drejtë, ne s'po kërkojmë diçka tjetër, të sqarohet edhe kjo çështje. Ndoshta ka qenë i propozuar më herët, sigurisht s'ka qenë deputet në atë kohë. Faleminderit!

KRYETARI: Kur është propozuar, s'ka qenë deputet, por është çështja nga komuniteti dikush duhet të jetë. Pasi e kemi vërtet çështjen e ngutshme, unë i kisha votuar.

Shkojmë në procedurën e votimit. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë komisionin. Votojmë tash! Prezentë janë 104 deputetë.

Me 62 vota “për”, 24 “kundër”, 15 abstenime, Kuvendi miratoi ose emëroi Komisionin Qendror për Regjistrimin e Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave, sipas propozimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe rekomandimit të komisionit funksional.

Mandati i Komisionit Qendror për Regjistrimin e Popullsisë përfundon me 31 dhjetor 2011.

Dhe, me këtë e mbylлим seancën e sotme. Mirupafshim në seancën e radhës!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve